Ekskluzivisht për portalin www.pashtriku.org

DILAVER GOXHAI
(SHPËTIM GOLEMI)

UÇK-ja dhe KADAREJA

(REFLEKSIONE)

NË VEND TË NJË POLEMIKE

PRISHTINË
2004

Dilaver Goxhai
(*Shpëtim Golemi*)
UÇK - ja dhe KADAREJA

Redaktor dhe korrektor letrar
Apostol Duka

Copyright©: Autori
Ndalohet çdo riprodhim i plotë a i pjesëshëm pa lejen me shkrim të autorit
Botues: SH.B. “Labova”

Tel. & fax: ++ 3554231535
Mobil: ++ 355682195744
Mobil: ++ 37744130701
E-mail: dilaverg@hotmail.com

DILAVER GOXHAI
(*SHPETIM GOLEMI*)

UÇK - ja dhe KADAREJA

Refleksione

Shtëpia Botuese “Labova” Tiranë, 2004

Shtypshkronja “Shkrola” - Prishtinë

“Atje ku mbahet një ushtri e madhe, çmimet janë të larta, sepse të gjithë shpresojnë të arrijnë fitime të jashtëzakonshme dhe pasuria e popullit shterron. Kur pasuria shterron, populli do të mërzitet.”

SUN XU

Homeri i letrave ushtarake

PARATHËNIE

Ngjarjet e Marsit 2004 në Kosovë me të drejtë ngjallën diskutime e vlerësime të shumta. Natyrshëm edhe të kundërta. Pavarësisht motiveve që shtynë, në opinionin ndërkombëtar u ngrit një mjegullnajë për to, duke fajësuar, gati tërësisht, faktorin shqiptar. Në këtë kurth, me dashje apo pa dashje, ranë edhe shumë personalitete shqiptare e madje forca të ndryshme politike e deri figura të shquara publike e njerëz të letrave. Dhe në qëndër të goditjes e të rivlerësimeve çuditërisht mbetën rrugët e zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare dhe UÇK-ja, e cila faktikisht nuk ekziston më si strukturë. Që individë, faktorë apo edhe segmente të forcave të caktuara shqiptare mund të kenë marrë pjesë apo edhe të kenë motivuar ngjarjet e Marsit 2004 dhe të kenë përgjegjësi për to, ndoshta nuk mund të përjashtohet. Por, për ne shqiptarët, nuk mund të përjashtohet edhe ajo se, nxitja e deri futja e atyre demostrimeve në rrugën e dhunës, të shkatërrimit e të djegieve mund të ketë ardhur edhe nga faktorë jashtëshqiptarë, për t'i përdorur si argument para faktorit ndërkombëtar për frenimin e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së Kosovës.

Për autorin e librit, revolta shfaqi vlerat e veta demokratike në ditën e parë të saj, më 17 Mars. Por në mëngjezin e ditës së dytë, sikurse tërheq vëmëndjen D. Goxhai te libri *UÇK-ja dhe Kadareja*, kur në të ndërhynë mësheftas faktorë të jashtëm, ato përfshinë edhe djegie e shkatërrime, deri edhe të kulteve fetare sërbe, aq shumë të përfolura, kulte që nga shqiptarët nuk u ngacmuan as në kohën e luftës kur kërkush nuk mund t'ua pengonte duart shqiptarëve. Gjithsesi të vërtetën do ta tregojë koha. Por, ajo që mund të thuhet sot, e që autori Dilaver Goxhai ngulmon fuqishëm në librin e tij analitik e debatues, shkakun e

shpërthimit të revoltës, ai nuk e gjen te forca apo organizatorë të ndryshëm, por kryesisht te një varg politikash të shtrëmbëra të faktorit të brendëshëm e të jashtëm në Kosovë, te varfëria në kulm e papunësia në përmasa të papara e në rritje, duke filluar që nga mbarimi i luftës.

Deklarata të shumta të të huajve dhe të vet shqiptarëve në analizë të këtyre ngjarjeve, vunë në pikëpyetje e deri në mohim shumë vlera të popullit e të kombit tonë, veçanërisht të popullit shqiptar në Kosovë. Madje, ne shqiptarët, sikurse e vë në dukje autori, për të qënë sa më bindës e servilë ndaj „çlirimtarëve“ europianë, kaluam edhe në mohime e kundërshtime të vetvetes, të vlerësimeve, përfundimeve e qëndrimeve tona në çështjen kombëtare të shprehura a shkruara jo shumë kohë më parë, pa folur për UÇK-në, e cila anatemohet për gjithëçka. Pikërisht këto e të tjera akrobaci politike të politikanëve a personaliteteve publike shqiptare, të përmasave të mëdha kombëtare, e kanë shtyrë Dilaver Goxhain që të futet në replikë me shkrimtarin e shquar Ismail Kadare, i cili gjithashtu, sikurse vë në dukje disa herë autori, ka revizionuar vetveten.

Deklarimet e fundit të Kadaresë për UÇK-në dhe çështjen kombëtare, i kanë shërbyer dhe i shërbejnë autorit D.Goxhai të mbajë një qëndrim të prerë jo thjesht ndaj pikëpamjeve vetiake të një njeriu, qoftë ky edhe shkrimtari i madh I. Kadare, por ndaj një dukurie të tërë politike te ne që, për përfitime konjiukturale e servilizëm ndaj faktorit ndërkombëtar, ka fituar e po fiton gjithnjë e më tepër terren në kurriz të zgjidhjes së çështjes sonë kombëtare.

Entusiazmin që ngjalli Lufta Çlirimtare dhe UÇK – ja si dhe mbështetja e fuqishme që morëm në ato çaste nga faktori ndërkombëtar për çuarjen përpara, deri në zgjidhje të problemit tonë kompleks kombëtar, tashmë e ka zevendësuar politika shqiptare pa shtyllë kurrizore, pa busull orientuese kombëtare. Madje, sipas autorit, shkohet edhe më tej. Në ditët e sotme ne nuk marrim as kurajon të përmendim edhe ato

vlera kombëtare që na i kanë vënë në dukje dikur vet të huajt e madje personalitete në zë të përmasave botërore, protagonistë të kohës, edhe për rolin e UÇK - së në çlirimin e Kosovës apo në zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare, sikur ato të jenë të mallkuara.

Një analist, më shumë se sa dukuria e jashtme e fenomeneve, duhet ta tërheq brendia, faktorët që i kushtëzojnë ato, forcat që i vënë në lëvizje. Kështu duhet të ndodhë edhe me vlerësimin e ngjarjeve të Marsit 2004. Për autorin ato nuk kishin organizator. Shpërthimi i vrullshëm i tyre ishte rjedhojë e akumulimveve të zjgidhjeve të gabuara politike, ekonomike e kombëtare në Kosovë si nga qeveritarët shqiptarë ashtu edhe ata të UNMIKU-t. Gjendja ekonomike në Kosovë është përkeqësuar më tej në periudhën e mbas luftës, papunësia ka arritur në përqindje tepër të larta. Populli ka rënë në hall, ai nuk ka se ku të trokasë sepse pushteti burokratik dhe i korruptuar, nga njëra anë, por edhe i „tredhur“ nga faktori ndërkombëtar, nga ana tjetër, me kufizimin në të drejta, nuk zgjidh asnjë problem. Populli me shtyrjen e tejzgjatur e me formulime e riformulime të pafundme, pa kokë e këmbë, ende nuk po gjen shpresë se çështja e pavarësisë së Kosovës do të zgjidhet, (ta lëmë mënjanë për një moment çështjen e bashkimit kombëtar). Populli i Kosovës vëren se shumë fshatra shqiptare pranë vijës kufitare me Serbinë apo ato të Bujanovcit, Preshevës e Medvegjës po boshatisen, ashtu sikurse kërkonte e luftonte edhe Millosheviçi dhe kërkush nuk reagon. Presidenti Rugova, tashmë edhe i mbështetur më fuqishëm thuajse nga gjithë politikanët shqiptarë të të dy anëve, duke e ndjerë veten më të sigurtë, nëpërkëkëmb si pa të keq, me vendime a dekrete vetiake, sikur të ishin pronë private, simbolet kombëtare (sajon flamur e himn kombëtar, që i shërbejnë përçarjes e jo integrimit mbarëshqipar). Ish - luftëtarët e UÇK-së, tashmë të çarmatosur e papërkrahje, e ndjejnë veten jo vetëm të

braktisur por edhe të dsikriminuar, teksa akuzohen si „ekstremistë“, „enveristë“, „elementë turbullues“, etj., edhe nga ata që zunë karriket politike e qeveritare në sajë të luftës së tyre. Më keq akoma. Ata ndjehen të zbuluar, madje të ndëshkuar rëndë nëpër proceset e pambarimta gjyqësore ende nga ligjet e vendosura nga Millosheviçi në vitin 1989, kur ai i hoqi autonominë Kosovës. Popullin dhe ish - luftëtarët e lirisë i revolton edhe fakti se disa nga ish udhëheqësit politkë e ushtarakë të UÇK-së, pasi morën kolltuqet politike e qeveritare, janë majmur shumë, kanë vënë pasuri të tundëshme e të patundëshme, ndërkohë që kur u vunë në ato funksione ishin me xhepe të grisur. Autori përmend një varg shkaqesh të tjera që popullin e shtynë në pakënaqësi dhe nga pakënaqësia në revoltë.

Për autorin e librit, ish luftëtarin e UÇK-së dhe ish zëvendësshefin e Shtabit të Përgjithshëm, Dilaver Goxhai, apo sikurse thirrej në luftë, Shpëtim Golemi, UÇK-ja dhe roli i saj në Lufën Çlirimtare janë të shënjta jo vetëm si simbol por veçanërisht si produkt në çështjen kombëtare në tërësi dhe atë kosovare në veçanti. Ndaj edhe ai ndalet gjatë në replikën e tij për lindjen, zhvillimin por edhe për atë çka dha ky formacion luftarak për Kosovën dhe çështjen tonë kombëtare. Nga ky kënd ai nuk pajtohet me „rivlerësimet“ që po i bëjnë rolit të saj, veçanërisht nën dritën e ngjarjeve të Marsit 2004. Këtej u kalua deri në mohim të rolit të saj, sikur UÇK - ja të ishte parashkruar se do të gjykohej e vlerësohej jo nga ajo që bëri e pruri me luftë, por nga ngjarje që do të ridhnin më vonë, sikurse janë ato të Marsit 2004.

Një ndër këta që rishikoi qëndrimin e vlerësimet e tij është edhe shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare. Autori i librit, një simpatizues, lexues e mbrojtës i hershëm e i sotëm në rrethet shoqërore i veprës letrare të Kadaresë, ndjehet i zhgënjyer nga një deklaratë e fundit e tij, ku Kadare, duke folur për çlirimin e Kososvës, gjithçka ja atribuon Europës, pa përmendur fare UÇK - në e madje edhe SHBA. Sipas autorit,

Kadareja ka ndryshuar shumë në mendim në çështjen kombëtare, që shtroi për zgjidhje lufta çlirimtare e fundshekullit të kaluar. Nga bashkim të trojeve shqiptare me shtetin amë, fillimisht, tashmë Kadareja ka kaluar e ka mbetur vetëm në caqet e pavarësisë së Kosovës dhe të një farë autonomie të pjesëve të tjera në përbërje të ish republikave jugosllave. Thënë ndryshe problemi është ngushtuar në caqet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut brenda shteteve ku shtrihen troje dhe popullsi shqiptare, duke çuar dëm gjithë ato sakrifica luftarake e gjak të derdhur thuajse nga e gjithë popullsia shqiptare në republikat e ish Jugosllavisë. Dhe, për D. Goxhain ky qëndrim nuk është një lapsus i thjeshtë, që ndoshta nuk do t'ia vlente të ndaleshe. Por ai, sikurse evidencohet në libër, është vlerësim i mbrujtur, i pjekur rast pas rasti, deri në ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë, që i vënë kapakun.

Nëpërmjet replikës me mjeshtrin e madh të penës shqiptare, me mënyrën se si ka ndërtuar strukturën e librit, autori kërkon të bëjë shjtellimin e rolit të UÇK-së në Luftën Çlirimtare e me rjedha të shkallës kombëtare të fundshekullit të kaluar, rol që kërkohet të tjetërsohet sot. Dhe këtë, autori e bën jo thjesht duke u nisur nga vlerësime a pozicionime vetjake edhe si ish luftëtar e madje anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, çka tek e fundit është tepër e pranueshme. Për të qenë më bindës, e prej këtej sa më pranë së vërtetës historike për këtë rol, autori iu drejtohet edhe deklarimeve të analistëve të ndryshëm, të protagonistëve të asaj lufte të madhe çlirimtare, luftëtarë e drejtues të UÇK-së, drejtues politikë e ushtarakë të forcave aleate në operacion e deri komandues të forcave kundërshtare në fushën e luftës. Madje këta të fundit UÇK-në e vlerësojnë si forcën e vetme tokësore në luftën kundër tyre, ndërsa aviacionin aleat si forcë të fuqishme që vepron nga ajëri.

Edhe nga këndshikimi i autorit, duke vlerësuar rolin e UÇK-së, kërkush nuk mund të mohojë rolin vendimtar të faktorit ndërkombëtar në Luftën e Kosovës. Por ato, UÇK-ja dhe forca ajrore e NATO-s, krahas faktorit politik të jashtëm, për autorin, përbëjnë dy anë të të njëjtit faktor ushtarak antimillosheviçian. Secili kishte rolin dhe funksionin e vet, të cilin e plotësuan sipas mënyrës, mundësive, forcave e mjeteve të veta në teatrin e caktuar luftarak. Të dyja këto forca ushtarake, thekson autori, ishin në unitet jo vetëm të qëllimit të përbashkët politik por edhe në bashkëveprimin e bashkërendimin e veprimeve luftarake aero-tokësore në vijat e frontit tokësor. Por, për autorin, kjo nuk do të thotë se, duke vlërsuar rolin e faktorit politik Perëndimor dhe të atij ushtarak të NATO-s, të mohohet apo edhe të nënvlerësohet roli i UÇK-së. Për autorin e librit, kjo e fundit, historinë e saj në këtë kuadër e në krah të aleatëve euroatlantikas, e shkroi me vepra, e vulosi me gjakun e bijve dhe të bijave më të mira të Kosovës, në çastet e vështira të luftës. Ajo ka hyrë në fondin e artë të historisë së kombit shqiptar dhe e tillë do të mbetet.

Në kuadrin e kësaj lufte, sikurse vë në dukje me të drejtë autori, *UÇK*-ja ka meritën e padiskutueshme të nismës fillestare luftarake kundër forcës ushtarake pushtuese serbe, nismë që vuri në lëvizje politike e më pas edhe ushtarake, faktorin ndërkombëtar e veçanërisht strukturat politiko-ushtarake euroatlantike.

Edhe ne shqiptarët, në analizën e dukurive, nuk kemi përse ta mbajmë kujtesën historike të shkurtuar në kohë. Faktori ndërkombëtar, posaçërisht Europa, këtu ka qënë për një shekull të tërë. Madje kjo e fundit ishte edhe arkitektja e padrejtësisë së madhe të coptimit të trojeve shqiptare që kurrë nuk e vrau ndërgjegja, përveç ndonjë justifikimi të akteve të saj. Ajo, me dëshirën e saj nuk vuri asnjëherë në lëvizje asnjë mekanizëm për të bërë qoftë edhe një ndreqje të vogël. Autori, edhe pse është kritik ndaj „çlirimtarit“ europian, nuk e shtron problemin nga ky kënd për të ngritur një stuhi antieuropiane.

Jo. Thjesht, mbështetur në të vërtetat historike të largëta e të afërta, kërkon të shkojë sa më pranë së vërtetës të shtruar për diskutim. Dhe kjo e vërtetë historike autorit i duhet për të analizuar e argumentuar rolin e vërtetë që ka luajtur edhe UÇK-ja, tashmë pjesë përbërëse, e pa ndarë dhe tepër e rëndësishme e historisë së afërme të çështjes sonë kombëtare në tërësi e posaçërisht të asaj kosovare në veçanti.

Dihen përpjekjet e vijueshme të popullit shqiptar në Kosovë për të drejtat e mohuara e deri në pavarësi, nëpërmjet demostratave aktive e deri në përgjakje me makinën ushtarake pushtuese serbe. Dihet gjithashtu edhe i ashtuquajturi „dypushtet“ i kukullës Rugova dhe diktatorit Millosheviç në Kosovë në vitet 90-të. Ky „dypushtet“, një iluzion i dëmshëm për shqiptarët, pruri gati shuarjen e qëndresës aktive edhe me mjete paqësore të popullit kosovar. Në vetvete, nga njëra anë, ai i bënte shërbimin më të çmuar Millosheviçit dhe, nga ana tjetër, çështja jonë kombëtare arriti në një pikë ngrirjeje. Tashmë në Kosovë realisht nuk kishte më faktor shqiptar por vetëm të huaj, të atij pushtues dhe të faktorit pasiv Perëndimor. Ishte e dhimbshme kur dëgjoje se Kosvën dhe viset e tjera shqiptare nën ish Jugosllavi, po e linin bijt e bijat e saj duke mërguar në Perëndim. Satrapi Millosheviç, trojet shqiptare thuajse i kishte pjesët më të qeta të Jugosllavisë së mbetur gjatë „dypushtetit“ të Rugovës. Ky ishte edhe argumenti që Millosheviçi shtronte e mbronte para ndërkombëtarëve kur vinte fjala për ankesa të ndryshme në kufijtë e të drejtave të njeriut (por jo të çështjes kombëtare) që dërgoheshin a dëgjoheshin deri te organizma të caktuara ndërkombëtare. Dhe vetëm brenda këtyre caqeve e nën këto konceptime mbetej çështja shqiptare nën Jugosllvinë e mbetur.

Nga kjo pikëngrirje, për autorin, nuk mund të shkrihej ujët, që më pas të ridhte në shtratin që i duhej çështjes kombëtare, bash prej atyre që e kishin ngrirë atë. Kërkohej një forcë e re, protagonistë të rinj, tërësisht të pampleksuar e pa

komplekse në ato shtjellime të viteve të fundit. Dhe në momente udhëkryqi të çështjes sonë kombëtare nuk kanë munguar kurrë personalitete vizionare apo edhe forca lëvizëse. E tillë për autorin, në këtë udhëkryq të çështjes sonë kombëtare në fundshekullin e XX-të u shfaq UÇK-ja. Fillimisht embrionale, si çdo krijesë e re, për shumëkënd jo bindëse për nga forca e madhësia, por tepër motivuese për nga ideali dhe misioni që merrte mbi vete. Dhe këtu ajo gjeti, gradualisht në rritje, mbështetjen popullore por edhe mbështetjen e korifejve bashkëkohës të çështjes kombëtare, si shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare, Akademik Rexhep Qosja apo edhe mjaft të tjerë, sikurse u ndesh edhe në përgojime e deri kundërvënie edhe nga faktori politik shqiptar, e natyrshëm, edhe ai ndërkombëtar.

Për autorin, Europa, më shumë se sa për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare, ishte për ruajtien e statukosë së gjëndjes në Ballkan dhe posaçërisht në ish republikat jugosllave. Për më tepër ajo i trembej faktorit shqiptar me një shtrirje në 5 republika ballkanike dhe me një mundësi të dukshme për të destabilizuar zhvillimet në Ballkan, në kërkim e mbrojtje të të drejtave të tyre njerëzore e kombëtare që përcaktoheshin edhe në akte ndërkombëtare, që vet Europa i kishte formuluar, miratuar e mbrojtur si të shenjta. Ndaj kjo e fundit kërkonte fillimisht ta injoronte apo edhe kundërshtonte dhe më pas, kur ky faktor, kryesisht nëpërmjet veprimit luftarak të UÇK-së, u bë faktor i rëndësishëm, kërkonte ta vinte e mbante atë nën kontroll. Dhe pikërisht, kur UÇK-ja u bë një forcë reale luftarake, që nuk mund të injorohej më e aq më tepër të kundërshtohej për vet misionin fisnik që përcillte por edhe për forcën gjithnjë në rritje, ajo u pranua dhe u njoh edhe nga faktori politik ndërkombëtar. Pas kësaj vrapoi edhe ai shqiptar. Ky i fundit, në tërësi e me pak përjashtime, më shumë se sa për qëllime atdhetare, u hodh në mbështetje të UÇK - së më tepër për përfitime të çastit në luftën e vet të brendëshme poltike.

Për autorin ishte forca dhe veprimi i armatosur i UÇK - së ajo që vunë në lëvizje makinën ushtarake millosheviçiane, duke bërë shkrumb e hi „qetësinë“ që mbretëronte në Kosovë apo edhe „gandizmin paqësor pasiv“ rugovian. Makina ushtarake sërbe, në kundërpërgjigje ndaj UÇK-së, duke ndërmarrë veprime të shumta luftarake të shkallës taktike e më pas edhe të shkallës operativo-strategjike, në pamundësi të asgjësimit të forcës së gjallë ushtarake të UÇK - së, apo të veçimit e të shkëputjes së saj nga populli, kaloi në masakra të papara në Kosovë. Në këto kushte strukturat përkatëse politike e ushtarake euroatlantike, me në krye SHBA - të, iu përgjigjën gjakatarit Millosheviç me forcën e armëve, ashtu sikurse vet ai vepronte në Kosovë. Në këtë mënyrë, në frontin e luftës, në Kosovë, vepronin në gjithë hapsirën kosovare paralel, në funksion të qëllimit të njëjtë e në mirëkuptim, dy forca ushtarake tashmë të ndërthurura, secila në hapsira e kushte të ndryshme, që pranonin e nuk mohonin njera tjetrën: në tokë, rendimet luftarake të UÇK-së dhe, nga ajëri, formacionet gjigande ajërore të NATO-s, të cilat, me goditjet e tyre të shumta nga ajëri, vepronin kryesisht jashtë Kosovës.

Autori i librit nuk merr përsipër të vërë në peshore se kush luajti rolin parësor. Ai thjesht argumenton me fakte e dekumente se, ishte UÇK-ja, lufta e saj e armatosur, edhe pse jo e pabarabartë për nga forca, që vuri në lëvizje formacionet ushtarake Perëndimore. Po nuk qau fëmija, thotë populli, nuk i jep gji nëna. NATO nuk mund të ndërhynte në se ne vet nuk do të bëheshim protagonistë e faktor lufte në fushën e luftës, në se nuk do të gjakoseshim me ushtrinë serbe në fushbeteja. Sekush në luftë, që nga ushtari e deri te gjenerali, nga shteti i vogël dhe deri te ai më i madhi, apo kualicion shtetesh, kanë meritat apo vlerat e tyre, pa i hyrë tjetrit në pjesë apo në lavdinë e fitores. Në se do të hidhnim vështrimin pak më tej në historinë e luftrave, do të shohim se edhe në Luftën e Dytë Botërore, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, si dhe e

shumë vendeve të tjera ballkanike apo edhe europiane, edhe pse nuk ishin faktorë përcaktues në mundjen e fashizmit, përsëri ato kanë merita të cilat kërkush, edhe vet aleatëve të mëdhenj (SHBA, ish BRSS dhe Britania e Madhe) as që u ka shkuar ndër mend që të mohojnë luftën e ndihmesën e përbashkët kundër fashizmit, edhe tani pas 60 vitesh. I tillë mbetet edhe roli i UÇK-së në historinë tonë kombëtare. Roli dhe ndikimi i UÇK-së del nga caqet e një lufte të armatosur dhe vetëm për Kosovën. Ajo vuri në lëvizje, në radhë të parë, mendimin e njerëzve, përfshi atdhetarë si dhe të klasës politike shqiptare, edhe pse kjo e fundit notonte ende në ujrat e veprimeve pasive apo edhe aktive pacifiste. Është fakt se, nën shëmbullin e luftës së UÇK-së dhe të rezultateve që ajo solli, çështja kombëtare u vu në lëvizje kudo. Formacionet ushtarake dhe veprimet e tyre luftarake shpërthyen zinxhir thuajse në gjithë trojet shqiptare, si në ato nën Kosovën Lindore (Bujanovc, Preshevë, Medvegjë), në Maqedoni, por edhe në Mal të Zi. Me forcën e armëve, edhe në këtë fund e fillim shekulli, shqiptarët, mu në mes të Europës, fituan dhe po fitojnë të drejtat e tyre të mohuara për një shekull. Madje, ishte ndikim e rjedhojë e kësaj lufte, thuajse në gjithë trojet shqiptare, që të ringrihet më me forcë edhe çështja çame nga politika shqiptare. Për këtë ne duhet t'i jemi përjetë mirënjohës UÇK - së.

Kolonel në pension XHEMIL ÇELA

Ish Punonjës Shkencor dhe Shef i Katedrës së Zbulimit dhe Studimit të Ushtrive të Huaja në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ish Antar i Këshillit Shkencor të Ushtrisë për Strategjinë dhe Taktikën.

EDHE TI KADARE

E MOHOVE UÇK - në!?...

(Refleksione)

NË VEND TË NJË POLEMIKE

Më 17 dhe 18 Mars 2004, në Kosovë ndodhën ato që ndodhën. Populli shqiptar rrebeloi i gjithi kundër gjithçkaje. U tha se shkak apo shkas u bë hedhja nga serbët në lumin Ibër e disa fëmijëve shqiptarë, të cilët u mbytën që të gjithë dhe serbëve nuk u hyri as edhe një gjemb në këmbë. Për diplomatët e huaj në Kosovë, për udhëheqësit ndërkombëtarë dhe vendorë të Kosovës, si dhe për ata në Europë e më tej, ato ngjarje u cilësuan të papritura, monstruoze e primitive. Ndërkohë, me shumicën e demonstruesve shqiptarë u bashkuan të gjitha shtresat dhe moshat, edhe studentët. Pothuajse të gjithë. Disa intelektualë "kokëfortë" kosovarë dhe shumë gazetarë, i dolën në mbrojtje popullit.

SI I VLERESUAN DISA POLITIKANË NGJARJET E MARSIT

Z. Holker, përfaqësuesi special i sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, deklaroi: “A po e lini të ardhmen e Kosovës në duart e ekstremistëve?.. iu lus, thyejeni murin e heshtjes dhe ejani e bashkëpunoni me policinë dhe UNMIK-un”. I pyetur përse fëmijët shqiptarë u detyruan me forcë që të hidheshin në ujin e ftohtë të lumit Ibër, ai tha: “Ta them të vërtetën, këtë informatë nuk e kam marrë ende... Sapo ta marr informacionin për këtë rast, do ta publikoj...”(?!) Tërë Kosova ishte informuar, përveç zotit Holker! Ç’padrejtësi!...

Z. Rugova deklaroi: “Situata e tanishme në Mitrovicë nuk është dobësi e liderëve,... dhe nuk e shoh si shumë produktive tash që të akuzohen liderët dhe të tjerët.”

Të nesërmen, erdhi urgjentisht nga Nju Yorku kryetari i Partisë Demokratike, zoti Hashim Thaçi, i cili deklaroi: “Të gjithë kemi investuar që në Kosovë të ketë përparim dhe ky përparim po përshëndetet nga Uashingtoni dhe Brukseli.”

Përgjigjia e z. N. Dacit ishte si dikur në monizëm, kur thuhej afërsisht: “Atë e di Partia, ju, rajaja, punoni.” Ja se si u shpreh ai: “Populli t’i kthehet jetës së vet, ndërsa ne të ushtrojmë përgjegjësitë tona.”

Ministri J. Krasniqi, i cili zevendësonte kryetarin e partisë së tij, refuzoi ta nënshkruante Deklaratën e UNMIK-ut, pasi e ndiente se populli kishte të drejtë. Ai u shpreh: “Për ne, revoltat dhe kërkesat e qytetarëve shqiptarë janë të ligjshme.” Mirpo edhe ai u tërhoq kur i erdhi shefi nga SHBA. Pas disa ditësh, ai doli në televizor dhe tha: “Qeveria e

Kosovës është më e mira në Ballkan.” Dallëndyshe, ktheje ndryshe…

AAK-ja, deklaroi se shprehte mospajtim me UNMIK-un, i cili nuk ishte treguar i gatshëm që ta integronte Mitrovicën me Kosovën. Me këtë deklaratë dykuptimshe, udhëheqësit e saj dëshironin të thoshnin se qeveria, ku ata bëjnë pjesë, nuk ka asnjë mangësi. Thuaj që s’janë të zgjuar!

Kryeministri Rexhepi u shpreh: “Pavarësisht se kemi arsye për emocione, shpreh mëllefin për mosefikasitetin e mëparshëm.”

Ja dhe një deklaratë disi më ndryshe nga të tjerat: “Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, kërkon nga UNMIK-u dhe KFOR-i që shqiptarët të trajtohen në mënyrë të barabartë.”

Ndërsa kryetari i LPK-së deklaroi: “LPK kërkon të thirret në interpelancë të jashtëzakonshme kryeministri Rexhepi dhe të japë dorëheqjen.”

Qeveria e koalicionit gjithëpërfshirës (pasi nuk ka opozitë), u bë grusht rreth kryetarëve të partive sokolesha. Thonë se kryetari për Ardhmërinë e Kosovës “theu këmbën”, ndaj nuk doli në publik për gati dy javë, nga që i ishin shfaqur në ëndërr tre vëllezërit e tij (dy dëshmorët dhe ai i pushkatuari politik). Të tjerët, mbajtën fjalime. Fajin, si gjithmonë, e kishte Ai, Populli. Popullin e akuzuan për gjithçka.

Havier Solana e quajti popullin shqiptar një popull terrorist. Pak a shumë, kështu foli edhe zoti Shifer.

Kjo tregon se ende vazhdohet të flitet me cinizëm për shqiptarët, gjë që e pohoni edhe Juve, zoti Kadare, kur i shkruani kështu Ukshin Hotit në librin “*Bisedë përmes hekurash”*: “Ekziston tashmë një traditë jo e vogël e cinizmit europian kundër Shqipërisë. Është bërë zakon që të bëhen kundër saj deklarata të tilla pa drojën e ndëshkimit moral…”

Por, sikundër do ta shohim më poshtë në rastin e ngarjeve të marsit, edhe juve, zoti Kadare, fatkeqësisht

shfaqeni si një nga cinikët më tipikë europianë dhe bini në të njëjtat pozita me ato të Holkerit, Solanës, Shiferit dhe shumë të tjerëve, që nxitojnë të hiqen mënjanë nga problemet e mprehta të Kosovës dhe të lajnë duart si Pilati…

Pas atyre ngjarjeve, Thaçi dhe Daci dolën në terren, për "takime gju më gju me popullin". Disa gazeta vendase (me sa duket gazetarë "rrebelë"), i krahasuan ato takime dhe mallkime me veprimet e politikanëve të dikurshëm shqiptarë, pas ngjarjeve të mars-prillit 1981, në Kosovë. Kur ktheheshin në mbrëmje në Prishtinë, ata i raportonin kryetarit të (mos)shtetit të Kosovës, i cili, pasi i falenderonte "nga thellësia e zemrës", iu shërbente nga një gotë me uiski. Presidenti i atëhershëm pinte uiski, që të harronte "marrëzitë" e popullit të tij, mirë po qehajallarët e tij, pinin me bindje e modesti vetëm çaj, që të ishin të freskët për të nesërmen... Ç'ngjashmëri!

Siç e shihni, zoti Kadare, politikanët vendorë të Kosovës mund t'i dallosh veçse përmes nivelit të servilosjes së tyre. Vetëm dy mbeten shqiptarë të "pakorigjueshëm":

I pari, është kryetari i LKÇK-së, i cili deklaroi: "Populli ka të drejtë! Qeveria dhe UNMIK-u kanë dështuar totalisht. Të japin dorëheqjen. Ç'presin më?!..."

I dyti, është Adem Demaçi, i cili, si gjithnjë "kundër rrymës", tha: "Zotërinj të institucioneve formale të Kosovës, zotërinj të UNMIK-ut, zotërinj të regjimit të Beogradit, për erupcionin e pakontrolluar të mllefit e dëshpërimit qytetar të Kosovës, ju jeni fajtorë dhe askush tjetër. Mos u mundoni t'i mjegulloni e t'i fshihni gjynahet tuaja..."

Të gjitha këto, u pasqyruan me vërtetësi dhe guxim nga shumica e gazetarëve të mediave të Prishtinës.

“MJEKIMI” I GJENDJES

Kal i egërsuar
S’le pas tym, po re,
Qetësi pas teje,
Ajo mbet atje.
Mbi gropat e udhës
Si mbi plag’ trokon.
Rrafshira të zymta,
Muzg pranvere, vonë.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia:“Ikja e Moisi Golemit”.)

Filluan arrestimet njëkohësisht në të gjitha qytetet kryesore të Kosovës. Shumica e të arrestuarve ishin të papunë. Me sa duket, menduan edhe për ta, gjetën mënyrën për t’i ushqyer.

Filluan analizat e autorëve të brendshëm e të jashtëm. Në ato analiza, u shfaqën dy linja: njera palë e justifikonte popullin, ndërsa tjetra e mallkonte atë. Nisën të botoheshin edhe intervistat e politikanëve europianë dhe politikanëve vendorë. Me përjashtim të udhëheqësit të LKÇK-së dhe Adem Demaçit, të gjithë “të intervistuarit” ishin pothuajse në të njëjtën linjë: Mallkim për popullin shqiptar në Kosovë!... Në këtë linjë ishin edhe deklaratat e pothuajse të gjithë politikanëve të Tiranës. Intelektualin e shquar dhe akademikun me autoritet mbarëshqiptar, zotin Rexhep Qose, filluan ta sulmonin, sepse, si përherë, i doli në mbrojtje popullit. Çfarë nuk i thanë, nuk harruan ta shanin edhe nga nëna!... Juve nuk e shatë, natyrisht, por kjo nuk mjafton. Sepse mund ta thoshnit një fjalë të mirë për të, ose të paktën t’i kërkonit një këshillë a një mendim para se të shpreheshit për problemet delikate të ngjarjeve të marsit 2004.

Të gjithë prisnin natyrshëm reagimin e shkrimtarit të madh shqiptar me reputacion ndërkombëtar, reagimin tuaj, zoti Ismail Kadare. Më falni, jo të gjithë, por ajo pjesa që quhet popull.

Dikur, kur populli shqiptar në Kosovë digjej e piqej, ishit juve, zoti Kadare, që i dolët i vetëm në mbrojtje, (por, më vonë, sikur keni filluar t'i përtypni nëpër dhëmbë ato fjalë historike për të), ndaj dhe populli pyeste: "Me kë do të jetë Kadareja, me ne, apo me?..." Kjo ishte pyetja që i bënin njerëzit e thjeshtë njeri - tjetrit nëpër biseda. Madje edhe nëpër familjet shqiptare shtrohej kjo pyetje.

Dhe, ja! 1 Prill 2004, të gjitha gazetat e Kosovës botuan shkrimin tuaj, me titullin shpresëdhënës: "Riparimi i së keqes" , në të cilin juve analizonit ngjarjet e 17 dhe 18 Marsit të vitit 2004 në Kosovë. Nuk mbeti gazetë pa u shitur. Si asnjëherë. Populli i lutej Zotit, besonte dhe shpresonte se mbase Kadareja nuk do të anonte nga... pikpamjet e Solanës. Por frika se Kadareja do ta dënonte popullin shqiptar në Kosovë, sikundër bëri edhe me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, për fat të keq, u vërtetua.

Ndër të zhgënjyerit, isha edhe unë. Jo se kjo ka ndonjë rëndësi të veçantë për temën që po trajtojmë, jo se unë do të merrja ndonjëherë guximin të përballesha ose t'iu kritikoja në fushën e letrave, por, si një pjesëmarrës aktiv në ngjarjet e viteve të fundit në Kosovë dhe si intelektual e gjirokastrit, sinqerisht nuk dëshiroja që të ndodhte kështu. Dhe, kjo është e kuptueshme. Si shumë dashamirës të letërsisë, iu kam admiruar jo vetëm si shkrimtar të madh, por edhe si një shqiptar të mençur e atdhetar të zgjuar. Edhe sot krenohem me veprën tuaj dhe bie në gjunjë para saj. Ajo është krenari kombëtare. Por, me sa duket, unë nuk e kisha vënë re se edhe juve keni një nerv të keq, një lloj xanxe, që e shfaqni shumë rrallë e që bie ndesh me nervin e shqiptarëve idealistë, nerv që vihet re herë pas here edhe në veprën dhe jetën tuaj. Ndoshta për shkak të atij admirimi që kisha, kam e do të kem

ndaj veprës tuaj, nuk kam mundur ta vija re atë "nervin" e keq. Ai që të do, nuk t'i vë re të metat.

Me këtë "analizë", më zhgënjyet, zoti Kadare. Lus Zotin të jetë një lajthitje e rastit, një lapsus. Nuk e prisja nga ju që, *çlirimtarë të Kosovës,* të cilësonit vetëm shtetet e Europës Perëndimore, pjesëmarrëse në NATO gjatë vitit 1999 dhe, indirekt, të sulmonit UÇK-në. Ndoshta është thjesht një qorollisje e juaja. Ashtu qoftë!...

Ndoshta folët kështu, se nuk mund të bënit ndryshe, ndoshta vetë pozita juaj shoqërore dhe ndërkombëtare iu vuri në vështirësi, iu diktoi dhe iu detyroi të ishit në një zë e në një valë me Holkerin, Solanën e kompani. Shumëkush e kupton këtë pozicion delikat tuajin. Por unë jo, të më falni. Unë mendoj se kishte një rrugë tjetër, shumë më dinjitoze, për të mos rënë në këtë lloj detyrimi: mund të mos flisnit fare dhe kjo do të ishte më e ndershme. Ose mund të flisnit në përgjithësi, si shumë të tjerë, në mënyrë që askush të mos mendonte, me ose pa të drejtë, se Ismail Kadareja kërkon të fitojë kapital politik, shoqëror e moral edhe mbi fatkeqësinë e një populli...

Nuk iu besoja syve kur lexoja në atë "analizë" se ngjarjet e 17 dhe 18 Marsit 2004 ishin, sipas jush,"zëmërim i verbër, vizion dritshkurtër, nga dufi katundaresk, ky sorrogat i keq i patriotizmit." Vërtet mendoni kështu për popullin e Kosovës, zoti Kadare?...

VARFËRIA EKSTREME E SHQIPTARËVE DHE ZOTNILLËKU I SERBËVE

O ju korba, pse s'm'i nxorrët
Syt' e zez mua të gjorit?
Që dot' rrugën të mos gjeja,
Rrugë shkretën,
Se kish vdekur dhe nëneja,
Ishte tretur.

(I. Kadare. Vargje nga poezia: "Baladë nizamësh".)

Eh! Juve, zoti Kadare, jo vetëm që shpreheni më keq dhe jeni ku e ku më i zellshëm e më cinik se Solana për ato ngjarje, por këtë zëmërim të popullit, 85 për qind e të cilit shtë mbërthyer nga papunësia, varfëria dhe rruga pa krye, e konsideroni me një të rënë të lapsit, thjesht si një… "duf katundaresk". S'ka më keq për njeriun e madh të letrave, që është edhe sot ndër më të lexuarit e më të dashurit në Kosovë. Mos vallë iu ka pëlqyer ky cilësim vetëm si një figurë e gjetur letrare dhe keni "rendur" pas saj, duke harruar se ka raste kur fjala vret më shumë se plumbi?!... Për fat të keq, nuk e njihkeni Kosovën, zotëri.

A dëshironi të bindeni për këtë shkallë të lartë papunësie të Kosovës, zoti Kadare? Le t'i referohemi për këtë, raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, zotit Kofi Annan, raport llogaridhënës i mbajtur përpara Këshillit të Sigurimit, 1,5 muaj para ngjarjeve të marsit në Kosovë. Ai raport, që pasqyron punën e bërë nga UNMIK-u

gjatë vitit 2003, si dhe flet për gjendjen në Kosovë, është botuar edhe në gazetën "*Koha Ditore*" të Prishtinës, më 2 Shkurt 2004. Ja çfarë thotë z. Kofi Annan në paragrafin 37 të tij: "Papunësia (*në Kosovë. Shënimi im*.), mbetet ndërmjet 50 dhe 60 për qind…"

Sikundër e sheh, ai bën fjalë për 50 - 60 për qind të të gjithë popullsisë. Dhe, pak rreshta më poshtë, në raport thuhet se shkalla e papunësisë arrin në 85 për qind të të aftëve për punë: "Forca punëtore në Kosovë, momentalisht, qendron në rreth njëmilion, 15 përqind e të cilëve janë "zyrtarisht të punësuar" (të regjistruar si taksapagues)... Niveli i papunësisë nuk merr parasysh punësimet joformale në ekonominë e zezë, të cilat janë edhe ato të rastit dhe të përkohëshme... Niveli i projektuar i rritjes ekonomike vjetore në shifrën 4,5 për qind, është më i ulët se në vitet e kaluara."

Ndërsa në paragrafin 36 të atij raporti thuhet*:* "Kosova mbetet njëra nga ekonomitë më të varfëra në rajonin e varfër… 12 për qind e popullatës jeton në varfëri ekstreme dhe 80 për qind e fermave private janë ndërmjet 0,5 deri në 2 ha, një masë që mezi mjafton për të ushqyer tërë familjen…"

Iu thonë gjë këto fjalët e fundit, zoti Kadare? E merrni vesh që shqiptarët e Kosovës, në fund të vitit 2003 dhe në fillim të vitit 2004, janë më të varfër se sa kur dolën nga lufta?!... Vetëm e vetëm pse ata u ngritën kundër kësaj varfërie, duke refuzuar të trajtoheshin si kavie laboratorike, ju i quani "katundarë me vizion dritshkurtër"? E dini zotëri, se shumica e këtyre "katundarëve" që juve i fyeni si pa të keq, janë edhe më qytetarë se qytetarët, se ata e kanë parë botën me sy shumë kohë para jush dhe flasin secili nga dy, tri e më shumë gjuhë të huaja; e dini vallë se ata janë pjesa më e shëndetshme e Kosovës, zemra dhe palca e saj?... E dini se në bibliotekat e tyre librat tuaja zenë vendin e nderit, se ata

janë blerësit dhe lexuesit tuaj më pasionantë?... Nuk e dini, sigurisht. Ose e dini dhe aq iu bën…

Edhe në "Memorandumin Ekonomik mbi Kosovën" të Bankës Botërore, botuar në atë periudhë, thuhet se 52 për qind e popullsisë jeton në kufijtë e varfërisë, se 15 për qind e tyre, kanë mesatarisht më pak se një euro në ditë, që do të thotë se jetojnë nën varfërinë ekstreme dhe 37 për qind e popullit jeton me një mesatare prej 1,42 eurosh në ditë dhe kjo, sikundër e dini, konsiderohet si varfëri klasike.

Ngritja në revoltë e masës më të madhe të popullit, tregon se kemi të bëjmë me një dukuri interesante. Dukuria qendron në atë se, si ajo pjesë e popullit që nuk pati besim te lufta e armatosur, edhe pjesa tjetër e popullit që e përkrahu dhe e mbështeti atë luftë, janë zhgënjyer nga rezultatet e pasluftës, pasi këto vuajtje i fshinë në një masë të madhe dallimet midis ish - pacifistëve dhe grupimit revolucionar. Madje edhe shtresa më ekstremiste pacifiste nuk mundi të thoshte ndonjë fjalë të mirë për politikat e ndjekura deri tani në Kosovë.

Tani po iu pyes, i nderuari zoti Kadare: "Të kërkosh bukë për të ngrënë, kur ke mbetur pa bukë, mos është edhe kjo "duf katundaresk? Po ata të dhjetëmijë studentët e Universitetit të Prishtinës, që u bashkuan me popullin në atë revoltë, mos janë, sipas jush, adoleshentë apo nostalgjikë komunistë"? A e dini zotëri se: "Shpesh herë, propozimet apo rezolutat, kur ato janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ende pa dalur, apo brenda një ore, janë anulluar nga Përfaqësuesi Special për Kosovën.", - sikundër shprehet një deputet i këtij kuvendi, në gazetën "Epoka e Re", të datës 28 qershor 2004?...

A e dini juve, zoti Kadare, se eksportet vendase mbulojnë vetëm tre për qind të të gjithë eksportit në Kosovë, kundrejt një 97 për qindshi, sa absurd aq edhe domethënës, të importeve që vijnë kryesisht nga vendet e ish - Jugosllavisë,

ndërsa me Republikën e Shqipërisë dhe me Bosnjë - Hercegovinën doganat janë dyfish më të larta, me qëllim që të mos hyjnë mallra prej andej? A e dini se edhe vetë librat tuaja doganohen rëndshëm dhe shpesh herë pengohen të hyjnë në Kosovë?!... Mos vallë e gjitha kjo bëhet nga që këto dy shtete banohen më së shumti nga myslimanë? Unë nuk e besoj, por druaj se e besoni juve. Dhe e besoni seriozisht, aq sa të kaloni edhe në fyerje e anatema…

A e dini juve, z. Kadare se, për mallrat që vijnë nga Serbia dhe Maqedonia në Kosovë, tregtarët e tyre paguajnë vetëm një për qind taksë doganore, ndërsa për ato mallra që fusin tregëtarët shqiptarë nga Shqipëria, Turqia, Bosnja etj., paguajnë 26 për qind taksë doganore? Mos vallë për këto arsye, të kërkosh të eleminohet kjo lloj politike diskriminuese ekonomike, e cila nuk stimulon as tregtarët dhe as prodhimin vendas, populli na qënkërka ekstremist e nostalgjik i komunizmit, sipas jush?

Ndoshta ju nuk e dini se, ndërkohë që shqiptarët e Kosovës shkojnë gjithnjë e më thellë drejt varfërisë, serbët e Kosovës merrnin dhe marrin mesatarisht 300 - 600 euro në muaj, ndërsa ndërkombëtarët, që punojnë ose bëjnë sikur punojnë në Kosovë, marrin secili nga 5 deri në 20 mijë euro në muaj, pa llogaritur këtu vjedhjet e mëdha që ata bëjnë me metodën e tenderave, në bashkëpunim me shqiptarët karrieristë e lojalë, kurse pjesa masive e nëpunësve shqiptarë të administratës marrin 150 - 200 euro në muaj. Mos harroni, çmimet në Kosovë janë ndër më të lartat në Evropë, pasi tregtarët i parashikojnë ato për pagat e majme të ndërkombëtarëve, që i afrohen shifrës marramendëse prej 100 mijë vetë. Mos vallë, se i dinë dhe protestojnë për këto dispropocione të mëdha, juve, zoti Kadare, i quani shqiptarët njerëz me vizion dritëshkurtër?...

Nuk mjafton që populli shqiptar vuan për bukën e gojës, por, për ta revoltuar edhe më shumë atë, televizionet çdo ditë jepnin dhe japin Rugovën, Dacin, Thaçin dhe Bajram

Rexhepin, duke bërë garë se cili prej tyre të falenderojë i pari serbët që rikthehen në Kosovë, ndërkohë që ka 5 vite që shqiptarët dhe boshnjakët e përzenë nga Mitrovica Veriore, që janë me qindra e qindra familje, nuk po kthehen në shtëpitë e tyre. “Pse nuk janë kthyer?”, - mund të pyesni juve. Sepse nuk i lenë çetnikët serbë, me emrin domethënës “Rojet e Urës”, të cilët shkëmbejnë cigare me ushtarët e KFOR-it francez. Pse nuk interesohen këta zotërinj për fatin e popullit të tyre, por iu djeg shpirti vetëm për serbët, apo se kështu bëhen më të pëlqyeshëm nga ndërkombëtarët? Politikë, hesapi! Mos vallë edhe juve jeni përfshirë në këtë garë, mos keni ende nevojë të bëheni gjithnjë e më i pëlqyeshëm prej këtyre ndërkombëtarëve?... Mos qoftë e thënë!

Ju lutem, mos harroni se, midis serbëve që kthehen, ka shumë meshkuj që kanë qenë në radhët e paramilitarëve gjakpirës. Dhe, janë këto akte të papeshuara të këtyre politikanëve, të cilat e detyrojnë popullin të ngrihet në revoltë. Prandaj, në vend që juve, zoti Kadare, t’i dënoni këta gjoja - politikanë, sikundër i keni dënuar më herët, ngriheni dhe i thoni revoltës së popullit: “duf katundaresk”. Lum si ju, që nuk e keni dufin katundaresk, por… qytetar.

A iu kujtohet se çfarë i keni thënë Denis Fernandezit më 5 maj 1999, për këtë trajtim përkëdhelës të serbëve nga Europa? Në se jo, po jua kujtoj unë, pasi e keni shkruar në faqet 275 dhe 277 të librit tuaj të mrekullueshëm “*Kohë barbare*”:

“ Serbët po shkojnë më larg se një spastrim etnik. Marrëzitë e tyre, me fjalë më të buta, ua kalojnë veprimeve të nazistëve në gadishullin ballkanik. Në dhunën e tyre, ka diçka të papërfytyrueshme sot. Ata përdhunojnë gra, vrasin fëmijë, masakrojnë djem të rinj. Vendosmëria e tyre është e lemerishme. Të bën të besosh se ata dëshirojnë të zhdukin çdo mundësi mbijetese, madje çdo fije jete. Atyre nuk iu mjafton përzenia e një populli, shpërngulja e tij nga

trojet e veta...", shkruani juve në faqen 275. Ndërsa në faqen 277, vazhdoni: "Serbët, duke u paraqitur me petkun e të keqtrajtuarve të mundshëm të Historisë, hiqen sikur Historia po ua fal të gjitha paudhësitë. Traktati i Versajës ka qenë i padrejtë për gjermanët. A i përligj dot kjo padrejtësi kampet e përqendrimit? Dhe, sigurisht, unë nuk i krahasoj serbët me nazistët në planin e organizimit. Unë veç po mbetem, në se mund ta them, te egërsia, te ajo shtazëri që do ta cilësoja si të drejtpërdrejtë. Nga kjo pikëpamje, serbët e kanë dendësuar krimin në këtë fundshekulli..."

Edhe sot, këtyre fjalëve të mençura nuk mund t'iu hiqet asnjë presje. Po atëhere, si e shpjegoni, zotëri, që juve, udhëheqësit dhe politikanët e Kosovës, ata të UNMIK-ut, të Shqipërisë dhe të Europës, "t'i harroni" kaq shpejt dhe të mos i keni edhe sot parasysh këto krime, që i shkaktuan plagë të pashërueshme popullit të Kosovës?!... A jeni dakord juve që historia të kthehet së prapthi dhe serbët të trajtohen sot si djemtë e vetëm të Europës (edhe pse kanë vepruar më keq se nazistët dhe nuk kanë treguar as edhe shenjën më të vogël të pendimit për krimet e tyre në Bosnjë, Kosovë e gjetkë), ndërsa shqiptarët të shkojnë gjithnjë e më shumë drejt varfërisë absolute? Dhe, kur ata ankohen, juve, me tërë ngarkesën dhe "frymëzimin" satanik të një shkrimtari të madh, i quani: "njerëz me duf katundaresk...". Zoti Kadare, më ndihmoni, se sot nuk po e marr vesh Kadarenë!...

Zotëri, serbëve të Kosovës, iu japin jo vetëm këta të UNMIK-ut nga 300-600 euro në muaj, por ata nuk i le pa gjë edhe shteti i tyre amë, ndërkohë që pensionistëve shqiptarë të Kosovës, që kanë punuar një jetë të tërë për Serbinë, kjo e fundit nuk jua njeh të drejtën e pensionit. Këtë fakt nuk e them unë, e thotë vetë zoti Kofi Annan, në paragrafgin 41 të atij raporti:

"Anëtarët serbë të Bordit Këshillëdhënës janë shpërblyer me një milion euro nga ana e Beogradit, të

dedikuara për qëllimet e qeverisë lokale. Stafi vendor serb i UNMIK-ut, po ashtu, marrin paga nga Beogradi, ndonse ata paguhen nga ana e buxhetit të Kosovës. Përveç Mitrovicës, puna e disa komunave të tjera po ashtu ka qenë e ndikuar nga Beogradi, i cili vazhdimisht mbështet strukturat paralele, të cilat janë të dëmshme për marrdhëniet brenda komunave dhe rrezikojnë përpjekjet për legjitimitet të të zgjedhurve komunalë. Edhe atëhere kur të punësuarit serbë në Kosovë dëshirojnë të punojnë si pjesë e instituioneve të përkohshmë, ata shpesh herë janë nën presion nga Serbia dhe Mali i Zi."

Përveç këtyre që përmenda, serbëve të Kosovës iu ngrihen shtëpitë me të gjitha komoditetet që ata dëshirojnë, ndërkohë që, për shqiptarët, vetëm 44 për qind e kërkesave për strehim janë zgjidhur, sikundër e pohon vetë zoti Annan në paragrafin 42 të raportit të tij vjetor. Dhe, të mos harrojmë që serbët ato shtëpi kanë për t'i shitur përsëri, për të dhjetën herë, sikundër kanë bërë deri tani me pronat dhe pasuritë e shqiptarëve, të cilat i kanë marrë falas nga shteti shtypës i tyre, ashtu siç i morën dhe po i marrin edhe tani falas nga UNMIK-u dhe qeveria e Kosovës, edhe pse ishin po ata që e dogjën Kosovën. Ndërkohë, banorëve të fshatit Hadë, në afërsi të minierës së thëngjillit në Kastriot (Obiliq), të cilët kanë nga 1000-2000 vjet në atë tokë e që tani duhet të shpërngulen prej andej (për shkak se ndodhen mbi shtresën e qymyrit, e cila duhet të shfrytëzohet), iu kanë ofruar nga 23 euro për metër katror të tokës dhe iu thonë: "Krisni bythën!", ndërkohë që 800 milionë eurot e sufiçitit të qeverisë së Kosovës në fundin e vitit 2003, nuk dihet se nga vanë e kush i mori midis "çlirimtarëve" të tu europjanë dhe politikanëve e funksionarëve ndërkombëtarë dhe ata shqiptarë...

Me sa duket, kur keni shkruar këtë "analizën" për ngjarjet e marsit në Kosovë, keni harruar se çfarë keni thënë për tokën e fshatarit, për dashurinë e tij të thellë për të, në

librin *“Ra ky mort e u pamë*”, pikërisht në faqen 82: “Më mirë se kushdo, një bujk e kupton se sa dhemb kur të shkulin nga toka që e ke punuar gjithë jetën.”

PUSHTETI PARALEL SERB NË KOSOVË

Por si mallkim në horizont u shfaqe ti,
Ata të hapën portat, s'dinin ç'ishe.
Pastaj (o, pastaj), kur flakët përdridheshin, gjindja ulërinte,
Klithnin: "oh, tradhëti!", por ishte vonë."

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia "Kali i Trojës.)

A e dini juve, zoti Kadare, se në Kosovë funksionon ende pushteti i shtetit me emrin Serbi dhe se serbët e Kosovës nuk i njohin dhe as duan t'i njohin as UNMIK-un dhe as qeverinë - kukull të Kosovës dhe, për më tepër, bëjnë si të duan; kur të duan bllokojnë deri edhe rrugët dhe tërt s'ua bën syri? E di që s'do të më besoni, por lexoni, ju lutem, se çfarë thotë vetë zoti Annan në paragrafin 53 të atij raportit vjetor: "Mungesa e pjesëmarrjes në institucionet e përkohëshme (*e ka fjalën për serbët. D.G.*) dhe mospërfshirja në procedimin politik, vetëm pengon progresin. Njëlloj edhe strukturat administrative paralele në Kosovë. Unë ftoj Beogradin që ta shkëpusë mbështetjen e vet për këto struktura."

A dëshironi më, zotëri? Nuk ke ç't'iu bësh këtyre katundarëve shqiptarë të Kosovës; ata janë pa vizion, janë mosmirënjohës, njerëz me dufe e huqe, që duan të prishin miqësinë me "çlirimtarët" europianë... Mos ua vini veshin, pasi, duke qenë njerëz "pa vizion" e tërë "duf katundaresk" nuk marrin vesh, nuk dinë as ç'bëjnë e as ç'thonë...

Juve mund të pretendoni, zotëri, se nuk i keni ditur dhe nuk i dini të gjitha gjërat që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës. Nuk e besoj. Sepse vetë ju, në Konferencën e

Hamburgut të 27 majit të vitit 1999, iu drejtuat një profesori pikërisht me fjalët dhe argumentet që unë përmenda më lart, të botuara këto edhe në librin "*Ra ky mort e u pamë*", në faqen 99 të tij. Mos i keni harruar edhe fjalët tuaja?...

KUSH UA KRIJOI MUNDESINË KRIMINELËVE SERBË TË "ARRATISESHIN" NGA BURGJET?

Potkojtë mbi shekujt duke vënë,
Ky kalë epokat do përshkojë,
Në bark të tij, përjetë do dridhet
E tmerrshmja tradhëti, o Trojë!

(I. Kadare. Vargje nga poezia: "Troja".)

Si i shpjegoni juve, zoti Kadare, largimet ("arratisjet" (!?)) misterioze nga burgjet e Kosovës të të gjithë kriminelëve serbë të luftës? Kush i ruante ato burgje, populli "ekstremist" dhe "nostalgjikët", apo policia e UNMIK-ut? Pse nuk kanë mundur të largohen në të njëjtën mënyrë, nga të njëjtit burgje, ish - luftëtarët e prangosur të UÇK-së, të ruajtur nga e njëjta polici që "ruante" (Më mirë të themi "ua rruante") kriminelët serbë të luftës?... Përballë këtyre veprimeve e qendrimeve djallëzore të "çlirimtarëve" europjanë të Kosovës, a mund të heshtë dhe të kënaqet populli i saj? A mund të bindet e të besojë ai se "çlirimtarët" ia kanë pa hile dhe të ketë edhe garancitë më minimale për të ardhmen? Madje edhe sikur ata "çlirimtarët" tuaj të dashur të kërkojnë falje për tërë këto "pakujdesi" në (mos)ruajtjen e kriminelëve serbë, mendoni se do ta bëjnë këtë sinqerisht?... Juve vetë, e besoni këtë, e mohoni që kemi të bëjmë me një farsë të rrezikshme në dëm të Kosovës?...

“NGUCJE NGA EKSTREMISTËT NOSTALGJIKË KOMUNISTË” (?!...)

Ata tërbohen kur shohin udhëve
Ngjyrat e botës,
Rininë e botës.
Kur kokat bionde të shqiptarëve,
Mbështetur mbi supet e botës.
Ata po bëhen histerikë, sikur i rrahin
me kamzhikë.

(I.Kadare. Vargje nga vëllimi: “Motive me diell”.)

Atë që tha zoti Solana, se ngjarjet në Kosovë i organizuan dhe i bënë ekstremistët, njëlloj e thatë edhe ju, zoti Kadare, duke i cilësuar ngjarjet si “ngucje nga ekstremistët nostalgjikë komunistë”.

Por, po ta pranojmë këtë logjikë të zotit Solana dhe tuajën, atëhere jemi të detyruar të pranojmë se, këta “ekstremistët nostalgjikë komunistë” janë më të organizuar, më të besueshëm e më të dëshiruar nga populli dhe, më të fortë se UNMIK-u, qeveria e Kosovës, forcat politike të Kosovës dhe KFOR-i, së bashku.

Në rast se do të pranonim se shpërthimin e revoltave në Kosovë e nxitën dhe e bënë “ekstremistët”, me të cilët ju nënkuptoni ish-luftëtarët e UÇK-së, atëhere jemi të detyruar të pranojmë se ata “ekstremistët komunistë nostalgjikë” janë edhe financiarisht më të fuqishëm se qeveria e Kosovës, e cila del me 800 milionë euro sufiçit. Dhe, më tej, po qe se do të ishin kaq të pasur “ekstremistët”, ata, jo vetëm që do të kishin në dorë tërë ekonominë e Kosovës, por do të kishin edhe pushtetin real, gjë që nuk ka ndodhur dhe nuk do ta besonin as fëmijët. Po të pranohej kjo, atëhere nuk do të kishim të bënim më me ndonjë “duf katundaresk”, por me

dufin pushtetmbajtës. Po kush vuan nga kjo sindroma e fundit, zoti Kadare, ish-luftëtarët e UÇK-së, idealistët, apo... të tjerët? Juve e dini mirë përgjigjen, po, për momentin, nuk iu volit ta thoni...

Po, mund të më thoni se, unë me termin "ekstremist" nuk nënkuptoj ish-luftëtarët e UÇK-së. Mirpo, është z. Michael J. Jordan, përfaqësuesi i *"Christian Science Monitor*", i cili shprehet qartë se për ngjarjet e marsit "analistët fajësojnë ish-ekstremistët nga radhët e UÇK-së". (*gazeta "Zeri", 24.09.2004*). Dihet, me këtë epitet cilësohen të gjithë ata që kanë dashur dhe duan bashkimin e Kosovës me shtetin amë.

Jua them këto, pasi ata "mundën ta bënin tërë këtë ngucje" në fshehtësi të plotë dhe në mënyrë shumë të organizuar, sa që, as të 29 agjenturat e huaja dhe as ato dy shqiptaret në Kosovë, që dihet se punojnë për të huajtë dhe me të huajtë, nuk arritën t'i zbulonin e t'iu binin në fije. Këtë nuk e them unë, por vetë zoti Holker, përfaqësuesi special për Kosovën, në një intervistë dhënë Radios Publike Zvicerane DRS, më 3 maj 2004: "Askush nuk ka llogaritur se do të ketë protesta. As unë, as dikush tjetër... Shërbimet sekrete të NATO-s kanë dështuar. Administrata ime nuk ka marrë asnjë paralajmërim nga Aleanca Veriatlantike, se mund të ketë protesta...". Lexo gazetën *"Koha Ditore*" të datës së nesërme.

Këtu, zoti Kadare, duhet të ketë edhe një dozë të së vërtetës. Sepse, sikundër e tregojnë edhe rezultatet e viteve të fundit, shërbimet sekrete kanë dështuar në shumë raste, për arsye se ato, jo vetëm që mbështeten në njerëz të rëndomtë e të paaftë për çdo lloj pune tjetër, por edhe sepse janë aq të përkushtuar për përfitime, sa që dinë të raportojnë jo për atë që flitet dhe ndodh ose mund të ndodhë në të vërtetë, po për atë që duan të dëgjojnë vetë këto shërbime sekrete, ashtu siç iu pëlqen shefave të tyre dhe politikës që

ata duan të ndjekin. Këta lloj agjentësh mbahen nga shefat e tyre, sepse edhe ata vetë e kanë më të lehtë të sigurojnë në këtë mënyrë një karrierë të gjatë dhe shumë përfitime të paligjshme. Mundet që në radhët e tyre të ketë edhe njerëz inteligjentë, por ka mundësi që ata të jenë agjentë të dy e trefishtë, gjë që do të thotë se ata raportojnë ashtu siç i intereson për momentin shërbimit që e paguan më mirë...

Kjo dukuri e mosnjohjes së të vërtetës reale, vihet re edhe në diplomacinë shqiptare, e cila nuk ka një bosht të vetin, pasi dihet: si të jetë informacioni, ashtu do të jetë edhe vendimi. Kjo dukuri u vërtetua edhe me CIA-n, edhe me Inteligjent - Servisin për luftën e fundit në Irak, gjë që është bërë edhe objekt debati si në Kongresin dhe Senatin Amerikan, ashtu edhe në Parlamentin Anglez.

Ngjajshëm me zotin Holker, u shpreh pak a shumë edhe shefja e Misionit Amerikan në Kosovë, zj. Marsi Ris: "Kurrë nuk e kemi imagjinuar që diçka e tillë mund të ndodhë në Kosovë..." Pothuajse të gjithë diplomatët e tjerë, si dhe shumë politikanë, u shprehën po kështu, të habitur...

Mirpo unë do të thoshja se kjo tregon që, as politikanët vendorë dhe as ata të huaj,nuk kanë arritur ende të njohin një tipar të veçantë të popullit shqiptar në Kosovë. Vuajtjet e gjata nën rregjimin diktatorial serb, i kanë kultivuar këtij populli një tipar të ndryshëm nga vëllezërit e vet të pjesës tjetër. Ky tipar, është heshtja para shpërthimit dhe jo nxitimi e impulsiviteti, që shpesh karakterizojnë pjesën tjetër. Në çdo kohë, e ke shumë të vështirë ta kuptosh dhe ta dish se çfarë mendon në të vërtetë ky popull. Shqiptarët e Kosovës janë mësuar të durojnë gjer në cakun e fundit dhe, kur ti kujton se ata mendojnë ashtu sikundër ti flet, pa ta thënë, as me fjalë dhe as më mimikën e fytyrës, as po dhe as jo, të venë në gjumë...Dhe, pikërisht në momentin kur ti nuk e pret, shqiptari kosovar shpërthen si vullkan, si ajo rrufeja në qiellin e kthjellët. Ky tipar u manifestua edhe në ngjarjet e marsit të vitit 2004.

Megjithatë, politikanëve, diplomatëve dhe drejtuesve në Kosovë, vendas ose të huaj, nuk iu falet të thonë se nuk e prisnin një reagim të tillë. Ju mund të thoni: “Si është e mundur, ju vetë e thatë se ky popull është e vështirë të kuptohet.” Pohimi im, nuk i çliron ata nga përgjegjësia, sepse “kazani” i Kosovës ka kohë që valon. Ka kohë që në Kosovë nuk dëgjohen zilet e vogla, pasi bien këmbanat e mëdha. Këtë e pranon edhe vetë zoti Kofi Annan në raportin e tij vjetor, në pikën “Sundimi i ligjit”, ku thotë shprehimisht se, nga qershori deri në dhjetor 2003, në Kosovë janë zhvilluar plot 103 demonstrata publike, që do të thotë një demonstratë në çdo dy-tri ditë. Atëhere, përse bëjnë të habiturin zotërinjtë?!... Mos iu duken këto demonstrata si ca lodra e aq, mos mendojnë ata se, me që pothuajse të gjithë shqiptarët janë të papunë, me këto forma proteste i kanë gjetur një punë vetes?... E pra, paralajmërimi ishte dhënë prej kohësh, por kambanat bien për ata që kanë veshë dhe jo për shurdhmemecët.

Edhe një pyetje tjetër, zoti Kadare: Ata që dogjën ditën e dytë të protestave, sepse në ditën e parë nuk pati as djegie e as thyerje, mos kanë qenë kontigjentet e atyre që vuajnë nga dufi i ... kolonizatorit? Po ju, a ia keni bërë ndonjëherë këtë pyetje vetes, para se të thoshnit ato që thatë?

Protestat e 17 marsit të vitit 2004, zotëri, nuk kanë të bëjnë as me “dufin katundaresk” të turmave dhe as me veprimtarinë e “elementeve nostalgjikë komunistë”, sikundër shpreheni ju dhe zoti Solana. Përkundrazi, kemi të bëjmë me një padurim popullor, të shfrytëzuar me mjeshtëri nga ata që thashë...

Mësojeni, zoti Kadare, se, gjashtë muaj para se të ndodhnin ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë, zëdhënësia e UNMIK-ut, një farë Izabela Karloviç,(mbiemri i saj mbaron pikërisht me... viç...), bëri një deklaratë fyese ndaj Luftës Çlirimtare të viteve 1997-1999, në Kosovë. Ajo tha, as më shumë e as më pak, se në Kosovë, nuk kemi pasur të bëjmë me ndonjë luftë, por thjesht me një grindje për pronësinë e saj.

Shkurt, asgjë nuk ka ndodhur, nuk janë vrarë e masakruar me mijëra njerëz, nuk janë djegur shtëpi e institucione, nuk janë grabitur pasuritë, nuk ka pasur krime, nuk ka ende të zhdukur pa nam e pa nishan. Asgjë nga këto nuk ka, veçse një grindje, një sherr banal, me të cilin nuk ia vlen të merresh... Për çudi, asnjë politikan shqiptar i Prishtinës nuk reagoi ndaj asaj deklarate poshtëruese. Madje, as edhe një gazetë e Prishtinës nuk pranoi të botonte një reagim të argumentuar timin për këtë çështje. Nuk pranuan ta botonin as gazetat që kontrollohen nga politikanët e dalë nga ajo luftë heroike edhe pse "Kosova Press" e futi në internet dhe radioja *"Kosova e Lirë*" e transmetoi dhe e ritransmetoi disa herë.

Politikanët heshtën dhe kjo do të thotë se ishin plotësisht dakord me zonjën Karloviç, ata pranuan të fyheshin e të shaheshin si s'ka më keq, vetëm që rehati dhe komoditeti i tyre të mos prekeshin. Por, ç'ndodhi vetëm disa ditë pas kësaj deklarate ndjellakeqe? Si për të testuar ndjenjat e popullit shqiptar të Kosovës, si për të vërtetuar në se edhe ky popull ishte në një linjë me politikanët dhe mund të duronte çdo lloj fyerjeje, duke harruar gjakun, sakrificat dhe heronjtë e vet, disa ushtarë të KFOR-t francez, me një oficer në krye, shkuan në Drenicë dhe provokuan familjen e simbolit të Luftës Çlirimtare të Kosovës, komandantit të lavdishëm Adem Jashari. Përsëri asnjë reagim nga politikanët. Pikërisht për këtë arsye, në fund të reagimit tim të sipërcituar, më 4 nëntor 2003, unë i kam thënë z. Karloviç: "... Vajtja e forcave të KFOR-it francez, disa ditë pas deklaratës suaj, tek banesa e familjes së Adem Jasharit, shtëpia - simbol e rezistencës sonë kombëtare të armatosur, e cila është shndërruar tashmë si një Mekë apo si një Jeruzalem për tërë shqiptarët, kam bindjen se mund të mos jetë e rastësishme dhe se mund të kemi të bëjmë me një skenar të përbashkët midis UNMIK-ut dhe KFOR-it, për të përdhosur simbolet dhe historinë tonë të re. Pikërisht për

këtë arsye, nuk përjashtohet mundësia që ky veprim i papranueshëm, të sjellë reagime të formave nga më të ndryshmet prej shqiptarëve të Kosovës dhe përgjegjësia atëhere do t'iu mbetet juve dhe institucionit që ju përfaqësoni..."

Sikundër e shihni, zoti Kadare, parandjenja ime, parandjenja e një luftëtari të lirisë, u vërtetua tërësisht vetëm pesë muaj më vonë. Sepse, zotëri, ne, luftëtarët idealistë, vërtet nuk kemi ndonjë shqisë më tepër nga të tjerët, por i kemi shumë të zhvilluara parandjenjat. Kot nuk thonë psikologët se, intuita e luftëtarëve të lirisë, është alfabeti që i lidh ata me Zotin...

Do të mjaftonin vetëm faktet që rendita më lart, për të thënë se nuk janë "ekstremistët nostalgjikë komunistë" shqiptarë dhe nuk është "dufi katundaresk", që i nxitën protestat masive të 17 marsit, por janë "zotërinjtë e institucioneve formale të Kosovës, zotërinjtë e UNMIK-ut, zotërinjtë e regjimit të Beogradit, (*shkaktarë, D.G.*) për erupcionin e pakontrolluar të mllefit e të dëshpërimit qytetar të Kosovës...", sikundër u shpreh Adem Demaçi.

Duke folur për reagimin tim ndaj zj. Karloviç, nuk dua aspak të mbahem me të madh ose të hiqem si një orakull apo parashikues i shquar. Aspak. Sepse, e them me sinqeritet, nuk e mendoja kurrë që zemërimi të shpërthente në ato përmasa. Në nëntor të vitit 2003, jo vetëm unë, por edhe analistët më në zë në Kosovë e jashtë saj, sikur edhe astrologët më të shquar të botës të na paralajmëronin, nuk mund ta mendonim atë lloj revolte popullore, ku vetëm një fije floku e ndau dramën nga tragjedia. Dhe, kjo do të thotë se populli di diçka më shumë se ne dhe është e sigurtë që e ka një shqisë më tepër se të vdekshmit. Edhe se juve, natyrisht, ndaj mendoj se nuk mund të sajohen e të flaken kundër tij epitete të tilla fyese si "duf katundaresk", "elementë nostalgjikë komunistë" etj., që nuk i kanë hije edhe një kalemxhiu të rëndomtë e jo më një shkrimtari të madh si juve. Mos e

harroni, zotëri, sot për sot juve jeni ndoshta shqiptari më i shquar, më i famshmi e më i njohuri në të gjitha trevat ku banon rraca jonë dhe, çdo gjë që bëni, që thoni e që shkruani, është në vemendjen e të gjithëve. Për mirë ose për keq, - kjo është në dorën, në ndërgjegjën dhe në nderin tuaj.

Zotëri, unë dhe shokët e mi të luftës nuk para mërzitemi shumë kur juve, zoti Solana dhe një kor i tërë politikanësh na quani "ekstremistë". Dhe nuk stepemi, por vazhdojmë të themi e të stërthemi me durim të vërtetat tona, të mbrojmë me modesti idealet tona, që besoj se kanë një çmim dhe një peshë të rëndë dhe nuk mund të lëkunden e të tunden nga vendi vetëm me ca fyerje e deklarata të rëndomta. Ato janë provuar në zjarrin e luftës; ato janë shpaguar me gjak e sakrifica të panumërta dhe nuk ka forcë në botë që t'i fshijë, t'i mohojë ose t'i shtrembërojë...

Ne e dimë se ju mund të tërhiqeni me po atë lehtësi të pazakontë që u vu re kur u shprehët për ngjarjet e marsit. Mund të thoni se, me termin "ekstremistë nostalgjikë komunistë", nuk keni parasysh ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK - së), por të tjerë, që do të thotë se merreni me njerëz hipotetikë. Mirpo kemi një fakt shumë kokëfortë, që na çon në përfundimin se ju e keni pasur fjalën pikërisht për neve dhe për askënd tjetër. Mësojeni:

Brenda një muaji, pas ngjarjeve të 17-18 marsit 2004, u arrestuan 271 persona të dyshuar, shumica e të cilëve ishin ish-pjesëtarë të UÇK - së, madje edhe dy komandantë Zonash Operative gjatë asaj lufte, si dhe dy kryetarë shoqatash të veteranëve të po asaj lufte. Por, për fatin e keq tëndin dhe të ndërkombëtarëve, vetëm 50 persona janë duke u hetuar nga prokurorët ndërkombëtarë, ndërsa të tjerët janë liruar, për mungesë provash... U liruan pothuajse të gjithë ish-luftëtarët, ose, siç iu pëlqen t'i quajnë disa këtu, ekstremistët. Kësaj radhe nuk e kam fjalën për juve, jo.

Dhe, ç'është më e bukura, sipas deklaratës së zëdhënësit të policisë së UNMIK-ut dhe të departamentit të drejtësisë, zotit Neeraj Signh, dhënë më 16 qershor 2004, bëhet e qartë se, nga hetimet e deritanishme, "nuk rezulton të ketë ekzistuar ndonjë organizatë, e cila mendohet të ketë drejtuar trazirat gjatë marsit."

Atëhere, a mund të shprehemi se ato revolta i nxitën ekstremistët (nënkuptoni, sipas jush, ish pjesëtarët e UÇK-së), kur nuk kemi asnjë lloj organizimi? A e beson njeri këtë? Ju e dini se, ish-luftëtarët, kanë përvojë në këto punë, pasi edhe kur ishte fjala për t'u hedhur në sulm qoftë edhe një ushtar i vetëm, duhej të merrej patjetër një vendim. Prandaj, si ju, ashtu edhe ne, duhet të marrim frymë të çliruar që në ngjarjet e marsit 2004 nuk kanë dorë ish-pjesëtarët e UÇK-së, sepse, në të kundërtën, gjërat mund të kishin shkuar shumë më keq...

Edhe zëdhënësi i KFOR-it, Jim Moran, po atë ditë deklaroi se "KFOR-i, aktualisht, nuk është duke mbajtur ndonjë person të arrestuar për ngjarjet e marsit.". *(Gazeta "Epoka e Re", datë 17 qershor 2004.)*

Tani, zotëri, besoj se e kuptoni atë që dua ta përsëris edhe një herë: Ngjarjet e marsit 20004 në Kosovë, erdhën nga shpërthimi i zemërimit të grumbulluar popullor për padrejtësitë e bëra dhe paaftësinë e administratës së UNMIK-ut, qeverisë dhe politikanëve të Kosovës, ndërsa ish-luftëtarët e UÇK-së, që u arrestuan dhe u liruan si pa të keq, nuk kishin asnjë lidhje me to. Me këta luftëtarë, ndodhi sikundër e thotë ajo shprehja e vjetër popullore: Kush e bën kulaçin e shtrembër? Nusja! Kush është nusja fajtore e Kosovës? UÇK-ja!...

Mirpo, këto dy deklaratat e fundit të zëdhënësve ndërkombëtarë, mund t'i kuptojmë e t'i trajtojmë edhe në një kënd tjetër: Përse të mos themi se, kjo situatë varfërie dhe pasigurie, është shkaktuar qëllimisht, që Kosova të shndërrohet në një ferr ekonomik për shqiptarët, në mënyrë që ata të mërziten e të largohen prej saj? Sikundër e analizon zoti Adem Demaçi, kjo do të thotë që sot, në Kosovë, të bëhet

“paqësisht” ajo që nuk e bëri dot as Millosheviçi, me gjak, zjarr dhe hekur, pra serbizimi i Kosovës. Faktet flasin gjithnjë e më shumë për këtë. Pse, si mendoni ju, kot bie ajo këmbana e multietnicitetit?...

Shumë shtete të Europës, thotë Demaçi, për ta bërë Serbinë për vete, janë gati ta sakrifikojnë Kosovën, duke e coptuar atë përsëri dhe duke krijuar minishtetin serb në Kosovë. Ky mund të jetë një qëllim, për t’i treguar botës se “shqiptarët, vetëm Serbia mund t’i qeverisë, pasi, e patë, ata nuk janë të aftë të vetqeverisen, ata janë mosnirënjohës, ata dogjën...”.

POLITIKA E HAPUR ME POPULLIN, VETËM AJO TË NXJERR NË DRITË

Atdheu është:
Lulet mbi varret e thjeshtë të të rënëve,
Vargjet e pafund të refugjatëve, me nofullat e kyçura.

(Ismail Kadare, marrë nga poezia: "Atdheu")

A e dini ju, zoti Kadare, se, prej muajit janar të vitit 2004 e deri sa shpëthyen revoltat në muajin mars, populli e dinte që ishin zhvilluar pesë takime të fshehta me serbët, jashtë Kosovës?!... Me intuitën e tij, me rrugët e tij të mistershme dhe me mënyrat e tij përherë të efektshme, populli e dinte mirë se, në këto takime, kishin marrë pjesë përfaqësues nga të trija partitë politike kryesore të Kosovës, ndërkohë që askush nuk e mori mundimin ta informonte atë. Mos vallë politikanët dritëshkurtërt të Kosovës menduan se, me gënjeshtra dhe me errësirë informative, populli do të mashtrohej e do të vihej në gjumë?... Ishte e pamundur! Populli e dinte dhe kudo diskutohej "me zë të ulët" për atë që po ndodhte. Ju e dini mirë se, vetëm politika e hapur me popullin të nxjerr në dritë, ndërsa politika e kulisave e zemëron dhe e zhgënjen popullin. Kështu ndodhi me PDK-në dhe AAK-në, për shembull. Nga njera anë, ato "deklaruan" se nuk do të merrnin pjesë në takimin e parë me serbët në Zvicër, ndërsa, nga ana tjetër, përfaqësuesit e tyre zhvilluan takime të fshehta në Kretë. A nuk ka të drejtë populli të zemërohet me të tilla pirueta diletantësh politikë?...

Po le ta shohim problemin e bisedimeve me Serbinë edhe në një kënd tjetër. Të gjithëve dhe sidomos juve, zoti Kadare, na kujtohet mirë Rambujeja. Ne e firmosëm

marrëveshjen atje, ndërsa pala serbe nuk firmosi. Logjikisht, problemi ka mbetur i hapur dhe dikur, duan apo s'duan serbët ose shqiptarët, duhet të përfundojë, të mbyllet. Dakord, kjo qendron. Po, për çfarë duhet biseduar e diskutuar dhe kush do ta përfaqësojë palën shqiptare në këto bisedime? Ky është problemi i parë, ndoshta nga më të rëndësishmit, sepse, siç thotë populli, fillimi i mbarë është gjysma e punës. Po ky fillim, mos është privilegj vetëm i politikanëve të sotëm në Kosovë, mos iu është mbushur mendja atyre se, në partitë që drejtojnë, janë mbledhur njerëzit më të mençur të këtij vendi?...

E kanë gabim. Ju, për shembull, nuk bëni pjesë në asnjë parti politike, as të tjerë njerëz të shquar nuk janë anëtarë ose militantë partish, po kjo s'do të thotë se s'duhet të pyeteni e s'duhet ta thoni fjalën tuaj. Aq më tepër duhet të pyetet populli, duhet marrë tagra e tij, sepse populli është i vetmi sovran që ka të drejtë të flasë dhe të vendosë. Dhe, populli i Kosovës ka votuar për këtë jo vetëm në referendumin e vitit 1991, por edhe përmes pushkës së tij, duke e shpallur botërisht se është për mosnjohjen e pushtimit e të pushtetit serb dhe të çdo lloj pushteti tjetër joshqiptar. Lufta e armatosur e popullit, ishte referendumi i vërtetë i tij, ishte pagëzimi me gjakun dhe erën e lirisë, komunikimi i tij shpirtëror me ëngjëjt, sepse edhe vetë ai doli nga lufta i larë e i pastër si një ëngjëll. Ndërsa politikanët tanë e kanë treguar dhe po e tregojnë me vepra se gjithçka mund të jenë, veçse ëngjëj jo... Atëhere, lufta, shkaqet dhe pasojat e saj, duhet të jenë pika referimi në bisedat me serbët dhe asgjë tjetër, që bie ndesh me historinë dhe me realitetin e sotëm.

Po, kot që flasim. Bisedimet e deritanishme janë bërë e po bëhen në nivel "ekspertësh". Se për çfarë flasin e diskutojnë këta "ekspertë", ata e dinë, sepse ende nuk ka një vendim të caktuar, një strategji të miratuar nga populli, sipas mënyrave tashmë të njohura për tërheqien e mendimit të tij. Dhe, kjo do të thotë se është filluar nga bishti e jo nga koka. Së pari, duhet të përcaktohet statusi i Kosovës, të ketë një

pikë nisjeje dhe pastaj të fillojnë bisedimet, qoftë edhe në nivel ekspertësh, ndryshe ato janë bisedime për bisedime, vetëm për të mashtruar popullin, duke i thënë se, ja, po flasim... Mirë, po flasim, po ku ishim dhe ku jemi? Asgjëkundi!...

E dyta, kush duhet ta përfaqësojë popullin në ato bisedime? Ju do të thoni: Ata që ka zgjedhur populli, ata po i zhvillojnë bisedimet... Unë do t'iu përgjigjesha: Jo, pasi ata që kanë shkuar dhe shkojnë aktualisht në bisedime, nuk janë të zgjedhur nga populli...

Ju mund të kundërpërgjigjeni se kjo nuk është e mundur, se, në Kosovë, janë zhvilluar zgjedhje të përgjithëshme.

Ndërsa unë do të thoshja se nuk është plotësisht ashtu, sepse, si Kornizën Kushtetuese, ashtu edhe Ligjin për Zgjedhjet, nuk i ka miratuar populli në asnjë formë, madje nuk i ka miratuar as ai gjoja - parlament i Kosovës, por janë të importuara dhe të imponuara nga ndërkombëtarët, me rrugëkalim Beogradin dhe me bekimin e tij. Për UNMIK-un dhe shqiptarët që i mbajnë iso, të gjitha rrugët i çojnë në Beograd dhe kalojnë e vijnë nga Beogradi...

A e kuptoni ju, zoti Kadare, se Korniza Kushtetuese, e cila ka institucionalizuar qenien e Kosovës si pjesë të Serbisë, vulosi përfundimisht fatin e pavarësisë apo vetvendosjes së Kosovës? Edhe me qiri ta kërkoje, si Diogjeni i lashtësisë, nuk mund të gjeje gjë më të keqe, më tipike dhe më të ngjajshme me dokumentet që iu imponojnë diktatorët shteteve të pushtuara. I gjithë pushteti politik është në duartë e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së, prandaj edhe nuk ka përse të ketë ministri të Jashtme të Kosovës. Edhe pse është krijuar prej kohësh qeveria e Kosovës, ligjin nuk e bëjnë ministrat e tredhur shqiptarë, por sekretarët e përgjithshëm të ministrive, të emëruar nga PSSP (të huaj, ose vendorë të shitur e të

shpërblyer). Interesant, zoti Kadare edhe pse u trodhën si eunukët, si nuk nxorrën asnjë mërmërimë ankimi këta politikanët tanë vendorë?!... Duke i mëshiruar, nuk na mbetet, veçse të admirojmë "artin" e përsosur të "çlirimtarëve" europianë edhe në këtë fushë. Sa bukur dinë të tredhin ata! Dhe, sa të urtë e të bindur janë pacientët e tyre?!...

Në atë Kornizë, nuk shihet as gjurma dhe as hapësira më e vogël për shprehjen e vullnetit të popullit, zoti Kadare. Ajo nuk votohet as nga Parlamenti dhe as nga Ansambleja (në rast se krijohet). PSSP është i plotfuqishëm në gjithçka; ai është përgjegjës për kontrollin e qeverisë - kukull, të cilin kontroll e bën përmes këshilltarëve dhe emërimeve e "rekrutimeve" në çdo ministri dhe në kryeministri. Pikërisht për këtë dhe për asnjë arsye tjetër, e dha dorëheqjen zoti Holker, se nuk e kishte bërë mirë kontrollin...

Edhe me këto që thamë, del se, e vetmja rrugë dhe zgjidhje e drejtë do të ishte që, përfaqësuesit në bisedimet me Serbinë, të ishin njerëz të zgjedhur drejtpërdrejt me referendum nga populli dhe jo emisarë e shërbëtorë të bindur të PSSP, që e kanë dorën në qese dhe lepurin në bark... Ndryshe, populli do të jetë përsëri i pakënaqur dhe nuk do t'i njohë rezultatet e bisedimeve. Dhe atëhere, atë mund ta pushtojë përsëri xhindi i "dufit katundaresk", dhe, mes tij, do të gjendeshin patjetër ca "elementë të pandreqshëm nostalgjikë komunistë"... Në këtë rast, ku do t'i kërkonit fajtorët e vërtetë, zoti Kadare?...

A themi se në Kosovë duhet të ndërtojmë demokracinë e vërtetë? Patjetër. Por ajo vendoset ashtu siç thoshte Ukshin Hoti për një rast të ngjajshëm me këtë që po flasim, për atë të Konferencës së quajtur "Londra- 2", në vitin 1993:

"Shqiptarët, sipas mendimit tim, është dashur të shkojnë në një konferencë të tillë me një kërkesë maksimale. Kërkesa maksimale, teorikisht do të impononte një delegacion të vetëm të shqiptarëve. Mirëpo,

këta e kanë parë të arsyeshm, e që të shkojnë me katër delegacione, gjë që do të thotë se, qysh më parë janë pajtuar me një status, me një zgjidhje të tillë që do të ishte zgjidhje parciale e problemit shqiptar." (Ukshin Hoti. *"Filozofia Politike", f. 268*).

Kështu ndërtohet demokracia dhe kështu zgjidhen problemet madhore kombëtare, apo jo? Mirpo, delegacionet tona jo vetëm që janë të ngjajshëm, sikundër thotë Ukshini, por, ca më keq, janë jopërfaqësues, sepse përbërjen e tyre e përcaktojnë eunukët shqiptarë dhe ndërkombëtarët e plotfuqishëm. Dhe, pjesëtarët e këtyre delegacioneve bëjnë si iu thonë këta lloj ustallarësh, i bëjnë temena Serbisë, në dëm të popullit të tyre..

Deri tani, populli shqiptar në Kosovë ka dhënë prova se di të dëgjojë dhe të bindet, ndërsa ndërkombëtarët dhe politikanët shqiptarë, kanë bërë kurdoherë të kundërtën. Ata kanë bërë të shurdhërin ndaj kërkesave të popullit tonë. Po, ç'po iu lodh kot edhe unë me këta politikanët e skopitur vendorë, zotëri! E ku kanë veshë ata? Ata shohin në sy vetëm PSSP dhe ai i drejton si manekinë, vetëm me shenja. Sus! ia bën ai me shenjë, sus rrinë ata; hop! kërkon ai, hopa hidhen ata. Ndërsa popullit, me atë farë Kornize Skllavëruese, nuk i jepet mundësia dhe e drejta të shprehet përmes referendumit, sikundër është vendosur e firmosur dikur në Rambuje, sikundër na është thënë.

E treta, kush duhet të jetë palë e tretë në bisedimet Serbi-Kosovë? Duhet të jetë një institucion ndërkombëtar vendimmarrës, që nesër, të ketë tërë autoritetin dhe të drejtën të përdorë të gjitha mjetet e ligjshme për t'u zbatuar deri në një vendimet që do të merren e nënshkruhen nga të dyja palët në bisedime. Për këtë qëllim, doemos që duhet organizuar një konferencë a mbledhje ndërkombëtare për Kosovën. Me palë të tretë, natyrisht që unë kam parasysh një institucion të tillë prestigjioz e autoritar si OKB - ja, ose si Bashkimi Europian

dhe asnjë lloj krijese tjetër, si G 7 a G 8, a qofte me rigon, si i themi ne andej nga Gjirokastra.

E pra, në qoftë se nuk plotësohen këto kushte, populli ka të drejtë të zemërohet e të rebelohet, gjë që nuk do të jetë e lehtë të parandalohet, në rast se problemet do të sorollaten e do të shtyhen për në kalendat greke...

MOSPËRGJEGJËSITË DHE ABUZIMET E POLITIKANËVE DHE QEVERITARËVE E REVOLTOJNË POPULLIN, I CILI U KA DHËNË ATYRE VOTËN

Copra imazhesh të botës së vjetër notojnë në erë,
Pirgje kështjellash, paragrafë të vjetër kanunesh,
lecka legjendash
Të grisura e të coptuara nga era e revolucionit,
Vërtiten e vërtiten në rrathë të mëdhenj, të padukshëm
Duke kërkuar një qoshe të mbrojtur nga era ku të bien.
Ulen ngadalë mbi kokat tona. Ja, gati po na prekin.
Po erë e fuqishme përsëri i vërtit
Në një vorbull të tmerrshmë. Revolucioni kurrë nuk fle.

(I.Kadare, poezia: "Copra imazhesh")

Dihet se, të rebelohesh kur të shkelet dinjiteti kombëtar, është virtyti më i lartë. Dhe, popujt e virtytshëm, rebelohen në këto raste, pavarësisht nga shkalla e tyre e lartë ose e ulët e qytetërimit. Me faktet që do të sjellim më poshtë, besoj se edhe ju, zoti Kadare, do të arrini në të njëjtat përfundime dhe do të pajtoheni me mua.

A e dini ju, zoti Kadare se, pas luftës, ata "komandantët e mëdhenj" të UÇK-së, filluan të bënin diferencime deri edhe midis dëshmorëve, duke i graduar ata pas vdekjes? Dikë e bënë gjeneral (kuptohet, të afërmit, miqtë dhe shokët e tyre), dikë kolonel, dikë major, dikë kapiten e dikë toger, pa patur asnjë ligj, ose të paktën një vendim kolegjial nga një forum i dalë gjatë ose pas luftës.

Ju lutem, a mund të ma shpjegoni ju dhe ata që i bënë e i bëjnë këto hynere se ku ndryshon gjaku i një dëshmori nga gjaku i një tjetri? Unë di se, të gjithë dëshmorët, kanë një panteon të përbashkët dhe e kanë atë njësoj. Atëhere, përse këto diferencime? A ka titull dhe gradë më të lartë se të jesh Dëshmor i Atdheut? Mos vallë dëshmorët luftuan dhe ranë për t'iu dhënë dikush grada pas vdekjes?... A e shihni, a e kuptoni, zoti Kadare, se si po e shpërfillin dhe po e ndotin keqas botën e ëndërrave të dëshmorëve të Luftës sonë Çlirimtare me të tilla dallavere? Nuk janë pak, zoti Kadare. Janë mbi dymijë dëshmorë të rënë nëpër beteja, që i kemi përcjellë me lotë kristali e krisma, pa llogaritur të tjerët...

Dhe dalin ca spurdhjakër, shumicën e të cilëve më shumë e pa lufta, se sa e panë ata luftën, ca të vetgraduar gjeneralë e kolonelë si Osman Gazepi i dikurshëm (që në numër bëjnë më shumë se tërë gjeneralët dhe kolonelët e forcave të KFOR-it) dhe luajnë me gjakun e dëshmorëve. Kjo është të vësh kujen dhe jo ta etiketosh zemërimin e sinqertë të popullit si "ngucje ekstremiste"!...

Mund të të shpallin Hero Kombëtar edhe për së gjalli, edhe për së vdekuri; mund t'ua venë emrin tënd kryeqytetit të vendit, ose disa qyteteve, për shërbime të larta ndaj atdheut, por titullin DËSHMOR nuk mund ta marrësh kurrë, në rast se nuk ke rënë në luftën për çlirim. Dhe, më duhet të them se, të gjithë dëshmorët e Luftës Çlirimtare në Kosovë, kanë qenë shumë më të dalluar e të lavdishëm nga sa flitet sot për ta (nganjëherë edhe me hipokrizi). Do të ishte gjëja më e natyrshme që, me emrin e tyre, të pagëzohej një qytet, një shkollë a një institucion, por, t'i ndash ata nga njeri-tjetri dhe t'i diferencosh me grada, - ky është një provokim i hapur. Madje, më shumë se një provokim. Atëhere, ku e gjetën këta "të mençur" të drejtën për të bërë një përzgjedhje të tillë cinike e për t'i dalluar dëshmorët nga njeri - tjetri?!... Përse dikë e lartësojnë, duke e bërë gjeneral a kolonel, ndërsa dikë e fyejnë, duke e mëshiruar me gradën më të ulët?!... A nuk

shkaktojnë edhe këto lloj provokimesh zemërimin e popullit; a mund të heshtin e të ulin kokën familjarët e dëshmorëve që iu mohohen meritat e djemve pas vdekjes? Ç'duhet të bëjë populli në këto raste, pasi ka thënë një herë, dy herë, tri herë e më shumë: "More, nuk i keni mirë këto punë..." dhe këta palo ish-eprorë e liderë as që duan t'ia dinë për zërin e tij të urtë? Mos populli duhet të thotë përherë e përherë "Amin!"?...

A e dini ju, zoti Kadare, se shumë nga liderët e sotëm të partive politike, ministra - fantazmë (si ata që kanë qenë në luftën tonë çlirimtare, ashtu edhe ata që e kanë mallkuar e anatemuar atë), ish - komandantë "të mëdhenj", pa folur për disa biznesmenë, prapa të cilëve fshihen politikanë e deputetë të njohur, të shoqëruar nga dhjetra roje e badigardë, me xhipa e makina luksoze që kushtojnë me dhjetramijëra euro, ndërtojnë vila me shumë kate, që edhe juve ua keni zilinë, blejnë restorante, hotele, banesa e shitore në Kosovë, Shqipëri, Kroaci e Slloveni, frekuentojnë mjedise turistike me çmime marramendëse, i shetisin fëmijët me aviona të posaçëm, bëjnë dasma njëjavore si ajo e mbretit Zog, ndërkohë që, para se të fillonte lufta, nuk kishin as brekë?!... Ku i gjetën milionat, kur populli nuk ka as bukë të hajë?!... A mund të heshtë dhe të mos zemërohet populli përballë kësaj batërdie hajdutësh e njerëzish të korruptuar gjer në palcë? Sepse Kosova është shumë e vogël, zoti Kadare. Me një të hedhur të syrit, e shikon atë skaj më skaj...

Ju mund të mendoni se, këto gjëra, i them nga mllefi, nga "dufi katundaresk" që nuk arrita të jem edhe unë një i pasur i tillë; mund të më akuzoni se dua që të jenë përherë të varfër njerëzit që kanë dhënë kontribute për atdheun. Jo! Nuk mendoj dhe nuk e dëshiroj kurrë një gjë të tillë. Por përgjigjen më të mirë për këtë problem e jep Rusoi. Ju, besoj se e keni lexuar, por jo këta profitërit e Kosovës. Ja se si shprehet ai te *"Ligjëratë mbi ekonominë politike":*

"Edhe për ata qytetarë që kanë bërë shërbime ndaj atdheut, do të jepen shpërblime nderi, por kurrë privilegje, ndryshe shteti do të ketë arritur në agun e të tatëpjetës së vet, sapo një njeri i vetëm në të do të mendojë se mund të mos i bindet ligjit dhe të jetë i pandëshkueshëm. Dhe, në se ndonjëherë, për fat të keq, ose fisnikëria, ose kasta ushtarake, apo çfardo tjetër klasë shoqërore, do ta bëjë të sajën këtë parim, gjithçka do të jetë e humbur pa shërim."

Teorikisht, njerëzit për të cilët e kam fjalën, nuk janë fisnikë, ata nuk përbëjnë ndonjë kastë ushtarake, ose ndonjë çfardo klasë tjetër shoqrore, po, prapseprapë, ata kanë krijuar të tërë së bashku një kastë mafiozësh të veshur me pushtet, që "e bëri të vetin këtë parim...", ndaj edhe mund të themi se gati "gjithçka do të jetë e humbur pa shërim..." Populli nuk e ka lexuar Rusoin, por ai nuk është i verbër, as budalla. Ai sheh, dëgjon, kupton, ndaj edhe Kosova u trondit nga tërmeti popullor, që i vuri aq shumë në alarm titullarët e administratave shtetërore, civilë dhe ushtarakë (aktivë dhe jo aktivë). Si thoni ju, kur tjetrit i janë vrarë djemtë apo vajza në luftën për çlirimin e Kosovës; kur i kanë mbetur sakat nga lufta një apo disa fëmijë të tjerë; kur i janë zhdukur familjarët dhe vazhdon të vuajë për bukë, a mund ta durojë ai këtë lloj kapardisjeje dhe pasurimi të pamerituar?... A nuk do të thotë kjo që të shkelësh e të harrosh sa hap e mbyll sytë edhe idealet e gjakun e të rënëve?... Po edhe fqinji i tij, që mund të mos jetë plagosur kaq egërsisht dhe mund të mos vuajë si ai, a nuk do të solidarizohet me të dhe a nuk do të zemërohet e rrebelohet përballë një polarizimi kaq të madh, kaq të shpejtë e kaq të padrejtë të shoqërisë, në dëm të shtresës që derdhi gjak e djersë për mëmëdhenë? Doemos. Si i thonë andej nga Gjirokastra: "Sheh fiku fikun dhe piqet."...

A e dini, zoti Kadare, se si shprehet me një humor të hidhur dhe tërë pezm populli i thjeshtë në Kosovë, kur shkojnë për të zgjidhur ndonjë hall nëpër komuna, institucione të

ndryshme shtëtërore, apo ministri? Po e them unë, pasi nuk ka ditë që nuk e dëgjoj: Ishallah nuk ka vdekur ndonjë i afërt prej administratës, thonë, prej portierit e deri tek titullari, ministri, se, një javë rrjesht do të rrijë mbyllur institucioni, pasi të gjithë do të shkojnë në shtëpinë e të ndierit (-rës), për të pritur "të pame" (ngushëllime). E tillë është shkalla e nepotizmit. Dhe ju habiteni se përse rrebelohet populli...

Ka edhe arsye të tjera se përse popullit tonë i humbi durimi, zoti Kadare. Disa ish -drejtues të luftës, që sot janë me pushtet civil apo ushtarak, kanë filluar të mburren, duke caktuar dhe festuar me të madhe datat e ringritjes së kazermave (fjetinave të ushtarëve), në vend të ditëve e datave të shënuara të luftës sonë të fundit çlirimtare. Më 1 nëntor 2003, më rastisi të ndodhesha në Lug(k)ar të Prishtinës, ku u festua dita e rindërtimit të fjetinave të ushtarëve, datë e cila është shënuar 42 ditë më vonë pasi UÇK-ja është shndërruar në TMK. E bukur mendje. Por veprime të tilla nuk janë kaq naive e "të pafajshme", jo. Me to, drejtuesit tanë përsëri duan t'iu bëjnë qejfin ndërkombëtarëve, madje edhe serbëve, duke pohuar tërthorazi se, në Kosovë nuk është bërë kurrfarë lufte çlirimtare, se nuk ka pasur as krime, as beteja dhe as të vrarë, të zhdukur, të masakruar ose të plagosur, ndaj nuk ka çfarë ditësh a datash të përkujtohen ose të festohen... Çudi për t'u çuditur!... Sa herë na janë djegur e shkatërruar kështjellat neve, shqiptarëve, zoti Kadare? Megjithatë, asnjëherë nuk kemi përkujtuar rindërtimin e tyre, por betejat e zhvilluara në to. Unë kështu e di.

Të festohej, të paktën, dita e parë e futjes në atë kazermë së forcave të Brigadës 153, kur ajo pastroi Prishtinën nga terroristët e fshehur, të ardhur nga Serbia, hajde de, mund ta pranonim me kënaqësi si një datë feste... Por, ta çvendosësh këtë ditë në mënyrën më absurde pesë muaj më vonë pas mbarimit të luftës, - kjo është sa marrëzi, aq edhe një sajesë ndjellakeqe. Mos vallë kjo është strategjia e atij

shtabi, sikundër foli përfaqësuesi i tij në atë tubim, që të jemi një popull pa histori, që brezave të ardhshëm t'iu themi se, kjo ushtri, e ka fillesën në ditën kur u lyen kazermat me gëlqere?!...

Këtë lloj tradite, kremtimin e ditëve të lyerjes së godinave ushtarake me gëlqere, le ta mbajnë e t'i pijnë lëngun ata që e kanë. Ndërsa ne, kemi aq shumë ditë, ngjarje të shënuara e data për t'i përkujtuar, kremtuar e festuar, sa s'dimë ku t'i çojmë, si i thonë fjalës. Në qoftë se e pranojmë që TMK-ja është pasardhëse e UÇK-së, atëhere le të festojmë ditët e krijimit të batalioneve, brigadave e zonave operative, ditët e luftimeve të suksesshme të tyre, që pasardhësit tanë të krenohen me të parët e tyre, ta dinë se bijtë dhe bijat e kujt janë. Të mos e bësh këtë, ta injorosh ose "ta harrosh" me qëllim, populli nuk ta fal, nuk e honeps dot dhe ka të drejtë të zemërohet e të rrebelohet, zoti Kadare.

Do të shtoja gjithashtu se, zotërinjtë e TMK-së edhe emërtimet e njësive luftarake të UÇK-së nuk i ruajtën, zoti Kadare. Sot nuk thuhet, për shembull brigada 111,114, 121, 133, 142, 153, 162 e të tjera, por ndryshe. Numëri i parë, njëshi, është zevendësuar me numërin 3. Përse e bënë zotërinjtë këtë? Çdo lloj përgjigjeje që mund të jepet, nuk është bindëse. Shumë bashkëluftëtarë dhe intelektualë shqiptarë të Kosovës, shprehin dyshimin se mos, me zevendësisimin e njëshit me treshin, pra duke e shndërruar, për shembull, shifrën 111 në 311, mos vallë synohet të ruhet vijimësia e Zonës së Tretë Ushtarake të Forcave të Armatosura të ish-Federatës Jugosllave, e cila përfshinte edhe Kosovën?!... Mos qoftë kështu, por populli "i nuhat" dhe i di të gjitha këto, zoti Kadare dhe ju e dini që, mbushet kupa e pastaj derdhet...

Si kanë vepruar dhe veprojnë shtetet e tjera në këto raste, zoti Kadare? Po marr, për shembull, emërtimet e njësive taktike dhe operative të ushtrisë italiane, të cilat edhe sot, janë të njëllojta me ato të formacioneve të ushtrisë së

Garibaldit. Ato emërtime janë ruajtur edhe kur erdhi fashizmi në fuqi, edhe kur u sulmua Shqipëria, Greqia e Jugosllavia; ato janë edhe sot, kur një pjesë e ushtrisë italiane ka ardhur në Kosovë. Ndërsa ne, në vend që të krijojmë traditën tonë, pasi për herë të parë krijuam në Kosovë një ushtri të rregullt e moderne, të dalë nga zjarri i luftës, nuk e respektuam këtë rregull krenarie, që e respekton e gjithë bota.

Me të drejtë, lind pyetja: Mos vallë këto veprime, që kanë lidhje me luftën tonë çlirimtare, bëhen për t'i humbur nami e nishani UÇK-së? Në këtë mënyrë, ne nuk mund ta quajmë nesër TMK-në trashëgimtare e vazhduese të UÇK-së, pasi nuk do të kemi asnjë gjurmë të kësaj të fundit. Këto veprime të mbrapshta e rrebelojnë popullin, zoti Kadare.

Ju, zoti Kadare, besoj se nuk dini edhe diçka tjetër, që shpjegon se përse u ngrit populli shqiptar i Kosovës në një revoltë të ndieshme dhe të njëhershmë kundër administratës vendore dhe asaj të UNMIK-ut dhe aspak kundër "çlirimtarëve", sikundër kërkoni të thoni ju e të tjerë. Në Kosovë, deri në atë datë, të gjithë shqiptarët janë dënuar sipas ligjeve të Serbisë. Mund të ma shpjegoni juve se si mund të ndërtohet demokracia në Kosovë, duke përdorur e zbatuar ligjet e kolonizatorit të saj?... Shqipëria është falenderuar nga BE për hartimin e ligjeve të standarteve auropiane. Përse nuk merren e të përshtaten ato ligje, kur edhe nuk ka nevojë të përkthehen? Po e jap unë përgjigjen: Me ligjet e Shqipërisë, ish-luftëtarët e UÇK-së nuk mund të quhen terroristë, ndërsa Serbia kishte hartuar ligje të posaçme për këtë qëllim. Ligje, që ndokush në Kosovë ose jashtë saj, i ka ende shumë për zemër.

Të mos harrojmë edhe diçka tjetër: Ato ligje, nuk interpretohen nga gjyqtarë të zgjedhur prej popullit, por të sjellë në Kosovë nga të huajtë, nga vendet e tjera, madje edhe nga shtete që nuk e dinë dhe nuk e njohin fjalën demokraci, si dhe nga gjykatës shqiptarë të diplomuar më së

shumti në Beograd, që kanë qenë ndër besnikët më të mëdhenj të ish - sundimtarëve serbë në Kosovë dhe që nuk i kanë dënuar shqiptarët sipas ligjeve, por sipas porosive të tyre. Po kështu mund të themi edhe për prokurorët shqiptarë e të huaj. Dhe, ajo që është akoma më skandaloze, i vetmi ligj i ri që është aplikuar në Kosovën e pasluftës deri në ngjarjet e marsit 2004, është ligji për përdorimin e dëshmitarit të fshehtë, të padeklaruar. Sipas këtij ligji, dëshmitarin e fshehtë (hajde e mbushja mendjen njeriut të thjeshtë se sa "i fshehtë" dhe sa i besueshëm është ai) nuk e njeh as i akuzuari dhe as avokati i tij; ai mbrohet, ka të drejtën të thotë ç'të dojë, të shpifë, të gënjejë, të sajojë të pavërteta, në interes të atyre që bëjnë arrestimet, akuzat dhe vetë gjyqet. Në Kosovë, kjo është absurde edhe ta mendosh e jo më ta bësh. Por ja që ndodh, ja që në këtë mënyrë janë dënuar deri tani gati 50 për qind e gjithë ish - luftëtarëve të UÇK-së. Kjo gjë të fut në mendime, zoti Kadare, por, mos u habisni, Kosova është sot bota dhe mbretëria e eksperimenteve...

Është gjithashtu edhe një ligj tjetër po kaq absurd: ai është ligji i të akuzuarit - bashkëpunëtor. Sipas këtij ligji, kur një person që është arrestuar për një vepër penale të kryer në bashkëpunim me dikë tjetër, pranon të bashkëpunojë me policinë, prokurorinë dhe gjykatën, - ai falet dhe të tjerët dënohen. Po mirë, kush na siguron dhe garanton se ky person nuk është provokator ose bashkëpunëtor i shërbimeve të huaja ose shqiptare (që gjithsesi, iu shërbejnë të huajve), me të vetmin qëllim të mbrapshtë: të penalizohen sa më shumë ish-luftëtarë të UÇK-së. Këta provokatorë - agjentë, njerëz pa parime e moral, që për atdhe, për nënë e për babë kanë vetëm paranë (dhe në Kosovë nuk është e vështirë të gjesh plot të tillë), e kanë më se të thjeshtë t'iu organizojnë e stisin rrengje e kurthe nga më të ndryshmit ish - luftëtarëve, të mbetur pa bukë e pa punë dhe pastaj të hiqen si "bashkëpunëtorë të penduar". Dhe, rastet kur këta lloj "të penduarish" kanë implikuar ish - luftëtarë të UÇK-së, nuk janë

të pakta. Të dyja këto ligje, zoti Kadare, i ka miratuar formalisht edhe kuvendi - kukull i Kosovës, me të vetmin qëllim, që UNMIK-u, i cili është skenaristi, regjizori, organizatori dhe zbatuesi i vërtetë i të tëra punëve që bëhen në Kosovë, të mbetet "dorëjashtë" dhe t'i lajë duartë si Pons Pilati.

A e dini, zoti Kadare, se, në këto pesë vite të pasluftës, në Kosovë po ndiqet një politikë e heshtur dhe e ethshme e shpopullimit të fshatit shqiptar dhe, nga ana tjetër, e forcimit të fshatit serb? Kjo politikë, maskohet me shprehje nga më të ndryshmet, si nga politikanët vendas, ashtu edhe nga të huajtë. Madje, një pjesë e tyre derdhin edhe lotë krokodili për këtë fenomen regresiv, por, në fakt, me politikat ekonomike që po zbatojnë në Kosovë, e bëjnë të detyrueshëm largimin e popullsisë së fshatrave malore drejt qyteteve të mëdha ose në emigracion, në të shumtën e rasteve në rrugë jo të rregullta.

Dhe, ja rezultati: Brenda 3-4 vjetëve pothuajse të gjitha fshatrat shqiptare në kufi me Serbinë janë shpopulluar e braktisur. Kjo rrudhosje e shqiptarëve, si pasojë e politikave të deritanishme dhe indiferencës totale administrative, pritet të sjellë pasoja tepër të rënda për Kosovën. Ja se ç'mund të ndodhë, madje do të ndodhë nesër me siguri, zoti Kadare:

E para, dhuratë më e mirë se shpopullimi i fshatrave në kufi me të, Serbisë nuk mund t'i bëhet. Nesër, do të jetë ajo e para që do të propozojë që këto fshatra, të popullohen me serbët e "larguar" nga Kosova. Kot nuk u krijua edhe ministria e Kthimit të të Shpërngulurve! Madje argumentimi i popullimit të atyre fshatrave me serbë, do të jetë shumë "bindës": shtrirja e njëjtë tëritoriale me fshatrat serbe, brenda kufijve të Serbisë.

E dyta, gjatë tetëdhjetë vjetëve të kolonizimit të Kosovës nga Serbia, kjo e fundit i ka bërë hipotekat e pronësisë mbi tokën ashtu si ka dashur ajo, kur dihet që, për këto qëllime, ka patur edhe memorandume strategjike. Nesër,

duke mos qenë ato fshatra të banuara nga shqiptarët, banorët e tyre të ligjshëm e autoktonë, serbët do të nxjerrin nga arkivat dokumentet që "vertetojnë" se, ato troje, kanë qenë pronë e tyre, pastaj do të bindin edhe Bashkimin Europian (që ka shumë qejf "të bindet", kur është fjala për serbët) dhe, kështu, fshatrat që kanë qenë nëpër shekuj pronë e shqiptarëve, do të tjetërsohen lehtësisht...

Të mos harrojmë, ka edhe një ligj ndërkombëtar për trashëgiminë mbi tokën, që Serbia do të përpiqet ta shfrytëzojë me mjeshtëri: Ligji thotë se, në qoftë se një pronë nuk shfrytëzohet dhe nuk i del për zot askush brenda dhjetë vjetësh, pa u penguar nga forca madhore, atëhere ajo pronë bëhet e shtetit. Ju kujtoj se, pesë vjet po mbushen dhe, edhe pesë vjet të tjerë, kalojnë sa hap e mbyll sytë... Po kush është shteti në këtë rast? Dihet ajo, shteti është Serbia, - këtë e thotë edhe Rezoluta 1244, edhe Marrveshja e Rambujesë. Ndaj dhe shtyhet jo pa qëllim kjo puna e statusit të Kosovës, zoti Kadare, hë sot e hë mot, që të mbushen si pa u kuptuar të dhjetë vjetët dhe Serbia të bëjë dasmën e mësipërme. Edhe kjo është një lloj "ferre", ku fle lepuri i moszhvillimit të referendumit për vetvendosje, tre vjet pas mbarimit të luftës, sikundër qe vendosur në Rambuje e që na e thatë edhe juve, zoti Kadare. Si e komentoni ju, zoti Kadare, që partitë politike të Kosovës, të cilat janë futur në parlament duke u shprehur se mbrojnë interesat e luftës së bërë, nuk protestuan dhe nuk e luajtën as gishtin e vogël për moszhvillimin e këtij referendumi në krye të tre viteve? Nuk ka asnjë lloj shpjegimi. Ka veçse fatalitet dhe hipokrizi të pashoqe nga ana e LDK-së, PDK-së dhe AAK-së, që e pranuan tërë servilizëm Kornizën Kushtetuese dhe u futën e po futen në zgjedhje në bazë të saj edhe pse hiqen sikur nuk janë me të...

E treta, duam s'duam, është i njohur fakti se, mbrojtësja e deritanishme e Kosovës, ka qenë kryesisht fshatarësia. Ndërkohë, duke u larguar drejt qyteteve të mëdha, tek kjo fshatarësi do të zbutet dalngadalë ajo ndjenjë sakrifice

aq e fortë për rezistencë dhe do të shtohet kështu armata e pacifistëve.

E katërta, a e keni pyetur ndonjëherë veten, zoti Kadare se përse UNMIK-u, qeveria e Kosovës dhe politikanët e saj në përgjithësi e kanë lejuar dhe po e lejojnë (për të mos thënë e stimulojnë) shpërnguljen e shqiptarëve nga fshatrat e qytetet e Medvegjës, Preshevës e Bujanovcit dhe e pranojnë sistemimin e tyre të përhershëm në Kosovë, ndërkohë që ulërasin e bërtasin, duke i përzenë me polici edhe lypësat me ngjyrë që vijnë nga Republika e Shqipërisë? Po jua them unë përgjigjen: Qëllimi është që të bëhet shpopullimi total i Luginës së Preshevës dhe, kështu, së bashku me fshatrat e tjerë shqiptarë të shpopulluar rishmëzi brenda Kosovës, të krijohet një hapësirë e konsiderueshme boshe, në kufi me teritoret e banuara serbe. Më vonë, dihet që do të synohet që ajo hapësirë të zihet nga kolonë serbë, duke arritur kështu zgjerimin real të Serbisë. Ju e dini që, Lugina e Preshevës, është i vetmi rrugëkalim i Serbisë e i Europës Qendrore për në Mesdhe. Dhe, pas kësaj, shqiptarëve nuk iu mbetet gjë tjetër, veçse të këndojnë këngë të ngjajshme me ato të Eposit të Kreshnikëve dhe të krenohen se dikur ato troje kanë qenë të shqiptarëve, por tani i ka marrë një bajloz i zi... A nuk po veprohet kështu për Toplicën e të tjera? Po heshtja apo mosveprimi përballë kësaj që po ndodh, a nuk përbëjnë tradhëti kombëtare, zoti Kadare? Nuk ka të drejtë populli të zemërohet për këtë?...

Po iu rikujtoj, zotëri edhe një fakt, që besoj se e njihni mirë. Para dy vjetësh, Maqedonisë i dhanë 2 500 ha të teritorit të Kosovës, të banuar përgjithësisht prej shqiptarësh autoktonë. Ia shkëputën Kosovës dhe ia dhanë Maqedonisë dhe... kaq, si të ishte ndonjë copë e shijshme byreku për stomakun e saj. As politikanët vendorë, as parlamentin fals të Kosovës, as presidentin tonë shumë të nderuar e të dekoruar edhe në Tiranë, as kryeministrin dhe qeverinë merre - merre

të Kosovës dhe as popullin shqiptar nuk i pyeti askush edhe pse këto gjëra bëhen me referendum dhe sipas rregullash e ligjesh ndërkombëtare dhe këtë ju e dini mirë. A ka ardhur "dynjaja" demokratike në Kosovë për të ndërtuar demokracinë? Atëhere, kjo është demokracia, për këtë jemi vrarë e gjakosur?!... A iu kujtohet se çfarë i keni thënë zotit Denis Fernandez për një gjë të ngjajshme me argumentin e mësipërm dhe që ka ndodhur me Rusinë?

"Kur Rusia s'pranon të lerë dy kilometra katrore nga teritori i saj, kjo gjë nuk skandalizon askënd. E, megjithatë, kjo Rusi është gjigandeske, e përbindshme. Ndërsa, kur është fjala për shqiptarët, atëhere prit! Pretendimet e tyre për të rifituar integritetin e vet, cilësohen si të rrezikshme. Por, ta themi midis nesh, cilat do të qenë pasojat?..." (I. Kadare. "*Kohë barbare*", f. 258)

Pyetjes që i drejtoni zotit Fernandez, po i përgjigjem unë, zoti Kadare: Po të kërkonin shqiptarët sot pak më shumë integritet, po të protestonin për aneksimin e tokave të tyre në favor të Maqedonisë dje e të Serbisë nesër, ata do të shpalleshin e quheshin pa mëdyshje si ekstremistë, njerëz me duf katundaresk, nostaligjikë komunistë, mosmirënjohës ndaj çlirimtarëve e të tjerë, e të tjera. Atëhere, kur edhe një shqiptar i madh e i njohur si juve, mban dy lloje qendrimesh dhe ka dy lloje gjykimesh brenda një periudhe kaq të shkurtër, ç'presim ne të na ndihmojnë të huajtë?!...

KUSH I DOGJI KISHAT?

Përse i le gërmadhat e Ilionit, ç'kërkon,
Që midis kohërave endesh si somnambul?
S'të mjaftuan zjarret, tempujt, klithmat e Trojës,
S'të mjaftuan qytetet që hëngre në kohët e
mëvonshme?
Tani hënë e bardhë, e vdekur mbi to shndrit.

(Ismail Kadare: Vargje nga poezia "Kali i Trojës".)

Në "analizën" për ngjarjet e marsit, ju, z. Kadare shpreheni se:*"Brenda një nate u dogjën aq kisha sa ndoshta nuk janë djegur gjatë një shekulli në Europë."*

Ndoshta është ashtu, por që të ketë aq shumë kisha serbe në Kosovë, vështirë se besohet. Ju, qëllimisht, nuk e jepni shifrën e kishave të djegura, me qëllim që ta befasoni e njëkohësisht ta bindni lexuesin apriori. Se përse e bëni këtë, mund ta shpjegoni vetëm ju…

Por, po qe se në Kosovë do të kish aq shumë kisha të djegura, do të besohej se në Kosovë predominon popullsia serbe dhe jo ajo shqiptare, gjë që nuk qëndron, pasi vetëm 13 kisha e manastire u dogjën dhe asnjë më shumë. Por a e dini ju, zoti Kadare, se, nga këto 13 kishat dhe manastiret, asnjë nuk u dogj gjatë ditës së parë të protestave? Ato u dogjën duke u gdhirë dita e dytë e protestave dhe gjatë asaj dite dhe, për çudi, brenda të njëjtës kohë në të gjithë Kosovën!.. Në qoftë se populli do të kishte atë urrejtjen që unë nuk e shoh gjëkundi, veçse në "argumentet" tuaja, atëhere përse nuk i dogji kishat dhe manastiret gjatë ditës së parë, kur nuk kish përforcime në to as nga ushtarë të KFOR - it dhe as nga polica e UNMIK - ut?...

Mirë. Me lejoni për një moment të kthehemi pak më prapa në kohë. Si e harruat kaq shpejt, zotëri, se, vetëm para pesë vjetësh, në Kosovë ka patur dy vite lufte të armatosur ndëretnike, midis shqiptarëve autoktonë dhe serbëve kolonizatorë dhe, sikundër dihet, gjatë asaj kohe nuk u dogj asnjë kishë apo manastir? Ja, në manastirin e Deviçit në Drenicë, për shembull, për nevoja të luftës, ishte instaluar një njësit i UÇK-së dhe jo vetëm që nuk u prek e nuk u prish asgjë, por edhe dy murgjërit që ishin atje, janë respektuar ashtu sikundër u takon njerëzve të nderuar të fesë. Kështu ka ndodhur edhe me manastirin e Deçanit dhe në shumë kisha të tjera, të cilat ndodheshin brenda territoreve që kontrollohshin nga UÇK-ja. Madje, ka patur edhe porosi e urdhra të rrepta nga Shtabi Përgjithëshëm për këtë qëllim, zotëri, që objektet e kultit kurrë të mos prekeshin.

Në rast se do të pranohet kjo që thoni juve dhe, në rast se do të pranohet edhe ajo tjetra, se "ekstremistët, të veshur me duhmë antiserbe" ishin ish-luftëtarë të UÇK-së, (paragjykim që e vërtetojnë arrestimet e shumta, për të cilat folëm më lart), natyrshëm lind pyetja: Në qoftë se këta "ekstremistë" ishin aq antitolerantë, pse nuk i dogjën ato kisha e manastire atëhere kur nuk mund t'i ndalonte e t'i akuzonte askush, se luftë ishte? Pse nuk i dogjën ato objekte kulti në shenjë hakmarrjeje në kohën që në Kosovë digjeshin xhamitë dhe shkatërroheshin të gjitha teqetë bektashiane prej formacioneve ushtarako - policore sërbe? Nuk i dogjën, e para, sepse nuk është në traditën e shqiptarit të merret me punë të tilla të errëta dhe, e dyta, sepse e dinin shumë mirë se çfarë ndieshmërie dhe ç'zhurmë e madhe propagandistike krijohet në raste të tilla… Dhe, të mos harrojmë që, në të kundërt, ushtria, policia dhe paramilitarët serbë dogjën e shkatërruan në Kosovë plot 218 xhami, kryesisht gjatë katër muajve të fundit të luftës. Si përfundim, duke perifrazuar fjalët tuaja, unë kam të drejtën morale të them se, kaq shumë xhami e teqe nuk u dogjën e nuk u shkatërruan as gjatë pesë kryqëzatave

të krishtërimit kundër muslimanizmit, zoti Kadare. Dhe të pyes: "Cilët janë primitivët e vërtetë, zotëri, ne, apo të tjerët?..."

Të mos harrojmë se, xhamitë dhe teqetë bektashiane shqiptare u dogjën në mënyrë të programuar e të organizuar, me urdhër të oficerëve serbë, pra me një vendim paraprak të shtetit serb.

Vetë zoti Wesli Klark e shpjegon këtë gjë në dëshminë e tij në gjyqin e Millosheviçit: *"Ishte e qartë nga burimet e tjera të besueshme se atje ishte një lloj selie e përbashkët e ushtrisë dhe policisë, nën drejtimin e Shahinoviçit, për të koordinuar veprimtaritë e ushtrisë dhe policisë në terren dhe për të evituar kontrollin e drejtpërdrejtë të forcave të armatosura nga Shtabi i Përgjithëshëm..., se atje kishte ende elementë, të cilët nuk ishin nën kontrollin e plotë politik të Milosheviçit."*

Dhe as juve e as Solana e kompani, as ata "çlirimtarët" europjanë, nuk thatë qoftë edhe një fjalë për djegien e tyre. Ne i dimë edhe arsyet, edhe psikologjinë që justifikon raste të tilla dhe që "përkthehen" pak a shumë kështu: "Ç'u lëron nënën shqiptarëve, ato janë institucione për myslimanët, të cilët nuk duhet të jetojnë në Europë, Europa është vetëm për të krishterët?..." A nuk janë tejet primitive edhe këto arsye dhe kjo lloj psikologjie, zotëri?

Lidhur me këtë problem, dëshiroj t'iu kujtoj se çfarë i keni thënë zotit Denis Fernandez, më 5 maj 1999:

"Dua të them që nuk iu shkrepi rastësisht në kokë: Shteti kriminel serb i kishte programuar dhe unë vazhdoj të jem i bindur se shërbimet e fshehta perëndimore qenë në dijeni."

Mua, zotëri, nga ato që kam parë në Kosovë, nga ato që di dhe që ndiej, më gërryen e më gërryen nga brenda një ide, një pyetje - fikse: Përse të mos themi se djegia e kishave serbe në Kosovë u bë përmes agjentëve të saj shqiptarë? A e dini, zotëri, se çfarë kanë deklaruar me gojën e tyre drejtuesit

kryesorë të shtetit serb në vitin 1999, menjëherë pas mbarimit të luftës, në lidhje me agjentët e tyre në Kosovë? Ne, thanë ata, kemi patur rreth 80 mijë agjentë të rregullt në Kosovë, që do të thotë agjentë të paguar rregullisht. Besoj se, shumicën e tyre, padroni i vjetër e ka ende nën komandë dhe ata vazhdojnë të jenë aktivë, gjë që shihet e kuptohet edhe nga informacioni shumë i hollësishëm që kanë mediat serbe për Kosovën. Mos i paguan kot Serbia ata agjentë?...

Fillimisht edhe unë nuk i kam besuar asaj shifre marramendëse, por më vonë jam bindur. Shumë intelektualë atdhetarë të moshës së thyer, të cilët në vitet '50-të kanë kryer kurset e partisë nëpër qytetet e Kosovës, tregojnë se, gjatë seminareve, iu është përsëritur shpesh se partia është shumë e organizuar dhe se forca e saj qendron te informacioni. Për këtë qëllim, thuhej, partia ka shërbimet e saj të fshehta. Për shembull, kujtojnë ata, na thoshnin se, në çdo 60 familje, sigurimi i shtetit ka 6 bashkëpunëtorë të rregullt, ndërsa kundërzbulimi i armatës ka parimin që, në çdo 60 familje, të ketë 12 bashkëpunëtorë të tillë. Këtij nuk mund t'i vesh emër tjetër, veçse spiunazh total, kjo do të thotë t'i ndërsesh të gjithë kundër të gjithëve dhe besoj se Kosova ka qenë një vend ideal eksperimentimi edhe në këtë fushë, për shkak të cinizmit me të cilin trajtoheshin shqiptarët.

A e dini, zoti Kadare, se "armata" e spiunëve na del se ishte dy deri tri herë më e madhe se efektivi i UÇK-së? Po të marrim parasysh se gjysma e popullit përbëhet nga pleq e fëmijë dhe po të heqim edhe vajzat e gratë e moshës së aftë për punë e për luftë, del që, në çdo 7-8 shqiptarë meshkuj të aftë për punë e luftë, ose në çdo 24 shqiptarë (duke llogaritur të tërë popullin e Kosovës), njëri ka qenë bashkëpunëtor i shërbimeve sekrete serbe (?!...).

Edhe në fillim të viteve '90-të, ishin kryesisht kosovarët e kësaj "armate" që erdhën në Shqipëri, të cilët, me bizneset dhe sjelljet e tyre, kishin për qëllim të nxisnin të

popullsia shqiptare e shtetit - amë ndjenjën e urrejtjes për Kosovën dhe shqiptarët e saj.

Edhe nxirja e realitetit nga gazetat që filluan të botoheshin në Prishtinë pas mbarimit të luftës dhe kthimit të popullit në trojet e veta, ku flitej vetëm keq për Shqipërinë dhe për popullin e saj dhe nuk thuhej asnjë fjalë mirënjohjeje për atë bujarinë e paparë ndonjëherë në historinë e njerëzimit, megjithë varfërinë e njohur dhe ekonominë e brishtë të shtetit shqiptar, bëhej me qëllimin djallëzor, që, nga njera anë, të bindeshin shqiptarët e Kosovës, refugjatë dhe jo – refugjatë, se kjo është Shqipëria e vërtetë dhe, nga ana tjetër, që edhe populli në Republikën e Shqipërisë të zemërohej për atë mosmirënjohje që shprehej nëpër gazetat e Prishtinës…

A e kuptoni se sa gabim bëni juve, kur po e përsërisni për të tretën herë se populli shqiptar i Kosovës duhet t'i falë këta spiunë, pa kërkuar, së pari, ata vetë falje, madje edhe pa e ndërprerë edhe sot veprimtarinë antishqiptare? Këtu, zotëri, juve shfaqeni i dyzuar dhe bini në një kontradiktë të thellë me vetveten. Kur bëhet fjalë për bashkëpuntorët e sigurimit të shtetit socialist shqiptar, të cilët në fund të fundit i kanë shërbyer, ashtu si i kanë shërbyer, vendit të tyre, ju kërkoni: *"të hapen arkivat sekrete pa asnjë kusht",* sikundër shkruani në përgjigjen që i dërgoni Blloshmit, përmes gazetës "*Shekulli*". Ndërsa për spiunët shqiptarë të Kosovës, që i kanë shërbyer një pushtuesi e kolonizatori (dhe kjo quhet thjesht tradhëti), ju, në sprovën, "*Shqiptarët në kërkim të një fati*", faqe 17, shkruani:

Në *një intervistë mendova të bëj një propozim mjaft delikat: Kosovarët e rekrutuar nga shërbimi sekret serb ishte mirë të faleshin publikisht prej Kosovës. Ishte e vetmia mënyrë për t'i shpëtuar nga ankthi…"*

Iu ardhka keq,… aq sa edhe mua më vjen shumë keq për këtë "mëshirën" tuaj të kulluar kristiane. Të gjorët, janë bërë për t'u qarë hallin. Të mos hapen dosjet e tyre, kërkoni

juve me “delikatesë” se qelbin dynjanë… Përse mbani, zotëri, dy qendrime diametralisht të kundërta për të njëjtin fenomen? Apo se Kosovën e konsideroni edhe juve ende si një “laborator” natyror eksperimentesh, apo se mendoni që spiunët këtu nuk kanë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me juve dhe nuk iu kanë bërë keq personalisht, gjë që në Shqipëri mund e duhet të ketë ndodhur?!... Në këtë rast, a nuk po shfaqeni edhe juve si një hakmarrës modern, zotëri, megjithëse keni folur e shkruar aq shumë kundër kësaj ndjenje primitive?...

Po le të kthehemi prapë tek spiunët në Kosovë. Me intuitën tuaj prej shkrimtari të madh, juve keni kapur diçka rreth asaj “armate” të stërmadhe, kur thoni në atë “analizë”:

“Në se do të vërtetohet, siç pritet, se dhuna ka qenë e organizuar…, nga shqiptarë të shitur te shërbimet e huaja, kryesisht serbe.”

Të jeni i sigurtë se djegiet janë organizuar e nxitur pikjërisht nga këta “shqiptarë të shitur” edhe pse, përsëri, mund të kërkoni të falen spiunët pa asnjë kusht. Më vjen keq, por nuk është hera e parë që juve, kur merreni me politikë, thoni të parën fjalë që iu vjen në mendje, duke harruar shpesh se çfarë keni thënë e shkruar më parë…

Edhe unë jam për atë, që të falen. Nuk jam për atë që bëri De Goli, pas Luftës së Dytë Botërore, i cili pushkatoi 13 mijë të tillë kolaboracionistë. Por, më parë duhen njohur dhe parandaluar për të vazhduar më tej rrugën e tyre të ndyrë, ndoshta edhe pa u shpallur se kur dhe kë kanë dëmtuar, me qëllim që të parandalohen hakmarrjet. Ndryshe, në Kosovë, tërë jetën do të kemi spiunë e tradhëtarë me bollëk dhe popullin shqiptar të Kosovës do ta brejë gjithnjë dyshimi.

Por, ç’them edhe unë! Nuk përjashtohet mundësia që të vijë dita dhe juve t’iu luteni atyre ta falin vetë popullin e Kosovës, që u çmend një ditë dhe shpërtheu një Luftë Çlirimtare, duke i prishur qetësinë Serbisë. Atëhere, do të ktheheshim t’iu luteshim edhe ne “ekstremistët”, duke thënë:

“Aman, na mbroni, na mëshironi!...” Se ata janë më shumë se ne, janë sa trefishi ynë, zotëri!...

Zoti Kadare, a e dini juve se çfarë flasin ca “gojë të këqija” këtej nga Kosova për djegiet e kishave? Thonë se janë parë edhe ca ushtarë të “çlirimtarëve” europjanë duke i spërkatur hyrjet e kishave me një lloj lëngu, që e trasportonin me ca bidona, si te ai teatri me Arturo Ui - në. Po “çlirimtarët” europjanë nuk bëjnë të liga, ai duhet të ketë qenë lëng kundra zjarrit. Vetëm se duhet të ketë qenë i skaduar, ndaj edhe zjarret që u vunë më pas e bënë se e bënë të vetën. Unë nuk iu besoj atyre gojëve. E kujtova këtë thashethem, jo për gjë, por vetëm e vetëm se andej nga rrini juve tani, ai milet është pak naiv dhe, kam frikë se mos i merrni për të vërteta ato që pëshpëriten për ca “çlirimtarë”…

Po ashtu, desha t’iu bëj me dije se, gjatë muajve janar dhe shkurt të këtij viti, kryeprifti i kishës serbe në Kosovë, Sava Jonjiç, nuk pushoi së foluri pothuajse çdo ditë në mediat sërbe, duke thënë se, së shpejti, në Kosovë do të kthehen pushteti dhe ushtria sërbe. Ku e dinte ai?!... Eshtë e qartë se këto shprehje kryeprifti nuk i thoshte për t’iu dhënë zemër serbëve që të mos iknin, por të ktheheshin në Kosovë. Jo, më shumë se kaq, ai kërkonte t’iu jepte sinjalin atyre të asaj armatës (që tashmë duhet të falen nga populli i Kosovës), që të ishin gati, se diçka do të ndodhte dhe diçka do të flitej, për të mirën e serbëve dhe për demonizimin e kosovarëve, ashtu sikundër ndodhi dhe sikundër u shprehën zotërinjtë Solana e Shifer, të mbështetur prej jush.

A iu kujtohet se çfarë keni shkruar në 7 prill 1999, te “*Ra ky mort e u pamë”*, në faqen 61, lidhur me këtë aftësi dhe perfiditet të shërbimeve serbe:

“Stili serb është ai i projektimit të krimit te pala kundërshtare. Përgatitet për masakër kundër të tjerëve dhe, ndërkaq, shpall se populli serb po masakrohet…”

Shumë bukur e keni thënë, zotëri! Atëhere, përse duhet të thoni sot të kundërtën, përse duhet të shpreheni në atë "analizë" se:

"U bë e besueshme teza e mbrapshtë se lufta në Kosovë nuk ka qënë luftë për liri, por për fé..., (që) t'iu mbjellin idenë fëmijëve dhe adoleshentëve se e keqja në Kosovë, përpara se të vinte nga Serbia diktatoriale , shoviniste e neokomuniste, ka ardhur nga kisha serbe."

Në qoftë se do të thoshnit se Serbia e veshi luftën e vet edhe me petkun e luftës kundër shqiptarëve, pse ata janë myslimanë, - këtë do ta besonim. Por, të thuash të kundërtën, këtu në Kosovë, - ky është një nonsens; këtë nuk e beson askush, përveç Solanës dhe Shiferit, të cilëve dihet që iu vjen mirë të dëgjojnë fjalë të tilla…

Kot që iu vjen mirë dhe kot që shpresojnë, zotëri! Le ta dinë ata zyrtarët europjanë, sidomos francezët, që juve i njihni mirë, se, po t'i lejohet popullit të Kosovës të vetvendosë për t'iu bashkangjitur trupit natyral të tij, të mos kenë frikë se mund të prishen manastiret dhe kishat e serbëve, as edhe për pakicën serbe të mos shqetësohen fare, pasi edhe juve e thoni te *"Ra ky mort e u pamë"* se *"populli shqiptar... mund të kritikohet për shumë gjëra, por ... nuk mund të mos lavdërohet për një gjë të mrekullueshme: tolerancën fetare, për të cilën ai, me sa duket, ze vendin e parë në botë*". Po kështu shkruani edhe për trajtimin e pakicave, duke sqaruar se, këto të fundit, janë trajtuar nga shteti shqiptar edhe më mirë se qytetarët e vet. Ju mund t'i siguroni me bindje të plotë se, serbët dhe kishat e tyre do të jenë më të sigurta në bashkimin Shqipëri - Kosovë, se sa në Kosovën - shtet më vete, edhe sikur Kosova të futet në BE para Shqipërisë. Besoj se këto gjëra juve i dini më mirë se kushdo tjetër, prandaj, iu lutem, shfrytëzojeni autoritetin tuaj në këtë drejtim dhe mos ndikoni që, lloj - lloj analistësh e politikanësh të merren me hipoteza dhe të shpallin si ekstremiste pjesën më idealiste e më kristalore të kombit shqiptar…

DEMONSTRUESIT ME GURË – USHTRIA ME PLUMBA

O ju korba atë natë
Syt' e zez përse m'i latë?
Drejt atdheut, n'errësirë,
ika detit,
Por të lidhur me zinxhirë
Prap e gjeta.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Baladë nizamësh")

Zoti Kadare! Kush i vrau shqiptarët demonstrues, ose ata që juve i quani ekstremistë? Kush qëlloi mbi ta?! Dhe, nuk janë pak, por plot 28 të tillë, shumica të rinj… Përse nuk ia bëni këtë pyetje vetes, sidomos kur dihet se armë në duar kishin vetëm policët ndërkombëtarë, serbët dhe KFOR-i, ndërsa populli ynë jo. Populli, kishte vetëm gurë. Atëhere, kush është ekstremist, ai që demonstron në mënyrë paqësore, apo ai që i përgjigjet demonstrimit paqësor me armë zjarri?...

Si e shpjegoni juve, zoti Kadare dhe ku është parë ndonjëherë në historinë e botës demokratike që, ushtarët e përgatitur për luftë të armatosur, të dalin me armë zjarri të mbushura para demonstruesve të paarmatosur dhe para adoleshentëve dhe fëmijëve?...

A e dini, zotëri, se në Itali, në vitin 2001, antiglobalistët hodhën më shumë granata "Molotov", se sa u hodhën gurë në Kosovë dhe, prapë ata u quajtën demonstrues, ndërsa ne u quajtëm popull ekstremist e jomirënjohës? Përse të ketë dy standarte demokracie? Në cilën konventë të OKB-së apo në dokumentet e Bashkimit Evropian thuhet që policia dhe ushtria kanë të drejtë të hapin zjarr kundër demonstruesve që përdorin vetëm gurë? Kjo gjë

ka ndodhur vetëm nën ish - regjimet e aparteidit në Afrikën e Jugut, kundër demonstruesve zezakë. Mos vallë kjo është e lejueshme dhe e pranueshme kur kemi të bëjmë me popuj që nuk bëjnë pjesë në Bashkimin Europian të Solanës, apo me popuj europjanë myslimanë, që mund të trajtohen e të përçmohen edhe më keq se zezakët e Afrikës së Jugut?...

"Nuk ka qeveri europiane që do ta mbijetonte një kërdi të tillë kundër dhjetra shtetasve, kështu si ndodhi në Kosovë.", shkruan bashkëluftëtari im, Shqiptar Oseku. *"Nuk ka qeveri europiane që do ta lëshonte urdhërin për të hapur zjarr dhe as ushtarak që do ta zbatonte një urdhër të tillë, kundër një turme që i ve zjarrin një kishe, një godine qeveritare, a një shtëpie të braktisur në Europë. Sepse tullat vendosen në vend përsëri, por jetët e njerëzve jo. Fakti që protektorati në Kosovë po orvatet t'i fshehë këto fakte e t'i shmanget përgjegjësisë së vet morale e juridike, është për mua, papërgjegjësi totale"*, përfundon ai.

KOSOVA MULTIETNIKE!?...

Kali përpin udhët,
Muzgu bie ngadalë.
Pse të dridhet freri
N'dorë gjeneral?
Leshrat gjithë pluhur
Të godasin sytë,
Mbi boshllëk të syve
Ball' i ftohtë i yt.

(*Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit")*

Tashmë, nuk është sekret të thuhet se, në Kosovë, kemi të bëjmë me zemërimin e një populli që ka shekuj që shtypet dhe që është mbi 95 për qind shqiptar, pavarësisht se Rugova, Thaçi, Rexhepi, Daci, Nano, Pëllumbi, Berisha, Meta e të tjerë, thonë se Kosova është multietnike. Sipas kritereve të Kombeve të Bashkuara, multietnik mund të quhet ai shtet dhe ai vend, i cili, nga të gjitha kombet përbërëse të tij, asnjë nuk e arrin shifrën 50 per qind. Rugova e di mirë këtë gjë, por i intereson të rrojë si pasha e të vdesë si pasha, pa ç`ia marton nënën popullit. Thaçi e di mirë këtë gjë, por i intereson të zerë vendin e Rugovës, me përkrahjen e të huajve. Daci e di mirë këtë gjë, por edhe ai kërkon t'i zërë vendin Rugovës, si në parti, ashtu edhe në poltron. Bajram Rexhepi e di mirë këtë gjë, por kërkon të ribëhet kryeministër edhe në zgjedhjet e ardhshme, madje ai e di më mirë se kushdo tjetër se këtë gjë e kanë në dorë ndërkombëtarët, ndërkohë që ia pa lezetin të qenit kryeministër. Dynja jallane kjo, zoti Kadare. Por të mos i gënjejë mendja dhe të vetbinden se populli i beson këtij lloj multietniciteti të shpikur të Kosovës. Çdo shtet aktual në

Ballkan, mund t'i afrohet të qenurit multietnik, por vetëm Kosova jo…

Vetëm Maqedonia mund të quhet me plot gojën shtet multietnik, pasi as maqedonët, as shqiptarët, as serbët, as turqit dhe as vllejtë e atjeshëm nuk e arrijnë shifrën 50 per qind, ndërsa Kosova është shumë - shumë larg kësaj përbërjeje. Për këtë arsye nuk mund të aplikohen ngjajshëm edhe në Kosovë kushtet e Marrveshjes së Ohrit, sikundër ka filluar të kërkojë zoti Thaçi kohët e fundit. Thuajuni atyre që përmenda më lart, me autoritetin dhe diturinë që këni, të shpikin ndonjë term tjetër për Kosovën, si puna e standarteve para statusit, ose ku di unë se çfarë dhe se si i kanë ngatërruar, pasi me multietnicitetin e Kosovës nuk u doli gjë dhe popullin e kanë zemëruar, dhe kjo është një nga të tjerat arsye që ai rrebeloi.

Në librin "*Ra ky mort e u pamë"*, në faqen 204, juve shkruani: *"Nuk u morrën parasysh 18 shekujt e jetës së saj (Kosovës), por dy shekujt e pushtimit sllav."*

Po tani, përse nuk i sqaroni ata të Bashkimit Europian, që nuk e marrin parasysh 95 përqindëshin e përbërjes shqiptare të Kosovës, por merren me 5 per qindëshin e pakicës serbe dhe e barazojë me 95 per qindëshin shqiptar, vetëm e vëtëm që ta quajnë Kosovën, ashtu siç atyre iu pëlqen ta quajnë, multietnike?! Dhe, përse kësaj daulleje i bien me aq pasion edhe politikanët shqiptarë të të dy anëve?!...

Interesant, sa të përkushtuar janë këta "çlirimtarët" europianë, zoti Kadare, që të gjitha çështjet jetike, të cilat kanë të bëjnë me shqiptarët, t'i bëjnë fiktive, të paqena dhe të na shesin si të vërteta vetëm fraza demagogjike?! Ja, për shembull: Gjatë zhvillimit të luftës, UÇK-ja u quajt nga ata vetë si një ushtri kryengritëse dhe si aleatja në terren e NATO-s, ndërsa sot e quajnë terroriste, anarkiste e ekstremiste. Për TMK-në, jemi marrë vesh, më 21 qershor 1999, që të ishte një lloj force e ngjajshme me Gardën Kombëtare Amerikane,

ndërsa faktikisht është një lloj ndërmarrjeje komunale me uniformë ushtarake; zyrtarisht Kosovën e quajnë pjesë të Serbisë, ndërsa neve na thonë të kundërtën; zyrtarisht vendosin të bëhet referendumi për vetvendosjen, ndërsa neve na thonë dale, se nuk keni plotësuar ca standarte, "nuk dini të kriheni bukur"... Na thonë: delni në zgjedhje dhe zgjidhni parlamentin, ndërsa, nga ana tjetër, parlamenti ynë ka të drejtën vetëm të bluajë si mulliri pa kokra; na thonë se e paskemi ne fajin që nuk ka siguri në Kosovë edhe pse në Kosovë kanë ushtarë e policë më shumë së sa ka Italia aktualisht, edhe pse ajo Itali i ka popullsinë 25 herë dhe territorin 1000 herë më të mëdha se Kosova. Edhe pse thonë që çdo popull ka të drejtë të vetvendosë për fatin e tij, na bien e na imponojnë një Kornizë të shpifur Kushtetuese, që nuk të jep asnjë të drejtë, edhe na thonë pastaj, që përfaqësuesit më të mirë të popullit janë ata që zgjidhen drejtpërdrejt me votë prej tij, pastaj e bëjnë ligjin që deputetët t'i përzgjedhin me listë Përfaqësuesi Special dhe kryetarët e partive politike. Në të gjitha vendet demokratike, kryetarët e partive zgjidhen nga partia, ndërsa këtu kryetarët vetshpallen dhe pastaj ata zgjedhin partinë; në çdo 100 banorë të Kosovës, 95 janë shqiptarë, ndërsa neve na thonë se jemi multietnikë, pasi mes nesh është edhe një serb, një turk, një boshnjak, një rom, një ashkali a një egjiptian, a një..., nuk e marr vesh, dhe plot e plot të tjera, më shumë se veglat e mitralozit të Metos...

A mund "t'iu jepni dum" këtyre gjërave, se neve këtej na e kanë bërë mëndjen dhallë. Kërkuam ndërhyrjen e Europës, që të na i zgjidhte këto halle, ajo na solli atë Kornizën që i futi liderët shqiptarë në vathë, sa s'bëjnë as gëk, as mëk. Mos vallë duhet të kthehemi shumë prapa në kohë dhe të fillojmë e të kërkojmë ndërhyrjen e hyjnive për të na i zgjidhur këto halle, këto ngatërresa, sikundër bënin paraardhësit tanë të motshëm, ashtu siç

shpreheni edhe juve në parathënien e librit të Rexhep Qoses “Vdekja më vjen prej syve të tillë”?

PËRKUSHTIMI PËR TË DËNUAR ISH - LUFTËTARËT E UÇK - së

Trok i kalit, trok i rëndë,
truallin e rreh.
N'ato varre kush është brënda,
ai gjithë i njeh.
Po pranë varreve të vjetër
sheh varre të rinj !
Ai rrudh ballin e rreptë,
armët tringëllin.
(Ismail Kadare Vargje nga poezia: "Kur bie nata")

E dini, zoti Kadare, se ku ndodhen sot ish-luftëtarët e UÇK-së? Kanë mbushur burgjet e Kosovës, duke iu montuar akuza nga më të ultat, ndërsa pjesa tjetër ka mbushur radhët e ushtrisë së të papunëve. Burgu dhe papunësia, për një ish-luftëtar idealist të lirisë, janë më keq se varri. Më shumë se gjysma e të burgosurve të Kosovës janë ish-luftëtarë të UÇK-së. Nga që ndërkombëtarët, së bashku me këta servilët tanë politikanë, po mundohen t'ia humbasin edhe emrin UÇK-së, tani po përpiqen t'i lënë historisë epitafin: UÇK-ja nuk ishte gjë tjetër, veçse një grumbullim terroristësh të frustuar. Madje edhe zotin Kofi Annan e kanë mashtruar dhe i kanë mbushur mendjen se, ish-luftëtarët e UÇK-së, janë të lidhur me organizatat terroriste. Edhe ai, së bashku me këta këtu në Kosovë, e shikojnë me përkushtim të madh mundësinë e arrestimeve dhe dënimeve të ish - luftëtarëve të UÇK-së. Ja se si shprehet zoti Annan në raportin vjetor për Kosovën, në paragrafin 47:

"Përkushtimi për të gjetur pjestarë të TMK - së, të lidhur me organizata ekstremiste dhe krimin e organizuar shënon një hap përpara në dhjetor 2003, kur një masë

disiplinore e ndërmarrë nga i dërguari im special solli suspendimin e 12 pjestarëve dhe hetimin e tyre nga policia. Ky ka qënë rezultat i hetimeve të përbashkëta të KFOR - it dhe UNMIK - ut, ... pas dyshimeve se disa pjestarë të TMK - së janë të lidhur me krimin e organizuar,... tek ata ka abuzim të funksionit, si dhe veprimtari ilegale."

Por, çfarë ndodhi më prapa, zoti Kadare? Në fillim të muajit qershor 2004, ata të dymbëdhjetë "ekstremistët" u rikthyen në detyrat e tyre të mëparshme në TMK, pasi "rezultati i hetimeve të përbashkëta të KFOR-it dhe UNMIK-ut" doli një zero me xhufkë, doli se ishin bazuar në të dhënat e shërbimit sekret serb, në të dhënat e rreme të pacifistëve dhe të armatës 80 - mijëshe të spiunëve dhe thashethemet e shërbimeve sekrete shqiptare, duke e demonizuar UÇK-në dhe ish-luftëtarët e saj. Besoj se keni filluar ta kuptoni që jeni ngutur disi në ato sharje, pavarësisht se unë nuk kam mundësi t'iu tregoj as majën e ajsbergut të padrejtësive ndaj UÇK-së dhe ish - pjestarëve të saj.

Që shpifej e shpifet kundër UÇK-së, juve, zoti Kadare, e keni shprehur edhe më 30 Dhjetor 1999, në intervistën dhënë gazetës zviceriane "Le Tempos", duke u shprehur:

" UÇK - ja është bërë viktimë e një demonizmi të ndikuar nga klishetë dhe skenarët serbë. Ajo është akuzuar herë si komuniste, herë si islamiste e mafioze, madje edhe në shërbim të Serbisë! Si rezistencë e armatosur, nuk përjashtohet mundësia edhe që të jenë bërë gabime...

Ata akuzohen edhe për terrorizëm, po ku, në ç'vend mbollën terror?!

Në Europë? Në Serbi?... Akuzat kundër tyre janë një dobësi e madhe.

Pikërisht këtu buron urrejtja e të ligjve ndaj trimave. Mbi të gjitha, këtu mendoj për pacifistët

shqiptarë, pasi ata e kanë akuzuar UÇK-në se është agjente e Serbisë!".

Edhe sot, pas pesë vjetësh, ato akuza kundër UÇK-së, jo vetëm që nuk janë reshtur, por, përkundrazi, janë intensifikuar në shkallën më të lartë. Tani, në mënyrë të institucionalizuar, me bekimin edhe të mjaft politikanëve e intelektualëve shqiptarë në Kosovë e jashtë saj.

Mendoj se duhet të kthjellohet dhe të shpjegohet me transparencë një gjë: ç'është gjithë ai përkushtim absurd i UNMIK-ut, por edhe i KFOR-it, për arrestime sa më të shumta dhe po kaq absurde të ish-luftëtarëve të UÇK-së; për mospranimin e atyre që janë të aftë për të punuar, në UNMIK dhe në KFOR; këmbëngulja e përhershme e tyre që termi UÇK të mos përmendet në asnjë dokument zyrtar, gjë që e thekson edhe vetë z. Kofi Annan, në raportin e dhënë së fundi, në Këshillin e Sigurimit, më 5 gusht 2004:

"…Një ligj i propozuar për statusin e Veteranëve të Luftës së UÇK - së…, term të cilin e hoqëm nga ligji…" *(Gazeta "Zeri",datë 5.8.04*).

Pra, thuhet se u hoq nga ligji pikërisht termi "Veteranët e Luftës së UÇK-së" dhe kjo flet qartë e hapur për mungesën e plotë të tolerancës ndaj çdo kërkese të shoqatave të dala nga lufta, si dhe për trajtimin e tërë ish-luftëtarëve si pengesa kryesore për mospranimin nga populli të multietnicitetit mosekzistent të Kosovës. Dhe kështu, dashje pa dashje, do të vijë një ditë që UNMIK-u, KFOR-i, parlamenti dhe qeveria e Kosovës të shndërrohen në armiq institucionalë kundër ish - pjesëtarëve të UÇK-së, të shndërrohen për ata në një lloj Babilonie biblike, me synimin e bërë qysh sot publik, që t'i humbasin UÇK-së edhe emrin. Mirpo, këto veprime dhe qëllime, popullin e irritojnë, sepse i cënojnë simbolin e Krenarisë Kombëtare, simbol i cili është i lidhur ngushtë me këtë popull, pasi ka ndodhur përzierja e gjakut të 2000 dëshmorëve, 2000 invalidëve dhe 14 mijë viktimave në fushat

dhe malet e Kosovës. Dhe, kjo përzierje gjaku, ka bërë që populli t'iu jetë çdo ditë e më shumë mirënjohës shokëve të tyre të mbetur gjallë. Këtë mirënjohje, populli e tregon në tubimet e përditshme që organizohen në Kosovë në përkujtim të të rënëve dhe të zhdukurve. Ndaj është mirë që, këtë fakt, ta fiksojnë të gjitha institucionet në Kosovë. Ata duhet ta dinë se UÇK-ja, krijimin dhe autoritetin e vet askujt nuk ia ka borxh asnjë individi, grupi individësh apo institucioni në Kosovë, por vetëm popullit shqiptar. Si rjedhojë, populli dhe ish - luftëtarët e tij nuk janë të detyruar që luftën e tyre t'ua kushtojnë disa "komandantëve" apo disa "liderëve", që pretendojnë se kanë monopolin e trashëgimtarëve të vetëm të UÇK-së. Këta të fundit, do të bëjnë mirë të jenë më të dëgjueshëm e më shoqërorë dhe të kenë më shumë respekt ndaj ish - luftëtarëve, sepse, me sa shihet, ata nuk e paskan njohur as luftën dhe as UÇK-në…

INSTITUCIONI I DORËHEQJES

Nata hesht mbi udhët
Larg zjarre çobenjsh.
Gjeneral Mojsi,
Përse shpatën zhvesh?
Rruga është e shkretë,
Troku natën mbush.
Veç ndërgjegjes sate,
Prapa s'të ndjek kush.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit")

Tek libri "*Viti i mbrapshtë"*, për një situate të vështirë , të njëllojtë me atë që kanë gatuar sot në Kosovë UNMIK-u dhe politikanët shqiptarë të saj, juve, zoti Kadare, shpreheni:

"Kryeministri i pare shqipëtar, Ismail Qemaili, ka administruar troje 10 herë më të mëdha se Shqipëria, ai i njihte gjysmën e ministrave të jashtëm të Europës, ishte diplomati më i shkëlqyer i perandorisë. Megjithatë, që në krizën e parë, për të shmangur përçarjen, për hir të unitetit të vendit, hoqi dorë nga pushteti."

Ndërsa tani në vend që t'jua propozonit një ide të tillë liderëve shqiptarë të Kosovës, që e gatuan vetë këtë kaos, na i lavdëroni nga që nuk dhanë dorëheqjen dhe e injoruan popullin edhe më keq se Solana. Me sa duket edhe për këtë çështje paskeni ndryshuar mendim! Dua t'iu pyes: "Kur keni patur të drejtë, atëhere kur shpreheshit për plakun e madh e të mençur të Vlorës, apo sot, kur, teksa juve lavdëroni (Për të mos e prishur me ta, kuptohet.) liderët e Kosovës? Ne krahasojmë vetvetiu Ismail Qemalin me Dacin, Thaçin, Rugovën, Haradinajn, Rexhepin e kompani si në dije, në përvojë dhe në veprime demokratike dhe na vjen të shkulemi

gazit. Por ndoshta për juve, krahasimi është i natyrshëm, përderisa nuk thoni edhe sot atë të vërtetë të madhe që e keni thënë dje dhe përderisa merrni në mbrojtje të pambrojtshmen.

Paska ndërruar seneja, zoti Kadare! Në vend që t'i thoni e ta këshilloni këtë kastë të korruptuar politikanësh të largohet sa më parë, i lavdëroni e iu bëni hapur thirrje të qendrojnë në kolltuqe. Dhe ata, kur vjen puna te dorëheqja, heshtin si nata, a si gurët e varreve. Është i ëmbël kolltuku, zoti Kadare. Juve nuk e keni provuar, se s'iu është dashur e s'do t'iu duhet kurrë, ndaj dhe i quani nganjëherë politikanët psikopatë të çmendur.

Në vend që të turpëroheshin këta politikanët vendorë nga revolta e popullit, jo vetëm që u shprehën, sikundër i cituam në fillim, por, i frymëzuar patjetër edhe nga "analiza" juaj, njeri prej tyre, kryeministri Bajram Rexhepi, në Kuvendin e Dytë Zgjedhor të partisë së tij, më 27 Qershor 2004, deklaroi:

"Trazirat e marsit ishin të papranueshme dhe të dënueshme për institucionet e Kosovës dhe spektrin politik... Ngjarje të tilla nuk i duhen Kosovës." (Gazeta "*Epoka e Re"*, datë 28 Qershor 2004)

Juve, zotëri, jo vetëm që nuk iu kërkoni, qoftë edhe për mirësjellje, formalisht, zotërinjve Daci, Rugova, Rexhepi, Thaçi, Haradinaj dhe ministrave të tyre të japin dorëheqjen nga postet që ata mbajnë e që i kanë ndarë midis veti, por bëni të kundërtën, i kërkoni popullit shqiptar të heqë dorë nga kërkesat minimale të tij, duke u shprehur si një Zeus modern:

"Dënimi (*i kërkesave të popullit shqiptar në Kosovë, D.G.*), ndoshta është dashur disa herë më i ashpër seç duhet."

Do të ishte mungesë modestie nga ana ime t'iu thoshja me këtë rast: "Iu lumtë!...". Por, më lind e drejta të gjykoj si më poshtë: Në qoftë se Ismail Qemal Vlorën, që juve e vlerësoni realisht e me të drejtë aq lart, për aktin fisnik të tij, dhënien e dorëheqies, edhe pse e kish besimin në popull dhe e njihte dhe e respektonte tërë Europa dhe e gjithë

perandoria turke para se të bëhej kryeministër i Shqipërisë, po zotërinjtë Ibrahim Rugova, Nexhat Daci, Bajram Rexhepi e kompani, pa folur për ministrat e titullarët e tjerë, që "mbijnë" e shtohen çdo ditë si fara e hithrës, kush i ka njohur para se ata të mbrinin në postet që kanë patur dhe kanë? Kush ka besim në ta, përveç ndërkombëtarëve në Kosovë, kryetarëve të partive të tyre dhe disa militantëve? Askush tjetër, madje as edhe shokët e dikurshëm dhe kushërinjtë e tyre. Cili ka qenë autoriteti dhe veprimtaria e tyre atdhetare, intelektuale, politike dhe shoqërore, e krahasuar me atë të Ismail Qemalit, para se ata të uleshin në ato poste? Zero me xhufkë!.. E, atëhere, si mund të vazhdojnë të jenë ata në krye të popullit, që e kanë sjellë në pikën dhe frymën e fundit, ndërsa juve, duke mbyllur me dashje sytë e veshët para ca të vërtetave të hidhura dhe duke i marrë ata hapur në mbrojtje, i thoni pak a shumë popullit: Jep dorëheqje, o popull - raja, nga kërkesat e tua, se mërziten politikanët, mërziten ndërkombëtarët dhe "çlirimtarët", se… " dënimi ndaj teje ndoshta është dashur të jetë disa herë më i ashpër. (!?...)

Kështu, a nuk e kundërshtoni hapur Kadarenë e vitit 2000, që dorëheqjen e politikanëve dhe qeveritarëve, kur vendi bie në amulli për shkak të paaftësisë së tyre, e keni quajtur "ide shpëtuese"?...

Por, politikanët dhe qeveritarët tanë nuk pyesin hiç për këtë "ide shpëtuese". Ata, nuk duan dhe nuk mund ta japin dorëheqjen, sepse iu mungon ndërgjegjia, dinjiteti dhe aftësia për të ndierë përgjegjësi për detyrën dhe aftësia për të reaguar, si dhe, nuk janë mësuar të njohin sfidat.

Zotëri i nderuar! Këta politikanë, deputetë e qeveritarë, që juve i mbroni e i vini (ndoshta pa qëllim) mbi popullin e tyre, marrin nga dy e tri paga mujore shtetërore, si në kohën e merhumit Zog, ashtu sikundër marrin edhe familjet serbe në Kosovë, ndërkohë që juve hiqni dorë nga fjala juaj e rreptë

dhe e drejtpërdrejtë dhe iu drejtoheni atyre me fraza të tilla të mjegullta e "të sheqerosura":

"Deklarata e Qeverisë së Kosovës është një hap i parë serioz kundër së keqes. Por hapi është i pamjaftueshëm. Riparimi duhet të jetë më i thellë. Të zbresë me guxim në themelet e së keqes."

Dhe, cilët janë, sipas jush, "themelet e së keqes"?

"Humbja e idesë së mirëkuptimit e bashkëjetesës.", thoni. Ndërsa unë nënkuptoj: E keqja është populli, të cilit qeveria duhet t'ia mbledhë rripat, ta detyrojë e t'i imponojë mirëkuptimin e bashkëjetesën me serbët që nuk pranojnë t'u kërkojnë as falje për mynxyrat që na kanë bërë dhe të mos e lejojë të zemërohet e të rrebelohet, sepse populli është thjesht një turmë…

Ndoshta fjalët e mia tingëllojnë pak ashpër, por ju s'keni pse të mërziteni, zoti Kadare. Iu qetëson kryeministri i Kosovës, i cili, në javën e parë të Korrikut 2004, në një intervistë dhënë RTK-së, në lidhje me atë mirëkuptimin tuaj, u shpreh afërsisht kështu: "Po të mos kishim serbët në Kosovë do të na dukej jeta monotone…"

Juve mund të thoni se, mirë e ka thënë. Është e kuptueshme. Po a e dini, zotëri, se cili është në Kosovë kuptimi i këtyre fjalëve? Këtu, ato fjalë "përkthehen" e kuptohen në këtë mënyrë: neve, shqiptarëve, po nuk na vrave, po nuk na përdhunove nënat, motrat, gratë e vajzat, po nuk na dogje shtëpitë, po nuk na përzure me dhunë nga vatrat familjare dhe trojet e të parëve, që pastaj të dalin ca "të marrë" që të luftojnë dhe ca ndërkombëtarë që të na ndihmojnë, në mënyrë që të kthehemi e ta fillojmë jetën nga e para në çdo dekadë, gjithçka tjetër na duket… monotone.

A mund të qetësohet populli me këto lloj shprehjesh - budallaqe, të nxjerra nga goja e kryeministrit të tij, kur asnjë pjesëtar i mikropakicës serbe në Kosovë nuk e thotë një gjë të tillë, kur serbët e këtushëm dhe ata përtej kufirit nuk kanë kërkuar kurrë falje për ato lloj krime të llahtarshe që i kanë

bërë këtij populli, nga që kishin e kanë dajë “kalin”?!... Mirë këtij kryeministrit të Hashimit i falet, pasi nuk ka lexuar kurrë ndonjë Histori të Popullit Shqiptar, të shkruar nga shqiptarët. Por, ta thoni juve një gjë të tillë, - këtë nuk ka peshore që ta mbajë, pasi jo vetëm që jeni shqiptari më i kënduar, por jeni i pari edhe i vetmi intelektual shqiptar me reputacionin më të merituar kombëtar e ndërkombëtar, jeni ai që i dolët në mbrojte UÇK-së me guxim dhe hapur, si burrat, duke e cilësuaraq bukur: Dalëzotësja e Kosovës. Kaq shpejt e harruat dhe e mohuat UÇK-në, Kadare?!... Përse tani UÇK-së i duhet të jetë humbëse dhe jo dalëzotëse?!...

Juve e kuptoni se, po u ngrit populli të kërkojë të drejtat e tij, duke i spostuar institucionet dhe partitë, - kjo e trondit kryeministrin; atij i lëviz kolltuku. Por harron kryeministri që ai me familien e tij shkon e rri nga një muaj në plazhet e Sarandës apo të Turqisë, duke harxhuar nga 200 - 400 euro në natë, ndërsa atë sasi parash nuk i marrin si rroga mujore në Kosovë as dy familje. E shihni, zoti Kadare, se sa shqetësohen për popullin këta qeveritarët, ndaj dhe janë dakort me atë “analizën” tuaj, me të cilën i trimëruat, aq sa tani flasin broçkulla dhe prapë iu duket vetja të mençur? E kuptoni, zotëri, se sa peshë ka fjala juaj? Iu lutem, kursejeni për këta tanët, pasi po na tjetërsohen edhe ata që dje sakrifikuan për popullin dhe sot kanë nga një karrike të mjerë…

Sa për atë që thoni se edhe populli i dënoi ato veprime të vetë popullit, më vjen keq ta them, por ia ke këputur kot, si kau pelës!... E keni gabim,zotëri. Në ato revolta u ngrit njëherësh, i gjithë populli shqiptar në Kosovë. Revolta, shpërtheu njësoj sikur të ishin të gjithë të gatshëm dhe të prisnin sinjalin për t’u nisur, si ata atletët që presin në start sinjalin - krismë. U ngritën aq shpejt dhe njëherësh, sa edhe reparte ushtarake të gatshme të ishin, nuk do të kishin

vepruar me aq kompaktësi. Kështu shpërthyen revoltat e 17 marsit në Kosovë.

Atëherë, për cilin opinion publik e keni fjalën, zoti Kadare, mos keni parasysh vetëm punonjësit ndërkombëtarë të UNMIK - ut dhe ata serbë e shqiptarë të tij? Jo, zotëri, nuk është fjala për ndonjë "zemërim të verbër" të "ekstremistëve nostalgjikë komunistë", as për "duf katundaresk". Përkundrazi, kjo është një "ngucje" prej paaftësisë dhe djallëzisë së administratës ndërkombëtare dhe asaj vendore në Kosovë…

KTHESA E KADARESË

Qindra vite shkuan,
Ti lëviz si ankth.
Dimëron në qiej.
Por dheu s'të qas.
Në kalldrëme shekujsh
Troku yt i zi,
Mojsi i Golemve,
Gjeneral Moj-Zi.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit")

Me sa shohim e lexojmë, juve, zotëri, e keni nisur vallen e pakënaqësisë kundër UÇK-së, qysh në vitin 2001, kur filloi lufta e armatosur e popullit shqiptar në Maqedoni, i organizuar në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Në atë kohë, 2 prill 2001, (kujdes me një e dy prillin, z. Kadare, se, me sa duket e kini periudhën e ndërimit të gjakut dhe ndodh që gaboni), juve deklaruat nga Parisi: "Ata (*luftëtarët, D.G.*), nuk janë gjë tjetër, veçse disa enveristë të kuq", pavarësisht se, më vonë, kur mbaroi lufta, u përpoqët të flisnit ndryshe, siç e keni bërë zakon këto vitet e fundit: një herë ashtu e një herë kështu, si të fryjë era…

Dhe era në Maqedoni, fryu që ç'ke me të. Pikërisht ata "ekstremistët nostalgjikë enveristë", arritën atje që, jo vetëm t'i jepnin popullit të tyre Universitetin e Tetovës; jo vetëm që të flitet shqip në parlamentin e asaj që quhet Maqedoni; jo vetëm që të gëzojnë pasaportën edhe në gjuhën e tyre; jo vetëm të rindajnë tani territoret administrative sipas përkatësisë etnike (dhe nuk është vendi t'i shtjellojmë më gjatë rrjedhat e këtij suksesi), por bënë që edhe në qytetin e Shkupit të përdoret zyrtarisht gjuha shqipe, që nuk dihet se

prej sa shekujsh ka qenë e mohuar. Do të guxonit ta quanit edhe sot Ali Ahmetin dhe bashkluftëtarët e tij "elementë nostalgjikë enveristë, zotëri"?...

A e shihni, pra, se çfarë janë në gjendje të bëjnë djemtë e nënave, (të gjalmëzezave, themi ne andej nga Labëria), ata që ju i shatë e i mallkuat, i anatemuat e i etiketuat si "ekstremistë enveristë". Në tërë ato analiza e deklarata që keni bërë këto vitet e fundit kundër tyre, mungon vetëm një … munxadhënës. Këndojnë një këngë andej nga Gjirokastra jonë, zoti Kadare, besoj se e keni dëgjuar: "Atje ku s'na shkonte fjala, / Na i hapte rrugën palla…"

Mos është e paktë kjo arritje e shqiptarëve të Maqedonisë? Pyes, nga që nuk iu kam dëgjuar të flisni e të shkruani për këtë vendosmëri shqiptare, ndërkohë që edhe për spiunët shqiptarë në Kosovë keni folur e shkruar disa herë. Nuk e di në se keni patur mundësinë ta dalloni se arritja e atyre "enveristëve" në Maqedoni është më e madhja deri tash, pas mbarimit të tre luftrave çlirimtare të shqiptarëve, në Kosovë, Preshevë e Maqedoni.

Dhe, atë ditë që ju bëtë nga Parisi atë deklaratën, ndodhej atje edhe kryeministri i atëhershëm i Shqipërisë, ronxhobonxhua Ilir Meta, i cili menjëherë, vetëm disa orë pas jush, bëri të njëjtën deklaratë fyese, por, kuptohet, pa finesën tuaj. Mos vallë atë mëngjes i keni pirë kafetë bashkë me Ilir Metën?...

MJEGULLNAJA RRETH UÇK-së

Në qetësinë e natës vini veshin,
A nuk dëgjoni që larg një trok të mbytur?
Nga thellësitë e miteve të lashtë drejt qyteteve
tona moderne
Po trokon e avitet një kalë.
Është kali i Trojës.
……..
Klithnin "oh, "tradhëti"!, por ishte vonë,
Qytetet dergjeshin përdhe tërë plagë, tymra e
zjarre
Tek jepnin shpirt, ndienin mbi gjoks një peshë,
Ca patkonj të tmerrshëm.
Hapnin sytë me zor.
Mbi gjoks të tyre ti kishe vënë këmbët si një ankth
Dhe po u merrje frymën.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Kali i Trojës")

Fatkeqësisht, ajo mjegullnajë e pacifistave "trima" shqiptarë, sikundër shpreheni juve, zoti Kadare, erdhi duke u rritur, si rjedhojë e ndihmesës së shërbimeve të huaja të instaluara në Kosovë, por edhe e atyre tonave (të jemi të sinqertë). Dhe ajo krijoi edhe tek juve shumë paqartësi për UÇK-në dhe mundësitë e saj. Ajo propaganda, arriti gradualisht, të krijojë një histori të re, një mit negativ për UÇK-në, një histori të paqenë, sipas një mekanizmi të mbrapshtë, që edhe syri juaj i mprehtë prej shkrimtari të madh ende nuk po e dallon.

Duke qënë se UNMIK-u afroi në institucionet e veta ata lloj pacifistësh intelektualë shqiptarë, që dijet e tyre i kishin

vënë dikur në interes të politikës antishqiptare të ish - Jugosllavisë, për të cilat ishin shpërblyer më tepër se bujarisht, si dhe ish-punonjës së institucioneve të ndryshme të Kosovës nën Serbi dhe nën ish-Jugosllavi,-patën përparësinë dhe mundësinë të ndërtonin një histori të rreme, të paqenë për UÇK - në.

Njëkohësisht, në atë administratë u punësua edhe një pjesë e asaj "armatës", asaj hatasë katër herë më të madhe se UÇK-ja. Mos u habisni. Është e vërtetë që, një pjesë e popullit shqiptar në Kosovë, u bënë pjesë organike e ish - Jugosllavisë dhe, më vonë, e Serbisë, pra pjesëtarë në bëmat dhe krimet e saj. Kjo dihet, pasi ka ndodhur me çdo pushtues. Edhe diçka tjetër s'duhet nënvleftësuar: Duke sunduar në Kosovë, Serbia i kishte të gjitha mundësitë që bashkë puntorëve të saj të shërbimeve sekrete, t'iu jepte, ndoshta edhe falas, shumë pasuri nga ato të popullit shqiptar të Kosovës, duke iu krijuar kështu kushtet që të merrnin në dorë, pas lufte, ekonominë e Kosovës. Është fakt që tashti ata kanë krijuar edhe monopolet e tyre në shumë fusha të jetës ekonomike të Kosovës.

Mbështetur vetëm në faktet që rendita më lart, a bindeni, zotëri, që UÇK-ja luftoi për të përfituar vetëm ish - të pasurit dhe ish-bashkëpuntorët e Serbisë, sipas asaj aksiomës së njohur e të vërtetuar jo vetëm një herë se luftën e bëjnë fukarenjtë dhe e gëzojnë të pasurit? Kjo ndodhi, sepse, kryesisht ajo shtresë që ishte bërë e pasur me ndihmën e ish - regjimit, iu kundërvu me të gjitha forcat dhe mjetet UÇK-së, pasi kishte motivin, kushtet dhe detyrimin ta bënte këtë. Me mbarimin e luftës, ish - të pasurve iu krijuan kushte edhe më të përshtatëshme për të shtuar pasuritë e tyre. Si? Atyre iu ishin krijuar mundësitë të ndërtonin vila, si dhe kishin e kanë edhe banesa nëpër pallate, të tyret, ose nga ato që ua lanë serbët nën ruajtje. Vilat, ua lëshuan me qera ndërkombëtarëve, me nga 1000 deri 5000 mijë euro në muaj. Vetë ata dhe fëmijët e tyre, u punësuan në UNMIK, me rrogat

1000 euro e lart dhe banojnë "thjeshtësisht" nëpër pallate, ose në vilat që kanë ndërtuar nëpër fshatra (pasi veturat nuk iu kanë munguar dhe nuk iu mongojnë).

Përsa iu përket ish-luftëtarëve të UÇK-së, edhe atë banesë që e kishin para lufte, ua dogjën ushtria, policia dhe paramilitarët serbë; në UNMIK dhe në organizatat e tjera jo-qeveritare të huaja dhe vendore, nuk mund të punësohen, pasi janë me "njollë" në biografi, si nacionalistë ekstremë. Duan bashkimin e shqiptarëve, gjë që nuk është pak etj. Mjerë ai që krenohet se është shqiptar, menjëherë e cilësojnë si nacionalist. Dhe, të parët që ua venë me shumë qejf këtë nofkë janë ata, politikanët tanë dhe pacifistët, ata ua çojnë listat e "ekstremistëve nacionalistë" të huajve, përmes shërbimeve sekrete shqiptare.

Kuptohet edhe të huajtë nuk kanë si të veprojnë ndryshe. Thuaj po deshe se nuk kemi mësuar nga lufta e klasave. Thuaj po deshe se nuk janë të njëjtët drejtues të luftës së klasave, si në Shqipërinë e brendshme edhe në atë të jashtmen, por që kanë ndryshuar kostumin…

Atëhere, për kë dhe përse luftuan ish-luftëtarët e UÇK-së, kur edhe bashkimin me atdheun-amë nuk e fituan? A bindeni më në fund, zotëri, që lufta e bërë nga UÇK-ja veçse krijoi kushte për t'u pasuruar edhe më shumë ish-të pasurit? Edhe kjo është patjetër një nga arsyet e rëndësishme se përse populli, i pakënaqur e i zemëruar, rrebeloi.

Po të ishte treguar e aftë Qeveria e Përkohëshme e Kosovës dhe, po të ishte në pozita atdhetare diplomacia e asaj periudhe e shtetit shqiptar, duke ndikuar që të punësoheshin në institucionet ndërkombëtare të instaluara në Kosovën e pasluftës, ish-kuadro dhe ish - luftëtarë të UÇK-së, të aftë e me shkollë, të cilët nuk ishin pak, si dhe intelektualë shqiptarë të formuar kombëtarisht, atdhetarë në kuptimin e vërtetë të fjalës, dashamirës të popullit të tyre dhe jo servilë, si dhe njohës të historisë së vërtetë të UÇK-së, nuk do të kishte

ndodhur demonizimi i ish-luftëtarëve të UÇK-së si "ekstremistë", "uzurpatorë", "terroristë" etj., ata nuk do të denigroheshin dhe nuk do të viheshin nën një mal të tërë shpifjesh e akuzash e gjyqesh - farsë e të montuar.

Mbjeshtjellja e UÇK-së me mjegullnajën e dendur të mitit të një ushtrie "terroriste" dhe "të paaftë", me sa shihet, ka bërë të vetën edhe tek juve, zotëri, që tani nuk e konsideroni më si një Ushtri Çlirimtare. Ndodhi ajo që juve e keni vënë re qysh në 26 shkurt 1999 dhe e keni thënë te libri "*Ra ky mort e u pamë", f.39*:

"Të vërtetat përzihen me rrenat e me gjysmërrenat. Pas çdo veprimi e qendrimi vihet një pikëpyetje, kërkohet një enigmë, pas çdo projekti një djallëzi edhe më e madhe. Ka përpjekje të dukëshme për të krijuar kaos.

Krimi ka nevojë për mjegull."

Juve, e dini më mirë nga unë, zotëri, se, kur një gënjeshtër përsëritet për një kohë të gjatë, populli fillon t'i besojë asaj, për të mos thënë se, vjen një kohë që e besojnë edhe vetë gënjeshtarët që e kanë shpikur... Dhe, sikundër e keni thënë edhe vetë se: "Akuzat kundër tyre (*kundër UÇK - së, D.G.*) janë një dobësi e madhe... Mbi të gjitha këtu mendoj për pacifistët shqiptarë...", ata pacifistët shqiptarë e kanë përsëritur gjithnjë e më me forcë rrenën e të qenurit të UÇK - së ekstremiste, qysh kur ajo lindi dhe deri sot e kësaj dite. Më vonë, ato akuza e shpifje filluan t'i bëjnë të vetat, krahas disa shteteve sllave, edhe disa shtete prej atyre "çlirimtarëve " europianë, tuajët e të Rugovës. Të gjitha këto, bënë që atyre rrenave t'iu besoni edhe juve. Dhe, për mua dhe për shumë të tjerë si unë, kjo është gjëja më e çuditshme, sepse, sikundër thoni te libri "*Kohë barbare", f. 60:*

"Një shkrimtar është më tepër se një parti, ai është një atdhe më vete.

Ai flet në emër të këtij atdheu...ai është ekuvalenti, zëdhënësi i vlerave të epokës së tij. Mund të rilindë

atdheun e vet, t'i vendosë gjërat në një tjetër perspektivë, t'i paraqesë ato në një mënyrë tjetër."...

KUSH DHE SI E MASHTRUAN KADARENË PËR UÇK - në

Kjo rruga përdridhet
Si gjarpër i zi
Për ku po vrapon,
Gjeneral Mojsi?
Pelerinën era
Ta ngre me tallaz.
Pluhur shumë lë pas.

(Ismail Kadare, vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit")

Prej momentit kur juve, zoti Kadare, filluat të dyshonit te mundësitë e UÇK - së, deklaruat: "E vërteta është se UÇK-ja nuk e çliroi dhe as nuk kish mundësi ta çlironte Kosovën". Dhe, qysh atëhere, këta shpifësit e paguar, pacifistët disfatistë shqiptarë, u bënë ndaj jush edhe më lajkatarë nga ç'kanë qenë më parë dhe "iu mbuluan"me plot fjalë të ëmbla e premtime. Pra, sapo ata e panë se juve filluat të lëkundeshit, duke "harruar" ose mohuar ato që kishit thënë më parë (këtë shënjë e dhatë në vitin 2001, kur botuat atë *sprovën*), fërkuan duartë e morën zemër. Duke iu pasur juve në krah, ata shtuan edhe propagandën keqdashëse kundër UÇK-së, ashtu siç shtuan edhe radhët e pasuesve e idhtarëve të tyre; zunë e u bënë edhe më të rreptë, sepse fituan vende të mira pune dhe përkrahje të të gjitha drejtimeve nga "çlirimtarët" tuaj europianë. Në këtë mënyrë, atyre iu krijuan kushte ta shumëfishonin intrigën dhe shpifjen. Në këtë rikthim të atmosferës pacifiste, juve e ndryshuat kryekëput mendimin edhe për zotin Rugova, ndaj të cilit ishit shprehur shumë ashpër në ditët dhe muajtë e Luftës Çlirimtare të Kosovës. Kështu, në intervistën e parë pas asaj "analizës",

dhënë revistë zvicerane “Galatea”, në javën e parë të Prillit 2004, juve e shpallni Rugovën lider përparimtar për Kosovën.

Është e natyrshme të thuhet se përcaktime të tilla kontradiktore dhe qendrimet tuaja të mëvonshme, rrezatuan dukshëm në të gjithë veprimtarinë e pacifistëve shqiptarë, të cilët, me ato intrigat e tyre, vazhduan t’i turbullonin edhe më shumë mendjet e shpirtrat e popullit të Kosovës dhe të shqiptarëve në tërësi, duke bërë bashkpuntorë në kurdisien e intrigave edhe një pjesë intelektualësh “të pavarur”. Madje, ata u treguan mjeshtër të vërtetë në këto lloj rekrutimesh, duke mashtruar edhe disa gjytyrimë karrieristë të ish-UÇK - së, të etur për lavdi, pushtet e pasuri dhe duke krijuar kështu një terren të përshtatëshëm për të goditur e mënjanuar nga të gjitha veprimtaritë, të gjithë ata shqiptarë në Kosovë, si dhe ata që erdhën e luftuan aty nga trojet e tjera amtare, që guxonin të shprehnin kundërshtimin më të vogël ndaj akuzave kundër UÇK - së, si dhe që nuk i miratonin veprimet e këtyre “gjytyrimëve” tanë.

Goditjet filluan me intrigat kundër pjesës më të pastër e më idealiste, kryesisht ish - pjesëmarrës në Luftën Çlirimtare të Kosovës. Në mbështetje të këtyre shpifësve, kaluan edhe shumë provokatorë, të cilët patën edhe ndihmën e gjyqeve të fshehtë e të manipuluar, me gjyqtarë e prokurorë të huaj, por edhe vendas, në të cilët jepen dënime ndaj djemve që ishin në radhët e UÇK-së, duke shpërndarë nëma e mallkime mbi ata ish-luftëtarë të pabindur për zgjidhjet e ofruara nga politikanët ndërkombëtarë e ata vendas. Kjo lloj lufte frontale kundër figurave të UÇK-së, që duan t’i qëndrojnë besnikë betimit të tyre, ka arritur deri atje, sa dalin e do të dalin “dëshmitarë” nëpër gjyqe edhe persona e personalitete që, neve, ish-luftëtarëve, vdekja mund të na shkonte ndër mend, por kjo thikë pas shpine, kjo vepër e tyre e shëmtuar, - jo. Të mos harrojmë se ajo “armata e padukshme” 80 - mijëshe, ndoshta është unikale në botë për një popull prej 2 milionësh. Ajo armatë kanceroze i kish shtrirë metastazat e saj në çdo qelizë

të shoqërisë kosovare, kuptohet edhe në ato të UÇK - së. Ajo ishte (pse të mos themi se është) ndoshta më e madhe edhe se vetë Kolona e Pestë gjatë luftës së Spanjës Republikane, ku shkuan vullnetarë nga e gjithë bota. Përse të mos i themi dhe ne asaj: Shtylla e Pestë e UNMIK-ut. Kjo e jona, jo Kolona, por Shtylla, besoj se është më e stërmadhe. Është një hata. Kështu që nuk duhet të habitemi për dëshmitarët e fshehtë e të hapur, për tradhëti ndaj shokëve të luftës, pasi historia ka treguar shumë raste të ngjajshme. Do të rrojmë e do dëgjojmë edhe për këto punë në Kosovë. Kemi kohë. Atëherë, kam frikë se do të ndëroni përsëri mendje për faljen e spiunëve, që jua kanë me hile të gjithëve, ndoshta juve më shumë se të tjerëve, sepse nuk jeni një shqiptar i zakonshëm...

E kemi thënë edhe më lart, ish - luftëtarët dënohen ende me ligjet e Sërbisë të nxjerra në vitin 1989, kur ajo i hoqi Kosovës autonominë. Gjykohen e dënohen, pra, nga gjykata jolegjitime, nga prokurorë dhe gjyqtarë të huaj, të pazgjedhur as nga populli i Kosovës dhe as nga Parlamenti inekzistent i saj. Atëhere, si mund të presësh drejtësi gjykimi, kur edhe vetë akuzat hartohen sipas ligjeve të atij shteti, kundër të cilit u ngrit populli dhe rrëmbeu armët. Të gjithë ata, që patën dhe kanë kurajon ta ngrejnë zërin kundër këtij ilegjitimiteti, janë dënuar dhe po dënohen me ashpërsi. Ndërsa “të bindurit”, spiunët, bashkëpunëtorët, pacifistët dhe veglat e tyre qorre, janë shpërblyer dhe po shpërblehen.

Bash në këtë kohë të trazuar, u shfaqët juve, me atë “analizën” tuaj, duke gjeneruar rrufe, mallkime, sharje e bubullima kundër ish-luftëtarëve të lirisë, këtej e tutje, nuk janë më dalëzotës e çlirimtarë, por...ekstremistë. Me atë “analizë”, zotëri, juve u shndëruat në një lloj shën Pjetri dhe, pacifistët e shpifësit i çuat në parajsë (se pak e kanë patur parajsën e deritanishme), ndërsa shumicën e popullit dhe çlirimtarët e tij, i dërguat në rrethin e shtatë të Purgatorit, duke i privuar edhe nga e drejta për të njohur të mirën dhe të keqen.

Zgjuarësia juaj e përcaktoi qartë ndarjen që ekziston në Kosovë: atdhedashësit nga njera anë (ata që krenohen se janë shqiptarë, por që, tash e tutje, për juve janë ekstremistë) dhe, nga ana tjetër, pacifistët (qurralëpirësit dhe puthadorët e të huajve, që edhe pse juve iu gënjen mëndja se janë shumica, koha do ta vërtetojë se sa e cilët janë). Përcaktimin ndarës e keni drejt, frontin dhe kriteret ku mbështeteni, janë të gabuara. Të paktën, ky është mendimi im.

Kjo vlen edhe për disa politikanë shqiptarë, që dikur kanë sakrifikuar së bashku me këta çlirimtarë. Nga dëshira për të marrë tek juve vizën për në parajsë, ata u larguan nga atdhedashësit dhe po mundohen të luajnë rolin e oportunistit.

LUFTA ÇLIRIMTARE DHE NDARJA E POPULLIT

Rrotull një boshllëk
Shtrihet nën re.
Toka është veç baltë,
Por jo më atdhe.
Toka si vejushë
Hoqi çdo stoli.
Vdiq atdheu, mbet balta
Nën trokun e zi.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit".)

Në momentin që filloi lufta e armatosur, populli në Kosovë u nda në dy grupacione kryesore. Sipas meje, në grupin e parë ishin pseudoatdhetarët, të cilët mbajtën gjatë gjithë kohës, një qendrim disfatist. Juve, zotëri, Kadare, e keni paraqitur shumë qartë strategjinë e këtyre njerëzve:

"Politika pacifiste-gandiste e kosovarëve, ka qenë e tillë që, jo ndeshje me armë, por as manifestime të thjeshta, nuk janë bërë askund." *("Ra ky mort e u pamë", f. 135.)*

Këta njerëz, të denjë për kohën e vendin ku lindën dhe për formimin e tyre të mangët atdhetar, ose bënin propagandë kundër UÇK-së, ose rrinin inaktivë, ose vetëdolën refugjatë në shtetin-amë dhe në Europë, me pretekstin se, ndaj ushtrisë së fortë e profesionale serbe, nuk mund të bëhet asgjë...

Edhe inteligjencia qytetare kosovare, në shumicën e saj, nuk e përkrahu luftën e armatosur, pasi ajo ishte përgatitur nga Beogradi me të njëjtën mendësi si edhe inteligjencia serbe, ishte një inteligjencie e përzgjedhur nga

Beogradi qysh kur pjesëtarët e saj ishin të rinj, kur në trurin e tyre mund të skaliteshin parimet e kulturës serbo-sllave. Kështu që, në shumicën e saj, ajo inteligjencie ishte tjetërsuar, kishte marrë fund së qeni shqiptare në botkuptim dhe luftonte si e sa mundte për një lloj jetese, ku kolonizatori serb dhe shqiptarët e kolonizuar të jetonin në paqe.

Vetë juve, zoti Kadare, kur i bëni pyetjen e dymbëdhjetë Ukshin Hotit, e përkufizoni shumë qartë këtë kategori të inteligjencies pacifiste:

"Dihen tashmë kritikat e forta kundër kësaj politike. Ajo quhet kapitulluese, ajo bëhet përgjegjëse për dështimin shqiptar të gjertanishëm në Kosovë, shkurt ajo quhet një politikë që i volit Sërbisë dhe jo shqiptarëve. Të tjerët, ata që e përkrahin këtë politikë, e quajnë të vetmen rrugë shpëtimi për Kosovën." (*Bisedë mes hekurave*", f.37)

Pse ata ndoqën atë politikë, ndaj edhe programuan zbrazjen e heshtur e të shpejtë të Kosovës. Qëllimi dihej dhe dihet, për të mos shpërthyer lufta çlirimtare në Kosovë.

Për atë vetëlargim të organizuar të shqiptarëve nga pacifistët, me të drejtë juve reaguat menjëherë. Ja çfarë keni thënë te libri "*Ra ky mort e u pamë", f. 92 - 93:*

"Në të vërtetë gjëma e zbrazjes së Kosovës është dhjetë herë më e madhe se bombardimi i Serbisë. Çdo shtet grykës do të pranonte një bombardim, (kaq të kujdesëshëm, kaq kalorsiak!) për të zhvatur një tokë kaq të pasur si Kosova, bashkë me dy milionë skllevër në të... Kjo zbrazje kishte së paku dhjetë vjet që zhvillohej në sytë tonë, ditë për ditë..., ajo e kish fshehur me kujdes ngjyrën e saj dramatike... Agjenci udhëtarësh për në Gjermani ose Zvicër. Me fjalë të tjera, agjenci të vërteta, që bartnin skllevër...Atë që, sipas dhjatës së Çubrilloviçit duhej ta bënte ushtria dhe policia sërbe, po e bënin vetë agjencitë shqiptare të udhëtimit. Agjencitë me pronarë disa herë shqiptarë e serbë. Agjencitë që merrnin një shpërblim tjetër prej shtetit sërb.

Asnjë nga këto agjenci nuk u kritikua nga asnjë forcë politike në Kosovë.

Asnjë lider kosovar, asnjë filozof a shkrimtar nuk dha kushtrimin për këto zyra varrimi. Edhe kur u detyruan të flasin për to, folën pa zëmër, sa për të larë gojën. Në një përgjigje të tërthortë për një nga kushtrimet e ralla, bërë këtë herë jashtë Kosovës, Gandi i saj shpall se "s'ka zbrazje të Kosovës, ka vetëm ikje njerëzish". Ç'përgjigje! Kështu zbrazej Kosova nga rinia e saj. E bashkë me rininë, ikte fryma e rrebelimit, me të fikej çdo shpresë. Asnjë agjenci udhëtarësh nuk u dogj me vajguri në Prishtinë."

Ajo që qendron mbi të gjitha dhe që ndikoi e dëmtoi së tepërmi mbështetjen aktive të luftës nga populli, është se, në krye të këtij grupacioni, ishte një udhëheqje politike si LDK - ja dhe satelitët e saj. Ajo ishte një parti e organizuar dhe e shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës dhe në diasporë, në radhët e emigracionit. Kurrë nuk ka patur populli shqiptar një parti kaq të organizuar, kaq të madhe dhe me shtrirje në të gjitha kontinentet ku banonin shqiptarë. Dhe ndoshta, kurrë më nuk mund ta ketë, as ai dhe as ndonjë popull tjetër, sepse ajo lindi në një kohë të veçantë, në kushte të veçanta dhe kishte një mison të madh. Se sa e si e plotësoi këtë mision, le t'ia lemë historisë, le të flasin më mirë për këtë analistët e studiuesit e Kosovës, që janë më të mirëinformuar...

Duke pasur këtë status, ajo forcë politike vuri në lëvizje jo vetëm strukturat e saj politike e partiake, por edhe organet shtetërore dhe ekonomike që kishte krijuar në Kosovë dhe jashtë Kosove. Si e tillë, LDK - ja pat organizuar një unitet organik në pjesën dërrmuese të popullit si nga ana politiko - ekonomike, ashtu edhe nga ana ushtarake, pasi dihet që krijoi FARK - un. Gjithë strategjia e saj, kishte prioritet shuarjen e luftës së armatosur çlirimtare në Kosovë, gjë që e shpjegoni edhe juve tek *"Ra ky mort e u pamë", f. 57:*

"Arsyetimi i LDK - së ka qenë: çdo demonstrim në rrugë do të jetë vdekje, do të na masakrojnë të gjithëve. Më mirë të heshtim."

Të kuptohemi, këtu bëhet fjalë për udhëheqjen kryesore të LDK-së dhe për strukturat poshtë saj dhe jo për antarët e thjeshtë, pasi shumë prej tyre dolën luftëtarë. Dhe, parafytyroni, zoti Kadare, që, në këto kushte kaq të disfavorshme për Kryengritjen e Armatosur në Kosovë, del përfaqësuesi i Shtabit të Përgjithëshëm i UÇK-së dhe deklaron se nuk paskesh nevojë për udhëheqje politike, çka donte të thoshte ta çoje luftën drejt katastrofës, ndaj dhe kam reaguar qysh në atë kohë.

Madje, pse LDK-ja kishte atë forcë organizative dhe pse kish atë qëllim për luftën e armatosur, ju e dini që grupacioni i parë, bëri një gabim strategjik në ato momente jetike për popullin shqiptar në Kosovë, që as edhe një politikan axhami nuk do të guxonte ta bënte: predikimin e një demokracie pluraliste në mes të një lufte guerile. Pse bëhej kjo? Që të shpartallohej dhe të çorientohej populli dhe sot, ata që predikonin dhe e synonin një gjë të tillë, dalin e na hiqen si atdhetarë të thekur. Mos vallë populli nuk i di dhe nuk i njeh se kush janë? Ndaj dhe u ngrit e rebeloi kundër hipokritëve që vazhdojnë ta drejtojnë e ta gënjejnë, sipas motos: "Prit gomar të mbijë bar."

Grupacioni tjetër, i kundërt me të parin, grupacioni i dytë i popullit, filloi ta shprehte pakënaqësinë, fillimisht në forma pasive, si për shembull, mbështetja e aksioneve që kryenin njësitet guerile dhe e formacioneve të ardhëshme të UÇK - së, duke i fshehur, ndihmuar dhe mos treguar aksionistët; duke hedhur poshtë e duke kundërshtuar propagandën pseudoatdhetare - pacifisto-gandiste-disfatiste - zbrazëse të Kosovës. Me kohë, mbështetia e tij u bë gjithnjë e më aktive. E, që të jemi më të saktë në këtë pikë, mbështetja më aktive luftës sonë i erdhi nga emigracioni. Ja se si detyrohet ta pranojë këtë fakt edhe gjeneralmajori i ushtrisë

jugosllave, Bzhidar Nikolla Deliç, ish - komandant i brigadës 529 të këmbësorisë së mekanizuar, me bazë në Prizren gjatë luftës, gjatë deponimeve të tij në Gjyqin e Hagës:

"Vullnetarët shqiptarë që vinin nga jashtë, dhanë një ndihmesë shumë të rëndësishme për UÇK-në."

Grupacionin e dytë në Kosovë, e përbënte më së shumti popullsia e fshatit dhe kjo pati arsyet e veta. Jo se popullsia e qytetit kosovar nuk ishte për lirinë e Kosovës, por propaganda pacifiste - disfatiste bëhej nga pjesëtarët e asaj popullsie, nga njerëz që ishin arsimtarë, mjekë, ekonomistë, inxhinjerë, hoxhallarë, me një fjalë intelektualë që gëzonin emër, simpati dhe autoritet në popull. Më e dëmshme në këtë kategori, ishte ajo pjesë intelektuale e ish - të burgosurve politikë, jo e paktë, që kishte përqafuar politikën pacifisto-gandiste.

Ndoshta lëvizja ilegale në qytet filloi edhe më shpejt se ajo në fshat, (aksionet e Zahir Pajazitit, i cili, në krye të njësiteve të tij, kishte për qëllim parandalimin e konsolidimit të institucioneve pushtuese dhe dekurajimin e shërbimit serb, duke goditur zyrtarët dhe kolaboracionistët më të egër e më të korruptuar, qeveritarët më të devotshëm të armikut), por kurrë nuk mund të merrte përmasat e lëvizjes si ajo në fshat, për shkak të dekonspirimit të shpejtë, pasi përballej me rreziqe të mëdha. Ilegalëve në qytete, iu duhej të punonin në kushtet e një konspiracioni shumë të thellë dhe pa armë, pasi në qytet kishim armatën pacifisto - disfatiste, që ishte më e rrezikshme se policia dhe shërbimi sekret serb, ndërkohë që ilegalët në fshat e kishin më të lehtë të mbroheshin nga kjo armatë.

Fshatarësia u bë rezerva e vërtetë e UÇK-së, pasi në fshatin kosovar, Serbia dhe RFJ-ja e kishin ndalur prej kohësh zhvillimin. Ndaj dhe fshatarësia rrebeloi dhe u shndërua shumë shpejt në një klasë radikale. Ajo vuante nga regjimi serb më tepër se sa banorët e qyteteve të Kosovës dhe, për të shpëtuar nga emigrimi i bijve të saj dhe nga vdekja prej

urisë, i nevojitej qoftë edhe një shkëndijë e vogël për të shpërthyer, ashtu sikundër shpërtheu.

Madje, në këtë luftë, u vërejt edhe një dukuri e rrallë: të gjithë bijt e larguar të fshatit në emigracion, me të shpërthyer lufta, u kthyen dhe mbushën radhët e UÇK-së, dukuri kjo që gati nuk është manifestuar në luftrat e mëparëshme. Edhe një pjesë e antarëve të LDK-së, që kishin shkuar në emigracion, u kthyen në Kosovë për t'u bërë luftëtarë të UÇK - së.

Pikërisht për arsyen se shumicën e luftëtarëve të UÇK-së e përbënte fshatarësia, udhëheqja politike e grupacionit të parë e klasifikoi atë padrejtësisht si të majtë, pastaj e etiketoi si enveriste, leniniste etj., kur dihet që fshatari pronar është baza e të djathtës. Ato etketime, ishin pjesë e strategjisë mashtruese pacifiste.

KU QENDRONTE EPËRSIA E LUFTËS SONË ÇLIRIMTARE?

Gjithë jetën mbetëm majë kalit,
Mbi tokën tonë, që na bekoi,
Ka kohë që s'shkelim me dy këmbë,
Por shkelim me katër patkonj.

(Ismail Kadare.Vargje nga poezia: "Kënga e ushtarëve të vjetër")

Me luftë guerile (partizane), ne që morëm pjesë në luftë, kuptojmë luftën masive, luftën popullore, me front jo të rregullt. Lufta jonë guerile nuk ishte gjë tjetër, veçse protestë e armatosur e popullit të zemëruar, që luftonte dhe kishte për qëllim të hiqte qafe pushtimin e egër shekullor të Serbisë nga Kosova, për t'u bashkuar ajo me Shqipërinë.

Dhe, UÇK-ja nuk ishte gjë tjetër, veçse forca kryesore goditëse e popullit të zemëruar shqiptar në Kosovë, por edhe pararoja luftarake e tij, nga që mungonte forca politike që duhej të delte në krye të asaj lufte. Pra, *UÇK-ja mori dy funksione, u bë njëkohësisht forcë goditëse dhe pararojë politike, ndaj dhe u shndërrua në një lëvizje çlirimtare me karakter mbarëshqiptar*.

Forcën dhe besimin në fitore, UÇK-ja e mori nga mbështetja e shumicës të këtij populli, si dhe nga mbarë kombi shqiptar. Po e theksoj edhe një herë: besimin në fitore e pati vetëm në mbështetjen mbarëshqiptare, por jo në udhëheqjen politike, pasi ajo nuk ekzistoi, ose, më saktë, u eleminua.

Edhe pse në fillim UÇK-ja luftonte me armë të thjeshta, dhe me një numur shumë më të vogël luftëtarësh në raport me policinë dhe ushtrinë sërbe, ajo përsëri nuk mund të

konsiderohej e paaftë të ndeshej me to (siç konsiderohet edhe sot, në disa nga shkrimet tuaja apo në intervistat e "strategëve" profanë), vetëm se nuk kishte të njëjtën sasi forcash e fuqi zjarri. Në mungesë të tyre, lufta që bënte UÇK-ja mbështetej nga populli. Pra, UÇK-së nuk i mungoi nevoja e domosdoshme, mbështetja nga populli në zonat ku ajo vepronte, ndërkohë që, këtë mbështetje, nuk e gëzonte as policia dhe as ushtria sërbe në Kosovë.

Mbështetja popullore që gëzoi qysh në fillim UÇK-ja, është një nga treguesit më kuptimplotë që vërteton se ajo nuk kishte tiparet e një ushtrie terroriste, sikundër donin ta etiketonin dhe duan. Këtu ndryshojnë ushtritë partizane nga ato terroriste, pasi këto të fundit nuk e kanë dhe nuk e gëzojnë mbështetien e popullit, ndaj dhe shfarosen shpejt nga forcat ushtarako -policore të çdo shteti.

Epërsia tjetër e UÇK-së, qendronte në njohjen me detaje të terrenit ku ajo vepronte. Luftëtarët e saj ishin bij të atyre fshatrave e rajoneve ku vepronin dhe i njihnin me sy mbyllur rrugët dhe drejtimet për hyrje e dalje nga çdo drejtim i mundëshëm ku mund të na vinte armiku. Kjo njohje, na jepte përparësinë për mundësi të larmishme manovrimi të shpejtë e të befasishëm, si dhe t'i njihnim mirë vëndet se ku duheshin fshehur njerëzit, mjetet, ushqimet etj. Këtë fakt e pohon edhe oficeri serb Bzhidar Deliç, që e përmendëm pak më lart:

"Për shkak të vendndodhjeve të tyre dhe mbrojtjes së organizuar, forcat e ushtrisë jugosllave dhe ato të ministrisë së punëve të brendshme e kishin tejet të vështirë të depërtonin, madje edhe t'iu afroheshim këtyre bazave."

Këto janë disa nga arsyet se përse lufta guerile filloi në fshatin kosovar, madje fillimisht në fshatrat më malore dhe më të vogla, sikundër ishin, për shembull, Likoci, Berisha, Fshati i Ri, Divjaka (Drenica e Jugore), ku u vendosën dhe vepruan gjatë gjithë luftës Shtabi i Përgjithëshëm i UÇK-së dhe institucionet e tjera të asaj lufte.

Në fshatrat e vogla e të thella malore, dihet që ka mungesë zhvillimi dhe varfëria e vuajtjet janë shumë më të mëdha se gjetkë, ndaj në këtë shkallë është edhe nevoja për ndryshime dhe përmirësimin rrënjësor të jetesës. Me një fjalë, UÇK-ja nuk ishte gjë tjetër, veçse interpretuese e dëshirave të masave popullore dhe kryesisht të atyre fshatare, pasi ajo përbënte shumicën e popullit në Kosovë dhe ishte më e vuajtura. UÇK-ja ishte protesta e armatosur e fshatarësisë dhe e pjesës tjetër të popullsisë shqiptare, të cilët bënë një luftë të drejtë për t'u bërë pronarë të asaj që ata, gjatë gjithë kohës, kishin dashur të ishin, që prona e tyre të mbetej një bazë e sigurtë jetësore edhe për pasardhësit.

Me këtë, nuk duhet kuptuar e thënë se lufta jonë çlirimtare ishte thjesht një luftë e fshatarësisë kundër teknologjisë dhe makinerisë ushtarake sërbe, sikundër thonë tërë mllef pacifistët. Ajo ishte një përleshje e vullnetit tonë kombëtar, e cila erdhi gradualisht duke u rritur e duke marrë tiparet e një kryengritjeje të vërtetë të armatosur, pavarësisht se këtë proces e ndërpreu në mes ndërhyrja e NATO-s.

Lufta partizane në Kosovë, kishte edhe një epërsi tjetër: ajo nuk i vari shpresat tek teknologjia dhe grumbullimi i miliardave (sikundër shprehet një ish - "lider", që nuk ka qënë asnjë ditë as në luftë dhe as në Kosovë), por tek njeriu, te populli. Kjo do të thotë se lufta jonë e armatosur u mbështet te zgjuarsia dhe mundësitë njerëzore, ndërsa ushtria sërbe u mbështet te diçka tjetër, diçka pasive.

Fatalisht, ushtria serbe ishte mbrujtur me mendësinë e kolonizatorit përherë shtypës e fitimtar dhe asnjëherë nuk ia bënte vetes pyetjen se çfarë do të ndodhte me të nesër, në rast se do të humbiste. Jo vetëm kaq, por ajo lloj ushtrie nuk merrej ose e nënvleftësonte politikën, ndërsa UÇK-ja merrej me politikë dhe e ngiti në politikë kërkesën e popullit. Pra, UÇK-ja krijoi në këtë aspekt një politikë dhe një mendësi të

re, fitimtare, ndaj dhe Serbia filloi të pësonte disfatë si në politikën e brendshme, ashtu edhe në aspektin ndërkombëtar, sepse ndeshej me një popull josllav të organizuar në një ushtri të armatosur dhe politike.

Lufta jonë erdhi duke u shkallëzuar gradualisht, pasi shfrytëzuam reagimin gradual të policisë dhe ushtrisë serbe, që nuk e kishin parashikuar rritjen e menjëhershme të UÇK-së. Strategjia e reagimit gradual të forcave serbe, nga populli ynë u kuptua si një lloj stepjeje dhe kjo e inkurajoi atë, duke shpresuar se do të vinte shpejt momenti për të realizuar një zgjidhje. Dhe ai përshkallëzim i shpejtë, solli edhe zgjidhje të shpejta, të imponuara edhe nga zhvillimet, koha e historia, sepse, përndryshe, rreziqet do të ishin shumë më të mëdha...

Gjithashtu lufta jonë, njëlloj si luftërat çlirimtare në vende të tjera, nxorri në pah edhe disa dukuri, ndër të cilat do të preferoja të veçoja:

1. Nuk është e nevojshme të presësh deri sa të krijohen të gjitha kushtet për kryengritje të armatosur; kryengritja i krijon vetë ato. E pamë 8 vjet me pritshmërinë pacifiste. Shpërthimi i saj në Kosovë e vërtetoi katërcipërisht atë përfundim.

2. Themelore në luftërat çlirimtare, është mbështetja popullore. Baza logjistike e kryengritjes në Kosovë ishte fshati, i cili mbeti i tillë deri në fund të saj.

3. Fitorja e luftimeve, betejave dhe e luftës përcaktohen nga morali i popullit dhe i ushtrisë së tij, nga këmbëngulja dhe mbijetesa dhe jo thjesht nga armët dhe raporti i forcave. Shembull më të mirë se sa e pamë me UÇK-në, nuk besoj se gjejmë. Po u jap një shembull kuptimplotë. Në luftën e Haraçinit luftuan jo më shumë se një togë luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare me një batalion të këmbsorisë së mekanizuar maqedone dhe pala e çlirimtarëvë dogji e kapi 16 tanke e autoblinda të armikut, përveç automjeteve të tjera, si dhe i kapi edhe 128 robër, ndërsa raporti i të vrarëve ishte një me trembëdhjetë në favor të

çlirimtarëve. Guerilasit tanë kishin vetëm armë dore këmbsorie e kundërtanke.

4. Sistemi i armëve, pajisjet fushore, pajisjet e komunikimit dhe të transportit, që janë paraparë nga ushtritë e përgatitura për luftë konvencionale kundërpartizane, sikundër ishte ajo serbe, shpesh do të luajnë një efektivitet të vogël, ose do të dështojnë tërësisht në terrene të thyera, kundër një ushtrie partizane, sikundër edhe ndodhi në Berishë, Gollak, Bajgorë, Topillë, Rugovë, Koshare, Pashtrik, etj.

5. Taktikat për luftë konvencionale, nuk kanë të njëjtin efektivitet kundër guerilasve, pasi forcat e ushtrisë pushtuese kanë nevojë për ripajisje, ristrukturime dhe ristërvitje, sepse i ndërron shpesh kontigjenti ushtar. Ndërsa luftëtarët tanë, jo vetëm që nuk zevendësoheshin me të rinj, por fitonin gjithnjë e më shumë përvojë dhe jua jepnin atë shumë shejt të rinjve dhe gjithnjë e më shumë rendimet tona luftarake ishin më efektive. Taktikat e ushtrisë serbe, sa më shumë kalonte koha e aq më pak të efekshme bëheshin, pasi taktikat e luftëtarëve tanë guerilas ndryshonin shumë shpejt dhe shumë shpesh. Edhe tanket, u pa se e kishin të kufizuar mundësinë kundër forcave tona kur përdornim taktikën guerile. Në ato kushte, ushtria serbe detyrohej më në fund të përdorte këmbsorinë e lehtë, dhe në të gjitha këto raste (flas për ato forca të UÇK-së që përdornin gjerësisht taktikën e luftës guerile) fitoria na pat buzëqeshur neve.

6. Mjetet luftarake të këmbësorisë dhe helikopterët, mund të luajnë një rol të rëndësishëm për kryerjen e manovrimeve dhe për mbështetjen me zjarr të forcave të një ushtrie të rregullt, por ato kanë efektivitet vetëm kur veprojnë në terrene të rrafshëta e të pabanuara dhe kur i përdorin mjetet e blinduara të transportit për mbështetje ose si rezervë manovruese. Por edhe pse në shumë terrene malore të Kosovës ka shumë nga këto kushte, sidomos Drenica, ato

mjete nuk mundën të përdoreshin kundër nesh me të njëjtin efektivitet si në luftimet midis dy ushtrive të rregullta.

7. Për ne guerilasit, që mbështeteshim në popullsinë fshatare, ishte shumë më e lehtë mbajtja e higjienës fushore dhe mbështetja mjekësore, ndërsa për ushtrinë e regullt serbe, kjo ishte shumë e vështirë të sigurohej, sidomos kur ajo detyrohej të vepronte për kohë të gjatë nëpër male, ndaj dhe largoheshin shpejt prej atyre rajoneve.

8. Uniteti i komandës është më i lehtë midis guerilasve, se sa në ushtritë e rregullta, pasi oficerët e kësaj të fundit mundohen të ruajnë secili kokën e vet, ndërsa komandantët partizanë janë idealistë të vërtetë dhe nuk e marrin parasysh rrezikun.

9. Kontrolli i qyteteve nga ushtria pushtuese serbe ishte një përparësi për të, por mund të ndodhë dhe e kundërta, mund të provohen edhe dëmtime, sikundër shihet në Irak. Lufta e jonë nuk mbriti deri në atë stad, pasi ndërhyri NATO-ja.

10. Dukuria më thelbësore, e nxjerrë nga përvoja e luftës sonë dhe nga të gjitha dukuritë e mësipërme, është se: Asnjë ushtri, sado e sofistikuar, e stërvitur mirë, e kompletuar deri në pe e në gjëlpërë, sado epërsi numerike të ketë dhe sado e pamëshirshme të tregohet, në qoftë se nuk është e aftë psikologjikisht dhe e motivuar për të luftuar, nuk mund ta fitojë luftën kundër një populli që ka vendosur të çlirohet. Ajo forcë ushtarake popullore, qoftë edhe e varfër në materiale dhe në numër, por që mbështetet në cilësitë morale, në vendosmërinë për fitore, në këmbënguljen vetijake dhe të pafundme, ajo gjithmonë, shpejt a vonë, do të fitojë.

DILEMA: KUSH E ÇLIROI KOSOVEN ?

Mojsi, ndërgjegjes,
Vallë si i re?
Ajo erret, bie
Mbytur gjak përdhe.
Larg dy-tri shkëndija
Potkonj shkrepëtit.
Ndan' udhës së madhe
Ndërgjegjja jep shpirt.

(Ismail Kadare.Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit".)

"UÇK – ja, Dalëzotësja e Kosovës."

Ismail Kadare

"Kosovën nuk e çliroi UÇK - ja, por Europa Perëndimore."

Ismail Kadare.

"Kosovën e çliroi bashkëveprimi luftarak i NATO - s me UÇK – në, të paraprirë nga SHBA - të."

Populli

"Në këto sulme, forca sulmuese përbëhej prej këmbsorisë së UÇK - së dhe aviacionit të NATO - s"

Bzhidar Deliç, ish oficer serb në luftën në Kosovë, Gjeneral Major.

Bazuar në "analizën" tuaj, z. Kadare, dalin pyetjet: Kush e meriton të quhet çlirimtar i Kosovës dhe kush e çliroi atë? Janë dy pyetje, që kërkojnë një përgjigje. Këto pyetje i shtruam qysh në fillim, meqenëse juve tani keni dalë në

përfundimin se, çlirimtarë të Kosovës janë ushtarët e shteteve europjane, pjestare të NATO - s.

Nga "analiza" juaj për ngjarjet e marsit, nuk mund të mos dalë përfundimi se, të gjitha shpërthimet popullore, na qenkërkan shprehje (demonstrime) të dufit katundaresk! Sipas jush, populli, i cili, përmes luftrave të vazhdueshme (që janë shpërthime popullore) dhe folklorit (të cilin e ruajti kryesisht fshati), na ruajti kombësinë, historinë, legjendat, kulturën dhe gjuhën, ka bërë gjënë më të keqe se, duke shprehur dufin e tij katundaresk, nuk na la të asimiloheshim si komb.

Dikur, një bashkëvendas i juaji, Avni Rustemi, i doli në mbrojtje Kosovës, vetëm pse një pasha shqiptaro - turk tha me cinizëm: "E dua Kosovën, por pa shqiptarët.", ndërsa pas 85 vjetësh, po me cinizëm e mendjemadhësi prej pashai, juve etiketoni si "duf katundaresk", rrebelimin këtij populli kundër vuajtjeve, varfërisë së madhe, padrejtësive, korrupsionit, përpjekjeve djallëzore të ndërkombëtarëve, serbëve dhe disa shqiptarëve të shitur për ta shpërngulur përsëri, por tash jo më me dhunë, por duke mos i krijuar asnjë lloj kushti për punë. Shkurt, vetëm e vetëm pse pati guximin të rrebelonte kundër padrejtësive të bëra nga administratat e Kosovës.

Sipas jush, meqenëse më ke bërë një nder, më ke ndihmuar të çlirohem nga një pushtues, paske të drejtën të zëvëndësosh pushtuesin në gjithçka!? Me këtë logjikë duhet të nënshtrohet edhe këtej e tutje populli i Kosovës?...

* *
*

Në atë "analizën" tuaj, midis të tjerave, shkruani: "U kapërcye një kufi që quhej i shenjtë: u goditën çlirimtarët...

Qëllimi i saj i vërtetë ka qënë pikërisht armiqësimi i shqiptarëve me Perëndimin."

Dhe kush janë sot çlirimtarët për juve, zoti Kadare? Të huajtë dhe vetëm të huajtë. Po ne të tjerët, ç'paskemi

bërë?! Ku e çuat UÇK-në, zotëri? E mohuat!?... Ani, thonë kosovarët. Ani, po them edhe unë, po prapseprapë UÇK- ja mbetet si një lapidar i madh dhe si një gur i rëndë themeli në çlirimin e Kosovës dhe në historinë e vetë kombit shqiptar. Përndryshe, përse nuk erdhi ajo NATO-ja "çlirimtare" e europjanëve atëhere kur populli i Kosovës lutej çdo të premte përmes Popit të saj musliman, të pagëzuar në katolik? Pse nuk erdhi ajo NATO "çlirimtare" europjane atëhere kur me qindra mijëra shqiptarë të Kosovës, për tetë vjet rrjesht, ngriheshin në demonstrata paqësore jo me armë, por vetëm me lugë e me pjata dhe ankoheshin e protestonin ndaj dhunës sërbe në Kosovë? Më në fund, përse ndërkombëtarët e mblodhën të vinin në Kosovë vetëm kur krisi dhe po rrezikohej të shpërthente ajo fuçia e njohur e barutit, përse erdhën ata vetëm kur doli DALËZOTËSJA e KOSOVËS, sikundër u shprehët juve për UÇK - në në mesin e vitit 1998?... Atëhere juve, zotëri, ndoshta nuk e dinit dhe nuk e mendonit se në Kosovë mund të vinte NATO-ja çlirimtare europjane, ndaj dhe e quajtët UÇK-në Dalëzotëse. Doemos që, në ato momente, juve keni menduar thjesht si një shqiptar idealist dhe jo si një njeri i shquar e analist, fjala e të cilit kërkohet të thuhet e të dëgjohet orë e pa kohë...

Dikur, edhe në kohën e monizmit, quhej absurditet edhe ta mendoje e jo më të shpreheshe se mund të ndodhte që, të gjithë shtetet e Europës Perëndimore dhe SHBA-të, të bashkoheshin ushtarakisht kundër një vendi të vetëm në Europë. Mirpo, ja që edhe absurditetin e dikurshëm e bëri realitet ajo Dalëzotësja, UÇK- ja, duke e hedhur tërë Europën mbi Serbinë, njëherësh dhe me maksimumin e forcave. Sikur të mos ishte në këtë mes UÇK - ja, të jeni i sigurtë se edhe Greqia do të kish marrë pjesë në këtë koalicion të madh, me forca ushtarake dhe me aeroportet e saj. Por, pikërisht se ishte Dalëzotësja UÇK, Greqinë e trembte qëllimi ynë strategjik, i shprehur thjesht dhe saktë në formulën e betimit të

luftëtarëve: Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Pse? Përgjigjen e jepni juve, më 13 prill 1999:

"Me sa dukej, një Shqipëri gjysëm e vdekur i voliste Greqisë... Është kjo e fundit që duhet ta trazonte ndërgjegjen greke, sidomos kur nisi tragjedia e Kosovës. Duke ruajtur gjithë përmasat, mund të thuhet pa frikë se drama e çamëve, djegiet e katundeve, vrasjet, së fundi shkulja e popullsisë dhe dëbimi drejt Shqipërisë, ngjan me atë çka ndodh këto ditë në veri. Mbulimi i krimit nuk përbën vetëm një cen moral, por nxit përtëritjen e tij."

(Ismail Kadare. "Ra ky mort e u pamë." F. 64 - 65)

Po sot, përse nuk flisni më me këtë gjuhë, zotëri? Përse e mohoni rolin e UÇK-së edhe si çlirimtare, por edhe si një faktor kryesor që ndikoi fuqimisht në ardhjen në Kosovë të ushtrive të NATO-s? Apo se kështu dhe jo ndryshe iu kanë këshilluar a urdhëruar të flisni?...

A iu kujtohet, zoti Kadare, se çfarë i thatë presidentit francez, zotit Zhak Shirak për UÇK-në, më 24 qershor 1999, në mëngjesin që hëngrët së bashku:

"Çështja e dytë që ngre, është problemi i UÇK-së. Ka shumë propagandë kundër saj. Ka demonizim. Do të jetë gabim fatal përjashtimi i UÇK-së nga proceset në Kosovë. Është e vetmja forcë që ka besueshmëri morale, sidomos në sytë e të rinjve e adoleshentëve. Energjia e saj, e disiplinuar natyrisht prej kontrollit të KFOR - it, duhet shfrytëzuar, sidomos për rivendosjen e rendit. Përjashtimi i saj, do të shtonte radhët e të zhgënjyerve."

Çuditërisht, pas kësaj deklarate, juve botuat sprovën: "*Shqiptarët në kërkim të një fati*", ku i ndryshuat kryekëput mendimet tuaja për UÇK-në dhe deklaruat:

"E vërteta është se UÇK - ja nuk e çliroi dhe as nuk kish mundësi ta çlironte Kosovën... Kosovën nuk e çliroi UÇK - ja, por Europa Perëndimore." (*Faqe 31*).

Dikush edhe mund të habitet se si është e mundur që Kadareja mori një pozicion të ri, diametralisht të kundërt me atë të mëparshmin, si për vlerësimin e UÇK-së, ashtu edhe për rolin dhe mundësitë e saj reale në çlirimin e Kosovës. Unë do të mendoja se, juve mbërritët në këtë pikë të re arsyetimi për UÇK-në dhe për njerëzit e saj, për arsye se u ndikuat nga mjegullnaja dhe propaganda anti-UÇK e shqiptarëve, pikërisht e atyre shqiptarëve që kishit parasysh juve në bisedën me zotin Zhak Shirak në 24 Qershor 1999:

"Çështja e dytë që ngre është problemi i UÇK-së.

Ka shumë prapagandë kundër saj. Ka demonizëm."

Po ashtu, juve ndërruat edhe mendimet që i patët dhënë gazetës "*Le Tempos*", në 30 Dhjetor 1999, ku shpreheshit:

"Ajo është akuzuar herë si komuniste, herë si islamiste e mafioze... Ata akuzohen edhe për terrorizëm, po ku, në ç'vend mbollën terror?!... Akuzat kundër tyre janë një dobësi e madhe. Pikërisht këtu buron urrejtja e të ligjve ndaj trimave. Mbi të gjitha këtu mendoj për pacifistët shqiptarë..."

* *
*

Lufta e përdorur nga UÇK-ja, zoti Kadare, kur ajo arriti të marrë formën e një ushtrie të regullt, ishte e një lloji të veçantë të luftërave, të njohura në Ballkan dhe në Europë, pas Luftës së Dytë Botërore. Mbështetur në njohjen time në terren, gjatë luftës, e cila për mua ishte sa profesionale aq edhe vetijake dhe, duke qënë në hallkat e larta drejtuese të asaj lufte në Kosovë, mund të them me përgjegjësinë e një ushtaraku specialist se lufta e UÇK-së, sidomos gjatë intervenimit të NATO-s, ishte pak a shumë e ngjashme me luftën e zhvilluar nga Ushtria Çlirimtare e Vietnamit të Jugut,

në vitet 1960-1972. Të mos harrojnë se 85 për qind e sulmeve të NATO - s u kryen në Serbi dhe jo në mbështetje të drejtpërdrejt në front, gjatë sulmeve të UÇK - së.

UÇK-ja ishte një ushtri moderne, që luftonte me taktikën e luftës guerile. Ky është tipari kryesor dallues i Luftës për Çlirimin e Kosovës, në periudhën nëntor 1998 - qershor 1999. Dhe, kjo don të thotë se UÇK-ja, duke qenë më e dobët ushtarakisht se sa ushtria serbe në shkallë strategjike, kishte si detyrë kryesore që të bëhej më e fortë se ajo në shkallë taktike, duke iu shmangur luftimeve dhe betejave të mëdha dhe duke mbajtur e zhvilluar epërsinë taktike. Qëllimi ishte që të kompensonim epërsinë serbe në shkallë strategjike, duke bërë konsumimin pjesë-pjesë të saj. Lufta jonë nuk synonte fitore mbi ushtrinë serbe; ajo synonte heqjen e sundimit serb nga Kosova, pasi sikundër thotë Wesli Klark :

"Rezistenca e guximshme është shpaguar shumë rallë dhe se forca ushtarake më së miri është ushtruar në aleancë me fuqitë më të mëdha."

Duke qënë se UÇK-ja ishte një ushtri moderne që luftonte me taktikën e luftës guerile, të ngjajshme me atë të Vitnamit të Jugut, kuptohet që ne ishim përgatitur për të bërë një luftë të gjatë. Dhe juve e dini mirë se luftrat popullore kanë gjunjëzuar dhe gjunjëzojnë perandori të tëra.

Përse e themi me bindje që UÇK-ja ishte një ushtri moderne?

Ishte e tillë, pasi ishte e organizuar në 28 brigada dhe në 7 zona operative, gjë që kurrë nuk është parë në historinë e popullit shqiptar të Kosovës. Përveç këtij organizimi, ajo plotësonte edhe këto kritere, që i jepnin tiparet e ushtrisë moderne:

1. Ajo ishte një ushtri e pajisur dhe e veshur me një uniformë të vetme, në të gjithë shtrirjen e saj në terren.

2. UÇK - ja kishte shënjën e vet dalluese, të cilën e mbante në uniformë çdo luftëtar i saj, deri te kuadri më i lartë.

3. Kishte organizimin e një ushtrie të rregullt, duke filluar që nga skuadra, toga, kompania, batalioni, brigada, zonat operative dhe deri te Shtabi i Përgjithshëm.

4. Funksiononte sistemi i komandimit në të gjitha nivelet që përmenda, si dhe u praktikuan shkolla e kurse kualifikimi të tyre gjatë luftës.

5. Ishte vendosur hierarkia dhe disiplina ushtarake, të sanksionuara në rregullat e saj me rregullore përkatëse funksionale, deri në dënimin më të rëndë. Në sajë të disiplinës sonë të rreptë dhe vetmohimit, UÇK-ja e ruajti të pacënuar entuziazmin e saj.

6. Funksiononin të gjitha drejtoritë, sektorët dhe dëgët e shërbimeve dhe armëve, në të gjithë piramidën ushtarake.

7. Ndaloheshin me rregullore dhe urdhëra, luftimet kundër popullsisë civile, e çfardo kombësie që të ishte ajo, madje edhe në rastet kur ajo popullsi mund të hapte zjarr kundër forcave tona.

8. Kishim sistemin e artilerisë. Natyrisht, ajo nuk ishte e shumtë, por të gjitha njësitë e UÇK-së kishin artlieri fushore, kurse me armatim të lehtë ishte pajisur shumë mirë e gjithë ushtria.

9. Funksiononte sistemi i komandim - ndërlidhjes: a) ai me radio, i cili funksiononte nga lart - poshtë dhe anasjelltas dhe shtrihej nga Shtabi i Përgjithëshëm deri në skuadër, në dy kanale; b) ai me telefon satelitor, i cili zbriste deri në brigade dhe c) ai i thjeshtë, me korier.

10. UÇK - ja kish krijuar bazat e rezervave për veshmbathje e ushqim, pavarësisht se bazën kryesore të furnizimit e kishte në popull. Përsa i përket furnizimit me armatim e municion ka patur një tendencë që ai të centralizohej, gjë që e shprehnin ata që nuk ishin në luftë, ose ata që hynin e dilnin shpesh herë nga Kosova, me qëllim që të privatizonin edhe luftën e ushtrinë. Ajo tendencë na solli

jo vetëm pengesa të ndryshme në rrugët e furnizimit me armatim, por edhe humbje në njerëz.

11. UÇK-ja kish edhe sistemin e edukimit, pavarësisht se jo në nivelin që ajo pati nevojë.

12. UÇK-ja kish medjat e saj: Radion *"Kosova e Lirë*", Agjencinë "*Kosova Press*" dhe gazetat periodike "*Çlirimi*" dhe "*Zëri i Kosovës*". (Për të qenë realist, duhet thënë se kjo pregatitej jashtë Kosovës dhe shpërndahej me vështirësi brenda në Kosovë.)

13. UÇK - ja kishte përfaqësuesit e saj politikë jashtë Kosovës. (Si e kryen detyrën ata, nuk është objekt i këtij diskutimi).

14. Ajo pati Përfaqësuesin e saj Politik brenda territorit të Kosovës, pavarësisht eleminimit të atij funksioni në prag të Konferencës së Rambujesë. (Kjo kërkon një analizë më vete, por paraprakisht mund të them se, kritikat tuaja të asaj kohe, rreth atij funksioni, nuk janë të mbështetura në analizën reale të situatës dhe, në shumicën e tyre, nuk qendrojnë).

Përveç tipareve të mësipërme, ka edhe fakte të tjera "kokëforta", që vërtetojnë qartë se UÇK-ja ishte një ushtri moderne:

55 për qind e të gjithë luftëtarëve të UÇK-së, ishin të moshës deri 29 vjeç, ndërsa mosha mesatare nuk i kalonte të 33 vjetët. Ish - të përndjekurit politikë dhe të dënuarit e tjerë për veprimtari atdhetare, që morën pjesë me armë në dorë në luftën për çlirimin e Kosovës, përbënin 25 për qind të UÇK-së dhe, mbi 70 për qind e tyre ishin me arsim të lartë. 20 për qind e UÇK-së ka qenë me arsim universitar, ndërsa 15 për qind me arsim universitar të pambaruar dhe 47 për qind ishin me arsim të mesëm. Mos u habit: 82 për qind e UÇK-së ishin me arsim të mesëm e atë universitar. Vetëm 18 për qind e luftëtarëve ishte me arsim fillor e tetëvjeçar. A nuk do ta kishte zili këtë nivel arsimor çdo ushtri moderne? Përballë tyre, a nuk mund të ndihet krenar çdo shqiptar, që, në një

moment të caktuar e të rëndësishëm historik, ky komb nxorri një ushtri vullnetare çlirimtare me mbi 82 për qind të saj me arsim të mesëm e të lartë?... Një ushtri të tillë, kaq të arsimuar dhe dhe kaq të vetdijshme, vështirë ta gjesh edhe në shtetet më të zhvilluara, të cilët i kanë kthyer ushtritë e regullta në ushtri profesioniste. Po t'iu shtojmë këtyre fakteve se 60 për qind e tërë luftëtarëve dhe dëshmorëve të UÇK-së kanë qenë prindër, atëhere argumenti bëhet sa i dhimbëshëm, aq edhe i pamohueshëm e krenar dhe çdo lloj etiketimi keqdashës do të ishte i papranueshëm dhe antikombëtar.

Pavarësisht nga shija e "hidhur" që mund të lejë krahasimi, nuk mund të mohohet se taktika e UÇK-së është pothuajse e njëllojtë me atë të Ushtrisë Çlirimtare të Vietnamit të Jugut. Po iu kujtoj, zotëri, se kundërshtari i asaj ushtrie ishte superfuqia më e madhe dhe më e fuqishme e kohës, e cila e bombardoi atë popull e atë ushtri, me të gjitha llojet e armëve e municioneve, si dhe me të gjithë teknologjinë më të sofistikuar ushtarake për atë kohë, duke hedhur mesatarisht 7 kg bomba për një njeri, ose tri herë më shumë bomba se gjatë tërë Luftës së Dytë Botërore. Përfundimi? Kundërshtari i madh i një ushtrie partizane u detyrua të ulej në tavolinën e bisedimeve dhe të largohej nga Vietnami i Jugut. Edhe pse kundër vietnamezëve u përdorën bombat me napalm dhe lëndët kimike, madje edhe bomba me peshe 7 ton, të hedhura nga aeroplanët e rëndë bombardues strategjikë, të cilat shkrinin gjithçka në një rreze prej 100 metrash (31 400 m^2) atje ku binin, shkaktonin një tërmet disaballësh në një rreze prej 3,5 kilometrash (40 km^2 ose 40 Milion m^2), përsëri ai popull dhe ajo ushtri e thjeshtë çlirimtare nuk u gjunjëzuan kurrë. Të tillë vendosmëri kishim ne, UÇK-ja dhe populli, që na mbështeti dhe që nuk dolëm e nuk kishim ndër mend të largoheshim asnjëherë nga Kosova...

Ndoshta nuk e tepëroj të them se vendosmëria e luftëtarëve të UÇK-së i ngjason qëndresës së 200 spartanëve

me në krye Mbretin e Spartës, Leonidën, në vitin 480 para erës së re, në *Grykën e Termopileve*, ku një grusht spartanësh hynë në luftë kundër një ushtrie të tërë perse, ku edhe sot, pas 2 500 vite, mbahet mend si shembull frymëzimi i qëndresës, guximit dhe trimërisë për mbrojtjen e atdheut. Ashtu edhe 20 mijë luftëtarët e UÇK-së luftuan në rrethim të plotë kundër një ushtrie 10 deri 15 herë më të madhe se ajo dhe më e fuqishmia në gadishull dhe do të mbahen mend si shembull i vetmohimit, qëndresës, guximit dhe trimërisë për çlirimin e Kosovës, me në krye Komandantin e saj Legjendar, Adem Jasharin, nën shembullin e tij.

Në qoftë se juve i keni mbështetur deklaratat, analizat dhe përfundimet tuaja jo në këtë heroizëm, por në përkufizimet e ca "udhëheqësve" të UÇK-së, që e "drejtuan" luftën duke qendruar kryesisht jashtë Kosovës, në rast se kini parasysh, fjala vjen, njërin prej tyre, i cili, qysh në muajtë e parë të pasluftës, më 6 nëntor 1999, në një intervistë dhënë javores "*Zëri", na* thotë: "Vendosëm të bënim një përpjekje për ta ndërtuar një lëvizje guerile në Kosovë. Kjo lëvizje do të kishte synim kryesor t'ia tërhiqte vëmendjen opinionit ndërkombëtar për rëndësinë e zgjidhjes së problemit të Kosovës.", atëhere paskeni të drejtë, ky është problemi juaj dhe jo i UÇK-së, as i Kosovës. Si mund të thuash se qëllimi i luftës ishte vetëm sa të tërhiqej vemendia e opinionit botëror dhe... kaq. Ç'strategji!

Së pari, lufta guerile nuk ndërtohet, por shpërthen, pasi lufta guerile është veprimtari dhe jo strukturë. Shpërthen lufta dhe, me zgjerimin e saj, fillon ndërtimi gradual i strukturave të saj. Por kjo bëhej po të vinin edhe ai zotëria dhe shokët e tj në Kosovë dhe jo të rrinin në Tiranë.

Së dyti, po e nise luftën, duhet t'i bësh llogaritë mirë, pasi shpërthimi i luftës do të thotë se ke vendosur: ose të fitosh ose armiku do të shkelë mbi eshtrat e tua. Lufta, nuk ka rrugë të mesme.

Nga njëra anë, të jesh i sigurtë se nuk e ke për ta fituar luftën dhe, nga ana tjetër, me vetëdije ta nisësh atë, - kjo është një absurditet, aventurë ushtarako-politike (më saktë, idiotizëm), ose gangsterizëm, ose thjesht tradhëti. Ku e kishte sigurinë ky zotëri se do të ndërhynte NATO - ja? Ku ishte kjo marrveshja me të në atë kohë?...

Në datën 27 nëntor, po ky farë "udhëheqësi" vazhdon intervistën, duke mbrojtur të njëjtën pikpamje:

"Në vitin 1998 UÇK - ja nuk kishte fuqi t'i bënte ballë makinës luftarake sërbe në një luftë frontale dhe në mbrojtje të popullatës."

Dua të pyes atë zotërinë, se cili ia dha atë strategji këtij që "ndërtoi luftën guerile në Kosovë", që të aplikonte luftën frontale? Megjithatë, me dashje apo pa dashje, ai zotëria na thotë një të vërtetë të hidhur: në vitin 1998, UÇK - ja aplikoi, në mënyrën më aventureske që mund të bëhet, luftën frontale. Atëhere, këtij dhe "liderëve" të tjerë, që kanë qënë me të, duhet t'iu kërkohet llogari deri në një, për atë katastrofë gati të pariparueshme që pësoi UÇK-ja në vitin 1998. Kjo deklaratë e tij na tregon edhe një të vërtetë tjetër: taktikën e luftës së UÇK-së në verën e vitit 1998, e përcaktuan, ose më saktë e imponuan, profanët dhe jo specialistët ushtarakë.

Në rast se ka patur ushtarakë që kanë këmbëngulur për atë lloj strategjie dhe taktike, atëhere duhet të pranojmë se ata, ose kanë qenë injorantë ose e kanë bërë këtë gjë me vetëdije, që UÇK-ja të asgjësohej (për fatin e mirë të popullit dhe në sajë të aftësive të luftëtarëve, ajo vetëm sa u shpartallua përkohësisht por u ringjall si feniksi pas disa muaj) dhe kështu të hiqej dorë një herë e përgjithmonë nga shpresa për t'u shkëputur Kosova nga Serbia. Çfarë kanë bërë ata, eksperiment me jetë njerëzish idealistë? Apo morën dhe zbatuan përvojën e luftës në Kroaci dhe në Bosnjë? Edhe në rast se janë bazuar në ato përvoja, përsëri e kanë patur gabim

dhe duhet të japin llogari, pasi Kroacia dhe Bosnja patën ushtri të rregullta dhe të fuqishme. Por, me sa shihet deri tani, ajo taktikë e ushtrisë sonë është përcaktuar nga "udhëheqësit" civilë...

Luftrat çlirimtare, nuk janë luftra me front të rregullt. Pikë. Të paktën nuk nisin si të tilla. Ato mund të përfundojnë në luftë me front të rregullt, por pasi të kenë kaluar disa faza, kur të jetë arritur dhe pastaj të jetë thyer ekuilibri i forcave, në favor të guerilasve. Por kurrë nuk mund të nisë lufta guerile me luftë frontale. Ndërsa me front të regullt, zhvillohen luftrat midis dy ushtrive afërsishtë të barabarta.

Së dyti, lufta jonë nuk nisi thjesht për mbrojtjen e popullsisë, pasi Kosova ishte e pushtuar, por për çlirimin e popullit, ose, më saktë, për largimin e sundimit serb, përmes një lufte të gjatë popullore. Dhe ushtritë guerile (partizane) nuk kanë territore të tyre qysh në fillim dhe nuk lindin për të mbrojtur këto territore. Ushtritë partizane, ku i ze nata nuk i gjen mëngjesi. Ato bëjnë luftë manovruese dhe mbrojtje manovruese. Lufta guerile nuk ka si synim të marrë e të mbajë territore të caktuara, por e bën mbrojtjen e popullsisë për një masë të caktuar të kohës, deri sa të thyejë sulmin e parë të armikut dhe t'i japë kohë popullsisë t'i largohet rrezikut dhe pastaj manovron së bashku me popullsinë e atij territori ku zhvillohen luftime. Luftimet e guerilasve nuk zhvillohen me ditë e me muaj, por me minuta dhe, maksimumi, me orë.

UÇK-ja iu qendronte përballë forcave të armikut për aq kohë sa nuk kish mundësi t'iu rezistonte më tej, pastaj e shkëpuste kontaktin. Kjo, për ne, ishte fitore. Pra, ruajtja e forcave tona nga asgjësimi. Mirëpo, gjatë pranverë – verës së vitit 1998 UÇK-ja bëri edhe gabime, si rjedhojë e asaj luftës frontale që "ndërtoi" ai "strategu". Kështu mund të përmendim luftimet në Rahovec, në Bardh të Madh, Loxhë etj., ku patëm asgjësim të forcave tona, pasi u zbatua lufta frontale pasive. Ndërsa në luftimet e tjera gjatë vitit 1998, ku zbatohej lufta frontale, vërtet nuk patëm asgjësim të forcave tona, por nuk

patëm as dëmtim të armikut në forca, pasi bënim vetëm luftë frontale pasive, pa kundërsulme dhe pa goditje të armikut nga shpina dhe, në momentin që shfaqej rreziku i rrethimit e azgjësimit, tërhiqeshim. Kështu ndodhi edhe në Grykën e Llapushnikut dhe në Junik. Megjithatë edhe taktika e luftës frontale që u aplikua gjatë pranverës dhe verës së vitit 1998, nga ana tjetër, pati edhe anët e veta pozitive, si për shembull: ajo taktikë e detyroi Serbinë të ekspozonte para tërë botës gjithë makinerinë dhe forcën ushtarake që pat sjellë në Kosovë, si dhe rriti në popull besimin në fitore, gjë që solli shtimin e radhëve të UÇK-së.

E megjithatë, për ushtrinë serbe ato luftime ishin humbje, me përiashtim të Rahovecit, edhe pse ne nuk e gjakosëm sikundër dëshironim. Fitore për të, do të ishte vetëm asgjësimi i forcave të UÇK-së. Ky ishte qëllimi i armikut. Qëllimi ynë ishte të bënim luftë me leverdi: ta gjakosnim, ta konsumonim, ta rraskapisnim dhe, gradualisht, ta detyronim të largohej nga Kosova.

Për ta bërë edhe më të qartë këtë pikë diskutimi, po i referohem luftës në Çeçeni, e cila është një luftë tipike guerile (partizane). Dihet që Çeçenia ka qenë krahinë Autonome e Rusisë, sikundër Kosova me Sërbinë. Në përiudhën e shpërbërjes të ish-Bashkimit Sovjetik, populli çeçen kërkoi statusin e republikës, i cili nuk iu dha. Atëhere ai shpërtheu luftën guerile, deri sa iu njoh statusi i Republikës, me disa kushte. Me fitoren e pavarësisë, u krijua Republika e Çeçenisë, e cila krijoi edhe forcat e saj të armatosura. Kur në krye të shtetit rus erdhi Putini, dihet që ai nuk ia njohu pavarësinë Çeçenisë dhe kjo është arsyeja që populli çeçen filloi dhe po vazhdon luftën e dytë guerile. Kur çeçenët u detyruan të kalonin përsëri në luftë, atëhere Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Çeçenisë, për shkak të raportit të forcave në fushën e luftës, me epërsi dërmonjëse nga ana e rusëve, mori vendimin që ushtria e rregullt e saj të

kalonte, nga lufta me front të rregullt, në luftën popullore pa një front të tillë. Realizoi atë që quhet tërheqje strategjike. Të gjitha njësitë dhe repartet e asaj ushtrie të rregullt, u shpërndanë në formacione të vogla, jo më të mëdha se një togë (30 ushtarë). Pse u bë kjo? Me qëllim që të realizohej ndryshimi gradual i raportit të forcave me metodën e asgjësimit pjesë-pjesë të armikut, deri në ekuilibrimin e forcave, ose deri në tërheqjen e forcave ruse. Me metodën e luftës pa front të rregullt, ushtria çeçene po shndërrohet për rusët në një ushtri "të padukshme".

Nga thëniet e "udhëheqësit" të UÇK-së, të cituara më lart, del se, ata e kishin vendosur t'i kundërviheshin ushtrisë serbe me luftën frontale të guerilasve. Pra edhe pse kanë qenë të bindur se "UÇK-ja nuk kishte fuqi t'i bënte ballë makinës luftarake sërbe në një luftë frontale" dhe e dinin se këta djem nënash do të vriteshin kot, megjithatë, iu thoshnin: "Shkoni në luftë!"... Të jetë e vërtetë? Mos ka qenë i dehur ky "udhëheqësi" kur është shprehur?!... Po qe se i marrim për të vërteta deklaratat e tij, atëherë detyrohesh të dyshosh se kanë qenë të tjerë ata që kanë gjykuar e vendosur pas tij, me të vetmin qëllim që të krijoheshin kushte të përshtatshme për Serbinë, që ajo të justifikonte shpopullimin e Kosovës prej shqiptarëve, ose zhdukjen e tyre, sikundër u mundua ta bënte!...

Nga ana tjetër, të pretendosh se bën apo ke bërë udhëheqjen politike të luftës, duke qendruar jashtë kufijve të Kosovës, sado të kesh mbështetje të lartë nga emigracioni, sikundër e patëm, nuk mundesh kurrë që të zevendësosh udhëheqjen brenda Kosovës. Ndryshe, ajo mund të jetë një lloj i çfardoshëm lufte, po kurrë nuk mund të quhet luftë çlirimtare.

Këtë e kish kuptuar drejt edhe njëri prej komanduesve më të suksesshëm të njësive tona operative, Ramush Haradinaj, i cili, në një intervistë, (*libri "Paqja e Gjeneralit", f. 33)*, shprehet:

"Unë kam qenë arrogant ndaj të gjithë mekanizmave që kanë ekzistuar jashtë Kosove, qofshin ato në Zvicër, në Shqipëri, a kudo tjetër... Shpesh i kam fyer, i kam kërcënuar, iu kam thënë se çka po bëni, pse nuk po vini në Kosovë, kush jeni ju, a jeni në vete, pse po rrini kështu, pse po i mbani djemtë peng, pse s'po luftoni, pse po i hani paret, pse po silleni me telefona në dorë etj...."

Përse i them të gjitha këto? I them për ta patur të qartë se, luftrat e mirëorganizuara çlirimtare, që përdorin taktikën guerile, përgjithësisht janë fituar dhe do të fitohen kundër çdo ushtrie, pavarësisht nga kohëzgjatja e tyre. Ky është një mësim që e ka nxjerrë Historia, jo vetëm në luftrat e mëparshme, por edhe në luftrat e 50 viteve të fundit, si në Algjeri, Vietnam, Afganistan, Bosnjë, Laos, Kamboxhia, Tailandë, në Kosovë, etj.

* *
*

Përfundimi juaj, zoti Kadare, i vitit 2001,se "Kosovën nuk e çliroi UÇK-ja, por Europa Perëndimore", çuditërisht përkon në kohë me të njëjtën periudhë kur ambasadori i Francës në Prishtinë i pat deklaruar pothuajse të njëjtën gjë gazetarit shqiptar Naim Balidema, duke i thënë:

"Ne jua sollëm lirinë dhe, për këtë, të na jeni mirënjohës, se neve iu çliruam."

Dhe, a e dini, zoti Kadare se ç'përgjigje i ktheu gazetari Balidema? Lexojeni te libri i tij: "*Tragjedia Kosovare", faqe 352*:

"Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Francë ishte një rezistencë e vogël, e udhëhequr nga gjenerali Sharl De Gol... Franca u çlirua me ndihmën e anglo - amerikanëve, ndërsa deri më sot nuk kam dëgjuar asnjë

francez të thotë: “Falenderojmë Zotin dhe aleatët, që i sollën Francës lirinë.” Përkundrazi, francezët ia shprehin mirënjohjen pikërisht asaj rezistence…”

Për të qënë të saktë rreth këtij fakti, duhet thënë se Rezistenca Franceze, e udhëhequr nga De Goli, numuronte vetëm 130 mijë forca. Dhe, po të bëjmë një krahasim, duke marrë parasysh numërin e popullsisë së Francës dhe asaj të Kosovës, del se, në çdo 450 banorë francezë doli një luftëtar, ndërsa në Kosovë, një luftëtar doli në çdo 70 banorë shqiptarë, që do të thotë se shqiptarët e Kosovës, të cilët krijuan një ushtri çlirimtare 32 mijëshe, morën pjesë në UÇK gjashtë herë më shumë se francezët në formacionet partizane të Rezistencës së tyre. Dhe iu kujtoj, zoti Kadare, se francezët konsiderohen edhe sot si kombi më krenar i Europës, kur është fjala për ndjenjat atdhetare.

Gjithashtu, për çlirimin e Francës nga Gjermania dhanë jetën 122 mijë ushtarë amerikanë, anglezë e kanadezë, gati sa numëri i luftëtarëve të vet rezistencës franceze, ndërsa për çlirimin e Kosovës forcat e NATO-s nuk derdhën asnjë pikë gjaku. Po ta krahasojmë shifrën e aleatëve të vrarë për çlirimin e Francës me humbjet e mundëshme të NATO-s për çlirimin e Kosovës, do të ishte njësoj që për çlirimin e Kosovës të vriteshin 30 mijë aleatë dhe përsëri ju e shumëzoni me zero rolin e UÇK-së. Edhe sepse sot kushtet e luftës kanë ndryshuar, por edhe sepse NATO-ja iu ruajt deri në fund ndërhyrjes në rrugë tokësore, gjë që do të sillte patjetër humbje të mëdha njerëzore për të, juve nuk e merni parasysh këtë fakt. Ndoshta se Kosova nuk është Francë, de, dhe s’ia vlen të rrezikohet aq shumë për të...

Do të shtoja edhe diçka tjetër: Franca, edhe pse është një komb gati 30 herë më i madh se popullsia shqiptare në Kosovë, edhe pse u çlirua me zbarkimin nga deti dhe ajëri të ushtrive anglo-amerikane, përsëri ajo u llogarit si fuqi fituese e Luftës së Dytë Botërore dhe sot, si e tillë, është anëtare e Përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me

të drejtën e vetos, si rrjedhojë e asaj Rezistence minore në raport me tonën.

Besoj se kjo është një përgjigje edhe për juve, zoti Kadare që po puqeni me zotin Rugova në këtë pikë, por me një ndryshim: Ai, përveç Europës Perëndimore falënderon edhe Zotin, gjë që ju nuk e bëni. Mirpo, duke përmendur vetëm Europën Perëndimore, indirekt mohohet ndihmesa vendimtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe personalisht e ish-presidentit Klinton ndaj nesh, sepse dihet që, 80 për qind e forcave ajrore, që angazhoi NATO-ja në luftën e Kosovës, ishin amerikane. Por as ju dhe as zoti Rugova nuk keni të drejtë ta shumëzoni me zero rolin e rëndësishëm çlirimtar të UÇK - së.

Unë po iu sjell edhe një shembull tjetër të një lufte të ngjajshme me tonën: Anglezët, në Malajzi, u desh të çonin 80 mijë trupa, ndërsa qeveria - kukull kishte 170 mijë trupa dhe nuk e mposhtën dot për 13 vjet me radhë lëvizjen guerile edhe pse ajo kishte vetëm… 10 mijë trupa, 25 herë më pak se kundërshtari. Vetëm bllokimi i depërtimit të armatimeve e mundi atë lëvizje guerile, për shkak se ajo gaboi, kaloi në taktikën mbrojtëse, në luftë frontale pasive. Të varësh shpresat e të presësh të të vijë armatimi nga burime të jashtme dhe të mos mbështetesh në rrëmbimin e tij me luftë, në depot dhe repartet e armikut, do të thotë të vulosësh disfatën tënde. Edhe në Afganistan, lufta mbeti gjatë gjithë kohës një luftë me taktikën guerile, ndaj dhe ish - Bashkimi Sovjetik u detyrua të largohej. Zbatimi nga guerilia i taktikës së luftës frontale të ushtrisë së rregullt, ndodh kur ushtrisë çlirimtare i mungon udhëheqja politike, si në Kosovë, ose kur atë e tradhëton udhëheqja, si në Greqi, në vitin 1949. Jua solla këta shembuj, për të sqaruar më mirë faktin se asnjë luftë antiguerile nuk mund të fitohet me strategjinë e epërsisë, pasi lufta guerile është luftë popullore, luftë e gjatë. Këtë gjë ia tha edhe zoti Klark Millosheviçit në gjyq:

"Në Kosovë ka patur një represion sistematik, i cili ka përfunduar në shpërthimin e një lëvizjeje të rezistencës... dhe, kur e përdorni forcën në një përpjekje për të ndaluar lëvizje të tilla, sikur kjo që ka mbështetjen e gjerë të popullit, nuk do të ketë sukses..."

Mund të lindë natyrshëm pyetja se ku e mbështesnim neve fitoren, vallë vetëm te zgjatja e luftës? Jo. Edhe ne kishim disa strategji. Njëra prej tyre ishte strategjia e mbrojtjes me sulm, e zbatuar prej nesh në mënyrë masive, pasi e pësuam gjatë verës së vitit 1998.

Kjo strategji filloi të zbatohej dalëngadalë në muajtë nëntor-dhjetor 1998, si mësim i nxjerrë nga pësimet e verës së '98-ës, por mori formën e saj të plotë dhe u miratua e u vendos si forma kryesore e luftës sonë më 20 mars 1999. Në këtë datë, Shtabi i Përgjithëshëm i UÇK-së, bëri një mbledhje të shpejtë e të jashtëzakonshme, pasi, një ditë më parë, ushtria serbe kishte filluar një operacion fshirës në zonën e Drenicës, në zbatim të planit "Patkoi". Në atë mbledhje të Shtabit te Përgjithshëm morën pjesë të gjithë drejtorët e drejtorive të tij dhe të sektorëve që ishin të pranishëm në Divjakë si dhe ne, zevendësat dhe ndihmësit e shefave kryesorë (specialistë ushtarakë). Ajo mbledhje është filmuar komplet dhe nuk di në se është zbardhur. Kam frikë se mos është zhdukur dokumentacioni i kësaj mbledhjeje, pasi nga paraqitjet e deritashme televizive, prej saj nuk është parë asnjë sekuencë. Në atë mbledhje u vendos që Ushtria Çlirimtare e Kosovës t'iu kundërvihej operacioneve ndëshkimore me forca të përqendruara të ushtrisë serbe, me taktikën e ushtrisë guerile (partizane). Ky vendim u konkretizua menjëherë në urdhërin e shkurtër luftarak, apo si ta quajmë ndryshe, direktivën, që iu dërgua komandantit të Zonës së Parë Operative të Drenicës, pranë të cilit ndodhej edhe Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm, Sulejman Selimi. Njëkohësisht, ai vendim u mishërua edhe në thirrjen politike të Shtabit të Përgjithshëm, që iu drejtua gjithë popullit shqiptar.

Atë mbledhje dhe vendimin që ajo mori, unë do ta quaja me rëndësi historike, pasi ai vendim shpëtoi përfundimisht UÇK - në nga asgjësimi i sigurt i saj, sepse u hoq dorë përfundimidht nga taktika e luftës frontale pasive dhe u përqafua zbatimi i taktikës së luftës aktive me front jo të rregullt (taktika e luftës guerile). Këtë aspekt të luftës sonë të asaj periudhe e pohon edhe një gjeneralmajor i ushtrisë jugosllave, zoti Bzhidar Deliç, që thotë:

"Mënyra e luftimit të UÇK-së ishte duke iu shmangur çdo lloj luftimi të drejtpërdrejtë. Ata përdornin taktikën: godit dhe ik".

Ai vendim shënon kthesën e madhe shpëtimtare të UÇK-së, pasi, prej asaj date, ideja dhe hartimi i luftimeve dhe operacioneve ushtarake dhe zbatimi i tyre iu la në dorë specialistëve ushtarakë, duke iu dhënë direktivë gjithë formacioneve luftarake të UÇK-së. Për këto arsye, ai vendim merr rëndësi historike, ndaj dhe UÇK - ja i përballoi me sukses dhe pa humbje të mëdha të pesë operacionet ndëshkimore të njëpasnjëshme që ndërmorën ushtria dhe policia serbe për shkatërrimin dhe asgjësimin e saj gjatë periudhës 18 mars - 10 qershor 1999.

Prej 20 marsit, duke kaluar përgjithësisht në taktikën e thyerjes së sulmeve të armikut nga vijat mbrojtëse dhe, pastaj, duke bërë "shkoqjen" graduale të forcave tona dhe shkëputjen e kontaktit të tyre me armikun në front dhe kalimin e tyre me skuadra dhe toga në shpinë të forcave të armikut, UÇK - ja arriti suksese të njëpasnjëshme.

Edhe rezistencën përmes luftës frontale të përkohëshme, që u përdor nga Zona e Dytë Operative, pas datës 20 mars (22 deri 31 mars 1999) në rajonin e Pagarushës, e bëmë për të vënë në zbatim më vonë taktikën e luftës guerile, për disa arsye:

Së pari, nuk kishim leverdi të bënim kalimin në shpinë të forcave të armikut, i cili na sulmoi me forca të shumta e të

përqendruara nga katër drejtime kryesore: Prej fshatit Duhël, përgjatë luginës së lumit të Mirushës, në drejtim të Malishevës dhe anasjelltas, me qëllim që të rrethonte forcat kryesore të Zonës së Dytë Operative, si dhe nga drejtimet: qyteti i Suharekës - Pagarushë dhe Rahovec - Pagarushë, pasi të gjitha lartësitë ishin në duartë tona dhe, po të kalonim në shpinë të armikut, duhej të luftonim në terrene fushore dhe në qendra të banuara, gjë që ishte krejt pa interes dhe e pamundur për neve në atë stad të luftës.

Së dyti, duhej të fitonim sa më shumë kohë, pasi ishim të angazhuar me strehimin dhe sigurimin e popullsisë së Drenicës, e cila ishte sulmuar dy ditë më parë dhe, një pjesë e asaj popullsie kishte ardhur në rajonet e maleve të Cërnalevës dhe të Berishës. Njëkohësisht, duhej të zhvendosnim gati 50 mijë banorë, që na ishin grumbulluar në rajonion e Pagarushës dhe t'i siguronim në malet e Berishës (një pjesë, e orientuam drejt malit të Zatriçit).

Së treti, duhej të merrnim masat e nevojshme, që, më vonë, pasi të ishte bërë tërheqja e forcave kryesore të Zonës së Dytë Operative, forcat serbe t'i shndërronim nga forca rrethuese, në të rrethuara.

Kur u arritën këto objektiva, në mesditën e datës 31 mars 1999, komandantit të Zonës së Dytë Operative, të paharruarit Tahir Sinani, iu dha urdhri që, me forcat e tij, të fillonte shkëputjen graduale të kontaktit me armikun. Kjo u bë me batalione. U tërhoqën pesë brigada me nga 500 deri 1000 luftëtarë, me përjashtim të një batalioni, të cilit iu vu detyrë që të mbronte me luftim në rrethim popullsinë e strehuar në malin e Zatriçit, deri në rimbërritjen e forcave tona kryesore dhe që u kthyen pas 24 orësh.

Të gjitha këto forca, u tërhoqën në malet e Berishës, ku ndodheshin gjithë institucionet kryesore të luftës. Mbrojtja e maleve të Berishës bëhej nga Brigada 121 e asaj zone, e cila u përforcua edhe nga ardhja e këtyre pesë brigadave. Kur forcat tona arritën ta kalonin lumin e Mirushës, armiku mundi

t'i bashkonte forcat e tij, që sulmonin nga drejtimi i Malishevës dhe ai i Duhlës. Me të mbërritur të pesë brigadat në Berishë, u bë riorganizimi i tyre, u kompletuan ato me municione dhe ushqime për tri - katër ditë luftime dhe, edhe pse ishin të lodhura, u urdhëruan që, duke shfrytëzuar njohjen e terrenit dhe kohën me shi e dëborë, për gjithë natën, të kalonin në fshehtësi përsëri vijën e frontit dhe të rihidheshin në rajonin e Pagarushës. Kalimi i vijës së frontit u bë me kompani. Nuk patëm asnjë të vrarë edhe pse armiku kish grumbulluar tanke, artilieri dhe këmbësori të shumtë. Gjatë tërë natës, të pesë brigadat, me përjashtim të një batalioni që kaloi në Nerodime, kaluan në Pagarushë dhe, duke aguar 1 prilli i vitit 1999, ato u hodhën në sulm të befasishëm në shpinë të armikut që ndodhej në luginë, ndërkohë që, përballë, goditej nga zjarri dhe kundërsulmet e Brigadës 121. Duke përdorur taktikën partizane, forcat serbe ranë në kurthin që ne iu kishim përgatitur, duke u rrethuar nga brigadat tona, përmes një veprimi të shkëlqyer e të rrallë të shkallës taktiko - operative. Kjo e detyroi armikun që të tërhiqte forcat kryesore nga lugina dhe t'i shpërndante ato, duke iu lehtësuar kështu kryerja e detyrës Brigadës 121…

Me rritjen e sasisë së forcave të "shkoqura" dhe të sulmeve të tyre, ne kaluam në krijimin e formacioneve më të mëdha sulmuese, në kompani dhe batalione sulmuese, që u quajtën kompani e batalione gardiste, term i huazuar nga Lufta e Madhe Patriotike e popujve sovjetikë gjatë Luftës se Dytë Botërore. Këtë ndryshim strukturor tonin, e patën venë re edhe kuadrot e ushtrisë jugosllave. Ja se si shprehet përsëri Bzhidar Deliç:

"Çdo shtab i UÇK-së kishte njësi të ndërhyrjes, që mbështesnin trupat e UÇK-së që vepronin në terren".

Krijimi i këtyre formacioneve në të gjitha brigadat dhe zonat operative, i dha një hov dhe një impuls më të madh luftës sonë çlirimtare. Me krijimin dhe hedhjen e përhershme

në sulm të këtyre formacioneve në shpinë të armikut, forcat e tij filluan ta ndienin veten të rrethuara, në të gjitha operacionet ndëshkimore që ai ndërmori, sepse forcat tona e godisnin në shpinë e në krahë gjatë gjithë kohës. Kështu i ndodhi edhe kur u sulmua zona e Berishës. Ky operacion, zgjati më shumë se një muaj dhe armiku nuk mundi t'i shtynte forcat e Brigadës 121 asnjëherë nga pozicionet e para të tyre, sepse në shpinë e godisnin formacionet gardiste të Zonës së Dytë Operative, të komanduara nga Tahir Sinani-Tropoja dhe ato të Zonës Operative të Drenicës. Kështu ndodhi edhe kur u sulmua zona e Nerodimës. Kështu ndodhi edhe kur nisi nga ana e forcave tona Operacioni "*Shigjeta*". Në atë moment, u vu në zbatim Operacioni "*Shigjeta - 2*", detyrë që e kryenin forcat e Zonës së Dytë e të Tretë Operative dhe Brigada 162 e Nerodimes. Këto forca, filluan të godisnin në shpinë forcat e armikut që ishin pozicionuar përgjatë kufirit shtetëror me Shqipërinë dhe Maqedoninë, në pritje të sulmit të NATO-s me forca tokësore.

Të gjitha këto suksese, erdhën si rrjedhojë e heqjes dorë nga taktika e luftës frontale mbrojtëse pasive dhe vënia në jetë e taktikës së luftës guerile, (kuptohet se, në raste të domosdoshme, taktika e luftës frontale zbatohej për sulm, sikundër kemi operacionin "*Shigjeta*" dhe luftimet e Brigadës 138). Përmes taktikës guerile, kishim qëllim që të mos i lejonim forcat ushtarako - policore serbe të kontrollonin për kohë të gjatë territoret që ne i kishim quajtur zona të lira. I sulmonim shpesh. Edhe në rastet kur armiku vinte me forca të shumta, ne kishim parashikuar t'i shmangeshim luftimit frontal për një kohë të gjatë (dhe këtë strategji pothuajse e zbatuam në të gjitha zonat operative, ku më shumë e ku më pak), të largonim popullsinë nga rreziku dhe ta godisnim armikun me forca të pakta, por të shpërndara në shumë pika, që ai të shpërndante forcat dhe të largohej sa më shpejt. Dhe ashtu kemi vepruar.

E zbatuam këtë strategji, pasi nuk duhej të lejonim largimin e popullsisë, ndryshe mbeteshim si peshku pa ujë.

Sado forca të shumta që angazhonte Serbia kundër zonave tona operative (popullatës dhe UÇK-së), pas venies në jetë në mënyrë masive të taktikës guerile nga ana jonë, armiku asnjëherë nuk mundi t'i merrte nën kontroll të plotë zonat e kontrolluara nga ne, pasi jo vetëm që kishim baza të shumta furnizimi e strehimi, në secilën zonë, por, mbi të gjitha, sepse kishim vullnetin e fortë dhe një strategji të suksesshme.

Kureshtarët mundet të duan të dinë se ku i mbështesnim neve shpresat për të patur një vullnet kaq të fortë. Nuk ka ndonjë sekret të madh. Shpresat, përveç që i mbështesnim në ato çka trajtuam për besimin në fitore, i mbështesnim tek taktika e luftës guerile dhe te ajo se në luftime ishim më shumë shqiptarë se sa serbë, të gjithë të gatshëm të vdisnim për Kosovën dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Si rjedhojë, rezervat tona në ushtarë ishin të pashtershme. Dhe, kjo strategji nuk na gënjeu. Na erdhën vullnetarë nga të gjitha trevat shqiptare, madje edhe nga kombe të tjera të Europës Perëndimore.

Kjo strategji kishte edhe anën tjetër pozitive, sepse rriste moralin e popullit edhe në zonat e tjera të Kosovës, ku, deri në atë moment nuk ishin zhvilluar luftime. Kur forcat serbe kryenin më vonë operacione fshirëse në zonat e tjera, atje qendronte më shumë popullsi se në zonën ku ishin zhvilluar luftime para saj. Kështu na ndodhi me Dukagjinin, por në mënyrë të veçantë me Gollakun dhe Nerodimen.

Strategji tjetër guerile, kishim atë të moslenies së armikut të qetë, ditën dhe natën, që ai të mos ndiehej i sigurtë dhe ta lodhnim sa më shumë që, më në fund, të largohej nga Kosova ose të kërkonte bisedime. Strategjinë e lodhjes, vetëm ne, guerilasit, mund ta përdornim me sukses, pasi ne e kishim në dorë se kur dhe ku do të luftonim dhe nuk diktoheshim nga armiku. Kjo sillte edhe rritjen e pasigurisë për forcat serbe. Dhe, rritja e pasigurisë tek ata, do të sillte, sikundër solli, konfliktet sa "të padukshme", aq edhe të pashmangshme

midis serbëve dhe kolaboracionistëve e indiferentëve shqiptarë, duke bërë masakra pa dallim. Këto konflikte sollën rritjen e radhëve të UÇK-së, me një sasi të konsiderueshme në njerëz, që nuk përfshihen në shifrën 32 - mijëshe të saj.

Strategjinë e lodhjes, e përdori edhe ushtria serbe. Kuptohet, sipas konceptit dhe mundësive të saj, përmes zjarrit të dendur e të vazhdueshëm me artileri. Mirpo dihet se, ne nuk bënim luftë pozicionale, nuk qendronim vetëm në një pozicion që të bëheshim objekt i kësaj artilierie, kështu që serbëve iu dolën huq tërë taktikat dhe strategjia të përdorura kundër nesh.

Kureshtarët, përsëri mund të interesohen të dinë se, kur kishim kaq suksese, si është e mundur që Serbia nuk u largua pa ndihmën e NATO-s? Kjo këkon një përgjigje të gjatë, pasi janë shumë faktorë, por një nga faktorët ushtarakë po e shpjegoj: Kosova është territor i vogël dhe jo shumë i thyer dhe, si rrjedhojë, Serbia nuk ishte e detyruar t'i shpërndante shumë forcat e saj të armatosura. Dhe, e dyta, ne e përdorëm atë taktikë, në shkallë të gjerë, kur NATO-ja hyri në luftë dhe kur armiku filloi sulmin me forca dërrmuese, për të na thyer e mposhtur me çdo kusht. Me një fjalë, Serbia u largua nga Kosova kur nuk ishte gjakosur në atë masë që do të fillonte të ekujlibrohej në forca me ne, pasi e kuptoi rrezikun, sepse ne u bëmë me aleatë, dhe, kështu, u parapriu humbjeve të veta të mëdha njerëzore.

* *
*

Do të zgjatem pak në përshkrimin e veprës së UÇK-së, sepse edhe sot ka njerëz që dinë pak apo aspak pë të. Duhet thënë që në fillim, se UÇK-ja luftoi në një rrethim të trefishtë. Rretimi i parë, rrethimi me rajone dhe zona. Ai rrethim u realizua nga ushtria, nga paramilitarët dhe nga policia serbe (kjo e fundit, vetëm deri në shkurt 1998, kishte

10024 forca), me një raport forcash 1 me 10 -15, deri edhe 1 me 20, në favor të armikut. Përsa i përket epërsisë së forcave sërbe në tanke, autoblinda, artileri, mortaja, ushqime etj., - ajo ishte absolute ndaj nesh dhe as që mund të flitet për raport forcash. Ky raport forcash, bëri të mundur që rrethimi i UÇK-së të ishte një rrethim i drejtpërdrejtë, ku shumica e zonave operative nuk kishin lidhje territorri të lirë midis tyre.

"Të jemi më preçizë, theksoi Wesli Klark gjatë dëshmisë së tij në gjyqin e Millosheviçit, kjo ushtri rrethonte një objektiv, e bllokonte atë, për të penguar riforcimin apo daljen. Pastaj policia hynte, arrestonte njerëz me emra në se kishte informacione të posaçme, pastaj shkonin paramilitarët dhe kërcënonin njerëzit, i plaçkisnin e kështu me radhë dhe, më pas, i dëbonin njerëzit nga shtëpitë e tyre. Dhe, e tëra kjo, nën kontrollin e autoriteteve."

Ky ishte rrethimi i parë, ku, në disa periudha, u kalua pothuajse në vija fronti, në mbrojtje, ndaj dhe disa "specialistë" ushtarakë të radhëve të UÇK-së janë mashtruar, si dhe janë mburrur dhe mburren edhe sot, duke thënë se UÇK-ja bëri luftë frontale.

Pati shumë drejtues midis nesh, që këmbëngulën ta ndiqnin atë taktikë, njësoj si lëvizja partizane greke, por triumfoi taktika e luftës partizane, sikundër e shpjeguam më lart. Ky lloj rrethimi, e vështirësoi shumë komunikimin midis zonave operative ku vepronin njësitë e UÇK-së. Por, me qënë realist, atij rrethimi ia morrëm shpejt dorën, e "shpërthenim" çdo ditë, me ndihmën e popullit, i cili na furnizonte me gjithçka. Kjo është edhe një nga arsyet pse Serbia përdori më vonë taktikën e "tokës së djegur".

Rrethimi i dytë, UÇK-së iu bë nga bllokimi dhe izolimi i kufijve politikë të Kosovës. Ky rrethim u realizua nga ushtria serbe. Ai ishte një rrethim, i cili, për qëllim "kishte përdorimin joproporcional të forcës, një përdorim ilegal të forcës, e

cila ishte paraparë sipas zgjidhjes së përdorur në vitin 1946", sikundër deklaroi gjenerali Klark në gjyqin e Millosheviçit dhe, njëkohësisht, të bllokonte furnizimin me armatim modern të UÇK-së. Por ne, edhe në këtë rrethim gjetëm shtigje. Kur Serbia përforcoi bllokimin e kufirit me Shqipërinë, ne filluam të blinim armë e municione në Serbi, si dhe shfrytëzuam kalimet në kufirin me Maqedoninë.

Që ushtria serbe ta kishte më të lehtë të realizonte rrethimin e parë e të dytë, si dhe që të përgatitjej sa më mirë për përballimin e NATO-s, ajo krijoi formacionet e paramilitarëve, duke nxjerrë nga burgu të gjithë të dënuarit për krime ordinere nga më të ndryshmet, të cilët i angazhoi që, veç plaçkitjes së popullit shqiptar në Kosovë, djegieve dhe përzenies me forcë të tij, të futeshin edhe në luftime kundër formacioneve të UÇK-së.

Rrethimi i tretë i UÇK-së, ishte izolimi politik, diplomatik dhe ai ushtarak i saj nga bota demokratike e "çlirimtare". Pra, kemi tre lloj rrethimesh, dy prej tyre ushtarake, gati të njëjtë me rrethimin e Krujës, që ju e shtjelloni bukur e bindshëm artistikisht te romani "*Kështjella*".

Por, me një përjashtim. Në rrethimin që iu bë dikur ushtrisë së Skëndërbeut, Europa e krishterë ishte tërësisht me të rrethuarit, pasi në Krujë mbrohej krishtërimi. Vatikani dhe Venetiku e mbështetën ushtrinë e Skëndërbeut me armatim, financa dhe ushtarë, ndërsa Europa dhe pacifistët shqiptarë:

"Nuk po lënë gjë pa thënë për UÇK-në: asaj i vishen ide marksiste-leniniste, idetë e maoistëve të vonuar..., (*ajo gjoja*. D.G.) udhëhiqet nga islamistë... Sigurohet se ajo strehon veç terroristë, nganjëherë edhe fashistë të vjetër. Në të vërtetë, bëhet fjalë për ta hequr qafe, pavarësisht se për mua, si për shumë shqiptarë, UÇK - ja është një lëvizje për çlirim kombëtar."

A nuk shpreheni kështu juve, zoti Kadare, në librin "*Kohë barbarësh*", f.288 ?...

Unë e kuptoj se juve nuk e keni patur plotësisht të qartë që UÇK - ja luftonte në një rrethim të trefishtë. Por, mos harroni se luftimi në rrethim është luftimi më i vështirë, luftimi që kërkon guxim, trimëri dhe heroizëm. Por, më e keqja është se, në rrethimin politik e diplomatik, për mos të folur për ata ushtarakë, kundër UÇK-së morën pjesë edhe politikanët shqiptarë të asaj kohe, të të gjitha trevave shqiptare, me në krye "Kryetarin" e Kosovës dhe të partisë më të madhe 700 mijë antarëshe, të mbështetur edhe nga ata të Tiranës...

Juve e dini se, braktisja, përjashtimi dhe "harresa" politike ndikojnë shumë në moralin luftarak të çdo ushtrie, aq më shumë te radhët e ushtrive çlirimtare, pasi kemi të bëjmë me një popull të tërë që lufton dhe jo me një ushtri të rregullt. E, megjithatë, ne mundëm të mbijetonim me këmbëngulje dhe ta tmerronim Serbinë, si dhe politikën thuajse hapur proserbe të "çlirimtarëve" europianë të ardhshëm.

Ekzistenca e atij rrethimi, sa të fshehtë aq edhe të dukshëm, i cili e ka fillesën në fundvjeshtën dhe dimrin e vitit 1998, e bënte edhe më të domosdoshme për ne zhvillimin e luftës sipas taktikës guerile dhe kurrësesi me front të regullt, pasi do të rezikoheshim të asgjësoheshim, sepse armiku kishte epërsi dërrmuese në të gjitha drejtimet. Vetëm përmes asaj taktike, ne filluam gradualisht të bëheshim më të fuqishëm ndaj armikut, në shkallë taktike.

Dihet se, dy ditë pas Rambujesë, ushtria serbe ndërmori sulme me forca të përqendruara për të asgjësuar forcat e Zonës së Parë dhe të Dytë Operative të UÇK-së. Në rast se do të kishim vazhduar të përdornim luftën në front të regullt, sikundër mbizotëronte ai mendim, ne do të ishim asgjësuar tërësisht. Pse përdorëm taktikën e luftës pa front të rregullt, ne i shpëtuam forcat tona nga asgjësimi. Me të kaluar në këtë taktikë, armiku u deryrua t'i shkoqte forcat dhe, kurrë më, nuk mundi të ndërmerrte ndonjë sulm të dytë me forca të përqendruara kundër të njëjtës zonë. Edhe kur armiku u

përpoq të sulmonte rajonin e maleve të Berishës (ku ndodheshin gjithë institucionet e luftës dhe mbroheshim vetëm nga një brigadë), me forca të përqendruara dhe nga disa drejtime, ishin forcat tona të Drenicës dhe ato të Pashtrikut, të cilat, duke e sulmuar nga shpina, jo vetëm që i shndërruan forcat serbe nga rrethuese në të rrethuara, por bënë që ne të fitonim epërsinë taktike në këto dy zona, sepse ishim ne që kishim filluar të merrnim nismën në shkallë operative.

Qysh në 20 mars 1999, forcat e zonës së Drenicës kanë bërë vetëm luftime sipas taktikës partizane, por, disa profanë në fushën ushtarake, e quajtën këtë lloj taktike si shpartallim të saj. Në të vërtetë, shkoqja e forcave të Zonës së Drenicës dhe e disa brigadave të Zonës së Pashtrikut, Dukagjinit dhe asaj të Llapit në nënreparte, deri në nivelin e skuadrës e togës dhe përdorimi i tyre sipas taktikës: godit si rrufeja dhe zhduku si era, ishte shpëtimi dhe jo shpartallimi i UÇK - së.

Edhe forcat e Brigadës153, që vepronin në Malësinë e Gollakut, vetëm në 18 deri 20 prill 1999 bënë luftime mbrojtëse, pasi në rajonin: Dyz - Makovc - Stallovë si dhe në Zllash e Marec ndodheshin rreth 200 000 mijë banorë të Prishtinës dhe Besjanës (Podujevës), pasandaj ajo brigadë përdori vetëm taktikën partizane, ndaj dhe është formacioni luftarak i UÇK-së që edhe pse ka zhvilluar më shumë luftime në atë periudhë, ka më pak humbje se të tjerët. Kjo dukuri u vërejt edhe në Zonën e Drenicës gjat muajve mars - qershor 1999, pasi ajo kaloi në taktikën partizane. Edhe Zona e Dukagjinit, kur u sulmua në prill nga forca të përqendruara të armikut, u detyrua të përdorte taktikën partizane. Vetëm Zona e Bajgorës zhvilloi kryesisht luftime mbrojtëse dhe, pjesërisht, ajo e Llapit, Pashtrikut dhe e Nerodimes, të favorizuara edhe nga terreni.

Në muajin maj 1999, pothuajse të gjitha zonat, me përjashtim të asaj të Bajgorës, kaluan në asgjësimin e armikut pjesë - pjesë, sipas taktikës partizane. Në atë periudhë,

armiku, i cili priste intervenim të NATO-s nga toka, u detyrua të përqëndrohej në drejtim të Shqipërisë dhe Maqedonisë, nga priste sulmin. Ndërkohë ne intensifikuam goditjet nga shpina të armikut dhe të kolonave të tij kur, ku dhe si donim. Kështu që kemi të drejtë të themi se ky intensifikim i sulmeve të rrufeshme nga ana jonë dhe fuqizimi ynë, mund dhe ka ndikuar te Serbia që ta pranonte në Kumanovë ndalimin e luftës në mënyrë aq të befasishme. Këtë e vërtetojnë edhe fjalët e zotit Klinton, në intervistën dhënë CNN ("*Ne luftën , ju paqen", f.154*):

"Ma merrte mendja se kjo punë (lufta) do të shkontë goxha gjatë. Jo se kisha përcaktuar ndonjë afat kohor të saktë, por e dija që do të vazhdonte goxha gjatë."

Ky pranim kaq i befasishëm i ndalimit të luftës nga Serbia, besoj se ka edhe një arsye tjetër. Millosheviçi, duke e parë se UÇK - ja po rritej dhe po bëhej gjithnjë e më agresive dhe po fitonte çdo ditë terren dhe nismë, ajo, jo vetëm që do ta ndihmonte kapitullimin e shpejtë të Serbisë, por do të bëhej palë e barabartë me NATO - n. Kjo nuk i pëlqente absolutisht Millosheviçit. Prandaj, që ai të mund ta mbante nën juridiksion me çdo kusht Kosovën, sikundër e ka ende, ka bërë llogaritë dhe i delte që ta pranonte në ato momente ndalimin e luftës. Pra, është fuqizimi dhe bëria shumë shpejt faktor përcaktues i UÇK-së që Milosheviçi mori atë vendim befasues. Ndoshta për këto mundësi dhe të drejta që do t'i lindnin UÇK-së, Milosheviçi të ket marrë edhe ndonjë sinjal në mënyra e rrugë të nëndheshme nga miqtë e tij në NATO, të cilët dihen.

Që Millosheviçi u frikësua se UÇK- ja po bëhej palë e barabart me NATO-n na bind edhe nje fakt tjetër dhe ai është deklarata për UÇK-në, në televizion, e Presidentit Amerikan, zotit Bill Klinton , bërë më 23 maj 1999, i cili tha: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës po shtohet dita ditës, ajo ka filluar të ndërmarrë ofensiva kundër forcave serbe..". E tha

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe nuk e tha dokushdo, zoti Kadare, prandaj, nuk është rastësi që pas një jave parlamenti i Serbisë pranoi tërheqjen e gjithë forcave nga Kosova, vetëm e vetëm që UÇK – ja të mos imponohej si palë e barabartë në Kumanovë, apo jo? Frika i ruan vreshtat.

E bëra këtë shpjegim të gjatë, pasi ende mbizotëron mendimi se UÇK - ja, jo vetëm që nuk kish aftësi të përballej me ushtrinë serbe, që ekziston edhe te juve, zoti Kadare, por thonë se ajo nuk bëri luftë, edhe atë që bëri ishte luftë frontale e jo efektive. Megjithëse kjo thënie mbështetet në disa fakte, por nuk është e gjith e vërtetë. Dimë se, gjatë vitit 1998, UÇK - ja përdori luftën ballore, si për shembull në Bardh të Madh, Llapushnik, në Loxhë, në Rahovec etj. Zbatimin e kësaj taktike, e shpreh edhe një komandant zone, Rustem Mustafa, i cili, në librin *"Lufta për Kosovën", f. 81*, thotë:

"Ne ndërmorëm masat që mund të merrnim. Bëmë hapjen e istikameve, ... në vijën frontale gjithkund kanë qenë të hapura kanalet..."

Pse përdori atë lloj lufte gjat vitit 1998, ndaj dhe mund të themi se UÇK-ja gati u shpartallua. Por ajo e rimori veten shpejt. U ringjall si Feniksi. Po të kishim vazhduar të aplikonim atë lloj lufte edhe më vonë, sot do të kishin mbetur gjallë vetëm "luftëtarët" në Tropojë, Kukës e Tiranë.

Rrethimin e tretë e keni ndjerë edhe juve, zoti Kadare, qysh në 11 janar 1999, kur shpreheni:

"Të krijohet përshtypja se diku (diku lart, në Olimp, në Bruksel), është menduar se ndoshta është më mirë që UÇK - ja të zhduket."

Nuk jeni gabuar. Do ta shohim më vonë se ai dyshim i juaji duhet të ketë qenë një vendim i vërtet. Dhe juve e dini mirë se rrethimi i tretë mund t'i sillte UÇK-së asgjësimin, sikundër i ndodhi gueriles greke më 1949, e cila, duke kaluar në luftë frontale, u bë objekt i dukshëm dhe i goditshëm nga armiku i saj, shumë më i fuqishëm ushtarakisht. Ndërsa ne u mbështetëm kryesisht në mbrojtjen e manovrueshme. Edhe

armatimet e municionet, pas dy rrethimeve, filluam t'ia rrëmbenim armikut ose ta blinim në territor të tij, ndërsa për furnizimet e tjera ndihmonte populli. Kjo ishte strategjia dhe taktika jonë partizane.

Pala Serbe, por edhe politikanët e Olimpit që përmendni ju, u trembën shumë, pasi ne u treguam atyre se dinim jo vetëm të luftonim, por të bënim edhe diplomaci. Në një moment, ne deklaruam se, po të fitonim do të bënim bashkimin e Kosovës me atdheun - amë. Ne e bëmë atë deklaratë, madje e vendosëm edhe në formulën e betimit tonë, pasi e dinim dhe e dimë se atë bashkim nuk e kanë dashur dhe nuk e duan as sot as shtetet tanë fqinj, as ata të Europës dhe as politikanët e partive të mëdha shqiptare, si në Prishtinë edhe në Tiranë, të cilëve, për çudi, tani iu janë bashkuar edhe dy parti të Prishtinës, liderët e të cilave kanë qenë drejtues të lartë të luftës në Kosovë.

Kjo frikë, që nuk është e sotme dhe as e panjohur, i detyroi të gjithë politikanët dhe diplomatët e Europës që të bashkoheshin dhe të bënin përforcimin e rrethimit të tretë, me qëllim që UÇK - ja ose të dorëzohej, ose të zhdukej. Mirpo luftëtarët e UÇK - së, që ishin elita idealiste e kombit shqiptar, trashëgonin guximin dhe trimërinë, ndjenjën e sakrificës dhe guximin e shqiptarëve, të cilat juve i përshkruani aq mirë te romani "*Kështjella*", ndaj mbijetuam.

Dhe mos harroni, që edhe bjeshkët e Kosovës janë terrene që përshkohen nga teknika luftarake, gati njësoj si terrenet fushore, ndaj nga luftëtarët kërkohej, përveç qendresës heroike, një lëvizshmëri shumë herë më e lartë se në çdo terren tjetër malor e të thyer, gjë që u arrit të bëhej me sukses. Qëndresa dhe guximi ynë vërtetuan tezën e Klauzeviçit, i cili thotë:

" Aftësia manovruese e një ushtrie dhe guximi i pamposhtur, që i mban masat të bashkuara sikur të ishin

të shkrira në një të vetme, e manifestojnë superioritetin e tyre në terren fushor.”

Duke qenë e tillë, UÇK-ja arriti të ishte bindëse dhe të imponohej që NATO-ja ta quante aleate të saj, përmes zedhënësit të saj Xhimi Shia. Dhe ajo e bëri këtë, por me shumë hile. Na konsideroi dhe bashkpunoi me ne si aleatë deri në momentin kur Sërbia e pranoi kapitullimin dhe iu drejtua tavolinës së bisedimeve, ku pala shqiptare nuk ishte e pranishme. Kjo, për arsyen se budallallëku (për të mos u shprehur më ashpër) ishte bërë më herët, qysh kur ishte pranuar që Kosova të mbetej pjesë e Serbisë dhe, kështu, ishte Serbia ajo që, zyrtarisht dhe me dokumente ndërkombëtare përfaqësonte edhe Kosovën në Kumanovë, duke mos na dhënë kohë që përmes pushkës ne, UÇK-ja, të bëheshim palë e barabart me NATO-n. Kjo edhe nga paaftësia dhe ngathtësia proverbiale e atyre që pretendojnë se kanë bërë udhëheqien e luftës tonë.

Para se të dalim në përfundimin se kush e çliroi Kosovën, desha të shtoja edhe diçka tjetër përsa u përker vlerave të UÇK-së, zoti Kadare. Desha t’u kujtoj diçka, që jam i bindur se ai truri i juaj gjigand do të mund ta analizoi nesër shumë herë më mirë se unë. Dua t’iu kujtoj se të gjitha luftrat e deritashme pothuajse janë zhvilluar për territore. Edhe lufta që bënte UÇK-ja, edhe lufta që bënte Serbia, ishin luftra për territore. Mirpo, në rast se nuk do të kish dalë në skenë UÇK-ja dhe lufta e saj këmbëngulëse, jam i sigurtë se sot nuk do të ekzistonte as NATO-ja në formën që ajo aktualisht ekziston, pasi kish mbaruar Lufta e Ftohtë dhe ishte vënë në pikëpyetje ekzistenca e saj pas shthurrjes së Traktatit të Varshavës. Këtë e le të kuptohet edhe zoti Wesli Klark në librin e tij “*Të bësh luftë moderne”, f.17-18*, i cili thotë: ishte “lufta e parë e luftuar në Evropë pas një gjysëm shekulli dhe lufta e parë e luftuar ndonjëherë nga NATO-ja”. Dhe më poshtë shton: “Aksioni i NATO-s në Kosovë përdoret si shëmbulli më i ri dhe më i freskët”, me të cilin nënkuptohet se kemi një lloj të

ri lufte, Luftën Preventive, e cila u bë nga NATO-ja, jo për territore, si deri atëhere, por për të parandaluar spastrimin etnik. Po të mos qe lufta e UÇK-së as nuk do të kishim daljen në dritë të kësaj lloj lufte dhe "NATO-ja, sipas të gjitha gjasave, - *shton po në atë vazhdim Wesli Klark* - nuk do të kishte mundur të mbijetonte në formën ekzistuese". Dhe, shpërblimi i pasluftës për UÇK-në? Në arrest!

Të gjitha këto fakte, citime dhe argumenta ua rendita për të dalë në përfundimin e qartë se, çlirimi i Kosovës u shpejtua nga ndihma e madhe e forcave ajrore të NATO-s e, në mënyrë të veçantë, me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të udhëhequra nga z. Bill Klinton. Por, të kuptohemi, ai çlirim, (le ta quajmë të tillë), u shpejtua dhe u bë në bashkveprim të ngushtë me luftën e popullit shqiptar të Kosovës, ku si forcë kryesore goditëse kish Ushtrinë Çlirimtare të tij. Pa ekzistencën dhe luftën e UÇK-së nuk do të flitej sot as për njerën dhe as për tjetrën. Me këto dua të them se, nuk mund të absolutizohet as roli i NATO-s, sikundër bëni juve dhe zoti Rugova dhe as nuk duhet kaluar në absolutizimin e rolit të UÇK - së.

Të thuash: Kosovën e çliroi Europa Perëndimore dhe askush tjetër, është ekstremizëm i mbështetur në parimet e servilizmit pacifist.

Të thuash: Kosovën e çliroi UÇK-ja dhe askush tjetër, është ekstremizëm i mbështetur në mosmirënjohjen njerëzore dhe kapadaillëk. Çdo ekstrem, është i papranueshëm dhe i dëmshëm. Prandaj, po perifrazoj fjalët tuaja, zoti Kadare. Le të kemi kurajon e të themi të vërtetën: Kosovën e çliroi bashkëveprimi luftarak midis UÇK-së dhe NATO-s, të paraprirë nga SHBA - të.

Juve e dini tash se NATO-ja veproi vetëm përmes ajrit, me aviacionin e saj luftarak, mirpo nuk besoj ta dini se aviacioni luftarak, ai i frontit, (ai që godet forcat dhe mjetet luftarake të kundërshtarit në fushën e betejës), nuk mund të

realizojë në kohë asnjë goditje të saktë kundër objektivave tokësorë taktikë të armikut, pa iu dhënë shenjëtregimi nga toka ose nga aviacioni - helikopter i tij, që qendron në afërsi të vijës së frontit, por që rrezikon.

Zotërimi i ajrit është i parëndësishëm, në rast se forcat ajrore nuk kanë një shënjëtregim të saktë, thuhet pothuajse në të gjitha doktrinat ushtarake të sotme. Dhe ky është një parim ushtarak, që juve iu falet të mos e dini. Këtu, mendoj unë, është një nga burimet e pozicionimit tuaj mohues ndaj UÇK - së, duke i hequr asaj të drejtën e të qenit çlirimtare.

Detyrën e shenjëtregimit për aviacionin e NATO-s, e kryenim ne, UÇK-ja, duke iu dhënë atyre koordinatat për objektivat ushtarakë tokësorë serbë të lëvizëshëm e të palëvizëshëm, me saktësi të lartë dhe, madje, jo një herë, por disa herë gjatë tërë ditës e gjatë tërë natës, pa pushim. Për këtë veprimtari të dendur, kemi edhe dokumente, pavarësisht se ato, Shtabi i Përgjithëshëm i TMK - së nuk i ka dorëzuar në asnjë arkivë të Kosovës apo të Shqipërisë dhe ndoshta, në kundërshtim me rregullat e ruajtjes së dokumenteve luftarake, janë marrë disa herë nga ushtarët e KFOR-it, gjoja për verifikim, sa që tani, vetëm një zot e di se ç'është bërë e ç'po bëhet me to. Do të ishte mirë për historinë e popullit tonë, që ato dokumente të shumëfishoheshin për qëllime të tilla përdorimi, ndërsa origjinalet të dorëzoheshin në Arkivin e Kosovës qysh në korrik të vitit 1999, porsa mbërritëm në Prishtinë dhe të mos mbaheshin dosido nëpër sirtarë, aq sa sot janë dhënë edhe shenja se po vihet dorë në to...

Ndoshta u zgjata pak, por ua përmenda këto mori faktesh dhe argumenta për t'u treguar juve dhe gjith atyre që nuk e njohin UÇK-në dhe luftën e saj, jo vetëm se çfarë lufte të suksesëshme bëri UÇK-ja, por edhe për t'u thënë se ajo gjysma e popullit shqiptar të Kosovës, mbi një milionë që nuk e la Kosovën nga që pati besim te UÇK-ja dhe e ndau fatin me të, nuk u zhgënjye nga ushtria e vet, pasi ajo e mbrojti popullin e saj denjësisht dhe e justifikoi besimin dhe ndihmën

e popullit edhe pse ishte shumë herë më inferiore në numur dhe armatim ndaj kundërshtarit me të cilin luftoi. Gjithashtu për t'u bindur juve dhe të tjerët se UÇK-ja ishte njëri prej faktorëve kryesorë që ia bëri Serbisë të pamundur qëndrimin në Kosovë.

Por, shumë më mirë e më saktë se unë, vetë juve i nxirrni në pah vlerat e UÇK-së, sidomos tek libri "*Shqiptarët në kërkim të një fati të ri", f. 32*:

"Ishte UÇK - ja ajo që i ra kambanës së alarmit për të zgjuar gjithë planetin. Ishte ajo që u vra e u coptua për t'i bërë të qartë botës se ç'po ndodhte në Kosovë. Ishte ajo që duke shërbyer si pararojë e NATO-s, arriti të tërhiqte makinën e rëndë ushtarake të saj në vendin e harruar që quhej Kosovë..."

"Për çlirimin e Kosovës, *vazhdoni në f. 54,* midis popullit shqiptar dhe Aleancës Atlantike u sajua ai bashkim i çuditshëm, ku shpenzimin më të vjetër të luftës, gjakun, e vuri populli i paktë shqiptar, kurse armët, NATO-ja e fuqishme."

Ndërsa në vitin 1999, në *f. 51* te *"Ra ky mort e u pamë",* theksoni:

"Flijimi i kosovarëve është i madhërishëm. Midis heshtjes, një popull i tërë po pranon të vejë kokën në satër. Për të paguar çmimin e lirisë. Nuk i ndodh çdokujt një gjë e tillë."

Pra, edhe e pranoni, nga njera anë, se "u sajua ai bashkim i çuditshëm, ku shpenzimin më të vjetër të luftës, gjakun, e vuri populli i paktë shqiptar, kurse armët, NATO - ja e fuqishme" dhe "një popull i tërë pranoi të vejë kokën në satër për të paguar çmimin e lirisë", edhe e mohoni si pa të keq nga ana tjetër, kur thoni: Jo, Kosovën nuk e çliroi ai popull që derdhi gjak, duke pranuar ta vinte kokën në satër, as ushtria e tij, por e çliruan ata që harxhuan vetëm municione dhe karburant. E shihni se sa kontraditor jeni, zotëri? Iu

kujtohet, sigurisht, se si i thonë andej nga Gjirokastra këtij lloj vlerësimi të vonuar: "Dhentë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres..."

Për t'i përforcuar këto përfundime, po citoj përsëri një nga deklaratat e gjeneralmajorit serb Bzhidar Deliç:

"Sulmi i dytë frontal i UÇK-së, i quajtur Operacioni "Shigjeta", u krye nga 27 maji deri më 7 qershor 1999. Ata sulmuan nga Shqipëria në drejtim të zonës së Pashtrikut. Në këtë sulm, forca sulmuese përbëhej prej këmbësorisë së UÇK - së dhe aviacionit të NATO- s."

Është një deklaratë e bërë nën betim, para gjyqtarëve e prokurorëve të Hagës, që nuk kërkon asnjë koment tjetër. Duke e dëgjuar e lexuar edhe atë, a nuk kemi të drejtë ta përsërisim me zë të lartë: Kosovën e çliroi bashkëveprimi luftarak midis NATO-s dhe UÇK-së, të paraprirë nga SHBA-të!

UÇK-ja ishte ajo që hapi rrugën e organizimit të Grupit të Kontaktit për Kosovën dhe të organizimit të Koferencës së Rambujesë, pasi ishte ajo që bëri zgjerimin e njohjes së kombit shqiptar, por edhe të çështjes së pazgjidhur shqiptare. Nuk mund të gjesh në historinë e luftrave çlirimtare një ushtri që të jetë lakuar aq shumë dhe për një kohë aq të shkurtër nga diplomacia ndërkombëtare, sa UÇK-ja.

Kush nuk e ka kuptuar dhe nuk e kupton ende, me ose pa qëllim, se UÇK-ja ishte baza morale e Luftës Çlirimtare në Kosovë dhe se ajo u shndërrua në një lëvizje mbarëkombëtare, duke ndikuar fuqishëm në çlirimin e Kosovës, doemos që do të shprehet kundër dhe do ta mohojë ose minimizojë rolin e saj. Ashtu siç bëni juve në rastin konkret, kur, me një të rënë të lapsit, synoni ta fshini nga historia dhe nga kujtesa e popullit atë lëvizje kombëtare shqiptare me emrin UÇK, që u shtri në tërë vendet e botës, ku ka qoftë edhe një shqiptar. Edhe në Francë, natyrisht...

UÇK-ja e rilindi Kosovën, pasi i vendosi gjërat në një tjetër perspektivë, prandaj iu bëri për vete e me vete dhe juve,

zotëri, aq sa të shkruanit për të me superlativa, duke mos e ditur se një ditë do të mundoheshit t'i reduktonit fjalët e vlerësimet tuaja dhe, për çudi, t'i harronit trimat e dikurshëm të UÇK-së dhe rolin e tyre si dalëzotës në çlirimin e Kosovës, sidomos kur bëni "analizën" e ngjarjeve të marsit 2004.

Mos e keni harruar me këtë rast edhe përgjigjen që iu kthen Ukshin Hoti në Korrik të vitit 1998, të cilën ju vetë e pasqyroni në faqen 130 të librit "*Bisedë përmes hekurash":*

"Kam besim të plotë te UÇK - ja, ashtu siç doli në skenë, në mënyrë dinjitoze dhe efikase, do të dijë të përmbushi misionin e vet, ose së paku t'i kontribojë edhe këtij qëllimi, me karakter universal, gjithënjerëzor dhe fisnik."

Kur e botuat atë libër në vitin 2000, juve nuk thatë asnjë fjalë kundër këtij përcaktimi të Ukshin Hotit, gjë që do të thotë se e keni pranuar që UÇK - ja e kreu detyrën e saj historike për çlirimin e Kosovës. Atëherë, përse pas katër vjetësh e përjashtoni misionin dhe kontributin e UÇK - së si çlirimtare dhe ia njihni ato vetëm NATO - s? A është i drejtë ky qendrim i dyzuar?...

* *
*

Vetë ish - presidenti i SHBA, zoti Bill Klinton, më 23 nëntor 1999, kur erdhi në Ferizaj (Kosovë) tha: "Luftëtarët e UÇK-së të ndihmohen t'i rikthehen jetës civile.", çka do të thotë se ai e vlerësonte realisht dhe pa mëdyshje veprën e UÇK - së. Po kujt ia tha ato fjalë, se?!... As vlerësimet e një presidenti të SHBA, që di seç thotë, se tërë ato burime poltike, diplomatike, ushtarake, teknike, historike e të të tjera e të tjera informacione, nuk ua mbushin mendjen disave. Ja ç'thotë përsëri për UÇK – në zoti Bill Klinton, më 23 maj 1999, në një nga konferencat e tij të shtypit:

"Megjithëse Millosheviçi ka dëbuar me qindra-mijëra shqiptarë kosovarë nga shtëpitë e tyre, ai nuk ka mundur të eleminonte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Madje edhe radhët e saj po shtohen dita - ditës. Ajo ka filluar të ndërmarrë ofensiva kundër forcave serbe, të cilat fshihen skutave për t'iu shpëtuar goditjeve ajrore. Tani Millosheviçi po përballet me.... këmbënguljen e UÇK-së." *(B. Klinton. "Ne luftën, ju paqen", f. 82)*

Ndërsa në f. 122, ku pasqyrohet intervista që i ka dhënë zoti Klintin "PBNews Hour", më 13 Qershor 1999, ai deklaron me sinqeritetin më të thellë se kontributi i UÇK - së për çlirimin e Kosovës është pothuajse i barabartë me atë të aleates NATO, duke e ndarë atë me përqindje. Ja se si shprehet Presidenti Klinton:

"Unë gjithnjë kam menduar se mundësia e rezultatit të kësaj fushate bombardimesh ka qenë më e madhe se 50 për qind. Dhe jam i kënaqur që ajo i arriti objektivat tanë."

Edhe pas kaq kohësh, pikërisht sot, në vitin 2004, kur ish - Presidenti Klinton botoi librin me kujtime "*Jeta ime",* ai përsëri flet me respekt për UÇK-në:

"UÇK-ja besonte se mund të ndeshej dhëmb për dhëmb me ushtrinë serbe". Zoti Klinton flet edhe sot kështu, sepse nuk merr urdhëra nga askush veç ndërgjegjes së tij, sepse asnjeri nuk guxon t'i thotë shkruaj kështu, bëj atë a këtë deklaratë apo analizë... Për fat të keq, juve ende nuk e paskeni fituar këtë lloj pavarësie dhe komoditeti...

Unë po pyes: Atë besimin e patundur dhe atë ndeshjen dhëmb për dhëmb të UÇK - së me ushtrinë sërbe dhe atë 50 përqindshin tjetër të mbetur, që përmend e nënkupton zoti Klinton, duke dashur të thotë se besonte në fitoren vetëm me aviacion (pasi poshtë qiejve ku fluturonin avionët luftarakë ishte një popull i tërë në frontin tokësor, që bashkëvepronte me atë aviacion dhe që kish pranuar të vinte

kokën në satër) kush i realizoi, zotëri, UÇK-ja, apo ndonjë Zot i panjohur juaji dhe i zotit Rugova?...

Kontributin e UÇK - së në atë luftë heroike të kombit tonë, e pranon edhe vet ish - komandanti i forcave të NATO-s në Kosovë, zoti Wesli K. Klark, i cili, në librin e tij *" Waging Modern War" ("Të bësh luftë moderne"*), në faqen 330 të origjinalit anglisht, shkruan:

"Ne gjithashtu pranonim informata nga UÇK-ja, që kishin të bënin me luftën, e cila zotëronte vijën dominante, vijën kyçe të komunikacionit në veri, në drejtim të Beogradit... Ne e vumë re se UÇK-ja mbante të hapur një korridor të vogël në veri të Shqipërisë përmes fshatit Koshare.

Lufta e vazhdueshme e saj i detyronte shpesh forcat serbe të delnin në terren të hapur, ku na jepej neve mundësia t'i godisnim ato. Ne kishim informata të konsiderueshme rreth planeve të UÇK-së për të sulmuar brenda në Kosovë... UÇK-ja i nxirrte batalionet serbe nga fshatrat, permes dyluftimeve, duke na dhënë neve mundësinë t'i sulmonim nga ajri."

Është po ky Klark, i cili, në vitin 2003, si dëshmitar në gjyqin kundër Millosheviçit, në Hagë, deklaroi:

"Në Kosovë, Serbia ka patur një përdorim të tepëruar të forcës si nga policia ashtu edhe nga ushtria dhe kjo e ka rritur motivacionin e popullatës për të rezistuar."

Atëhere, zoti Kadare, a mund ta shpjegoni juve se kundër kujt e përdori Serbia atë ushtrinë dhe policinë e tepëruar, kundër mullinjve me erë, kundër grave, vajzave, pleqve, fëmijëve dhe civilave të tjerë të paarmatosur, apo kundër një ushtrie që i bënte ballë me trimëri një makine ushtarake të përbindshme e të stërfishuar? Të shpjegoni gjithashtu në se rezistencë të armatosur, që e detyroi Sërbinë të sillte aq shumë forca, e bënin vetëm ca "ekstremistë

nostalgjikë komunistë", apo një organizim i madh luftëtarësh të betuar e idealistë, i paparë ndonjëherë në Kosovë e ndoshta edhe në Ballkan, kur bëhet fjalë për kohët dhe luftërat moderne. Juve dhe zoti Solana mund t'i quani si të doni ata njerëz, por e vërteta mbetet e vërtetë dhe historia mbetet histori...

Ndoshta nuk e keni harruar se, në Kosovë, Serbia solli pjesën më të madhe të forcave të saj të armatosura, që duhet t'iu shtojmë natyrshëm edhe "armatën" e bashkë punëtorëve të saj shqiptarë në Kosovë, nga e cila UÇK-ja ishte dy-tri herë më e vogël, ashtu siç ishte gati 10-20 herë më e vogël se forcat ushtarako - policore serbe. Megjithatë ishte ajo, UÇK-ja "e vogël", që triumfoi. Ky fakt, të sjell ndër mend vetvetiu vargjet - epope të Fan Nolit:

Rent kudo duke bërtitur,
Nëpër shekuj faqendritur,
Se i vogli shtrin viganin
Dhe i shtypuri tiranin,
Veçse tok, tok, o Marathonomak.

* *
*

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja: "Si është e mundur që t'i mohohet UÇK-së merita e vërtetë e saj për çlirimin e Kosovës?" Nuk është vendi në këto refleksione modeste t'i jepet një përgjigje e hollësishme dhe e detajuar kësaj pyetjeje. Megjithatë, do të përpiqem të shpjegoj diçka me pak rrjeshta, bazuar edhe në atë çka pashë drejtpërdrejt në frontin e luftës.

Shkaku kryesor përse UÇK-së nuk i njihet, as nga ndërkombëtarët dhe as nga politikanët shqiptarë të Tiranës e të Prishtinës, merita e saj si bashkëçlirimtare e Kosovës, qendron në mungesën e pafalshme të Udhëheqjes së saj Politike.

Pse nuk patëm në krye të luftës një udhëheqje politike të caktuar, të aftë të bënte marrveshje të caktuara dhe të parashikonte e të parandalonte zhvillimet e padëshiruara e keqinterpretimet, ndaj dhe sot ish-luftëtarët e UÇK-së u përplasën e dergjen burgjeve, pasi konsiderohen si një grup guerilasish të vendosur, kokëkrisur, vetëm për të luftuar kundër sërbëve. Pra ata trajtohen thjesht si njerëz të mbarsur me një urrejtje patologjike nacionale, si kriminelë dhe jo si çlirimtarë, vetëm e vetëm pse nuk kishim udhëheqje politike.

Edhe kaq sa po heqin e vuajnë ish - luftëtarët, përsëri është mirë, pasi asnjë parti nuk ka qenë në udhëheqje të luftës dhe asnjë parti nuk e pranon se mbron vlerat e asaj lufte çlirimtare. Madje, këtë nuk pranojnë ta bëjnë edhe ata kryetarë e drejtues partish, që kanë qenë drejtpërdrejt në luftë. Në atë intervistë dhënë gazetës "*Kosova Sot",* të datës 30.12. 2003, zoti Hashim Thaçi shprehet:

"Partia Demokratike e Kosovës nuk është parti e luftës, është parti e qytetarëve të Kosovës, sepse unë i konsideroj të gjithë qytetarët e Kosovës si çlirimtarë."

Pra, zoti Hashim konsideron si çlirimtarë edhe pacifistët që propaganduan e vollën vrer kundër UÇK-së dhe luftës së saj e që sot nuk janë edhe aq paqësorë sa hiqeshin; edhe atë "armatën" e heshtur 80 mijëshe të bashkë punëtorëve të djeshëm e të sotëm të Serbisë (spiunët); edhe serbët e Kosovës që iu bashkangjitën egërsisht ushtrisë dhe policisë serbe; edhe ashkalinjtë e maxhupët që iu bashkangjitën me urë zjarri në duar paramilitarëve serbë dhe dogjën tërë Kosovën; edhe profiterët e luftës, të cilët e shfrytëzuan atë për t'u pasuruar; edhe ata indiferentët që nuk donin të dinin se bëhej luftë në Kosovë e që shpreheshin si prifti: Larg vetes time. Aferim! Qenka munduar shumë për ta gjetur e formuluar këtë të (pa)vërtetë... Po UÇK - ja, atëhere, ku mbeti, në rast se të gjithë këta kanë luftuar për çlirimin e Kosovës? Nuk ngelet gjë tjetër veçse t'i quajmë ekstremistë

gjithë ish-luftëtarët e UÇK-së, pasi kanë luftuar kundër "çlirimtarëve" të Hashimit. Tash merret vesh se kë quan ekstremista Hashimi në atë thirrjen e famshme të tij, në 3 prill 2004, dy dit pas asaj "analizës" tuaj, zoti Kadare, kur u drejtohet serbëve të Kosovës dhe u thotë: "Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga kombësia e tyre, kanë më shumë çështie që i bashkojnë se sa i ndajnë... Ne si qytetarë të Kosovës duhet të lidhim një kontratë mirëkuptimi në mes nesh... *që të mos i dëgjojmë ekstremistët*".. Kështu, "ekstremistët" e tu, të Solanës e të Hashimit na mbetën pa përkrahien e asnjë force politike, (pasi atë thirrje e firmosën shumica e partive shqiptare), d.m.th. "ekstremistët" na mbetën pa atdhe! Atëhere, kush mbetet atdheu i ish - luftëtarëve që ju të gjithë i quajtët "ekstremistë"? Nuk mbetet gjë tjetër, veçse të themi: UÇK-ja do të mbetet përjetësishtë atdheu i tyre. Ajo është një atdhe më vete.

Mungesa e udhëheqjes politike të luftës në Kosovë, solli mungesën e organizimit të unitetit organik të popullit nga ana politiko-ekonomike dhe ushtarake, ku do të përfshiheshin shumica e atyre që ishin të aftë për luftë. Pse nuk patëm udhëheqjen aq të nevojshme politike, ndaj dhe pjesëmarrja në luftë ishte e kufizuar, ndaj dhe shumica e njerëzve të thjeshtë të popullit nuk kishin ndonjë besim kushediçfarë në fitoren tonë. Dhe, kjo shumicë, vazhdon të heshtë e të mos shprehet edhe sot. Jo se tani nuk është bindur për atë që ndodhi, por ndoshta sepse nuk e kapërdin dot faktin që dje u tregua aq mosbesuese e inaktive dhe pranoi të ndikohej e të përpunohej nga pacifistët, të cilëve nuk iu mungonte për asnjë çast udhëheqja politike.

Mungesa e udhëheqjes politike të luftës, sjell lindjen e sektarizmit, por edhe një depërtim më të lehtë të agjenturës së armikut, duke e degjeneruar atë, nga një luftë çlirimtare, në luftë në interes të një grupacioni të caktuar.

Arritja e synimit dhe qëllimit të mbrapshtë e të paramenduar që në krye të Luftës Çlirimtare të Kosovës të

mos ishte asnjë forcë apo grupacion i caktuar politik, solli mosbashkimin e gjithë popullit. Mënjanimi i forcave të tilla politike, si LPK dhe LKÇK, si më të mundëshmet dhe më pretendentet që mund të delnin në atë kohë në krye të luftës dhe zëvendësimi i tyre me një apo disa individë (organizim që më vonë u quajt Drejtori Politike), bëri që politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare, (por edhe asaj shqiptare që nuk i interesonte lufta), t'iu jepej mundësia të bënin si të donin, sikundër edhe bënë. Dhe, kur iu arrit këtij qëllimi, kur u arrit "të mënjanohej rreziku", vetëm atëhere bota e njohu dhe e përkrahu UÇK - në.

Konkretisht, kjo ndodhi menjëherë pas dalies në TV të zëdhënësit të Shtabit të Përgjithëshëm të UÇK-së, zotit Jakup Krasniqi, dhe deklaratës së tij naive e të diktuar: "UÇK-ja nuk ka nevojë për të qenë nën kontrollin e çfardo force politike." Mospranimi i idesë së dalies të një force të caktuar politike (ose një grupacioni politik) në udhëheqje të luftës, u justifikua me sllloganin absurd: "Është krijuar ushtria, prandaj kush dëshiron të luftojë, le të futet në UÇK."...

Po mirë, zotërinj të nderuar ndërkombëtarë dhe ju zotërinj politikanë të kombit tim, kur partitë apo grupacionet politike nuk u dashkan për të udhëhequr veprimtarinë më të madh njerëzore, sikundër është lufta çlirimtare, atëhere përse qënkan të nevojshme ato, për të bërë biznese e për të fituar tendera në paqe?!... Kush është më e rëndësishme, udhëheqja në luftë e popullit, apo e ashtuquajtura udhëheqje e tij në ato fushatat e shënmtuara propagandistike, ku "lufta" bëhet thjesht për të fituar ca vota më tepër dhe për t'u pasuruar disa persona, sikundër i kemi parë deri tash partitë shqiptare dhe ato të tjerat në Ballkan?

Nuk kaluan disa ditë nga ajo deklaratë e Shtabit të Përgjithshëm dhe diplomacia botërore, përmes të dërguarit të posaçëm të SHBA për Ballkanin, zotit R. Gelbard, deklaroi: "UÇK - ja nuk është një grup terrorist. Nga çdo anë që ta

marrësh, ata janë një grup kryengritësish.", (*gazeta* "*Rilindia", datë 06.06.1998*).

Pse nuk u bë më herët ajo deklaratë nga zoti Gelbard? Sepse, deri në atë kohë, në udhëheqje të Luftës sonë Çlirimtare ishte LPK - ja dhe më 11 Maj 1998 ishte nënshkruar një marrveshje, midis Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe LKÇK - së, për "Bashkimin e të gjitha forcave çlirimtare në luftën e armatosur... dhe për krijimin e Frontit Politik të Luftës, për bërjen e politikës së luftës.", sikundër theksohej tekstualisht...

Me t'u eleminuar mundësia e daljes në krye të luftës e një udhëheqjeje të mirëfilltë politike brenda Kosovës, po ata persona që mohuan nevojën e saj dhe po ata që kishin deklaruar se mund të shpërthente lufta në të gjitha trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë, tashmë i qetësuan e iu premtuan ndërkombëtarëve se nuk do të kishte luftë në Maqedoni. (Mirë që shqiptarët e Maqedonisë nuk dëgjuan nga ai vesh...) Prej atij momenti, Lufta Çlirimtare e Kosovës u vu nën kontrollin e plotë të diplomacisë ndërkombëtare, për të mos thënë kryesisht të asaj europiane.

Mirpo dihet se vetëm Udhëheqja Politike është e aftë të propozojë rrugë dhe zgjidhje të reja politike në çdo lloj situate të zhvillimit të luftës, ndërsa individët mund të manipulohen. Mungesa e forcës politike në udhëheqje të luftës, sjell mungesën e parrullave politike të luftës, të cilat janë promotori i saj, pasi ato shprehin qëllimin strategjik të luftës. Mungesa e një force politike të caktuar në krye të Luftës sonë Çlirimtare solli mosargumentimin e domosdoshmërisë së lindjes së konfrontimit ushtarak të popullit shqiptar të Kosovës me Sërbinë, ndaj dhe radhët e UÇK - së mbetën të kufizuara në numër.

Në rast se nuk ka udhëheqje politike, nuk ka se kush t'i bëjë analizat për përcaktimin e strategjive dhe taktikave ushtarake e politike që kërkon etapa, apo analiza politike e ideologjike mbi të drejtën e popullit për vetvendosje; mbi të

drejtat e njeriut, të drejtat për ushqim e ndihma humanitare e të tjera... Këtë të fundit e përjetuam tmerrësisht.

Për t'u maskuar disi fakti se lufta dhe UÇK-ja kishin mbetur pa udhëheqjen e nevojshme politike, Shtabi i Përgjithëshëm i saj i kërkoi politikanit shqiptar të asaj kohe, me reputacion ndërkombëtar, zotit Adem Demaçi të pranonte të ishte Përfaqësuesi i saj Politik. Dhe juve do të shkruanit me eufori për këtë rast:

"Është një mrekulli që shefi i saj shpallet një shkrimtar, e aq më tepër, një shkrimtar martir."

Demaçin, si idealist që ishte, pavarësisht se bëri gabimin dhe pranoi ta kryente atë detyrë si individ dhe jo së bashku me forcën politike që ai drejtonte, nuk mundi ta manipulonte asnjera palë. Kjo solli divorcin e tij me UÇK-në, në kohën e Koferencës së Rambujesë. Megjithatë, Demaçi i dha vlera UÇK-së, por edhe kjo e fundit i dha vlera të reja Demaçit.

Forca politike në udhëheqjen e një lufte është domosdoshmëri, pasi lufta guerile vjen gjithnjë duke u rritur, duke kaluar nga aksionet në luftime, nga luftimet në beteja, nga betejat në operacione, ndërkohë që forca e armikut qendron në vend. Si rrjedhojë, format e luftës sonë ndryshonin dhe duhej të ndryshonin në vijimësi me objektiv, që të bënim gjakosien dhe konsumimin gradual të armikut, deri sa të arrinim në ekuilibrimin e forcave, e cila, nën një udhëheqie të zgjuar politike, do të krijonte mundësitë dhe shanset për fitore në çdo betejë.

Sikur të kishim një forcë politike në udhëheqje të luftës, nuk do të na ndodhnin ato mosmarrëveshje që ndodhën midis Demaçit dhe Shtabit të Përgjithshëm, sepse ky i fundit, në një moment të caktuar, i mori kompetncat edhe vetë Përfaqësuesit Politik. Përse ndodhi kjo? Sepse, duke u zevendësuar forca politike nga një a dy persona, sikundër ishte Demaçi, individët ka më shumë mundësi të mashtrohen,

të manipulohen, ose të mënjanohen duke u përdorur ndaj tyre forca apo presioni, pasi nuk ka kush t'i mbështesë në çaste të rëndësishme e delikate.. Kurse po të kishim një apo disa parti politike në udhëheqje të luftës, do të kishim edhe Kuvend, Konferencë apo Plenum të Jashtëzakonshëm të asaj force (grupacioni) politike dhe do të kishim një rrahje të problemit mbarë e prapsh për qendrimet që duhej të mbaheshin në Rambuje. Nuk do të kishim ato lojëra politike që na ndodhën, si: jo pyetëm atë komandant e jo pyetëm këtë komandant. Përralla me mbret e qofte me rigon. Komandantët emërohen, kurse udhëheqësit zgjidhen. Po, kush i zgjodhi ata udhëheqës që shkuan në Rambuje?...

Ka edhe mendime, se, po të mos e nënshkruanim Rambujenë, do të shpalleshim terroristë. Sigurisht që kishim të bënim vetëm me një spekulim propagandistik dhe sigurisht që askush nuk mund të na kërcënonte e të na shpallte terroristë, pasi ishim njohur ndërkombëtarisht si Ushtri Çlirimtare dhe i plotësonim të gjitha kushtet e Konventës së vitit 1949. Por ekziston edhe fakti se po të ishim terroristë nuk do të ndesheshim, sikundër u ndeshën, me një ushtri të tërë. Ajo ndeshje ishte e pashmangshme edhe sikur 100 Rambuje të mbaheshin për ta parandaluar...

Parimi themelor i luftës partizane, kur ajo arrin ekuilibrin e forcave, është që, çdo luftim, çdo përleshje apo betejë, të zhvillohet me vendosmëri deri sa të fitohet, gjë që ndryshon 100 per qind me taktikën e deriatëhershme të saj, taktikë, e cila parapëlqen luftime sa më të shkurtëra e të befasishme, sipas parimit: godit si rrufeja dhe zhduku si era. Mirpo arritja dhe kalimi në këtë stad të luftës nuk mund të bëhet pa një udhëheqie politike të njohur e të besueshme.

Individët që zëvendësojnë forcën politike në udhëheqje të luftës, mund dhe janë më të ashpër në deklarata, por janë reformistë ose sektarë në veprime, pasi në këto raste bëhet politikë personale dhe jo politikë kolegjiale. Ashtu siç thotë Majakovski:

Njëshi zero e fyl,
Njëshi send i kotë.
Po qe një dhe rëndësi po pate,
Asnjë trung pesë pëllëmbë s'e ngre dot
E jo më një pallat me pesë kate.

Po të kishim në krye të udhëheqjes së luftës një forcë të caktuar politike, kuptohet se do të ishim pjestarë të barabartë në Marëveshjen e Kumanovës dhe sot do të flisnim ndryshe.

Përfundimisht, mund të themi se udhëheqja politike e Luftës për Çlirimin e Kosovës ka kaluar nëpër ca ngjarje shumë interesante, që në disa momente ngjason me puçet ushtarake, që të le të kuptosh se ndoshta është luftuar për interesa grupore dhe jo për interes të të gjithë popullit shqiptar të Kosovës.

Akti i parë i tillë, është shmangia e LPK-së nga udhëheqja e luftës, edhe pse ajo e solli gjëndjen deri në shpërthimin e saj. Udhëheqja e LPK-së, u zevendësua nga një grup njerëzish që më vonë formuan atë që u quajt Drejtori Politike. Shmangia e LPK - së nga udhëheqja e luftës, u bë lehtësisht, pasi nuk mund të bëhet kurrë udhëheqja politike e luftës duke qendruar në Europë dhe jo në Kosovë. Pra, ata që e uzurpuan me forcë udhëheqjen e luftës, e patën të lehtë, pasi kishin argumente bindëse. Mirpo këtë hap, që parimisht mund të quhet pozitiv, del se ata nuk e kanë patur thjesht në interes të luftës, por sidomos në interesin e ngushtë të grupit të tyre. Pse? Sepse edhe ata vet "udhëhoqën" nga jashtë Kosovës, vetëm se e spostuan qendrën, nga Zvicra në Tiranë. Të vetmen gjë pozitive që bëri ai grup, ishte hyrja herë pas here ilegalisht në Kosovë, e dy antarëve të tij (H. Thaçi e K. Veseli), të cilët drejtonin në terren edhe aksione luftarake, duke u bërë kështu shumë të dobishëm dhe duke fituar me kohë, emrin dhe tiparet e personaliteteve të luftës...

Për rrjedhojë, kjo veprimtari u pasua edhe nga hapa të tjerë pozitivë. Shumë ish - drejtues të LPK - së, e lanë Zvicrën dhe erdhën e rrëmbyen armët si ushtarë të thjeshtë. Natyrisht që ky hap ishte edhe më pozitiv se ai i grupit të parë, mirëpo ata njerëz erdhën në luftë si individë, si idealistë dhe jo si organizim partiak. Në rast se do ta riorganizonin LPK - në brenda në Kosovë, atëhere shumë gjëra mund të kishin shkuar më mirë, ashtu siç nuk mund të përjashtohet mundësia që të kishte deri edhe konfrontime me armë, sepse disa gjëra tashmë kishin shkuar shumë larg...

Veprimi i dytë, në dëm të daljes së një grupacioni politik në krye të luftës, ndodhi kur u anullua në mënyrë të njëanshme marrveshja midis Shtabit të Përgjithshëm dhe LKÇK-së. Edhe në këtë rast, shkaktarë të prishjes ishin të njëjtit persona, ata që rrinin e udhëhiqnin nga Tirana, ndërkohë që LKÇK - ja vepronte brenda Kosovës.

Veprimi i tretë, ndodh kur Adem Demaçi u kërkua si individ dhe pranoi detyrën e Përfaqësuesit Politik të UÇK - së. Ardhja si individ në atë post të rëndësishëm, pa forcën politike që ai drejtonte deri atëhere, kuptohet që nuk do të kish jetëgjatësi, ose do të sherbente vetëm si një lloj garniture politike.

Veprimi i katërt, ndodhi kur Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, (e sqarojmë edhe një herë, Shtabi i Përgjithshëm dhe jo Drejtoria Politike, e cila pretendonte se bënte udhëheqjen e luftës), i mori kompetencat Përfaqësuesit Politik dhe shpalli një drejtori të atij Shtabi si udhëheqëse politike të luftës çlirimtare...(!?) Gishti të drejtoi trupin!

Veprimi i pestë, ndodhi kur Rugova dhe Bukoshi sabotuan dhe refuzuan pjesëmarrjen në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, e cila do të bënte udhëheqjen e luftës dhe i kishte të gjitha mundësitë, sepse ndërkohë ishin të ngritura të gjitha organizimet e nevojshme politike, ekonomike dhe ushtarake, pra kishim UÇK - në. Me sa duket, Rugova përsëri nuk deshi të braktise pozicionin e tij, atë të të qenit

kundër luftës së armatosur çlirimtare. Kjo u bë edhe më e qartë me vajtjen e tij në Beograd, prej nga i bëri thirrje NATO-s të ndalte bombardimet dhe, as sot e kësaj dite, as nuk e ka shpjeguar ndonjëherë këtë lloj donkishotizmi dhe as që i ka kërkuar popullit falje.

Por edhe përfaqësuesit e UÇK-së ose nuk ditën të bashkpunonin me Rugovën dhe Bukoshin për formimn e Qeverisë së Përkohëshme, ose ndoshta u erdhi për hosh qëndrimi i tyre për përzgjedhjet e kolltuqeve ministrorë. Pse këta përfaqësuesit e UÇK-së u treguan aq reflektivë ndaj atyre kërkesave? Mos ndoshta në atë "duel", secila palë shihte interesat e klanit a grupit të vet dhe jo ato kombëtare? Bukoshi pak a shumë e ka pranuar këtë fakt në intervistat që ai ka dhënë për Rambujenë.

Pikërisht sepse ndodhën këto pështjellime dhe u shmang udhëheqja politike, ndaj na ndodhi "surpriza" e hidhur e asaj mbledhjes në mal të Berishës, ku u diskutua deri edhe për shuarjen e UÇK-së, veprim që unë do ta quaja Varkiza kosovare dhe iu ftoj të lusim Zotin që të mos e kemi kurrë fatin e mëvonshëm të... Varkizës.

* *
*

Por, le të kthehemi përsëri tek aftësitë e UÇK-së dhe të shtrojmë një pyetje të thjeshtë: "Përse e rrezikonin Sërbinë ata djem shqiptarë që bënin rezistencë, kur nuk ishin të aftë ta çlironin Kosovën, siç po thuhet tani?" Përgjigjia është po kaq e thjeshtë sa vetë pyetja: Kundër tyre u ngrit një makinë e përbindshme ushtarake, sepse ata rrezikonin qendrimin e mëtejshëm të Sërbisë në Kosovë.

Rezistencën e atyre "ekstremistëve", e vlerëson po ai Klarku që drejtoi ushtritë e NATO – s në Kosovë, i cili thotë se,

vetëm gjatë muajit tetor 1998 UÇK-ja nuk ishte e fuqishme dhe vërtet ashtu ka qënë ndërsa.

"Më vonë, *vazhdon Wesli Klark*, UÇK-ja u rigrupua, e rimori veten, u riarmatos dhe ndërmori aksione."

Në se dikush kërkon të bindet për këtë deklaratë famoze të tij le të lexojë gazetën "*Kosova Sot*" të datave 19 deri 26 dhjetor 2003, të cilat pasqyrojnë deklaratën e U. Klarkut në gjyqin e Hagës.

Zotëri! Përgjegjshmëria e zotit Klark për ato që thotë, është në përputhje dhe në harmoni me përgjegjësitë e mëdha që ai ka ushtruar dhe kjo nuk mund të mohohet, ose të kundërshtohet. Është e qartë se ishte UÇK - ja ajo që mbajti mbi supe barrën më të rëndë të luftës në Kosovë, pasi ajo u ndesh ushtar me ushtar dhe u gjakos, ndërkohë që juve dhe gjithë UÇK-mohonjësit e tjerë e dini se NATO-ja zhvilloi vetëm luftë teknologjike. Mbështetur në këtë veçori që pati lufta, -NATO-ja me teknologji dhe ne me forca të gjalla, - mund të themi me bindje se çlirimi i Kosovës është kontribut i madh, aspak i vogël i popullit shqiptar të Kosovës dhe i Ushtrisë së tij Çlirimtare, është kontribut edhe i vetmohimit dhe heroizmit të lartë të kombit shqiptar, i tërë atyre vullnetarëve të trevave të tjera shqipëtare, që rrëmbyen armët dhe shkuan në rradhët e UÇK - së. Kuptohet se, që ky vetëmohim të kurorëzohej shpejt e me sukses, për vetë kohën e vendin kur vepronim dhe për kushtet delikate historike në të cilat duheshin gjetur zgjidhjet, e bënin të pashmangshme nevojën për ndihmën e NATO-s, e cila duhet pranuar se është e paçmueshme dhe unikale në llojin e vet.

Goditjet kirurgjikale të aviacionit të NATO-s bënë që të shpejtohej çlirimi i Kosovës. Po ua përsëris: Ndërhyrja e NATO-s e shpejtoi çlirimin e Kosovës dhe bëri të arrihej ai me humbje më të pakta se sa në rastin kur UÇK-së do t'i duhej të luftonte edhe për disa vite. Ne nuk e mohojmë që NATO u bë forca kryesore goditëse kundër makinerisë ushtarake serbe në Kosovë, por ama nuk mund ta mohojë askush, as juve dhe

as ata që i falen zotit, që UÇK-ja u shndërrua natyrshëm në një forcë ushtarake tokësore të NATO-s, pasi "lufta e vazhdueshme e saj i detyronte shpesh forcat serbe të delnin në terren të hapur, ku na jepej neve mundësia t'i godisnim ato.", sikundër shprehet z. W. Klark, pavarësisht se sot "çlirimtarëve" europjanë nuk iu vjen për hosh ta pohojnë një gjë të tillë...

Për ta bërë të plotë rolin që luajti UÇK-ja në atë luftë, na duhet të parashtrojmë edhe një moment tjetër: Ndërhyrja e NATO - s në Kosovë u bë konform Konventës së Gjenevës të vitit 1959, për qëllime humanitare, sikundër e shpjeguam dhe vetëm me aviacion. NATO-ja goditi vetëm objektivat ushtarake dhe ato objekte industriale që ndihmonin luftën, kryesisht jashtë Kosove. Dihet se, vetëm 15 per qind e aviofluturimeve dhe bombardimeve u kryen mbi Kosovë, madje edhe ato, në masën mbi 50 përqind kundër objekteve industriale dhe administrative dhe jo mbi ushtrinë serbe. Këto fakte të bindin se goditja kryesore kundër forcave të gjalla të armikut dhe makinerisë ushtarake serbe në Kosovë ishte vepër heroike e UÇK-së.

KADAREJA DHE LUFTËTARËT E LIRISË

Nga lufta vijmë, në luftra shkojmë.
Në zjarr e tym na shkoi kjo jetë.
Gjithmonë drejt luftrash shtegëtojmë,
Siç shtegëtojnë drejt dimrit retë.
.....
Nga luftra vijmë, në luftra shkojmë
Dhe tjetër fat s'kërkojmë ne

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Kënga e ushtarëve të vjetër")

Ju, z. Kadare me veprën tuaj keni edukuar dhe do të edukoni me dhjetra e qindramijëra lexues të popullit tonë e të tjerë, ndoshta edhe miliona, dhe do të mbaheni mend si shqiptari që bëri më shumë në këtë drejtim. Por juve na keni mësuar e frymëzuar se si ta duam atdheun dhe si të gjejmë me luftë e përpjekje lumturinë tonë, sikundër bëtë edhe vetë dikur...Atëhere, do të ishte më mirë të merreshit me veprat tuaja dhe të mos i sulmonit kaq egër, për asnjë lloj arsyeje, ata "ekstremistat", djemtë e Dalëzotëses së Kosovës, pasi ata u bënë protagonistët e vërtetë të zgjidhjes së një padrejtësie e problemi të madh historik, që e prisnim dhe e ëndërronim qysh prej gati një shekulli; ata mbrojtën Kosovën, mbrojtën lirinë, mbrojtën popullin, mbrojtën ligjin kundër pushtuesve, mbrojtën të drejtën njerëzore, mbrojtën ardhmërinë e gjysmës së kombit, duke shkuar vullnetarisht në luftë, vepër e madhërishme kjo, që atyre pacifistëve shqiptarë iu dukej përherë si një fantazi histerike, nga që nuk ndieheshin burra kurrë.

Pacifistët shqiptarë nuk kanë për ta kuptuar kurrë se dashuria për atdheun të bën të falësh çdo dashuri tjetër; ata nuk e dinë se dashuria për atdheun të bën të gëzohesh për lumturinë e bashkatdhetarëve, për lumturinë e qytetarëve të shtetit tënd, pavarësisht nga kombësia.

Të tillë ishin luftëtarët e UÇK-së dhe jo ekstremistë e nostalgjikë; ata e sakrifikuan veten vullnetarisht për një ndjenjë të lartë detyre. Shumë prej nesh dhanë gjithçka, ranë për lirinë e Kosovës, ndërsa juve e harruat dhe e mohuat edhe këtë fakt dhe na quajtët "shokët e gjallë të atyre ekstremistëve".

VËLLEZËR ARMIQ, VËLLEZËR TË ARMIQËSUAR, APO AS NJËRA DHE AS TJETRA?

Ik e ik përpara
Mbrëmja nxin dhe nxin.
I ndërgjegjes troku
Prapa oshëtin.
Kalin tënd për freri
Ajo seç ta ze,
Ti në vrap e sipër
Shpatën vrulltas ngre.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit".)

Juve, zoti Kadare, në atë "analizën" tuaj, shprehjen franceze: "les freres énemies" e përktheni qëllimisht "vëllezërit armiq" dhe jo sikundër ajo e ka kuptimin e saktë në shqip: "vëllezër të armiqësuar". Si mund të ndodhë që porsa lindin nga të njëjtët prindër, dy vëllezërit të jenë armiq? Këtë nuk e pranon asnjë logjikë. Vëllezërit, kur ata lindin të tillë, janë vëllezër gjenetikë dhe duhen pra si vëllezër, por gjatë jetës, për shkaqe e interesa të ndryshme, ata mund të armiqësohen. Kjo është e para. E dyta, shqiptarët e Kosovës, me sa di unë, nuk kanë qenë kurrë vëllezër me serbët, pasi serbët janë ardhacakë dhe, një i ardhur me dhunë në shtëpinë tënde, në rastin më të mirë, mund të adaptohet nga prindërit e tu, pas një periudhe mund të thuhet për të me dashuri: e kam si vëlla, por ti kurrë nuk je vëlla gjaku e geni me të. Madje edhe djalit të vëllait të babait, me të cilin jemi gjithsesi një gjak, përsëri ne nuk i themi vëlla, por kushëri i parë, sepse

nuk kemi lindur nga i njëjti bark, nga të njëjtët prindër. Edhe vëllait me njerkën i themi vëlla me babë dhe jo thjesht vëlla.

Atëhere si mund të quhen shqiptarët dhe serbët vëllezër, kur nuk janë jo vetëm nga i njëjti komb e vend, por as edhe nga i njëjti kontinent; ata nga Azia, ndërsa neve nga Ballkani i Europës. Hane Shan, hane Bagdat, thonë andej nga Gjirokastra...

Të përdoret ky term për kortezi, siç shpreheshim dikur për rusët apo për kinezët, - kjo edhe shkon; të përdoret në kuptimin fetar, - gjithashtu shkon, sepse, pavarësisht nga besimi i secilit, të gjithë jemi vëllezër dhe të bababartë para Zotit, që është Një.

Por, t'iu thuash vëllezër të ardhurve me dhunë e gjak në shtëpinë tënde (të tillë janë serbët e Kosovës), atyre që, duke qenë gjithnjë më të fuqishëm se ti, ndërkohë që ti ke mbetur edhe pa prindër (pasi Kosova, duke u shkëputur dhunshëm nga dheu - amë mbeti vërtet jetime), të rrahin, të mundojnë të përçmojnë e të torturojnë çdo ditë, - kjo e kapërcen edhe mëshirën e njohur kristiane dhe është jashtë çdo logjike e ndjenje njerëzore. Mund t'i merrni si të doni fjalët e mia, po as kosovarët dhe as serbët nuk iu besojnë fjalëve tuaja dhe të propagandistëve e analistëve si ju. Ata e dinë se deklarata e analiza të tilla bëhen thjesht për momentin, për demagogji dhe konsum të përditshëm propagandistik...

Vetë juve, zoti Kadare, tek libri "*Ra ky mort e u pamë*", f. 225, shkruani:

"Gjithë historianët seriozë, duke nisur nga antikiteti e gjer në ditët tona, pranojnë se dy popujt më të vjetër të gadishullit janë grekët dhe shqipëtarët."

Atëhere, nga na i nxorrët serbët vëllezër?!... Kaq shpejt e harruat se si shpreheni në vazhdim të frazës së parë:

"Teza shqipëtare e përkatësisë së Kosovës bazohet në pyetjen e thjeshtë: prej kujt banohej Kosova para ardhjes së sllavëve?"

A nuk e thoni juve, zotëri, në f 220, të po atij libri:

"Pyetjes se ku e ka zanafillën dhe shkaqet urrejtja e frikshme midis serbëve dhe shqipëtarëve?..."

dhe a nuk e jepni po vetë përgjigjen:

"Zanafilla pa dyshim, duhet kërkuar në shekujt 8 e 9, kur dyndja sllave, e nisur nga stepat e Uralit, mbërriti në kufijtë e shqiptrëve. Nën trysninë sllave, shqiptarët u tkurrën për herë e më tepër."

Vëllezër janë ata që "të tkurrin" e të vrasin, zotëri?!...

Por, as vëllezër të armiqësuar nuk mund të quhen mes vedi shqiptarët dhe serbët në Kosovë, pasi këta të fundit, kurrë nuk kanë pranuar të jetonin si vëllezër me shqiptarët. A e shihni se edhe "shkelmat" e fundit të serbëve, këtu e kanë bazën, pasi nuk ka serb të pranojë që ta drejtojnë shqiptarët....

E di kushdo se, "vëllezërit e armiqësuar", në të shumtën e rasteve vjen një moment dhe bashkohen, sidomos kur ata mbrojnë një kauzë të përbashkët. Por shqiptarët e Kosovës dhe serbët në tërësi, sado demagogë e të pasinqertë me historinë të tregohemi, kurrë nuk i kanë bashkuar armët dhe kurrë nuk kanë luftuar së bashku kundër një armiku të tretë. Edhe në Luftën e Dytë Botërore, pjesa dërrmuese e popullit shqiptar të Kosovës kaloi me nacionalistët, të cilët luftuan edhe kundër nazifashistëve, edhe kundër serbëvë, pavarësishtë në se ata ishin komunistë apo çetnikë. Nacionalistët shqiptarë dështuan, se nuk patën udhëheqje politike.

"Vëllezër të armiqësuar" mund të quhen sot partia e LSDM-së në Maqedoni, (e udhëhequr nga Branko Cervenkovski, i cili është me origjinë sërbe dhe ndaj e kërkon bashkimin e Maqedonisë me Sërbinë) dhe partia e VMRO-së, (e udhëhequr nga Lupçe Gjeorgjevski me origjinë bullgare, që kërkon për këtë arsye, bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë), por që të dyja këto parti bashkohen e bëhen motra (është njëlloj si të thuash vëllezër...) kur vjen puna për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni. Ndërsa kjo logjikë nuk

vlen, ajo është e varfër dhe e pamjaftueshme kur kërkohen me zor argumente për gjoja vëllazërimin e lashtë të shqiptarëve e serbëve në Kosovë.

Edhe Mali i Zi dhe Sërbia mund të quhen "vëllezër të armiqësuar", vëllezër që, pa asnjë mundim, i miqësoi përsëri, i pajtoi e i bashkoi Solana, kur "u tromaks" nga mundësia reale që Kosova të fitonte pavarësinë, apo të bashkohej natyrshëm me Shqipërisë. Ka edhe plot fakte e argumente të tjera, që shpjegojnë e vërtetojnë se teza juaj nuk është e drejtë. Ajo është jashtë kohës dhe nuk ndreq asgjë, edhe po qe se e përsëritni. Sepse vetë juve keni thënë:

"Kosova është një truall i madh ku prej dhjetra vjetësh është konservuar krimi. Atje koha nuk ka lëvizur që nga Lufta e Dytë Botërore."

(I. Kadare. "Ra ky mort e u pamë", f.203 – 204.)

Atëhere, përse nuk e thoni që ky fakt ekziston edhe pas vitit 1999 e këtej? Kur pushoi lufta në Kosovë, asgjë nuk ndryshoi, por, shkallë - shkallë, u bënë dhe po bëhen përpjekje që të konservohet përsëri krimi, me qëllim që kosovarët t'i kthehen përsëri Serbisë në kuptimin më të plotë të kësaj fjale. Përse nuk thuhet hapur, zotëri, se në këto pesë vjet të pasluftës, që përkojnë me kohën e largimit të forcave ushtarako - policore sërbe nga Kosova, asnjë hap më shumë se një armëpushim i thjeshtë midis ish - palëve ndërluftuese nuk është bërë. Gjendja vazhdon hiq e mos e këput, të gjithë bëjnë analiza e deklarata edhe më të çuditshme se këto tuajat, por askush s'di të të thotë me saktësi se ç'do të ndodhë në të ardhmen. Askush, as ndërkombëtarët, as politikanët shqiptarë këtej e andej kufirit, as kosovarët dhe as vetë serbët. A nuk i thonë kësaj ta shtysh zgjidhjen e problemit në kalendat greke, duke i përkeqësuar edhe më shumë gjërat dhe a nuk ka të drejtë populli të zemërohet e të rrebelohet nga e gjithë kjo pritje e mundimshme?.. Sigurisht, sepse asgjë dhe asnjë nga aspiratat e tij nuk është realizuar. Arsyet e këtij stanjacioni

dhe të këtyre të vërtetave të hidhura i duhen shpjeguar popullit me durim dhe jo të ushqehet ai me përralla të mbushura me "ekstremistë" e "adoloshentë". Populli ka nevojë të dijë më shumë, të shohë një rreze shprese në këtë rebus të pazgjidhshëm politik dhe jo t'i flitet me hipokrizi e t'i mbushet mendja për gjëra që ai i di më mirë se cilido, sepse i ka hequr mbi shpinën e vet. A mund t'iu besojë ndonjë kosovar kur i thoni se paskemi qënë dikur vëllezër me serbët, por se kush na ngatërroi për gjëra kot së koti dhe u armiqësuam çuditërisht. Kështu tha edhe Hashimi në atë thirrjen e famëshme të tij të 3 prillit 2004, me siguri i frymëzuar prej jush: "Ne dhe serbët kemi më shumë gjëra që na bashkojnë se sa na ndajnë." (!?)...

Ndërsa vetë juve, zoti Kadare, po në librin *"Ra ky mort e u pamë", në f. 195 - 196* thoni krejt të kundërtën e këtyre fjalëve të Hashim Thaçit, që duken që atje tej se janë thjesht demagogji. Ja se sa i vërtetë jeni dhe sa bukur shpreheni: "sjellja demokratikisht me barbarinë është pasojë tragjike për demokracinë. Ligjet e qytetërimit s'kanë asnjë efekt mbi barbarët...."?

Mund ta themi me plot gojën se, ky përfundim gjenial juaji i atëhershëm,u vërtetua plotësisht në Kosovën e pasluftës. Ndryshe nga sa këshillonit juve, gjatë këtyre pesë viteve, populli shqiptar i Kosovës, u soll më tepër se urtë dhe më shumë se demokratikisht me serbët dhe ndërkombëtarët. Dhe, jo vetëm me ta, por me gjithë botën. Pranoi të bëheshin eksperimente me të, pranoi zgjidhjet politike, ekonomike e sociale të ofruara, gjithçka. Dhe, ç'fitoi? Atë që sot, serbët, gjoja të persekutuarit e përkëdhelur të Europës, kërkojnë ndarjen e Kosovës dhe kantonizimin e saj, gjë që në fakt po e arrijnë dalngadalë, si për shembull: në Mitrovicë, Graçanicë dhe enklavat e tjera, brenda Kosovës, duke kërkuar tani që këtë ta realizojnë edhe ligjërisht!

Përse nuk shpreheni, zotëri edhe për Kosovën Lindore, të cilën këta "çlirimtarët" europianë nuk e përmendin dhe nuk e shkruajnë kurrë nëpër axhendat e tyre; përse nuk bëhet asnjë hap, që edhe atij populli t'i jepet e drejta të vetëdeklarohet, qoftë edhe për faktin se u soll demokratikisht, sipas dëshirës së ndërkombëtarëve dhe politikanëve të Tiranës e Prishtinës, kur pranoi të dorëzonte armët UÇPMB-ja, por iu mbani ison atyre dhe na thoni se "Në Kosovë, humbi ideja e mirëkuptimit dhe bashkëjetesës nga shqiptarët."

E keni harruar, zoti Kadare , se çfarë keni thënë dikur në librin e sipërcituar:

"Në qoftëse populli sërb nuk mund të fajësohet për krimet e pjesës më të egër të tij, ai mund të fajësohet për pranimin e krimit."

Këto janë, me pikë e me presje fjalët tuaja, ndërsa në "analizën" e datës 1 prill 2004, pa na e sqaruar në se populli serb e ka pranuar të paktën fajin e "pranimit të krimit", në se ka bërë ndonjëherë autokritikë a ka kërkuar falje publike, na "këshilloni": "...shqiptarët duhet të pajtohen me serbët me vullnet ose me gjysëmvullneti. Me hir ose me pahir."

Cilën prej këtyre thënieve të besojmë, cilën të marrim sot për bazë, zotëri?!...

Juve nuk dalloheni për kujtesë të dobët. A iu kujtohet se çfarë i keni thënë zotit Denis Fernandez për një çek të viteve '70?:

"Më kujtohet se rastësisht, kam takuar një çek që ishte larguar nga Çekosllovakia. Më tha: "Sa të lumtur duhet të jeni! Jetoni pa rusët, pa sovjetikët. E pabesueshme.""

Çekët janë sllavë, por prapseprapë nuk i duronin e nuk i durojnë dot sllavët barbarë, ndërsa shqiptarët qenkan të detyruar të "pajtohen me sërbët me vullnet ose me gjysëmvullneti. Me hir ose me pahir."...

Unë nuk jam kundër bashkëjetesës me serbët, pasi fati e ka sjellë që të jemi fqinj të përjetshëm, por ta kërkosh një

gjë të tillë tani, kaq shpejt, kur plagët që iu shkaktuan serbët shqiptarëve janë ende të nxehta e të përgjakura dhe dhembin sa herë prishet koha, ky është të paktën një nonsens, një kërkesë ultimative që vetëm shqiptarëve mund të merret pa të keq guximi t'iu bëhet dhe askujt tjetri... Tjetër akoma, miqësia, vëllazërimi e pajtimi nuk bëhan me urdhër, as me zor; ato vijnë vetvetiu, kur krijohen një varg kushtesh që i përligjin ato. Çfarë kushtesh iu janë krijuar kosovarëve, që "urdhërohen", si të ishin thjesht ca fëmijë të zemëruar kot, që të "pajtohen me serbët, me vullnet ose me gjysëmvullneti. Me hir ose me pahir."...

Si mund të shpreheni kështu, kur, më parë, po ju, në librin "*Ra ky mort e u pamë"*, f. 68, shkruani:

"Kriminelit Radovan Karaxhiç, një farë kohe i pëlqente të përsëriste tezën se "dalëngadalë viktimat fillojnë e ndjejnë dashuri për torturuesit e tyre." ?...

Këtë tezë të fundit, këtë lloj psikologjie kriminale, xhelatët serbë ëndërruan ta vinin në jetë pikërisht me shqiptarët… Ndaj, i parë sot në largësi e me gjak të ftohtë, "gandizmi shqiptar", ai që pranonte në heshtje këtë gjëmë e këtë mashtrim, "ishte vdekje për shqiptarët e Kosovës.", sikundër ju shpreheni.

Duke u shprehur ashtu siç e cituam më lart, natyrisht që juve s'keni dashur dhe s'keni kështilluar që viktimat - shqiptarë, të ndienin ndonjëherë dashuri për torturuesit - serbë të tyre. Kjo do të ishte e papranueshme. Atëhere, përse pas pesë vjetësh, kur asgjë nuk ka ndryshuar nga psikoza serbe, kundërshtoni vetveten dhe ngriheni e na urdhëroni ta pranojmë këtë vdekje "me hir a me pahir"?!...

Edhe në "analizën" për ngjarjet e 17 dhe 18 marsit, në mbarim të pjesës së dytë të saj, juve shpreheni:

"Kanë kaluar 6 vjet nga tmerret në Kosovë dhe nuk ka asnjë shenjë të dënimit të tyre nga pala fajtore. Ky

mosdënim ka qenë midis të tjerash një nga shkaqet e mllefit të grumbulluar në Kosovë."

Ndoshta është një konstatim realist, që "iu ka rrëshqitur" për momentin, ndryshe nuk mund të thoshnit pas shtatë paragrafësh, në fund të pjesës së tretë:

."Pajtimi është i përligjur, qoftë edhe me pahir." Ndërkohë që më 30 dhjetor 1999, në gazetën zvicerane *"Le Tempos"*, jeni shprehur drejtpërdrejt dhe me një frymë të rrallë realiste për këtë lloj pajtimi që predikoni sot:

"Do të duhet filluar që të bëhet presion mbi Serbinë, në mënyrë që ajo të pranojë krimin e vet, të ushtruar ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Në se ajo do ta bënte këtë, atëhere shpirtrat e shqetësuar të Kosovës do të fillojnë ta gjejnë qetësinë e tyre..... Por po bëhet e kundërta: po kërkohet nga shqiptarët që t'i falin serbët! Kjo nuk është vetëm mizore, por është edhe raciste".

A doni më citime dhe argumente pro dhe kundër nga ato që keni thënë e shkruar në kohë të ndryshme, zoti Kadare? Një njeriu të zakonshëm edhe mund t'i falen lajthitje të tilla, po kur ato i bëni pikërisht juve, atëhere jemi të detyruar të vihemi në mendime dhe të pyesim veten: "Ç'po ndodh kështu me më të madhin e letrave tona?!..."

A iu kujtohet zotëri, se si u suallën anglo-amerikanët në fund të Luftës së Dytë Botërore ndaj popullit gjerman, që e kishte mbështetur nazizmin, sikundër serbët e Kosovës mbështetën millosheviçizmin? Komanda e forcave anglo-amerikane lëshoi urdhrin e pazakontë që, të gjithë gjermanët, prej moshës 14 vjeç e lart, me punë të detyruar dhe pa shpërblim, të hapnin të paktën varret, për të varrosur viktimat e shumta, si dhe të pastronin rrugët e Gjermanisë nga gërmadhat.

Ndërsa në Kosovë, ku "Gjatë këtyre viteve të fundit nuk më kanë dëgjuar veshët që sërbët të protestojnë ndaj

asaj që po ngjet në Kosovë, ca më pak të pikëllohen për fatin e kosovarëve…

Ata nuk i dënojnë vrasjet, as shprehin qoftë edhe keqardhje për to", sikundër shkruani juve te libri "*Kohë barbare",* f.282, këta serbë të papenduar ndonjëherë, jo vetëm që nuk u detyruan të rihapnin qoftë edhe një nga 450 vorrezat masive që dikur i kishin hapur me kënaqësi për të groposur shqiptarët e masakruar prej tyre, por nuk u detyruan as të tregonin, ose të tregojnë sot të paktën, se ku i kanë groposur shqiptarët që ende konsiderohen të zhdukur, përfshi edhe mikun tuaj, gjigandin e mendimit politik shqiptar, Ukshin Hotin.

Si mund të shpjegohet kjo sjellje ndryshe e "çlirimtarëve" europianë, madje edhe e vetë Rugovës ndaj sivëllezërve të nazistëve? Por unë, më kot e shtroj këtë pyetje, sepse vetë juve e keni dhënë përgjigjen e kësaj pyetjeje, duke shkruar po tek *"Kohë barbare", f.297*:

"Millosheviçi nuk është aq i izoluar sa ç'e pandehim. Ai ka idhtarë disi gjithandej, dhe shtëpisë Europë po i kanoset vdekja që mban maskë të kuqe."

Po në atë intervistë, zotëri, juve thoni se serbët e Kosovës, që t'i riktheheshin skenës politike, duhet të bënin atë që bëri Gjermania pas Luftës së Dytë Botërore, të dënonin krimet e sivëllezërve serbë. Veçse ata "çlirimtarët" e dashur europjanë dhe "gandisti" Rugova, jo vetëm që nuk iu kërkuan serbëve të na kërkonin të paktën ndjesë, sikundër bënë gjermanët, por bënë të kundërtën: hartuan një Kornizë Kushtetuese, e cila pranonte dhe pranon që në Parlamentin e Kosovës të futen ekstra 20 deputetë serbë, përveç atyre që votohen nga populli. Këtë Kornizë e firmosi "gandisti" i juaj progresist, e miratoi me fjalë vëllai i dy dëshmorëve dhe ish - komandanti - hero i Zonës së Tretë Operative të Dukagjinit;e kundërshtoi me fjalë, sa për të mashtruar popullin, ish - Drejtori Politik i UÇK-së, Hashim Thaçi, por të nesërmen edhe

ai “e hëngri fjalën” dhe pranoi të futej në zgjedhjet parlamentare me atë Kornizë Kushtetuese...

Dhe ky nuk është një mëkat aq i vogël sa duket. Po ta kishte bërë praktikisht atë që tha Hashim Thaçi, ashtu sikundër nuk firmosi dhe sikundër deklaroi për Kornizën Kushtetuese, po të ngulte këmbë e të thoshte se partia që ai drejtonte, nuk do të futej në zgjedhjet parlamentare pa u ndryshuar Korniza Kushtetuese e imponuar nga europianët, kuptohet që as Ramush Haradinaj dhe as partitë e tjera që ishin grumbulluar rreth tij nuk do të shkonin në zgjedhje. Si rrjedhojë, donin a nuk donin “çlirimtarët” europjanë do të detyroheshin ta ndryshonin atë farë Kornize, e cila shqiptarët i trajton si dikur Sërbia, qytetarë të dorës së dytë, ndërsa sërbët si qytetarë të rendit të parë...

Ja pra, pse u revoltua populli dhe jo se e “ngucën ekstremistët nostalgjikë komunistët”, as se e pushtoi xhindi i “dufit katundaresk”, sikundër e “zbuluat” ju. Ato epitete nuk keni të drejtë t’ia thoni një populli të tërë, pasi në ato revolta u ngrit pothuaj i gjithë populli shqiptar i Kosovës, madje edhe familiarët e politikanëve të Kosovës, me përjashtim të atyre vetë dhe të shpurave të tyre.

Dhe prapë juve, Solana, Shiferi e të tjerët kërkojnë me ngulm që serbët të trajtohen si djali i përkëdhelur i njerkës, të mos i thonë popullit shqiptar asnjë fjalë ndjese, duke treguar të paktën edhe formalisht sadopak pendim për krimet e vrasjeve masive të shqiptarëve, por përkundrazi, të na i vrasin përsëri fëmijët e të na i mbysin në lumenj dhe, prapë e prapë ne, vetëm ne, të pajtohemi, “me hir a me pahir”!... Si mund të ndodhë dhe përse duhet të jenë të parët shqiptarët që të pajtohen me serbët e Kosovës, kur të gjithë ata, pa përjashtim, u angazhuan në krime, duke iu bashkangjitur ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve sërbë dhe duke zhdukur me mijëra shqiptarë, të cilëve ende nuk iu dihet as varri?!... Kur edhe sot, pas pesë vjetësh, në mënyrë të organizuar, na mbysin fëmijët shqiptarë në lumin Ibër dhe nuk na kanë thënë

e nuk pranojnë të kërkojnë as ndjesën më të vogël?!... Mos duhet t'iu themi atyre: "Na falni që folëm pse na vratë e na mbytët fëmijët!"?!...

Madje serbët nuk u mjaftuan me hedhjen e fëmijëve në valët e tërbuara të Ibrit, në mes të dimrit, por hapën edhe digën e liqenit, që të dyfishohej sasia e ujit në lumë dhe që mosnxjerrja e fëmijëve nga lumi të ishte e sigurtë. Mos vallë ata që hapën digën e liqenit, ishin fëmijë dhe adoleshentë serbë, që vepronin në digë nën hundën e policisë ndërkombëtare, apo ishin serbë të rritur?!... Atëhere, le të shpjegohemi të paktën midis nesh dhe ta sqarojmë se cili popull duhet të detyrohet i pari të pajtohet, me hir a me pahir; cilët po e fusin e kultivojnë urrejtjen deri edhe tek fëmijët, serbët apo shqiptarët...

Mos harroni, zoti Kadare se vëllezërit shqiptarë më të rritur të këtyre fëmijëve që u mbytën në Ibër në 16 mars 2004, "kanë qenë dëshmitarë të tmerreve të papërfytyrueshme" të luftës para pesë vitesh, sikundër e pranoni edhe vetë në "analizën" tuaj. Dhe sot, vetëm se këta dëshmitarë, ish - fëmijë në periudhën e masakrave të para pesë viteve dhe adoleshentë në masakrën e lumit Ibër, ngrihen dhe protestojnë, ju e quani veprimin e tyre: "Zakon i shëmtuar e burracak, i ndikuar me sa duket nga konflikti izraelito - palestinez, përdorimin e fëmijëve në protestat e të rriturve.".

Ndërsa dikur, në faqen 110 të librit "*Ra ky mort e u pamë",* keni shkruar:

"Vetëm të vdekurit nuk lëvizin më. Të plandosur aty - këtu ndanë udhëve. Të mbytur nëpër puse. Një pjesë të ngrënë nga korbat, si në këngët e vjetra. Popujt e hershëm ndjellin, me sa duket, tmerre të tmerrshme."

Po tani, ç'të bëjnë kosovarët, këta ish - fëmijët dhe ish adoleshentët e para pesë viteve, t'i harrojnë "të vdekurit që nuk lëvizin më...", kur askush nuk iu afron asnjë punë dhe

as nuk u gjen e nuk iu jep asnjë fije shprese as për të zhdukurit? Juve kërkoni që shqiptarët të pajtohen me sërbët "me hir a me pahir", ndërkohë që më 26 qershor 1999, ne faqen 122 të po atij libri, shkruani:

"Në qoftë se dikush do të kishte shpresë që armiqësia shqiptaro - serbe do të niste të zbehej pas një shekulli, përdhunimi i vajzave dhe i grave do ta shtynte atë edhe një shekull tjetër."

Besojmë se nuk i keni harruar fjalët tuaja, zoti Kadare? As ato që keni shkruar në 26 mars 1999, te ky libër, f.54:

"Duket e pabesueshme kur mendon se Perëndimi po e bombardon Jugosllavinë…Duket si ëndër. Ka ndodhur një ndryshim në boshtin e botës. *Rrugët tona me Sërbinë ndahen këtu përjetë*".

Unë, do t'iu këshilloja me modesti t'i harronit sa më shpejt ato që keni thënë kohët e fundit, pavarësisht se në çfarë kushtesh keni folur, "me hir a me pahir..." Në të kundërtën, situatën delikate në të cilën e keni vënë veten, do të na duhej ta shpjegonim po me fjalët tuaja: "Rimohuesit janë përherë më të zellshëm."

"Ra ky mort e u pamë", faqe 125.

Do të na duhej të shfletonim gjithashtu edhe faqen 142 të këtij libri, ku polemizoni për shkrimin e Veton Surroit "*Mbi fashizmin kosovar*" dhe t'i shihni me sy kritik ato çka shkruani edhe për atë:

"Shpjegimi nuk është i ndrlikuar po të kihet parasysh se ajo sëmundje e rëndë që i ra një zhgani intelektualësh në Shqipëri, për t'u ngritur kundër popullit të tyre. U ngritën në emër të paanësisë, të "mungesës së nacionalizmit", të një vizioni kinse të emancipuar modern të politikës etj., etj., kurse në të vërtetë u ngritën të shtyrë nga interesat më meskine: të fitojnë simpatinë e zyrave sterile ndërkombëtare, e bashkë me sipmatinë të fitojnë paratë e tyre, bursat udhëtimet, stazhet, etj… Shpesh në

shtypin shqiptar në Tiranë, Prishtinë ose diasporë, ndeshet një alternativë: ta mbrosh popullin tënd në mënyrë primitive, apo ta shesësh në mënyrë moderne. Alternativë e aspektshme, e mosqoftshme, tragjike".

Në shkrimin "*Ballkani: të vërteta dhe të pavërteta*", botuar në vitin 2000, juve shkruani:

"Popujt e Ballkanit nuk janë tribu që grinden për gjëra të kota."

Ndërsa kur bëni "analizën" e revoltës masive popullore të marsit në Kosovë, popullin e Kosovës e trajtoni pikërisht si një tribu që u grin për gjëra të kota dhe thoni se, "qëllimi i saj kryesor ka qënë armiqësimi i shqiptarëve me Perëndimin, rjedhimisht, prerja e rrugës drejt Europës..." (?!...)

A do t'i besonit këto fjalë po t'i thoshte dikush tjetër, zotëri?... Kur t'i lexonit ato, a nuk do t'iu kujtohej shkrimi juaj me titullin "*Triumfi i krimit*", botuar në gazetën "*Le Mond*" në 3 maj 1999, ai shpjegimi juaj brilant se, për ta bërë të mundur bashkjetesën midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë duhet, së pari: "thënia në sy e së vërtetës. Dhe e vërteta, sado e ashpër, është shpëtuese. Në qoftë se populli sërb nuk mund të fajësohet për krimet e pjesës më të egër të tij, ai mund të fajësohet për pranimin e krimit. Sepse me trishtim duhet konstatuar se shumë pak zëra janë ngritur kundër barbarisë serbe nga vet serbët. Venia në dukje e përgjegjësisë kolektive të këtij vendi është qendrimi i vetëm korrekt që mund të mbahet ndaj tij. Rjedhimisht, pranimi i fajit dhe dënimit të tij është i vetmi shteg i hapur që i mbetet këtij vendi për t'u rikthyer në familjen e popujve."

Po në atë shkrim, juve i drejtoheni popullit italian, që demonstronte kundër shqiptarëve gjatë periudhës së intervenimit të NATO - s në Kosovë:

"Qeveria italiane, para disa vitesh, ngriti një monument në një fshat të Ukrainës, për strehimin e pesë robërve italianë, por Italia nuk u kujtua kurrë të bënte këtë për 40 mijë ushtarët e vet në Shqipëri. Rjedhimisht, përpara se të dalin në rrugë kundër shqiptarëve, të rinjtë italianë është mirë të kujtohen se kush iu dha strehë etërve të tyre."

Përfundimisht, zotëri, edhe juve përpara se t'i propozoni popullit shqiptar në Kosovë idenë e mirëkuptimit dhe të bashkjetesës me serbët, është mirë të kujtoheni për gjithçka që keni thënë për ta para pesë vitesh dhe t'ua thoni përsëri e përsëri atyre serbëve që nuk kanë të ngopur me gjak shqiptarësh. Ua thoni atyre dhe unmikasve, sepse nuk ka asnjë arsye të miratoni çdo gjë që thonë e që bëjnë ata... Në se kjo nuk mjafton, atëhere mund t'i thoni përsëri popullit shqiptar në Kosovë që të ulë kurrizin e të durojë...

PREKJA E SIMBOLEVE TË KOMBIT

Ik e ik, e zezë
Rruga - shkretëti.
O, ç'e tmerrshme
Është kjo qetësi.
Trok i tradhëtisë
Natën mbyt e mbush,
Kokën pas ç'e kthen,
Prapa s'të ndjek kush.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Ikja e Moisi Golemit")

Kemi edhe diçka tjetër zoti Kadare që e ka irituar popullin tonë. Miku juaj i kohëve të fundit, "intelektuali i izoluar progresiv", zoti Rugova, gati dy vjet para shpërthimit të revoltave, kudo ku shkonte nëpër manifestime a tubime të ndryshme, përdorte disa simbole private në vend të simboleve tona kombëtare, sikundër janë Flamuri dhe Himni Kombëtar. Këtë e pranoi edhe një pjesë e mirë e "komandantëve të mëdhenj" të UÇK - së, të cilët Flamurin Kombëtar e zëvendësuan me hartën e Kosovës, kur nuk ekziston asnjë lloj ligji i Parlamentit të Kosovës për një gjë të tillë, madje nuk thuhet gjë as në atë Kornizën...

A mund ta durojë dhe ta falë populli këtë përdhosje të simboleve të tij kombëtare?!... Populli nuk e harron se, me atë Flamur të përndritur në dorë dhe me Himnin Kombëtar në gojë, djemtë e vajzat e tij e derdhën gjakun lumë për vetvendosien e Kosovës. Po Rugova s'e ka për gjë ta fyejë dhe ta provokojë popullin; ai është i dashuruar vetëm me... vetveten, pa le ta quani juve sa të doni intelektual progresist. (Të paktën, të përdorej fjala shqipe: përparimtar.)

Mos vallë është një "sëmundje e vjetër" e diktatorëve, artistëve dhe shkrimtarëve të mëdhenj kjo prekja e simboleve, sikundër bëri skulptori legjendar qipriot, Pigmalioni, i cili ra në dashuri me statujën e Galatesë, që bëri vet dhe iu lut Venusit t'i jepte asaj jetë dhe u martua me të? Ndoshta, sepse më kujtohet se si e keni trajtuar këtë te romani "*Shkaba"*. Aty, personazhi juaj, i hipur mbi shkabën që i kishin rënë fuqitë, e godet atë me thikë, që ajo të ndiente dhembje e të ecte pak më tej.

Ai personazhi juaj e goditi simbolin për të shkuar pak më tutje, për t'ia arritur një qëllimi të afërt. Këtë po bën edhe Rugova, godet simbolet e kombit për të realizuar atë që duan disa shtete europiane dhe që ai të shpërblehet me karriken e presidentit të përjetshëm të Kosovës.

Juve, sigurisht që nuk dëshironi dhe nuk luftoni të bëheni ndonjëherë president. Iua kanë ofruar karriken presidenciale dhe e keni refuzuar dhe ky veprim është në përputhje me madhështinë tuaj, me faktin se një shkrimtari të madh si juve s'kanë ç'i duhen postet, karriket, dekoratat, madje as politika dhe vetë politikanët. Atëhere, ç'patët me UÇK-në, përse e mohuat dhe e anatemuat atë?!... A nuk është shndërruar edhe UÇK-ja tashmë në një simbol të Historisë më të Re Shqiptare?...

VETVENDOSJE, APO PAVARËSI?

Ç'bëtë andej tutje,
Ç'nam, ç'batërdi?
Për nam s'u kujtuam,
Bëmë Shqipëri.

Po kthehen, dil t'i shohësh
Të ralluar me plumb,
Xhufkat mbi opinga
Nga tymi - shkrumb.

(Ismail Kadare. Vargje nga poezia: "Kthimi i shqiptarëve nga lufta".)

Në shkrimin "*Ballkani: të vërteta dhe të pavërteta*", juve thoni:

" Duke njohur tërë vështirësitë që lejon mundësia e ndryshimit të kufijve në kohën e tashme... Evropa nuk duhet gjithsesi, në mënyrë arrogante të varrosë këtë ide shpëtuese. Ajo është e vetmja ide shpëtuese, që na lejon të shohim dritën e daljes nga tuneli. Mbyllja e kësaj drite është baraz me provokacionin më të rëndë që mund t'i bëhet një populli: dekretim për heqien e të drejtës së lirisë. Asnjë popull në botë nuk mund ta pranojë këtë, e aq më pak një popull në Europë. Pranimi i idesë së lirisë vetvendosëse, përgatitia me durim e mençuri e saj, do të jenë një lehtësim i madh në ndërgjegjen e popujve të Ballkanit. Pa këtë lehtësim, janë të pamundura hapat drejt uljes së tensionit e drejt paqes."

Janë fjalë që s'ke ç't'iu e heqësh e ç't'iu shtosh. Po ku ua venë veshin ndërkombëtarët dhe "çlirimtarët" europjanë fjalëve të tilla, ideve të tilla shpëtuese!... Ata, se nga "gjetën"

një të ashtuquajtur Kornizë Kushtetuese dhe i mashtruan shqiptarët, lidhur me atë çka thuhet në Marrveshien e Rambujesë, ku u premtua se, pas tre vjetësh, banorëve të Kosovës do t'iu jepej e drejta të vetvendosnin, përmes një referendumi mbarëpopullor. Në vend të atij referendumi, përsëri se nga u shpikën ca standarte. A nuk duhet ngritur me të madhe zëri edhe për këtë padrejtësi historike, në vend që revoltën e shqiptarëve për të ta quani "duhmë vetvrasëse,… duhmë katundareske… e nxitur nga ekstremistë nostalgjikë komunistë"? Me çfarë nostalgjie komuniste u protestua në ngjarjet e 17 dhe 18 marsit 2004, përveç se kosovarët shprehën padurimin e tyre për mosmbajtjen e premtimit të shkruar në letër, referendumin për vetvendosje? Mos vallë referendumet janë shpikur nga komunistët?... Me sa mbaj mend unë, ata s'para i kanë patur shumë qejf referendumet dhe protestat. Për kurrfarë nostalkgjie komuniste nuk mund të bëhet fjalë kur proteston për burgosjen e bijve çlirimtarë të popullit me pretekste nga më absurdet; në rast se kërkon mosposhtërimin para atyre që na kanë vrarë e prerë 18 shekuj me radhë. Këtë juve e dini edhe më mirë se unë, prandaj, ju lutem, mos i detyroni njerëzit të thonë: "Kadareja kundërshton Kadarenë?!..."

Ne, ish - luftëtarët e radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë ai popull që na mbështeti në atë luftë, as nuk kemi qenë dhe as nuk jemi ekstremistë. Të tillë janë politikanët shqiptarë aktualë. Të gjithë pa përjashtim, nga cilado anë e kufirit dhe e "barrikadës" Rugova, Thaçi, Nano, Berisha, Daci, Pëllumbi, Rexhepi, Haradinaj, Meta, Xhaferri dhe një lukuni e tërë pas tyre, që shprehen çdo ditë për PAVARËSINË E KOSOVËS dhe bëjnë pak ose aspak për të. Për fat të keq, me ta u rrjeshtuat edhe juve, që keni qenë kurdoherë "një kokë më lart" se ata dhe opozitar i përjetshëm i tyre. A nuk është qendrim ekstremist ai që bie ndesh me marrveshjen e Helsinkit, kërkon krijimin e dy Shqipërive në kufi me njëra tjetrën? Kaq naiv të jetë zoti Rugova sa të mos e

kuptojë se bota nuk e ka lejuar, nuk e lejon dhe nuk do lejojë kurrë këtë?!...

Të gjithë juve keni deklaruar dhe prapë po deklaroni se Enver Hoxha e shiti Kosovën, pasi nuk e bashkoi në fund të Luftës së Dytë Botërore me Shqipërinë. Po tani, që thuhet se bota Perëndimore është me ne, sidomos kur është në sinkron të plotë me juve të gjithë, përse nuk mundeni ta koregjoni e ta vini në vend atë "tradhëti" të Enver Hoxhës, por kërkoni shkëputje të përjetshme të Kosovës me Shqipërinë? Duke kërkuar Pavarësi të Kosovës, vërtet mendoni se do të na e japin ndonjëherë "çlirimtarët" tuaj europjanë, vërtet e besoni këtë?!...

Ndërsa neve, ish-luftëtarët e UÇK-së, gjatë gjithë luftës sonë, por edhe në mbledhjen e fundit të datës 26 qershor 2004, në Kuvendin e Dytë Zgjedhor të Shoqatës sonë të Veteranëve në Kosovë, në përputhje me atë çka firmosën përfaqësuesit tanë në Rambuje, kemi deklaruar dhe deklarojmë: T'i jepet e drejta popullit të Kosovës të vetdeklarohet për statusin e saj, si një e drejtë legjitime e të gjithë popujve. Mirpo, nga që kryesia e kësaj shoqate është nën dirigjimin e PDK-ë, rezoluta jonë nuk u botua askund, se bie ndesh me "Pavarësinë" e Thaçit...

Ne nuk themi: duam bashkimin e Kosovës me Republikën e Shqipërisë! Nuk themi: duam Pavarësinë e Kosovës! Nuk themi që Kosova t'i rikthehet Sërbisë apo shtetit sllav Serbi-Mali i Zi, ose që ajo t'i bashkangjitet Bashkimit Europjan. Ne vetëm themi: DUAM VETVENDOSJE!

Cilët janë më demokratë në këtë rast, ish - luftëtarët dhe "populli i tyre ekstremist", sikundër i quajtët juve me Solanën, Shiferin e të tjerë, apo ata që shajnë e anatemojnë kundërshtarët vetëm e vetëm se nuk thonë "Amen!" në çdo rast dhe nuk janë në një mendje me ta? Po ekstremist, kush është në këtë rast, juve që e keni me "detyrim – përcaktim"të thoni: "O Pavarësi të Kosovës, o ramë e vdiqëm!" (edhe pse e

dini që kjo është vetëm një kërkesë propagandistike e demagogjike, që bëhet vetëm për të mashtruar popullin), duke deklaruar se "kërkoni" krijimin e një shteti të ri, apo ish – luftëtarët dhe populli i tyre "ekstremist", që kërkojnë të drejtën e vetvendosjes dhe jo krijim ose jo të një shteti të ri? Kush është kërkesë dhe formë më demokratike, e jona apo e juaja?

Moszhvillimi i referendumit sipas Marrveshjes së Rambujesë, për vetpërcaktim e popullit shqiptar, është një ndërprerje e proceseve demokratike në Kosovë. Shpikja e standarteve dhe zevendësimi i referendumit me to, u përcaktua nga ndërkombëtarët si një përmirësim i mëtejshëm i asaj marrveshjeje. Mirpo ngjarjet e marsit 2004 në Kosovë treguan se nuk kemi të bëjmë me kurrfarë përmirësimi, por, përkundrazi është një gjetje e keqe (Mos qoftë e qëllimtë!), që bëhet shkak për konflikte nga më të ndryshmet. Në këto kushte, secila palë është e detyruar të bëjë "një hap prapa" dhe ta rishikojë ofertën e saj. Në të kundërtën mund të kemi përsëri revolta e rrebelime dhe juve përsëri do të viheni në siklet të gjeni e të dënoni përmes analizash të thelluara ekstremistët, nostalgjikët, mosmirënjohësit e mbrujtur me dufin katundaresk dhe plot e plot fajtorë të tjerë...

Dikur, në f. 30 të librit, i keni thënë kështu Ukshin Hotit:

"...çdo popull ka të drejtë për liri, vetvendosje, kulturë të vetën, me përjashtim të këtij populli... Vetvetiu dëshiron të bësh pyetjen: e përse 8 milionë shqiptarë janë të rrezikshëm bashkë e jo 80 milionë gjermanë, 160 milionë rusë, ose 1 miliardë e 200 milionë kinezë etj. (këta dy të fundit bashkë me bombat e tyre atomike?). Përse 2 milionë shqiptarë duhet t'i jepen Serbisë xhuxhe? Në emër të ç'logjike, të ç'morali?"

Ndërsa Ukshini, në f. 106, iu është përgjigjur:

"Bashkimi në një shtet i popullit shqiptar është indikatori më i sigurtë i tejkalimit (i vdekjes) të mendimit gjeopolitik, andaj edhe indikator i njëmendësisë së

proceseve integrative...Bashkimi në një shtet i trojeve dhe i popullit shqiptar është në vijën e drejtimit, të bashkimit të Europës, dhe jo në kundërshtim, apo kundër tij. Andaj mbetet se kjo gjë mund të kundërshtohet vetëm në emër të: frikës nga e panjohura, ose të frenimit, apo të ngadalësimit të proceseve për hir të kësaj frike, por gjithnjë duke e synuar mbisundimin e saj. Kjo gjë, natyrisht, në formën e saj më të keqe, do të arrihej me viktimizimin e sërishëm të shqiptarëve. Ndërkaq, në formën e saj më të mirë, të natyrshme, do të duhej të arrihej me të kundërtën e këtij viktimizimi - me bashkimin e tyre në një shtet të vetëm shqiptar. Detyrë e shqiptarëve është që ta luftojnë edhe këtë frikë të Europës, që t'ia heqin atë.

Mënyra më e mirë për ta arritur këtë, do të ishte sikur ta detyronin Europën që t'i respektonte edhe principet, edhe qëllimet e veta të deklaruara, gjë që shqiptarët tani janë duke e bërë me forma dinjitoze të luftës. Dëgjoj për shembull se UÇK - ja rreptësisht iu përmbahet normave ndërkombëtare të luftës dhe për këtë më vjen mirë."

Atëhere, keni qenë në akord të plotë me Ukshin Hotin. Po tani, përse nuk kërkoni, së pari,vetvendosjen, por këmbëngulni për "pavarësinë" e Kosovës?!

Ideja e pavarësisë së Kosovës nuk është e re. Ajo është kërkuar në vitet '60-të dhe '80-të, në kushtet kur ka ekzistuar RFJ, që Kosova të ishte një republikë në përbërje të Federatës, dhe, pas kësaj, duke shfrytëzuar kushtetutën, të mund të shkëputej nga RFJ, sikundër bëri Sllovenia. Madje për atë kohë ajo ishte një kërkesë shumë përparimtare, pasi, me parrullën "Kosova - Republikë", nënkuptohej bashkimi në të i të gjitha trojeve shqiptare që përfshiheshin nën Jugosllavinë e dikurshme dhe që kishin një shtrirje të pashkëputur territoriale.

Por, të qendrosh sot në atë kërkesë, do të thotë që, jo vetëm që gjithçka që ka përparuar në këtë drejtim ta shumëzohet me zero, por edhe që të kërkosh zbatimin e dy alternativave të mundshme, që rrjedhin nga kjo kërkesë:

E para, në rast se Kosovës i njihet pavarësia, ajo mund të shndërrohet në një koloni të Bashkimit Europian. Sepse, kur nuk e pyet një popull se si dëshëron ai të jetojë, kur ai konsiderohet e trajtohet si i paaftë të zgjedhë e të vetvendosë dhe dikush tjetër e përcakton fatin e tij, atëhere kemi të bëjmë me pushtim ose kolonizim të ri të tij dhe nuk mund të flitet për asnjë lloj pavarësie. Të mos e harrojmë edhe faktin kokëfortë, që në Kosovë kemi të bëjmë me një popull të kolonizuar dhe jo me një shtet. Si rjedhojë, së pari duhet që këtij populli t'i krijohet mundësia të vetpërcaktohet se si ka dëshirë të jetojë në të ardhmen, të fitojë një lloj identiteti kombëtar, përndryshe ai do të mbetet një popull - fëmijë. Së dyti, a ishte Federata Jugosllave një lloj integrimi i shumë kombeve dhe nuk arritën të integrohen për 80 vjet? E si mund të arrihet integrimi i shqiptarëve të kosovës në një lloj federate, sikundër është BE, ku bejnë pjesë mbi 40 kombe, ndërkoh që nuk u arrit në një federatë me 7 kombe?

Ja çfarë ka thotë Ukshin Hoti për këtë problem :

"Kosova nuk mund të stoliset me një demokraci të imponuar nga jashtë, se asaj demokracia nuk i duhet për t'u stolisur e as për të vallzuar me të.

Kosova nuk mund të arrijë në Evropë pa një demokraci autentike të saj." ("*Filozofia politike", f.95.*).

Madje, pak a shumë këtë ide e ka shprehur edhe ish - presidenti Amerikan, zoti Bill Klinton, në Samitin e Paktit të Stabilitetit në Sarajevë, 30 korrik 1999:

"Së dyti, transformimi dhe integrimi i këtij rajoni nuk mund të arrihet pjesë - pjesë, një herë një krahinë, një herë një vend, një herë një krizë. Por nuk kemi të bëjmë as me garë, në të cilën vendet më të begata bëjnë garë

për të shpëtuar" nga Ballkani në kurriz të fqinjëve të tyre." *(B.Klinton."Ne luftën, ju paqen", f. 184.)*

Alternativa e dytë, mendoj se mund të ishte më vrastarja dhe më e keqja. Në rast se Kosovës i jepet pavarësia, atëhere do të krijohen të gjitha mundësitë që në një të pastajme, me dallaveret dhe marifetet që vetëm Serbia dhe Europa dinë t'i shpikin dhe me pretekstin se nuk mund të ketë dy shtete të pavarur shqiptarë në kufi të njeri - tjetrit, ajo t'i bashkangjitet federatës së Solanës, Serbi - Mal i Zi.

Si në rastin e parë edhe në të dytin, pavarësia nuk sjell asnjë favor për popullin shqiptar në Kosovë, pavarësisht se liderët e LDK, PDK dhe AAK-së shprehen se kjo pavarësi do t'i zgjidhë të gjitha hallet dhe problemet e popullit, si me shkop magjik. Të vetmit fitues me pavarësimin e Kosovës janë e do të jenë vetëm politikanët e saj, pasi ata mbeten pashallarë të përjetshëm.

Në rast se Kosovës i jepet vërtet pavarësia, atëhere do të krijohen shumë shpejt kushtet për tjetërsimin e popullit të saj. Janë pikërisht ato kushte që ka tash pesë vjet që po trumbetohen nga klani pacifist, dhe që përbënin një ndër shkaqet kryesore, që e detyroi popullin të ngrihej në revoltë të papërmbajtshme.

Me sa duket, Rugova, duke e patur Titon idolin e vet, dëshiron të mësojë prej tij ose ta imitojë atë. Tashmë dihet që Titua ishte ideologu që krijoi artificialisht dy "kombe" të reja: kombin maqedon, me një gjuhë gjysëm bullgare e gjysëm sërbe dhe kombin mysliman, i cili nuk ka ekzistuar kurrë dhe nuk ekziston, por që Europës i pëlqeu. Nisur nga kjo ide hibride, menjëherë pas luftës, Rugova filloi të kërknte krijimin e kombit kosovar, të organizuar në një shtet që do të quhej Dardani. Me emrin e bukur të fisit të vjetër ilir, synimi i tij është të mashtrojë e të përgjumë popullin. Si antishqiptar i betuar, e nisi me nxjerrjen nga kushediçfarë arkivash të një flamuri të ri, krejt të ndryshëm nga ai i kombit shqiptar, ku vetëm

fotografia e tij ka mbetur pa u vënë. E dimë që, për këtë nismë, e përkrahët edhe juve, por kjo është puna juaj.

Më vonë, pasi publikoi flamurin e "kombit kosovar", Rugova stisi, sa hap e mbyll sytë hymnin e këtij kombit, duke përshtatur për këtë qëllim një këngë popullore të trevës së Kosovës. Pas këtyre dy elementeve aq të domosdoshëm të simbolevet të një shteti të ri, ai iu vu me pasion çështjes që është gjëja më e rëndësishme për një komb: gjuhës dhe kulturës, duke hartuar një plan të studjuar mirë dhe financuar bujarisht nga "çlirimtarët" europianë. Dhe si?

Çdo javë, në Kosovë del një gazetë, e cila po "argumenton" domosdoshmërinë e ndryshimit të gjuhës shqipe të njësuar. Hera-herës, duket sikur kërkohet të krijohet a të shpiket një komb i ri, i quajtur kombi kosovar me gjuhë shqipe, veçse me gjuhën e periudhës së principatës së Dardanisë së para dy-trimijë vjetëve, gjuhë që të mos ngjasojë fare me shqipen e sotme të njësuar. Duket si një kërkesë "e pafajshme"por nuk është tamam kështu.

Duke qenë i dashuruar njëlloj si me gjuhët e vjetra edhe me historinë, Rugova e sheh të papërfunduar misionin që nisi Perandoria Otomane pas luftërave të Skëndërbeut. Dhe ky mision ishte, as më shumë e as më pak, shpërbërja e kombit shqiptar, duke nxjerrë prej tij katër kombe të ndryshëm, si hakmarrje që e penguam për pushtimin e Europës, ndaj dhe Turqia i ndau në katër vilajete trevat shiptare.

Për këto tre hapa "shumë të rëndësishëm" të Rugovës gjatë këtyre pesë viteve të pasluftës, juve jeni shprehur me simpati në revistë zvicerane "Galatea", në fillim të muajit prill 2004, menjëherë pasi botuat atë "analizën" e famshme për ngjarjet e marsit në Kosovë:

"Janë pesë vjet pasigurish që bënë që lideri, në të cilin unë kam besim, - Ibrahim Rugova - ka pasur një izolim progresiv."

Komplimentet e njëllojtë për njerëzit që mendojnë njëlloj, janë normalë, vetëm se juve e paskeni harruar se çfarë

i keni thënë Denis Fernandesit në tetor 1998 për gjëmën që e gjen një popull, po qe se i ndërrohet gjuha:

"Bëhet fjalë për kujtesën tonë. Europa që përpiqet të mbrojë vlerat e qytetërimit perëndimor përse e lejon një agresion të këtillë, i cili prek themelet e një populli? Përse të lejohet që një pjesë e shqiptarëve të kthehen në majmunë diturakë, të cilët do ta përqeshnin historinë e vet me një shkrim të huajtur dhe për më tepër, të importuar?.. T'i heqësh një populli përdorimin e gjuhës së vet, është njëlloj si t'i cungosh jo vetëm trashëgiminë, historinë, kulturën e tanishme, por edhe t'i gjymtosh aftësitë shpikëse, një kahie të prirur kah ardhmëria...Ky është krim kundër intelektit, domethënë kundër njerëzimit.

A nuk shprehet pikërisht Lantreamant - i që: Gjithë ujët e detit nuk do të mjaftonte për të fshirë një njollë gjaku intelektual?"(*Kohë barbare, f.260-261)*

Ndoshta intuita juaj prej shkrimtari të madh e ndien se qëllimi nuk është për të zgjuar nga gjumi mijëravjeçar një gjuhë të vdekur, por që gjuha shqipe në Kosovë të zëvendësohet me një gjuhë të huaj. Atëhere, si mund t'i thuhet progresist Rugovës, kur vetë juve, një muaj më parë se ta pagëzonit Rugovën me këtë epitet, jeni shprehur kështu në intervistën dhënë "Dojçe Veles":

"Kombësia është një gjë objektive e njeriut. Është si të ndërrosh nënën dhe babanë me dhunë. Të thuash s'kam këta, por kam dy të tjerë."

Për këtë vallë duhet quajtur Rugovën progresist, se kërkon të na ndërrojë jo vetëm nënën e babanë, por edhe vëllezërit e motrat dhe të gjithë njerëzit e një gjaku?...

Përveç këtyre tre elementeve dallues të një shteti, Rugova, ka dalë edhe me një teori tjetër, sa finoke, aq edhe të zgjuar. Madje unë do të thoshja se ajo është ndoshta parulla më e zgjuar që ai ka hedhur në publik gjatë 15 viteve në krye të politikës shqiptare në Kosovë, për të mos thënë e

vetmja. Ai thotë: T'i njihet Kosovës Pavarësia Formale. Po ç'është kjo pavarësi formale që kërkon Rugova, mund të pyesë dikush. Mos vallë ka redaktuar vetveten, pasi atë kërkesën e tij: Pavarësi për Kosovën, e kanë bërë të vetën edhe Thaçi e Haradinaj dhe ai nuk ka asnjë dëshirë të flasë si ata?...

Jo, Rugova mendon shumë hollë dhe sheh shumë larg në këtë pikë, pavarësisht se mjaft analistë e politikanë e marrin si një gafë të radhës atë kërkesë të Rugovës dhe qeshin me të. Dihet që Kosova nuk është njohur dhe nuk njihet që të jetë shtet. Si e tillë, ajo quhet një vend i papërcaktuar dhe aq, prandaj edhe nuk thuhet se Kosova ka qenë një shtet i kolonizuar, por thuhet : populli i Kosovës ka qënë një popull i kolonizuar. Për këtë arsye edhe ndërhyrja e NATO - s u quajt ndërhyrje humanitare, pasi rrezikohej zhdukja e një populli, ose shpopullimi i atij populli nga vendi i tij.

Në rast se do të pranohej kërkesa e Rugovës: Pavarësi Formale për Kosovën, atëhere Kosova do të njihej si një shtet i veçantë, ndonse përkohësisht nën protektoratin e OKB - së, ndërsa tash quhet një vend, një popull nën protektoratin e OKB - së. Në rast se i jepet Kosovës Pavarësia Formale, atëhere kapërcehet etapa e parë e zgjidhjes së statusit të një populli, që është etapa e vetvendosjes së tij. Nuk do të bëhet më referendum për vetpërcaktimin: për bashkim me Republikën e Shqipërisë apo për të qenë Kosova shtet më vete dhe i pavarur.

Po t'i shtojmë kësaj edhe faktin që kjo etapë kapërcehet duke qenë forcat ndërkombëtare paqeruajtëse në Kosovë, që do të thotë se edhe sikur të ndodhë që në krye të Republikës së Shqipërisë të vijë një parti apo një qeveri radikale e djathtë, ajo nuk mund të kryejë asnjë hap ose veprim në drejtim të bashkimit me dhunë. Po ashtu, eleminohet edhe mundësia e një bashkimi të vetvullnetshëm të popullit shqiptar të Kosovës me Republikën e Shqipërisë,

sikundër ndodhi me të dy Gjermanitë. Në rast se i njihet Kosovës pavarësia formale, të nesërmen e largimit të NATO - s atë nuk do të guxojnë ta prekin as Serbia, por as Republika e Shqipërisë, sepse do të ndërhynte menjëherë OKB - ja, por në këtë rast jo si ndërhyrje humanitare, por me vendim të Këshillit të Sigurimit, sikundër u bë për Kuvajtin.

Të mos harrojmë edhe faktin tjetër, atë që, pas Rugovës qendrojnë shtete - këshilltarë, në kryeqytetet e të cilëve ai është formuar si intelektual: Beogradi, Parisi, Roma, që tërë jetën e tyre kanë menduar e janë lodhur se si e si ta "ndihmojnë" sa më shumë kombin shqiptar.

Po mund të thotë dikush se, kollaj edhe po qe se Kosovës i jepet pavarësia, përsëri e ka në dorë parlamenti të vendosë. Cili parlament, zotëri? A e dini se deputetët e tij zgjidhen me listë dhe jo drejtpërdrejt nga populli? Kjo bëhet me qëllim, që në Parlamentin e Kosovës të vijnë ata deputetë eunukë, që mendojnë njësoj si kryetarët e partive ose që nuk mendojnë fare, por që iu binden kryetarëve në mënyrë të verbër. Kjo gjendje do të zgjasë dhjetra vite, deri sa të jenë arritur diferencat e parashikuara midis Republikës së Shqipërisë dhe popullit shqiptar në Kosovë dhe të harrohet çështja e këtij bashkimi, kundër të cilit ka qënë, është e do të jetë Europa, në të cilën, për fat të keq, kombi ynë nuk ka patur dhe nuk ka asnjë mik për të qenë.

Ja pra, se çfarë nuhati dhe përse u ngrit e rrebeloi ai popull, ja se përse paska shpërthyer "dufi katundaresk" i tij. Me gjithë këto "hynere" të Rugovës gjatë këtyre pesë vjetëve, është e drejta juaj, zoti Kadare, ta quani atë "intelektual progresist", po sa shpejt e harruat atë 3 prillin e vitit 1999, kur ai u shfaq në TV duke u zgërdhirë me Milosheviçin, teksa i kërkonte NATO - s të ndërpriste bombardimet kundër Sërbisë?... Juve thatë atëhere me plot të drejtë:

"Prapë se prapë, ai s'mund të jetë më lider. Është një ndërprerje që i ngjan asaj të fatit të keq, që të bie nga qielli ose nga një sëmundje." *("Ra ky mort e u pamë", f.55.)*

...Duke shkruar këto radhë për Pavarësinë e Kosovës, sepse m'u kujtua "ceremonia e poshtërimit përfundimtar", sikundër shprehet Bernarnd J. Fisher, te libri "*Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945", f .69*, për atë 15 prill 1939 të hidhur, kur Vërlaci dhe 48 shqiptarë mjeranë të tjerë, ia dorëzonin kurorën e Shqipërisë xhuxhit Viktor Emanueli. Ato momente groteske të përshkruara nga B. Fisher, sepse më ngjasojnë me të sotmen në Kosovë. Ja se ç'thotë ai:

"Gjatë fjalës së pranimit të kurorës prej Viktor Emanuelit, si edhe gjatë fjalës së Musolinit një ditë më parë, shqiptarët kishin vënë veshin me ankth për të dëgjuar fjalën *"pavarësi"*, por ata nuk e kishin dëgjuar atë aspak.

Musolini, i cili e kishte ndierë këtë gjë, i premtoi Çianos se ai do t'iu fliste atyre rreth pavarësisë kombëtare dhe sovranitetit përpara se ata të largoheshin për në Shqipëri. Kjo përrallë duhej ruajtur për hir të shqiptarëve në përgjithësi dhe për hir të kolaboracio nistëve në veçanti."

Bela me këtë mendjen, zotëri, ku nuk vete. Nga vajti dhe m'u faneps tani pavarësia e kolaboracionistëve shqiptarë?!..

Përfundimisht, i vetmi shpëtim për popullin shqiptar të Kosovës, mbetet bashkimi i kësaj të fundit me Republikën e Shqipërisë, përmes referendumit të vetvendosjes, sikundër e argumentoni ju në bashkëbisedimin me Ukshin Hotin. Madje, në kushtet që jemi sot, bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk ndryshon kurfarë kufijsh ndërkombëtarë.

Te kjo tezë gjen shpjegimin pse ish luftëtarët e UÇK-së persekutohen dhe me njëmijë forma shtrëngohen të largohen nga Kosova dhe Shqipëria, pasi idetë e asaj lëvizje, që u quajt UÇK, janë ide që e shpëtojnë Kosovën

nga tjetërsimi edhe pse ne e kërkojmë që ai bashkim të bëhet me referendum, institucionalisht. Këtu e gjen shpjegimin edhe deklarata e PDK-së dhe e AAK-së se ato nuk janë parti të luftës, por të gjithë popullit.

Në rast se arrihet pengimi i mosbashkimit të Kosovës me R. Shqipërisë dhe në se Kosovën ia atashojnë ndonjë bashkimi tjetër, atëherë asgjë nuk do të kursehet për të zhdukur traditat e këtij populli, gjë e cila ka filluar me gjuhën.

E drejta për vetvendosje e popullit shqiptar të Kosovës theksohet edhe në Deklaratën e OKB - së të 16 dhjetorit 1994, e titulluar "Implementimi i Deklaratës mbi Garantimin e Pavarësisë të Vendeve dhe Popujve Kolonialë, A/49/49 (1994)", e cila në plan të parë ve vetvendosjen, pastaj pavarësinë. Për deri sa Kosova nuk ka qënë shtet, por një popull i kolonizuar nga Sërbia, atëhere duhet të bisedohet vetëm për vetvendosje. Ja se çfarë thuhet në deklaratën e mësipërme të OKB - së, në paragrafin 1 të saj:

"Riafirmohet rezoluta e saj 1514 (XV) dhe gjithë rezolutat e tjera mbi dekolonizimin, duke përfshirë edhe rezolutën e saj 43/47, në të cilën ajo ka deklaruar se dekada që fillon në vitin 1990 si Dekada Ndërkombëtare për Çrrënjosien e Kolonializmit dhe rikujton Fuqitë administrative, në përputhje me këto rezoluta, të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për t'u dhënë mundësinë popujve të territoreve që janë të interesuar të ushtrojnë tërësisht dhe sa më shpejt që të jetë e mundur të drejtën e tyre për vetvendosje ose pavarësi."

Pra, në rast se Kosovës do t'i jepet pavarësia, nuk do të kemi gjë tjetër, veçse një rikolonizim të saj. Atëhere, kush është ekstremist? Solana dhe miqtë e tij ndërkombëtarë e shqiptarë, që nuk duan të venë në jetë të drejtat themelore të njeriut dhe rezolutat që vetë ata i kanë miratuar, duke shfrytëzuar postet që kanë, apo ne që pranuam të çarmatoseshim se iu besuam juve që na thatë se, pas tre

vjetësh do të zhvillohej referendumi për vetvendosje, sikundër patën firmosur Thaçi e Rugova edhe me porosinë tuaj? Sikundër e shihni, ju dhe ata keni ndryshuar, neve kemi mbetur ata që ishim. Idealisti nga ndershmëri dallohet. Juve kërkoni Pavarësi të Kosovës, gjë që nuk thuhet as në Marrveshien e Rambujesë, ne kërkojmë vetvendosje, atë që ata e kanë pranuar dhe firmosur në Rambuje. Kush është ekstremist ai që e mban fjalën dhe beson në rezolutat dhe marrveshiet ndërkombëtare, apo ata që nuk i zbatojnë ato, duke ndryshuar edhe premtimet e dhëna?

A e shihni, zotëri, se sa të sinqertë dhe të ndershëm janë luftëtarët idealistë të popullit tonë? Kujtohuni se çfarë keni thënë kohët e fundit në intervistën dhënë dy gazetarëve shqiptaro -amerikanë me prejardhje nga viset shqiptare në Mal të Zi (*Botuar te gazeta "Bota Sot", 27 korrik 2004*.):

"Prandaj e quaj të arsyeshme kërkesën popullore që shtetin ta drejtojnë njerëzit e kulturës, letërsisë dhe artit, sepse ata kanë një dozë idealizmi shumë më të lartë se shumë njerëz të tjerë, të profesioneve të tjera."

Por ju nuk e dini se sa idealistë janë ata që janë gati në çdo moment ta vendosin kokën në satër për popullin e tyre. Ju na paragjykoni e na anatemoni, sepse kështu bëjnë "çlirimtarët" dhe miqtë tuaj "me peshë" në Kosovë. Ja që juve keni vendosur të jeni mik me elitën dhe jo me vegjëlinë. Përballë këtij pozicioni të ri që keni marrë, ne nuk mund të bëjmë asgjë tjetër, veçse të shprehim keqardhjen tonë njerëzore. Dhe t'iu themi se më kot na bini në qafë e na sulmoni me lloj - lloj të pavërtetash.

Mos vallë, t'i kërkosh dikujt të të japë borxhin që të ka e që ta ka premtuar edhe me dokument zyrtar, na qenka ekstremizëm? A ishin vetë "çlirimtarët" europianë, që, së bashku me Rugovën, Thaçin, Veton Suroin e Blerim Shalën, madje edhe me këshillat e këmbënguljen tuaj, që firmosën Marrveshien e Rambujesë? A nuk na na thatë: "Dorëzojini

armët, se, pas tre vjetësh, do të organizojmë referendumin për vetvendosjen e popullit të Kosovës? Po!

Ne u besuam dhe e bëmë tonën. Po juve, çfarë bëtë?!... Përse nuk e mbajtët fjalën?...

Nuk e mbajtët, sepse që në ato momente na e patët me hile, u bëtë bashkëpunëtorë me europianët, sepse e dinit që ai referendum nuk do të mbahej kurrë. Këtë të vërtetë të hidhur e pohon me lehtësi edhe vetë zoti Klinton, në Kreun 52 të librit të tij "*Jeta ime*":

"Kosovarët nuk donin të binin dakort për të pranuar autonominë, në rast se nuk merrnin garanci për mbajtjen e një referendumi…

Grupi ynë vendosi ta shkruante marrveshjen në një formë të tillë, që ta vononte mbajtjen e referendumit, por të mos e mohonte atë përfundimisht."

Ja se si paska qenë puna! Mbajtja e referendumit "do të vonohej, por nuk do të mohohej përfundimisht." Shkurt, premtimi të bëhej sa të hidheshin firmat dhe sa të dorëzoheshin armët, se pastaj...

Pastaj do të vinin standartet...

Me shpikjen e standarteve nga "çlirimtarët" europianë, a nuk kemi të bëjmë hapur me mohimin e referendumit? Po mohimi i referendumit nga Rugova dhe Thaçi, dy liderët e partive kryesore të Kosovës dhe nënshkruesit e asaj marrëveshie, a nuk është mashtrim në mes të ditës, përderisa populli dhe UÇK-ja mbi bazën e fjalës dhe firmës së tyre i dorëzoi armët? Puna e tyre tashmë dihet, por çudia është se ku e çoi mushka edhe z. Haradinaj, që e ka larë Kosovën me gjak dhe sot u bashkua me ta?! Pse nuk e braktisën Parlamentin kur u mbushën tre vite? Atëhere, kur populli mashtrohet, nuk ka të drejtë ai të rrebelohet? Vetëm për këtë i quani juve të rrebeluarit ekstremistë?!...

Kjo nuk është e drejtë! Në rast se juve, Solana dhe miqtë e tij në Prishtinë e Tiranë merrni guximin dhe na thoni

sot me cinizëm: “Na lumtë që iu mashtruam!...”, atëhere është radha dhe e drejta e popullit të bëjë diçka për të ruajtur së paku dinjitetin e tij dhe për t’iu thënë se një popull dhe një ushtri çlirimtare mund të mashtrohen përkohësisht, po kurrë përjetësisht!

Populli nuk ngrihet kurrë në këmbë pa ndonjë motiv të drejtë. Apo mos vallë referendumi i tremb disa diplomatë e politikanë ndërkombëtarë e vendas, ca të sklerotizuar para kohe, se mos kështu na krijohet “Shqipëria e Madhe”? Dikur juve e keni shpjeguar qartë se kush e ka shpikur dhe kush e trumbeton këtë term, armiqtë tanë, ndërsa tani mbroni pikërisht ata njerëz dhe ato institucione, që fabrikojnë kurthe e padrejtësira kundër një populli të tërë.

“Shqipëria është dymijë vjeçare. Është më e vogla nga këto vende të vegjël. Si për ironi të historisë, gjatë këtyre dymijëvjeçarëve, Shtetet Ballkanike janë zgjeruar, me përjashtim të Shqipërisë që në një farë mënyre është tkurrur. Dhe pikërisht Shqipëria përbën problem dhe cilësohet, në këtë rast,ekspansioniste”, i thoshnit zotit Denis Fernandez, në faqen 256 të librit. Po tani, a do të kishit guximin t’i përsërisnit ato fjalë? Vështirë të besohet.

Pse, vetëm për shqiptarët u dashka zbatuar Statusi i Veçantë për të drejtën e vetvendosjes! Këtë, Solana, grekët dhe francezët, deri diku dhe italianët, nuk e thonë hapur, por ama e nënkuptojnë dhe e bëjnë në praktikë. Dhe juve iu mbani iso, dhe e njëjta gjë bëhet në çdo zyrë të Prishtinës e Tiranës, që nga nëpunësit më të thjeshtë e deri te presidentët...

Pse i gënjen mëndja këta teoricienët dhe shpikësit e termit “Shqipëri e Madhe” dhe, po qe se Kosova dhe Shqipëria futen në BE veç e veç, atëhere do të shmanget rreziku i krijimin të “Shqipërisë së Madhe”?! Në rast se do të ekzistonte me të vërtetë ky rrezik, atëhere me futjen në Bashkimin Europian do të krijoheshin kushte edhe më të mira, sikundër ndodhi me dy Gjermanitë, apo jo?.

Për të mos e bërë referendumin për vetvendosje, politikanët dhe diplomatët e huaj dhe ata shqiptarë po përhapin një propagandë sa djallëzore, aq edhe antishqiptare. Ata thonë se, po të bëhet në këto momente referendumi, ka rrezik të mos bëhet bashkimi, pasi populli i të dy Shqipërive nuk është i gjithi me një mendje. Ndarja e gjatë kohore e Kosovës me Shqipërinë, thonë ata, ka çuar në zhvillime të ndryshme kulturore dhe, këto dallime, në disa raste janë të mëdha etj., etj. Mund të jetë edhe kështu, po kjo s'është as arsye dhe as argument. Me kë e kanë më të lehtë shqiptarët të integrohen, me ata që nuk janë shqiptarë, apo me njeri - tjetrin?...

Kjo "shpikje" e kushedisajta në vargun e shpifjeve, sepse e tillë është, nuk përkon aspak me mendimin e vërtetë që ka populli. Unë vetë, ndoshta jam ndër të paktët shqiptarë nga Republika e Shqipërisë që kam jetuar me popullin shqiptar të Kosovës gjatë luftës. Vazhdoj edhe sot, pas lufte, të jetoj me këtë popull dhe besoj se e njoh mirë mendimin e popullit shqiptar të asaj ane e të kësaj ane, lidhur me çështjen aq shumë të ëndërruar të bashkimit të tyre. Përballë asaj propagande të shpifur e ndjellakeqe, nuk më mbetet gjë tjetër, veçse të klith nga dhimbja e zhgënjimi i thellë dhe të them me të gjithë forcën e shpirtit dhe zërit tim: Bashkojeni këtë popull, se nuk ka asnjë lloj diferencimi kulturor midis tyre! Madje ju siguroj se, në shumë aspekte, populli shqiptar i Kosovës puqet me pjesën jugore të Shqipërisë më mirë se me malësinë e Shkodrës dhe të Tropojës.

Por, politikanët shqiptarë të të dy anëve i fryjnë asaj gënjeshtre, sepse ata do të jenë të vetmit humbës të interesave të tyre po u bë bashkimi. "Prisni të plakemi ne, pasi të jemi pasuruar, atëhere le të bëhet referendumi", duan të thonë ata përmes asaj propagande të gënjeshtërt..

Mirë ata, zoti Kadare, se kështu e ka puna dhe profesioni i tyre, po juve, si është e mundur të bini në këtë

qorrsokak, kur e dini shumë mirë që serbët, të mbështetur fuqimisht nga tërë sllavët, kanë gati 500 vjet që përpiqen të dalin në Adriatikun e shqiptarëve?!... Mos vallë populli shqiptar i Kosovës nuk na dashka ta gëzojë detin e vet, por është i gatshëm t'ua falë atë sllavëve?!... A ka vend të rrijë kjo gënjeshtër me brirë, a e besoni juve atë?...

Për ta hequr vemendjen nga referendumi dhe për të mos e bërë fare atë, ndërkombëtarët, por edhe liderët vendorë, filluan me dënimet e shumta e të shpeshta të çlirimtarëve shqiptarë. Ata i shfrytëzuan ligjet serbe si armë sulmi dhe si mburojë kundër popullit, gjoja "për të mirën e Kosovës." Dhe, kjo "e mirë", ky lloj preteksti është kamzhiku më i rrezikshëm për çdo popull. Me këto veprime, ata kujtuan se kishin gjetur mjetin më të përshtatshëm për t'ia mbyllur gojën e për ta nënshtruar këtë popull dhe për ta shmangur atë në këtë mënyrë, nga e mira reale e zbatimit të atij referendumi, atij vendimi të përbashkët shqiptaro – ndërkombëtar.

Dhe, këto veprime, ata i bënë paralel me grumbullimin e parave të shumta gjatë periudhës të pasluftës (ndërkombëtarët me rrogat e majme mbi 100 mijë € në vit, ndërsa vendorët me kontrabandën, tenderat etj.). Ata menduan se e kishin arritur gjithçka dhe, si rjedhojë, i bashkuan interesat e tyre të veçanta kundër interesit të përgjithëshëm të shqiptarëve, duke e kërcënuar popullin: "Mbylle gojën! Kosova është multietnike. Nuk ka referendum, ka standarte!..."

Në këtë mënyrë, ata bënë që veset publike të kenë fuqi më të madhe se e mira publike, duke iu hequr vlerën jo vetëm marrveshieve të përbashkëta, por duke rrezikuar të humbiste edhe bamirësia që bënë ndërkombëtarët para pesë vjetësh.

Përse arritën në këtë pikë liderët vendorë e ata ndërkombëtarë? Sepse ata ngatëruan një ligj shoqëror shumë të madh. Kujtuan se ata vetë janë shteti, ata janë populli dhe harruan që janë vetëm funksionarë të tij. Duke bërë këtë

ngatëresë, ata kujtuan dhe besuan se populli është i paditur e naiv dhe ka përherë detyrimin të sakrifikojë për ta dhe jo ata për popullin. Është e sigurt se ata ushqehen dhe kultivojnë me arrogancë koncepte të tilla agallarësh. Këtë e vërteton më së miri edhe fakti se asnjeri prej tyre nuk bëri asnjë lloj autokritike dhe asnjeri nuk e dha dorëheqjen pas atyre ngjarjeve të jashtëzakonshme të marsit 2004. Dhe kjo është një nga ato dhjetra arsyet që shpjegojnë se përse populli u rrebelua, ndërkohë që juve i morët politikanët me mjaft gjakftohtësi në mbrojtje.

OPINIONI I KLASËS POLITIKE SHQIPTARE DHE AI I PUBLIKUT PËR NGJARJET E MARSIT

Kështu gjithmonë endesh, duke kullotur vdekjen
As lufta, as uria, as murtaja.
Nuk kanë ngrënë kaq qytete sa ti.
……..
Tani kërkon përsëri
Prapë ke uri.
Barku yt i drunjtë s'ngopet kurrë
Zgavrat e tua të errëta i ke drejtuar mbi ne.
Ngadalë po avitesh. Ndihen patkoj.
Trak - truk me ritëm heksametrik
Patkonjt' e tu po ndihen.
Vini veshin! Vini veshin! Kali i Trojës!

Ismail Kadare.Vargje nga poezia: "Kali i Trojës".)

Populli i di mirë të gjitha ato që përmendëm më lart, z. Kadare, por politikanët i gënjen mendja dhe përpiqen ta çorjentojnë atë, duke i thënë se na ishin ca "ekstremistë nostalgjikë komunistë" që e gënjyen dhe e çuan të derdhte gjak. Ndërsa juve u rrjeshtuat menjëherë në krah të tyre, duke iu mbajtur iso në atë "analizën" tuaj: "...dënimi i dhunës prej opinionit publik dhe i klasës politike në Kosovë , e sidomos në Shqipëri, ka qenë një faktor tepër pozitiv."

Për cilën klasë politike e keni fjalën, sepse në Tiranë është po ajo që ka qenë edhe në vitin 1997, kur bisedonit kështu me Ukshin Hotin ("*Bisedë përmes hekurash", f.17.*):

"Klasa politike e saj (e Shqipërisë, D.G.), për fat të keq, në pjesën më të madhe, s'është veç një grumbull

njerëzish të paaftë, të varfër mendërisht e të dyshimtë moralisht. Mendjengushtësia e tyre, shpirti hakmarrës e meskin janë bërë proverbiale në botën e sotme, ashtu si cenet e pjesës tjetër të psikopatëve të Ballkanit."

Si është e mundur, z. Kadare, që, ai "grumbull njerëzish të paaftë, të varfër mendërisht e të dyshimtë moralisht", të jenë aftësuar aq shumë sa të jenë në gjendje të bëjnë analiza kaq të sakta?

Mos harroni, zotëri, se edhe në Prishtinë janë po ata politikanë shqiptarë që i anatemuat kur folët për ato agjencitë e zbrazjes së Kosovës në fillim të viteve '90-të:

"Agjensi që merrnin një shpërblim tjetër prej shtetit sërb. Asnjë nga këto agjensi nuk u kritikua nga asnjë forcë politike në Kosovë.

Asnjë lider kosovar, asnjë filozof a shkrimtar nuk dha kushtrimin për këto zyra varrimi. Edhe kur u detyruan të flasin për to, folën pa zemër, sa për të larë gojën."

Gjithashtu, në të dyja anët e kufirit shqiptar, janë po ata politikanë që, jo vetëm nuk e përkrahën UÇK - në, por:

"Poshtërimi i UÇK-së prej tyre filloi në mënyrë të fshehtë, tinzare…përgojim i hapët i djemve dhe vajzave të UÇK-së. Quheshin agjentë të serbëve ata që jepnin jetën në luftë kundër serbëve. Nuk kam dëgjuar gjer më sot të jetë kërkuar ndjesë për këtë blasfemi.", sikundër thoni në "*Ra ky mort e u pamë", f.14-15*. Si mund të prisni ju dhe ne, fjalë të mira prej atyre që nuk kanë kërkuar ende ndjesë për mëkatet e së shkuarës? Mos vallë pozicionet dhe qendrimet e tyre të sotme iu vijnë për mbarë, apo tani ata janë bërë psikopatë dhe zbrazës më të zgjuar?!...

Juve thoni se klasa politike në Kosovë i dënoi ngjarjet e 17dhe 18 marsit dhe këtë e quajtët faktor pozitiv. Dakord, po për cilën klasë politike e keni fjalën? Për Rugovën që është mbyllur në atë shtëpinë e tij që e quan presidencë, që ka fituar konkursin me vetveten, për të bërë himnin kombëtar dhe flamurin e një shteti që nuk ekziston, për atë që, i vëtmi pasion,

e vetmja punë që ka bërë dhe bën, është koleksionimi i gurëve të rrallë nga minerat e Kosovës,për t'ia dhuruar me xhentilensë çdo kalimtari të huaj që viziton Kosovën? Kjo është e gjithë puna dhe pesha e tij si Numëri Një i Kosovës?!...

Me atë klasë politike, mos e keni fjalën edhe për bashkfirmosësin me Rugovën në Rambuje, zotin Hashim Thaçi, kryetarin e partisë së dytë në Kosovë? Para se të flasim për "progreset" e Thaçit, le të sqarojmë diçka tjetër:

Pas nënshkrimit të Marrveshjes së Rambujesë, Rugova dhe Thaçi, me propozimin edhe të amerikanëve, ranë dakort të krijonin një qeveri të vetme për Kosovën. Ishin të parët Rugova dhe Bukoshi që, një ose dy javë pas Rambujesë, e prishën atë marrveshje dhe refuzuan të merrnin pjesë në qeveri. Për arsye objektive apo subjektive, serioze apo joserioze, - kjo ngre pak peshë, në raport me dëmin që solli. Kur grinden dy palë, të dyja kanë faj, pavarësisht nga shkalla e tij.

Në rast se do të ishte kompletuar dhe do të funksiononte si duhej qeveria në fjalë, sado e brishtë të ishte, ajo do të realizonte udhëheqjen politike të luftës dhe do të këmbëngulte që të ishim palë më vete në bisedimet e pasluftës, në Kumanovë, gjë që nuk u arrit dhe na kushtoi e po na kushton shumë edhe sot. Kuptohet, kjo do të arrihej në rast se përfaqësuesit e të dy grupacioneve tona kryesore politike do të vinin interesat kombëtare mbi ato personale dhe partiake. Po të kishte ndodhur kjo, sot nuk do të ishim në kushtet dhe gjendjen që jemi. Ta degjeneroje atëhere çështjen e zgjidhjes së problemit të Kosovës me ca grindje të pakuptimta për kolltuqe ministrash, - kjo do të thoshte që Rogova dhe Bukoshi jo vetëm të largoheshin nga problemi themelor, sikundër u larguan, kur populli ynë po bënte edhe sakrificat më madhore për fitoren dhe çlirimin e Kosovës, por është edhe diçka më shumë. Është ndoshta një akt tradhëtie i radhës, një shërbim i zakonshëm ndaj padronëve të

vjetër...Atëhere, si mund t'iu besojë populli këtyre lloj politikanëve?...

E dyta: Ta pranojmë se Rugova me Bukoshin nuk morën pjesë në atë qeveri jo se morën urdhër të bënin ashtu siç bënë, por se nuk u plotësuan kushtet që vunë ata për këtë qeveri. Po zoti Thaçi, i cili i doli me kënaqësi për zot asaj pune, si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, përse nuk ia pranoi kërkesat Rugovës, kur e dinte se qeveria ishte e përkohshme dhe e dinte gjithashtu se, për Rugovën dhe Bukoshin, më shumë rëndësi kishin kolltuqet se sa populli që digjej e piqej?!... Le t'i vinte në provë dhe të vërtetohej në se donin më shumë kolltuqe, apo ishte diçka më e thellë. Mirë këtë nuk e bëri, pasi kishte shumë presione, por përse nuk këmbënguli të ishte palë më vete në bisedimet e Kumanovës?..

Do të ishte krejt ndryshe po të mos i pranonte kushtet skllavëruese që iu vunë në ato bisedime. Në rast se do të kish bërë këtë presionin e nevojshëm diplomatik, politik e ushtarak, ai do ta kishte shkarkuar veten dhe shokët e tij të luftës nga ajo përgjegjësi e madhe historike që "iu ka rënë në kokë" dhe që e pranuan në Rambuje, pavarësisht se sa janë në gjëndje ta kuptojnë të tjerët këtë. Ato ditë kur në Kumanovë luhej fati i Kosovës, ai nuk kish pse të bridhte nëpër Europë. Ndoshta edhe për këtë qëllim e nxorrën jashtë Kosove, që t'i jepej mundësia të luftonte si Ismail Qemali. Nuk guxon asnjë diplomat të ta thotë hapur qëllimin e vërtetë të ftesës, se vjen dita dhe del e vërteta, por ai, edhe sikur të mos ishte ftuar për atë qëllim, ai duhej ta shfrytëzonte momentin në të mirë të Kosovës dhe jo për të promovuar veten. Po të ishim të gjithë bashkë, kam bindjen se do të kishim bërë diçka. Por, ashtu të shpërndarë, njëri gozhdës e tjetri patkoit, u bë ashtu si u bë dhe ashtu siç jemi. Çfarë zgjidhi Thaçi me ato sorollatjet nëpër kancelaritë e Europës? Asgjë. A i erdhi mirë kur pranoi të ishte në krye të asaj qeverije? I erdhi. Atëhere, pse nuk e justifikoi postin që i dhanë, përse nuk e mbajti peshën që

kërkohej prej tij?!...? Vërtet e kishte shumë të vështirë ta bënte këtë, por jo të pamundur.

Mirë që ato momente dhe situata nuk diti t'i shfrytëzonte, po kur erdhi qeveria në Kosovë dhe Rugova bënte plazh e vakanca në Itali, pse nuk e thirri Kuvendin e Kosovës dhe të krijonte një qeveri legjitime, ide kjo, që i është sugjeruar jo vetëm një herë? I është thënë hapur se të gjithë deputetët janë gati ta miratojnë qeverinë e re dhe kushtetutën, me të dyja duartë. Dhe, të mos e harrojmë faktin që, atëhere LDK - ja ishte tulatur me sjelljet poshtëruese të kryetarit të saj. Populli atëherë thoshte: LDK - së i kanë rënë brekët në fund të këmbëve. Ndërsa të gjitha partitë e tjera ishin pro UÇK - së. Deputetët e Parlamentit të Kosovës, që ishin zgjedhur në mars 1998, ishin gati për çdo lloj bashkpunimi, aq më tepër që Qeveria e Përkohshme në ato momente gëzonte përkrahjen e ndërkombëtarëve. Po të ishte krijuar qeveria legjitime, do të ishin kapërcyer shumë etapa, zgjidhjes së të cilave tani iu vimë anës. Qysh të nesërmen e mbledhjes të atij Parlamenti, Rezoluta 1244 do të vihej para një fakti të kryer dhe do të bëhej e pavlefshme. Dhe, kur të vinte OKB - ja, donte apo nuk donte, do të vihej vetëm në rolin e këshilltarit dhe sot nuk do të kishim atë Kornizën Kushtetuese, ose si i thonë në Kosovë, Kornizën Skllavëruese. Kjo lloj ngathtësie, - le ta quajmë kështu, për të mos bërë ca pyetje të tjera, që do ta kokolepsnin më keq punën, - ishte një mëkat i pafalshëm, me shumë kosto politike e sociale për Kosovën. Ishte një rast i humbur, që vjen vetëm një herë dhe nuk mund të përsëritet më. Zotësia, trimëria dhe zgjuarsia në këto raste tregohen në politikë. Po, përse i duhet vendit një politikan "i këtij kalibri", në mos iu dashtë për ta kapur rastin për brirësh?!...

Për këto (mos)arritje i falenderuat politikanët e Kosovës, zoti Kadare? Po diplomatët dhe politikanët e Tiranës, ku ishin në ato momente? Po opozita "atdhetare" me në krye Berishën, pse bënte sehir? Përse nuk e ndihmuan dhe nuk e

orientuan zotin Thaçi, që të bënin së bashku atë akt të madh dhe atë reagim historik, si dikur Ismail Qemali? Ishte pikërisht momenti që të përfundonte rruga e nisur nga Ismail Qemali, po, për fat të keq, kalorësit e rinj shqiptarë nuk ishin as shokët e tij dhe nuk kishin as idealet, përkushtimin dhe inteligjencien e tij.

Historia përsëritet, por në një shkallë më të lartë. Ajo u përsërit për shqiptarët pas 87 vitesh, por ja që diplomacia jonë ishte nën nivelin e qeverisë së Ismail Qemalit. Kosova qante për të zotin. Ajo digjej, Rugova, Bukoshi e Thaçi, Mejdani, Majko, e Nano kriheshin...

Po ata që mburren se kanë udhëhequr Luftën tonë Çlirimtare dhe që, dje në Rambuje e sot në Kosovë, i rrinë në krah Thaçit, ku ishin në ato momente deçizive kombëtare? Iu rrofshin Tirana e Zvicra, se Kosovës nuk iu ndodhën kur kishte aq shumë nevojë për ta!...

Është e qartë se të gjithë ata e kishin mendjen te karriera dhe e ardhmja e tyre, dhe jo e kombit. Dhe, karrieristët sakrifikojnë çdo gjë për hatër të vetvetes.

"...që të bësh karrierë, përveç zellit e shërbimeve të ndryshme, duhet të kesh një të dhënë të veçantë,... që te disa është shpirtkazmëria, pabesia e lindur, servilizmi, apo dreqi e di se çfarë.", shpreheni juve tek libri "*Vajza e Agamemnonit" f.46*. A u vu re kjo "e dhëna e veçantë" tek politikanët e atëhershëm, që ishin dhe janë në krye të skenës shqiptare, zoëri?...

Duke iu referuar dokumenteve të botuara pas mbarimit të luftës, kuptohet se gjithë politikanët shqiptarë, në vend që të këmbëngulnin për pjesmarrjen e UÇK-së në Kumanovë, si palë më vete dhe e barabartë në bisedime, merreshin me përgatitjen e skenarëve për të fshehur mashtrimin ndaj UÇK-së, në lidhje me përmbajtjen e Marrveshjes së Rambujesë. Një nga ata skenarë, ishte gjoja përgatitja dhe organizimi i bisedimeve fiktive midis NATO - s dhe UÇK - së, të zhvilluara në malet e Berishës, në datat 18 –

20 qershor 1999, për çmobilizimin dhe "transformimin" e UÇK - së, në të cilat kam asistuar edhe unë. Realizimi i këtij skenari ishte edhe arsyeja e vërtetë se përse u bënë ndryshimet në krye të Shtabit të Përgjithëshëm të UÇK - së në dy muajtë e fundit të luftës. Ata që guxuan dhe shprehën dyshim për ato ndryshime, e pësuan si Laokonti, të cilën ju e shprehni aq bukur te poezia për të:

Më në fund "vija e butë" fitoi mbi "të ashprën"
Dhe ne, "kokëfortët", na vunë në arset.

Fiktivitetin dhe farsën e atyre "bisedimeve", e vërteton edhe fakti se asnjëherë, nuk u zbatua asnjë nga pikat e "marrveshjes" midis NATO-s dhe UÇK-së, të shtuara nga ne ato ditë.

Që ato bisedime ishin fiktive, - kjo u kuptua qysh në fillim, ndonse vetëm njëri nuk pranoi të merrte pjesë në to: komandanti i Zonas së Parë Operative e Drenicës Heroike, Sami Lushtaku, duke u shprehur: "Kjo është tradhëti!". Kështu bëri edhe trimi i Tropojës, Tahir Sinani, komandanti i Zonës së Dytë Operative. Pas lufte, ky i dyti u shkarkua menjëherë nga detyra, ndërsa Sami Lushtaku është i pari komandant zone që u çmobilizua...

Sot, kur lexojmë fjalimin e z. Bill Klinton, mbajtur para kombit amerikan më 10 qershor 1999, ditën e përfundimit të Marrveshjes së Kumanovës, ose dhjetë ditë para se të zhvilloheshin bisedimet tona me NATO - n në Berishë, se:

"Ushtria Çlirimtare e Kosovës duhet të demilitarizohet, ashtu siç kanë rënë dakort...", (*Shih "Ne luftën, ju paqen", f.115.*), del shumë qartë se, ato ditë, këta "liderë besnikë" të UÇK - së, në vend që të merreshin me mbrojtjen e fitores sonë, gjë që na takonte, merreshin me dallavere pas shpinës së atyre që derdhnin gjak, vetëm e vetëm që të siguronin kolltuqet për vete dhe për njerëzit e tyre. Ku, kur dhe nga kush ishte dhënë fjala që shqiptarët të mos

kishin ushtri?!... Zoti Kadare, se mos iu gënjen mendja dhe e besoni që TMK - ja është ushtri. Jo, ajo është vetëm një organizatë civile me uniformë ushtarake, që mbahet ende vetëm për të mashtruar shqiptarët e për t'iu thënë: Ja ku e kini ushtrinë që deshët...

Edhe në Afganistan kemi të njëjtin protektorat si në Kosovë, por Afganistanit iu lejua të mbajë dhe të armatosë me të gjitha llojet e armëve konvencionale, një ushtri prej 70 mijë vetësh, pothuajse analfabete, ndërkohë që UÇK-ja ishte një ushtri me 82 për qind me shkollë të mesme e universitet, edhe pse atje janë forcat ndërkombëtare, si në Kosovë. Vetëm për shqiptarët paska ligje, vendime dhe rregulla të veçanta?!...

Në rast se ata liderë, të cilët pretendojnë se i kishin dalë për zot politikës dhe luftës sonë, do ta kishin çuar UÇK-në si palë në bisedimet e Kumanovës, (dhe mundësia ishte, nuk ka asgjë që nuk bëhet), atëhere populli nuk do të kish të drejtën morale t'i përfliste për asgjë, sikundër i përflet sot. Populli veçse do t'iu ishte mirënjohës e do t'i mbante mbi krye e sipër.

Në këtë marrveshje, nuk mori pjesë UÇK-ja si palë e tretë ndërluftuese, sepse liderët shqiptarë kishin pranuar në Rambuje që Kosova të mbetej pjesë integrale e Serbisë, për të cilën u bë edhe divorci i Demaçit me UÇK-në. Në rast se pala shqiptare do të ngulte këmbë të ishte palë në bisedime, sikundër e shpjegova më lart, ne do ta kishim shpejtuar zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Në fund të fundit dihet se luftrat çlirimtare bëhen për të patur fitues dhe humbës dhe jo për kompromise. Kush ishte fituesi në atë luftë? As ne dhe as serbët. Pra edhe pse u derdh gjak, përsëri kemi një kompromis dhe asgjë tjetër. Në mbarim të luftës, nuk kanë rëndësi luftimet apo betejat e suksesshme, ato i mbeten historisë, rëndësi kanë frytet dhe fundi i saj. Por frytet mungojnë, ndërsa fundi i ëndërruar është tepër i largët... Ndaj ne sot po paguajmë kompromisin e asaj marrveshjeje në Kumanovë, ku nuk shkuam dhe, për të fituar

atë dinjitet të humbur, të jeni i sigurtë se do të humbasim shumë kohë dhe shumë energji.

Duke mos kërkuar dhe duke mos këmbëngulur që të shkonim si fitues në Kumanovë, "udhëheqës" tanë bënë faj tragjik në drejtim të strategjisë politike të UÇK-së, pasi iu iku nga dora rasti më i volitshëm. Ata besuan "premtimet" e të tjerëve dhe kjo, në mos pastë emër tjetër, është një naivitet i pafalshëm politik, që nuk është pa pasoja deri edhe në shkallë kombëtare.

Juve mund të thoni se ishte shumë e vështirë të shkonim në Kumanovë si palë fituese. Ishte vërtet e vështirë. Por, pikërisht këtu kërkohej zotësia e mprehtësia e politikanëve, se për të tjerat ishte UÇK-ja, që s'kishte lënë asgjë mangët nga detyrat e saj. Siç ka thënë Bismarku: bashkimi i Gjermanisë nuk do të realizohej me fjalë, por me zjarr e me hekur, - ky ishte në fakt edhe qëllimi i luftës sonë. Edhe lufta politike, edhe presioni ushtarak, (duke thënë se nuk i dorëzojmë armët në se s'marrim pjesë në bisedime, pasi UÇK - ja në ato momente ishte dyfishuar), janë një lloj lufte. Madje ne kishim edhe një armë të fortë në dorë, mosfirmosjen e Rambujesë nga serbët. Ajo i bëri të pavlefshme disa nene të Rambujesë, sikundër ishte ai i qendrimit në Kosovë të forcave ushtarako-policore sërbe, i cili u anullua, gjë që e theksoi edhe zoti Klinton. Madje politikanët tanë, përfaqësues e mbështetës të UÇK-së, kishin mundësi ta shfrytëzonin edhe atë deklaratë të zotit Klinton. Ata patën shansin dhe momentin të deklaroheshin se Marrveshja e Rambujesë ka rënë nga fuqia, pasi u bë gjakderdhje e madhe pas atij nënshkrimi. Mund të thoshnin se ne nënshkruam për të mos u bërë gjakderdhje, por ky pakt u shkel e të tjera, e të tjera. Në luftë, ose do të më vrasësh, ose do të të vras. Në diplomaci, ose do të ma hedhësh, ose do të ta hedh. Të dyja janë hile "të pranuara", kjo dihet. Zhvillimi i ngjarjeve, ishte asokohe i favorshëm për politikanët tanë. Por…, përse s'i bënë hapat e duhur, përse

nuk i shfrytëzuan shanset? Ata e dinë. Me kë u konsultuan, ata e dinë. Përderisa ata, antarët e delegacionit kosovar dhe nënshkruesit e Rambujesë nuk pranojnë sot e gjithë ditën, të thonë: ai nënshkrim ka patur edhe pasoja të dëmshme për Kosovën, të lind e drejta të dyshosh për shumë gjëra. Historia do t'i tregojë të tëra.

Këto e të tjera fakte skandaloze, kuptohet se duhet të trajtohen nga stiudiuesit dhe historianët. Këtu, vetëm sa i cekëm, për t'iu treguar juve, se populli ka filluar t'i njohë mirë politikanët e të dy krahëve në Kosovë, ndaj dhe rrebeloi e do të rrebelojë sa kohë që ata do të mundohen ta mashtrojnë.

Për këto arsye, zoti Kadare, nuk kanë vlerë deklaratat e këtyre lloj politikanëve, pasi ai shpërthim revolte në Kosovë erdhi si rrjedhojë e politikës së gabuar të deritashme të UNMIK-ut, LDK-së, AAK-së dhe PDK-së, në mënyrë të veçantë kundër ish - luftëtarëve dhe familjeve të tyre, që janë lënë pa asnjë mbështetje, pa punë dhe dënohen me gjyqe farsë. Atje duhen kërkuar shkaqet dhe jo te "ekstremistët" dhe "adoleshentët". Popullit i dhimbsen ish luftëtarët. Unë e di që juve e dini dhe i keni thënë këto jo vetëm një herë, por, ju lutem, bëni diçka që ta marrin vesh edhe ata liderët...

Zoti Kadare! U mundova t'iu sillja një mori faktesh dhe argumentesh, për të dalë në përfundimin se liderët e meritojnë të quhen të tillë kur ata janë në gjendje të dallojnë sfidat që ende nuk janë të dukshme për bashkëkohësit e vet. Në të kundërt, vetëm liderë nuk mund të quhen.

Ndoshta, herë pas here, mund të jem shprehur edhe ashpër, dhe për këtë u kërkoj ndjesë, por më ngushëllon fakti që është një Ismail Kadare, i cili dikur ka thënë: E vërteta është e hidhur, por të shëron.

F U N D

Prishtinë, prill - shtator 2004

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5
EDHE TI KADARE E MOHOVE UÇK – në!?... 15
“MJEKIMI” I GJENDJES 23
VARFËRIA EKSTREME E SHQIPTARËVE DHE ZOTNILLËKU I SERBËVE 27
PUSHTETI PARALEL SERB NË KOSOVË 35
KUSH UA KRIJOI MUNDESINË KRIMINELËVE SERBË TË “ARRATISESHIN” NGA BURGJET? 37
“NGUCJE NGA EKSTREMISTËT NOSTALGJIKË KOMUNISTË” (?!...) 39
POLITIKA E HAPUR ME POPULLIN, VETËM AJO TË NXJERR NË DRITË 47
MOSPËRGJEGJËSITË DHE ABUZIMET E POLITIKANËVE DHE QEVERITARËVE E REVOLTOJNË POPULLIN, I CILI U KA DHËNË ATYRE VOTËN 53
KUSH I DOGJI KISHAT? 65
DEMONSTRUESIT ME GURË – USHTRIA ME PLUMBA 73
PËRKUSHTIMI PËR TË DËNUAR ISH - LUFTËTARËT E UÇK - së 79
INSTITUCIONI I DORËHEQJES 83
KTHESA E KADARESË 89
MJEGULLNAJA RRETH UÇK - së 91
KUSH DHE SI E MASHTRUAN KADARENË PËR UÇK - në 95
LUFTA ÇLIRIMTARE DHE NDARJA E POPULLIT 99
KU QENDRONTE EPËRSIA E LUFTËS SONË ÇLIRIMTARE? 105
DILEMA: KUSH E ÇLIROI KOSOVEN ?111
VËLLEZËR ARMIQ, VËLLEZËR TË ARMIQËSUAR, APO AS NJËRA DHE AS TJETRA? 165
PREKJA E SIMBOLEVE TË KOMBIT 179
VETVENDOSJE, APO PAVARËSI? 181
OPINIONI I KLASËS POLITIKE SHQIPTARE DHE AI I PUBLIKUT PËR NGJARJET E MARSIT 201
PËRMBAJTJA 211

Goxhai, Dilaver (Shpëtim Golemi)
Kaq shpejt e harrove UÇK-në, Kadare, refleksione;
Red. Apostol Duka - Tiranë.
SHB “Labova”

ISBN:
Format:
Shtypur në shtypshkronjën “Skrola”, Shtimje.
Kosovë, 2004.1111

© Pashtriku.org, Mars'2012